

Asllan Hamiti



Gjuhë shqipe

**PËR KLASËN VI
TË ARSIMIT FILLOR
NËNTËVJEÇAR**

Gjuhë shqipe për klasën VI të arsimit fillor nëntëvjeçar

Autor:

Asllan Hamiti

Recensentë:

Ismet Osmani

Nevajet Isaki

Arlinda Pasholli - Sharofi

Lektore:

Ajten Qamili

Redaktor profesional:

Refail Sulejmani

Redaktor:

Refail Sulejmani

Redaktimi grafik dhe teknik: Vesna Depinovska – ARS STUDIO

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2023

Botues:

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut
rruga "Shën Kirili dhe Metodi", nr. 54, 1000, Shkup

Shtypi: Evropa 92 - Koçan

Tirazhi: 6845

Me vendim për miratimin e këtij teksti mësimor në lëndën Gjuhë shqipe për klasën VI të arsimit fillor nëntëvjeçar nr. 26-2147/1 të datës 04. 09. 2023 i miratuar nga Komisioni Kombëtar i Teksteve Mësimore.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:811.18(075.2)

HAMITI, Asllan

Gjuhë shqipe për klasën VI të arsimit fillor nëntëvjeçar / autor
Asllan Hamiti. - Shkup : Ministria për arsim dhe shkencë e Republikës së
Maqedonisë së Veriut, 2023. - 236 стр. : илустр. ; 29 см

ISBN 978-608-273-575-7

COBISS.MK-ID 61716485



Përmbajtja

Prejardhja e gjuhës shqipe	6
Shkrimet e para të gjuhës shqipe	8
Komunikimi dhe gjuha	12
Komunikimi dhe llojet e tij	15
Gjuhësia dhe degët e saj	18
Klasifikimi i tingujve	22
Rregullat drejtshkrimore për përdorimin e ë-së fundore	26
Ndarja e bashkëtingëlloreve sipas shkallës së zëshmërisë	29
Ndërrimet fonetike	32
Ndikimi i tingujve mbi njëri-tjetrin	32
Zëshmimi dhe shurdhimi i bashkëtingëlloreve	34
Rregullat drejtshqiptimore e drejtshkrimore në lidhje me ndërrimet fonetike	36
Drejt-përdorimi i bashkëtingëlloreve të zëshme e të shurdhëta	38
Përshtatja në zëshmëri e bashkëtingëlloreve sh, zh, ç nistore me tingujt që vijnë pas	40
Theksi	42
Vendi i theksit në fjalët e gjuhës shqipe	44
Rregullat e theksimit të fjalëve	45
Pjesët e ligjëratës	51
Emri	54
Kategoritë gramatikore të emrit	60
Numri i emrit	63
Trajta e emrit	66
Rasat e emrit	67
Mbiemri	72
Kategoria e rasës të mbiemrat	76
Kategoria e shkallës të mbiemrat	77
Përemri vetor	80
Trajtat e shkurtra të përemrit vetor	82
Përemri dëftor	83



Folja	86
Kohët e foljeve	88
Fjala	96
Fjala dëftore	97
Fjala pyetëse	98
Fjala nxitëse	99
Fjala dëshirore	100
Gjymtyrët kryesore të fjalisë (kryefjala dhe kallëzuesi)	102
Kryefjala	104
Kallëzuesi	105
Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën	106
Fjala e thjeshtë	108
Përcaktori	111
Llojet e përcaktorëve	112
Kundrinori	114
Kundrinori i drejtë	114
Kundrinori i zhdrejtë	115
Rrethanori	119
Leksikologjia	123
Kuptimi leksikor i fjalëve	124
Fjalët me një kuptim dhe fjalët me shumë kuptime	125
Kuptimi konkret dhe abstrakt i fjalëve	128
Gjuha shqipe dhe kompjuteri	130
Sinonimet, homonimet dhe antonimet	132
Fjalët e parme, të prejardhura dhe të përbëra	137
Përdorimi i shkronjave të mëdha	146
Përdorimi i shenjave të pikësimit	150
Përdorimi i vizës	154
Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit	156
Përdorimi i drejtë i apostrofit	158
Si të flasim dhe si të shkruajmë mirë?	161
Ndarja e letërsisë	162
Lirika	165
Veçoritë e poezisë	166
Strofa dhe llojet e saj	168
Rima	170
Poezia atdhetare (patriotike)	171
Poezia e peizazhit	172
Bagëti e bujqësia	173
Figurat stilistike	176



Epika	178
Legjenda ose gojëdhëna	179
Liqeni i luleve	179
Rozafa	180
Guri i skënderbeut	182
Përralla	183
E bija e mbretit dhe trëndafilat	183
Miti	184
Përbindëshi i bistricës	184
Tregimi	185
Një natë në Stamboll	186
Novela	187
Oxhaku	187
Romani	189
Afërdita	189
Romani aventurier	191
Don Kishoti pret me shpatë kokën e viganit...	191
Personazhi	193
Dy vëllezërit	194
Luli i vocërr	195
Fabula, tema dhe ideja e veprës epike	196
Lumi i vdekur	196
Narratori (rrëfyesi)	200
Malësorja	201
Kompozicioni i veprës epike	203
Bukuria që vret	204
Dramatika	206
Romeo e Zhulieta	207
Drama	209
Emira	209
Komedia	212
Koprraci	212
Tragjedia	214
Antigona	214
Të shprehurit dhe krijimtaria	217
Tregimi pa mend	218
Ritregimi (me gojë dhe me shkrim)	219
Ujku	219
Përshkrimi (me gojë e me shkrim)	221
Fshati im	223
Gazetaria	225
Liria e shprehjes dhe sjellja etike në mjedisin digjital	230
Stereotipet dhe gjuha e urrejtjes në media dhe në rrjetet sociale	233

PREJARDHJA E GJUHËS SHQIPE

Do të mësojmë për:

Prejardhjen e Gjuhës shqipe.

Do të dimë:

Për prejardhjen e Gjuhës shqipe.

Në botë sot fliten rreth 7.000 gjuhë e dialekte. Për shkak të prejardhjes së përbashkët ato formojnë 20 familje gjuhësh. Gjuhët indoeuropiane formojnë një familje gjuhësore, e cila përfshin një numër të madh gjuhësh të gjalla e të vdekura, që kanë afri dhe bashkëpërkime të shumta ndërmjet tyre në fjalor, në fonetikë dhe në gramatikë. Ato rrjedhin nga një gjuhë e përbashkët që quhet gjuha mëmë indoeuropiane dhe shtrihen në Europë dhe në një pjesë të madhe të Azisë e të Indisë. Për këtë arsye kjo familje gjuhësore quhet indoeuropiane. Gjuhët indoeuropiane klasifikohen në 10 grupe a degë gjuhësore.

Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoeuropiane. Në dallim nga shumica e gjuhëve të përafërta që formojnë grupe gjuhësore, shqipja formon degë të veçantë, të mëvetësishme në këtë familje gjuhësore.



Shqipja i ka ruajtur tiparet themelore të trashëguara nga gjuha mëmë indoeuropiane, si në fonetikë, në gramatikë (në morfologji e leksik). Ajo nga kjo kohë e lashtë ka trashëguar rreth 2.500 fjalë, si: *ditë, natë, dimër, ujk, ujë, punë, zemër, i lehtë, i thellë, i rëndë, jam, kam, bie, ha, pi* etj. Mirëpo, në rrjedhë të shekujve është zhvilluar dhe ka pësuar ndryshime.


Sipas klasifikimit gjeografik, shqipja bën pjesë në gjuhët ballkanike, bashkë me greqishten, maqedonishten, bullgarishten, arumanishten, turqishten ballkanike dhe të folmet e serbishtes jugore. Gjuhët ballkanike, përveç shumë fjalëve të përbashkëta, kanë krijuar edhe disa tipare të përbashkëta fonetike e gramatikore.

Ka disa teori për prejardhjen e Gjuhës shqipe: se shqipja rrjedh nga pellazgishtja, ilirishtja, trakishtja, iliro-trakishtja etj. Por, deri më tani mbizotëron mendimi se Gjuha shqipe rrjedh nga ilirishtja, ndërsa shqiptarët janë pasardhës të ilirëve. Sipas një studimi të ri, gjuha shqipe dhe populli shqiptar janë të paktën 6 mijë vjet të vjetër dhe autoktonë në këto troje.

Zgjerohet diturinë nga interneti

Lidhuni në internet në adresën: <https://www.portalishkollor.al/argetim/vendi-i-shqipes-ne-familjen-e-gjuheve-indoeuropiane> dhe mësoni më shumë për këtë temë.





Gjuha mëmë indoeuropiane
Pema gjuhësore indoeuropiane

Detyrë



Shikojeni pemën gjuhësore indoeuropiane. Çfarë vëreni në të?

Në pikëpamje historike, Gjuha shqipe mund të ndahet në katër periudha:

- ilirishtja** (shqipja arkaike, nga parahistoria deri në shek. VII);
- shqipja e vjetër** (në shekujt VIII-IX);
- shqipja e mesjetës**, që quhet edhe **abërishte** (në shekujt X-XII);
- shqipja e re** (nga shek. XVIII e deri në ditët tona).

Në **shqipen e re** dallojmë tri faza zhvillimi:

- periudha e Pararilindjes (shek. XVIII);
- periudha e Rilindjes (afërsisht periudha midis viteve 1820-1920), dhe
- faza e shqipes së sotme (pas vitit 1920 e deri më sot).

Shqipja mund të degëzohet edhe në:

- periudhën Parakombëtare (që nga Gjon Buzuku - shek. XVI e deri më vitin 1920) dhe
- periudhën Kombëtare (nga Rilindja e këtij, përkatësisht nga viti 1920 e deri më sot).

Mendoni dhe përgjigjuni

- Në cilën familje gjuhësh bën pjesë Gjuha shqipe?
- A është e vjetër Gjuha shqipe?
- Nga rrjedh Gjuha shqipe?



SHKRIMET E PARA TË GJUHËS SHQIPE

Do të mësojmë për:

shkrimet e para të Gjuhës shqipe.

Do të dimë:


dokumentet e para të shqipes së shkruar.

Shqipja është një nga gjuhët më të vjetra, por e dokumentuar me shkrim mjaft vonë, në shekullin XV. Shkrimet e para të Gjuhës shqipe i quajmë edhe dëshmi të para të shkrimit të shqipes, dokumente të para të shqipes, sepse me to zë fill (nis, fillon) të shkruhet Gjuha shqipe.

Dokumentet e para të shqipes së shkruar janë:

1. Formula e Pagëzimit (1462);
2. Fjalorthi i Arnold fon Harfit (1497) dhe
3. Perikopeja e Ungjillit (fundi i shek. XV - fillimi shek. XVI).

Dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe është “Formula e pagëzimit”, e vitit 1462. Kjo është një fjali e shkurtër në gjuhën shqipe **“Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit”** (në shqipen e sotme: Unë të pagëzoj në emrin e t’Atit e të birit të shpirtit të shenjtë) që gjendet në një qarkore të shkruar në latinisht prej 37 faqesh, nga Kryepeshkopi i Durrësit, Pal Engjëlli, bashkëpunëtor i ngushtë i Skënderbeut. Këtë formulë të përkthyer në shqip mund ta përdornin prindërit për të pagëzuar fëmijët e tyre, në rastet kur nuk kishin mundësi t’i dërgonin në kishë, ose kur nuk kishte prift. Formula është shkruar me alfabetin latin dhe në dialektin e veriut (gegërisht).



Formula e Pagëzimit, pati rëndësi praktike për t’ua lënë emrin foshnjave në familjet shqiptare të krishtera; ndërsa sot, si dokumenti më i vjetër i shkruar shqip, ka rëndësi për historinë e gjuhës dhe kulturën shqiptare.

Dokumenti i dytë, i shkruar në gjuhën shqipe është **“Fjalorthi i Arnold fon Harfit”**. Udhëtari gjerman Arnold fon Harf në vitin 1496, u nis nga Kelni (Gjermania), për të bërë një vizitë në tokat e shenjta, në Palestinë. Në vitin 1497 ai kaloi nëpër bregdetin e Shqipërisë, duke qëndruar në Ulqin, Durrës e Sazan. Gjatë këtij udhëtimi për të komunikuar sadopak me njerëzit, ai shënoi 26 fjalë shqipe, 8 shprehje e numrat 1 deri 10 dhe 100 e 1000 të shoqëruar me përkthim në gjermanisht.

Perikopeja e Ungjillit (të Pashkëve ose e Pashkës) është dokumenti i tretë i shkruar shqip me shkronja greke. Ky është një përkthim çamërisht (shqip) i një pjese të Ungjillit sipas Mateut, që këndohet për Pashkë. Ai i përket fundit të shekullit XV ose fillimit të shekullit XVI. Dokumenti ka rëndësi si dëshmi për kohën, i shkruar toskërisht.

Mendohet me të drejtë se shqipja duhet të jetë shkruar shumë më herët sesa shekulli XV. Mbetet detyrë për gjeneratat e reja të hulumtojnë nëpër arkivat dhe bibliotekat e vjetra për të zbuluar shkrime edhe më të moçme të shqipes si dhe për të bërë gjurmime arkeologjike për të gjetur dëshmi të reja të ilirishtes, e të shqipes së vjetër.

Zgjerohet diturinë nga interneti

Për dokumentet e Gjuhës shqipe më gjerësisht mund të lexoni në internet në adresën: https://www.wikiwand.com/sq/Dokumentet_e_Gjuhes_Shqipe.



Libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe, që njohim deri më sot, është **“Meshari”** i Gjon Buzikut, i vitit 1555. Kjo vepër është përkthim nga latinishtja (e italishtja) në shqip i një libri me pjesë liturgjike, për t’u përdorur nga priftërinjtë që vepronin në trojet shqiptare gjatë shërbesave të tyre.

Buzuku e shqipëroi këtë libër në gegërishten veriore, me alfabetin latin të plotësuar me disa shkronja cirilike për të shënuar tingujt që i ka shqipja (si: q, gj, th, dh, z, x etj). e që mungojnë në latinishten. Këtë alfabet do ta përdorin edhe shumë autorë pas tij, me ndonjë ndryshim të vogël.

“Meshari” ka rëndësi të jashtëzakonshme për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Në të e gjejmë shqipen e shkruar të shekullit XVI, me gjithë pasurinë e saj fonetike, gramatikore e leksikore. Ky libër shënon edhe fillimin e letërsisë së vjetër shqiptare. Gjuha e përpunuar e këtij libri dëshmon se duhet të ketë edhe vepra të tjera të mëhershme të shkruara shqip.



Detyrë



Në kolonën e parë janë dhënë disa fjalë e grupe fjalësh nga “Meshari” i Gjon Buzukut. Në kolonën e dytë shënoni formën e fjalës të të folmes tënde dhe në kolonën e tretë formën e gjuhës letrare.

<i>Gjuha e Buzukut</i>	<i>E folmja ime</i>	<i>Gjuha standarde</i>
tue u kujtuom		
gluha		
me ditunë		
me zditunë		
mendetë		
atyne		
ta duonë		
kini me gjegjunë		
ka me klenë me ju		
tue ndjekunë		
tue bam		
vepërënë teme		
ndë kallënduor		
mbë gluhët tanë		



Lexoni këto vargje të shkëputura nga poezia “Gjuha Shqipe”, shkruar nga Gjergj Fishta (1871-1940). Çfarë na thotë autori?

GJUHA SHQIPE

*Pra, mallkue njai bir Shqyptari,
 qi këtë gjuhë të Perëndis',
 trashigim, që na la i Pari,
 trashigim s'ia len ai fmis;
 edhe atij iu thaftë, po, goja,
 që përbuzë këtë gjuhë hyjnore;
 qi n'gjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,
 flet e t'veten e lën mbas dore.*

*Në gjuhë shqype nanat tona
 qi prej djepit na kanë thânun,
 se asht një Zot, qi do ta dona;
 njatë, qi jetën na ka dhânun;
 edhe shqyp na thanë se Zoti
 për shqyptarë Shqyppinë e fali,
 se sa t'enden stina e moti,
 do ta gzojn kta djalë mbas djali.*



Përforcim në formë të kuizit (garës)



Nxënësit ndahen në dy grupe. Ata duhet të kenë në dispozicion 10 minuta për të diskutuar dhe për t'u marrë vesh cili nxënës për cilën pyetje do të përgjigjet pa lexuar në libër. Çdo përgjigje e plotë dhe e saktë vlerësohet me 2 pikë, përgjigjja gjysmake dhe pjesërisht e saktë me 1 pikë, ndërsa përgjigjja e pasaktë ose mospërgjigjja me 0 pikë. Pyetja pa përgjigje e njërit grup i kalon grupit tjetër. Mësimdhënësi shënon pikët në tabelë. Në fund mblidhen pikët dhe shpallet grupi fitues.

GRUPI A	GRUPI B
1. Sa gjuhë e dialekte tani fliten në botë?	1. Sa familje gjuhësh formojnë gjuhët e botës?
2. Pse quhen gjuhë të gjalla e gjuhë të vdekura?	2. Në cilat fusha kanë afri dhe bashkëpërkime gjuhët indoeuropiane?
3. Nga cila gjuhë e përbashkët burojnë gjuhët indoeuropiane?	3. Ku fliten gjuhët indoeuropiane?
4. Në sa grupe a degë gjuhësore klasifikohen gjuhët indoeuropiane?	4. Në cilën familje gjuhësore bën pjesë Gjuha shqipe?
5. A ka ruajtur Gjuha shqipe tiparet themelore të trashëguara nga gjuha mëmë indoeuropiane. Në cilat fusha?	5. Sa fjalë ka trashëguar shqipja nga gjuha mëmë indoeuropiane?
6. A bën pjesë shqipja në gjuhët ballkanike? Pse?	6. Cilat janë gjuhë ballkanike?
7. Cilat janë teoritë e prejardhjes së Gjuhës shqipe?	7. Prej nga rrjedh Gjuha shqipe?
8. Cilat janë katër periudhat historike të Gjuhës shqipe?	8. Cilat janë tri fazat e shqipes së re?
9. Kur fillon e kur mbaron periudha Parakombëtare?	9. Kur fillon e kur mbaron periudha Kombëtare?
10. Shqipja është gjuhë e re apo e vjetër? Pse?	10. Kur ka filluar të shkruhet Gjuha shqipe?
11. Cilat janë dokumentet e para të shqipes së shkruar?	11. Cili është dokumenti i parë i Gjuhës shqipe?
12. Cili është dokumenti i dytë i Gjuhës shqipe?	12. Cili është dokumenti i tretë i shkruar shqip?
13. Cili është libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe? Kush e ka shkruar dhe kur?	13. Çfarë dini për "Mesharin" e Gjon Buzukut?
14. Në qoftë se do të gjenit ndonjë shkrim të vjetër të shqipes, çfarë do të bënit me të?	14. Çfarë rëndësie kanë dokumentet e para të shqipes së shkruar?
15. Çfarë do të thoni diçka tjetër që nuk u tha deri më tani lidhur me prejardhjen e Gjuhës shqipe?	15. Çfarë do të thoni diçka tjetër që nuk u tha deri më tani lidhur me shkrimet e para të shqipes?
Gjithsej pikë	Gjithsej pikë



KOMUNIKIMI DHE GJUHA

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> komunikimin; skemën e komunikimit dhe elementet kryesore: dhënësi, mesazhi, marrësi. 	<ul style="list-style-type: none"> të shpjegojmë konceptin e komunikimit; skemën e komunikimit dhe elementet e tij.

Çdo ditë i dëgjojmë fjalët *komunikoj dhe komunikim*. Por, a keni menduar çfarë domethënie kanë këto fjalë?

Fjala *komunikoj* domethënë shkëmbej mendime apo informacione me dikë; ndërsa *komunikimi* është një ndër veçoritë më të rëndësishme të njeriut me anë të të cilit shkëmbehen dhe kuptohen informacionet midis dy a më shumë njerëzve.


Pra, ne çdo ditë marrin dhe japin informacione, të cilat na nevojiten në jetën tonë të përditshme. Disa nga këto informacione i marrim dhe i japim me ndihmën e sinjaleve të thjeshta, siç është për shembull *drita e kuqe e semaforit*, që do të thotë “ndal”, ose *lëvizja e dorës*, që do të thotë “mirupafshim”, apo *tingëllimi i borisë së një makine*, që do të thotë “më lini të kaloj”. Megjithatë, pjesa më e madhe e informacioneve merren me ndihmën e komunikimit nëpërmjet të folurit.

Por, mbi të gjitha duhet mbajtur në mend se çdo lloj i komunikimit arrihet vetëm atëherë kur pjesëmarrësit i interpretojnë shenjat në mënyrë të njëjtë. Nëse ky sistem shenjash, me anë të të cilit komunikojmë, shprehet nëpërmjet të folurit, atëherë kjo nënkupton që të dy palët duhet ta njohin atë gjuhë.



Skema e komunikimit dhe elementet kryesore

Gjatë procesit të komunikimit ne zbatojmë një skemë të caktuar, ku kemi gjithmonë një **dhënës** i cili ka një **mesazh** dhe të cilin duhet ta përçojë te **marrësi**. Por, që mesazhi të përçohet me sukses, duhet të ekzistojë një **kod**, i cili mund të jetë gjuhësor (verbal) dhe jogjuhësor (joverbal). Veç këtyre, duhet doemos të ekzistojë një **kanal** komunikimi, i cili ndodhet ndërmjet dhënësit dhe mesazhit, mesazhit dhe marrësit. Nëse dhënësi jep mesazhin nëpërmjet të folurit, kanal janë fjalët e shqiptuara, ndërsa për marrësin kanal është të dëgjuarit. Në fund, duhet të ekzistojë edhe një element që quhet **referenti**, e që në fakt është objekti apo tema e komunikimit.



Detyrë



Lexoni mesazhin dhe plotësoni skemën e komunikimit për secilin mesazh me dhënësin dhe marrësin përkatës.

dentisti	nxënësit
mësimdhënësi	shoferi
blerësi	pacienti
polic i trafikut rrugor	shitësi

Dhënësi	Mesazhi	Marrësi
	Hapni librat e Gjuhës në faqen 34!	
	Lidhe rripin e sigurimit!	
	Dua një kilogram domate.	
	Dhëmballa juaj është e prishur!	

Detyrë



Ndërto skemën e një komunikimi gjuhësor. Vendosi elementet në vendet përkatëse.

Sot do të lexojmë një poezi të bukur.




Dhënësi	_____	✓ të folurit,
Kanali	_____	✓ sot do të lexojmë një poezi të bukur
Mesazhi	_____	✓ mësuesja
Kanali	_____	✓ të dëgjuarit
Marrësi	_____	✓ nxënësit
Kodi	_____	✓ poezia
Referenti	_____	✓ gjuha e folur

KOMUNIKIMI DHE LLOJET E TIJ

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> llojet e komunikimit: komunikimi verbal dhe joverbal, treguesit, sinjalet, shenjat. 	<ul style="list-style-type: none"> të dallojmë komunikimin verbal dhe atë joverbal; të bëjmë dallimin ndërmjet treguesit, sinjalit dhe shenjës.

Ndër llojet më të rëndësishme të komunikimit janë: **komunikimi verbal (gjuhësor)** dhe ai **joverbal (jogjuhësor)**.



Komunikimi verbal

Komunikimi verbal është lloji i komunikimit, ku mesazhi transmetohet përmes *fjalëve të shqiptuara* ose komunikimit me gojë dhe *fjalëve të shkruara* ose komunikimit me shkrim.

Për të pasur komunikim verbal ne duhet të zhvillojmë katër aftësitë gjuhësore: *të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit* dhe *të lexuarit*. Në këtë komunikim, dhënësi e përdor gjuhën në mënyrë aktive – flet ose shkruan, ndërsa marrësi e përdor gjuhën në mënyrë pasive – kur dhënësi flet, marrësi dëgjon; kur dhënësi shkruan, ai lexon.

Kur komunikojmë me gojë folësi flet, pra prodhon tinguj. Tingujt kur bashkohen formojnë fjalë dhe këto e përbëjnë mesazhin. Tani mesazhi, nëpërmjet valëve të zërit shkon te dëgjuesi apo marrësi dhe ky e pranon me anë të dëgjimit.

Këtu, dhënësi i mesazhit u jep fjalë ndjenjave, mendimeve, ideve dhe i shpreh ato në formën e fjalimeve, diskutimeve, prezantimeve dhe bisedave. Komunikimi verbal është i drejtpërdrejtë, ndërsa efektiviteti i tij varet nga qartësia e fjalës, volumi, shpejtësia dhe cilësia e fjalëve të përdorura në bisedë. Në rastin e komunikimit verbal, reagimet janë të menjëhershme pasi që ka një transmetim në kohë reale dhe marrje të mesazhit nga dhënësi te marrësi.

Kur kemi komunikim me shkrim, shkruesi shkruan dhe mesazhi shkon te lexuesi apo marrësi. Në këtë rast, kanal i transmetimit të mesazhit është shkrimi. Këtu, shkronjat grupohen në fjalë dhe krijojnë mesazhin, ndërsa lexuesi apo marrësi e merr atë duke i lexuar fjalët e shkruara nga dhënësi. Tani komunikimi nuk është i drejtpërdrejtë, por i tërthortë.

Komunikimi joverbal

Komunikimi joverbal është informacion ose emocion që shprehet pa ndihmën e gjuhës së folur. Ai mund të realizohet nëpërmjet këtyre kanaleve: shikimit, dëgjimit, nuhatjes, prekjes dhe shijes. Përdor lloje të ndryshme shenjash, si: tinguj jo të artikuluar, zhurma, gjeste, shprehje të fytyrës, vizatime, imazhe, drita, ngjyra etj.

Krahasuar me gjuhën e folur, gjuha joverbale është më pak e kontrollueshme, por njëkohësisht më e fuqishme, pasi bart me vete shumë emocione dhe ndjenja, të cilat shpesh është e pamundur t'i shprehim me fjalë. Këtë informacion për gjendjet tona të brendshme ne e marrim nga cilësia e zërit, kontakti i syve, shprehjet e fytyrës, gjestet, lëvizjet e trupit etj.

Komunikimi joverbal arrihet nëpërmjet dukurive dhe veprimeve jogjuhësore, ndër të cilat mund t'i përmendim treguesit, sinjalet dhe shenjat.

Treguesit

- Nëse nga dritarja e dhomës shikojmë jashtë dhe shohim që pemët lëvizin – kuptojmë që fryn erë;
- Nëse shohim tym të dendur diku në lagje, kuptojmë që po digjet diçka;
- Nëse koha është e vranët me re të dendura - kuptojmë që së shpejti do të bjerë shi.

Nga shembujt e dhënë më sipër, mund të vimë në përfundim dhe të themi që **treguesit janë dukuri të rastit që tregojnë diçka, por nuk i drejtohen askujt.**

Shembuj të këtillë janë të shumtë dhe hasen çdo ditë. Çfarë do të kuptonit ju nëse do të vërenit këta tregues:

- Gjurmë këmbësh në një korridor të porsalarë;
- Gjurmë të një frenimi të fortë dhe copëza xhami të shpërndara në rrugë;
- Disa njerëz të veshur me xhakëtë dhe shall;
- Ylberi me ngjyrat e tij të bukura.

Thoni ju disa tregues dhe shpjegoni kuptimin e tyre.



Sinjalet

Nëse jemi para një semafori, duke shkuar në shkollë, shuhet drita e kuqe dhe ndizet drita e gjelbër për këmbësorë. Çfarë tregon ky sinjal dhe kujt i drejtohet?

Sigurisht që e dini: ai tregon që lejohet kalimi i rrugës dhe i drejtohet kalimtarit.

Ja edhe disa sinjale të tjera:

- Llamba e verdhë pulsuese e makinës;
- Zilja e shkollës;
- Zëri i autoambulancës.

Nga shembujt e dhënë më sipër, mund të vijmë në përfundim dhe të themi që **sinjalet, në dallim nga treguesit, janë shenja të caktuara sipas një marrëveshjeje të vendosur më parë, e që u drejtohen njerëzve.**

Vazhdoni listën e mësipërme dhe tregoni kuptimin e çdo sinjali.



Shenjat

Dikush ju pyet nëse do të shkoni në kinema. Ju, në vend që t'i përgjigjeni me gojë, i përgjigjeni me lëvizjen e kokës nga lart-poshtë. Çfarë tregon kjo shenjë te ne? Tregon që e pranon ftesën për të shkuar në kinema.

Por, mund t'i përgjigjeni edhe duke lëvizur kokën majtas-djathtas. Kjo shenjë te ne tregon që ju nuk e pranoni ftesën.

Në disa vende të tjera këto shenja kanë kuptimin e kundërt. Pra, edhe kuptimi i shenjave vendoset me marrëveshje nga njerëzit.

Ja edhe disa shenja të tjera: shenjat e pikësimit, shenjat e komunikacionit, shenjat që përdoren në matematikë etj.

Nga shembujt e dhënë më sipër, mund të vimë në përfundim dhe të themi që **shenjat janë gjestet, figurat, vizatimet etj., që përdoren për të na treguar a për të na kujtuar diçka.**

Komunikimi joverbal ka rëndësinë e tij, sepse shërben si përforcues i komunikimit verbal. Megjithatë, në komunikimin e përditshëm të dy llojet e komunikimit ndërthuren mes tyre për të përçuar në mënyrë sa më të plotë informacionin nga dhënësi te marrësi dhe për t'u realizuar më mirë komunikimi.





GJUHËSIA DHE DEGËT E SAJ

Do të mësojmë për:

- gjuhësinë dhe degët e saj.

Do të dimë:

- degët kryesore të gjuhësisë.

Meqë gjuha është mjet kryesor për komunikim midis njerëzve dhe për zhvillimin e të gjitha shkencave e të mbarë shoqërisë, ajo ka filluar të studiohet qysh në kohët më të lashta të historisë së njeriut. Shkenca që merret me studimin e gjithanshëm të gjuhës quhet **gjuhësi** ose **linguistikë** (nga *lingua* = gjuhë), që do të thotë *shkencë mbi gjuhën*. Kjo shkencë i studion veçoritë e përgjithshme të të gjitha gjuhëve: lindjen dhe zhvillimin e tyre, ndryshimet që ndodhin etj. Degët kryesore të gjuhësisë janë: *fonetika*, *leksikologjia* dhe *gramatika*.

Fonetika është degë e gjuhësisë që studion tingujt e gjuhës, mënyrën e formimit të tyre, veçoritë akustike e fiziologjike, llojet e tingujve, ndryshimet që pësojnë tingujt në pozicione të ndryshme, theksin, intonacionin, rrokjen etj. Me fonetikën është i lidhur ngushtë edhe drejtshqiptimi ose ortoepia.

Leksikologjia po kështu është degë e gjuhësisë, e cila merret me studimin e fjalëve të një gjuhe. Fjala *leksikologji* vjen nga greqishtja dhe përbëhet nga fjalët *leksis* = fjalë dhe *logos* = dituri, që do të thotë shkencë mbi fjalët. Pra, leksikologjia, studion thesarin e fjalorit të një gjuhe, kuptimin e fjalëve, shprehjet frazeologjike etj.

Gramatika është dega më e rëndësishme e gjuhësisë, sepse ajo studion strukturën e gjuhës e kjo është ana më themelore e gjuhës. Fjala *gramatikë* vjen nga greqishtja *gramatechne* që do të thotë art i të shkruarit. Por, sot me këtë fjalë kuptojmë shkencën që merret me studimin e rregullave të ndryshme të fjalëve dhe të bashkimit të tyre në togfjalësh e në fjali. Gramatika ndahet në dy pjesë: në morfologji dhe sintaksë.

Morfologjia është ajo pjesë e gramatikës që merret me studimin e rregullave, sipas të cilave fjalët pësojnë ndryshime në fjali si dhe me klasifikimin e tyre nëpër klasa.

Sintaksa është pjesë e gramatikës që merret me studimin e rregullave të bashkimit të fjalëve në togfjalësh e në fjali dhe të fjalive në periudhë (fjali të përbërë).

Gjuhësia (Linguistika)

Fonetika

Fonologjia

Leksikologjia

Gramatika

Morfologjia

Sintaksa

Ushtrime ndërvepruese (interaktive)



Ushtrimi 1:

Nxënësit ndahen në grupe, u jepen ilustrime në të cilat ka mjete të ndryshme komunikimi, p.sh.: televizor, telefon, kompjuter dhe më pas u jepet detyrë të mendojnë se çfarë mesazhesh mund të përcillen nëpërmjet mjetit të paraqitur në ilustrim. Secili grup bën një prezantim të shkurtër para grupeve të tjera. Më pas fillon një diskutim me pyetje të synuara: Si quhet procesi në të cilin bëhet shkëmbimi i mesazheve /informatave? Çfarë përdoret si mjet për të përcjellë mesazhet? A përdoret vetëm fjalë? A përdoren gjeste dhe mimika të fytyrës? Si quhet ai që e dërgon mesazhin dhe si quhet ai që e merr (pranon) mesazhin? Nxënësit në grupe, duke përdorur teknikën Kalavesh, i paraqesin elementet bazë të komunikimit.



Ushtrimi 2:

Nxënësit punojnë në çifte. Shikojnë fotografi dhe imazhe të ndryshme të shenjave që i përdorim çdo ditë (gjethe të verdha, pëllumb me një degë ulliri në sqep, zile shkolle, makinë e zbukuruar me lule, gjurmë shpute në plazh, semafor). Nën çdo foto/imazh, nxënësit duhet të shkruajnë se çfarë mesazhi është dërguar dhe si i është dërguar ky mesazh marrësit. Zhvillohet bisedë rreth asaj se çfarë është shenja, cili është roli i saj dhe cilat nga shenjat nga ana e dërguesit janë dërguar me një qëllim të caktuar dhe cilat janë dërguar pa qëllim të paracaktuar. Më pas, nxënësit në çifte i radhisin shenjat nga shembujt në dërrasën e zezë në një tabelë të ndarë në dy kolona: sinjale dhe shenja. Disa prej çifteve e prezantojnë tabelën me shenjat e radhitura (sinjale dhe shenja) përpara gjithë klasës. Në fund, tabela plotësohet edhe me shembuj të tjerë të komunikimit me simbole.





Ushtrimi 3:

Nxënësve u prezantohen lloje të ndryshme të komunikimit përmes fotove, videove, inserteve. Nxënësit i identifikojnë dhe i shpjegojnë përmes diskutimit llojet e ndryshme të komunikimit nga prezantimi i bërë. Më pas ndahen në grupe. Secili grup krijon dhe prezanton nga një shembull për lloje të ndryshme të komunikimit me figura dhe me fjalë. Grupet e tjera dëgjojnë dhe plotësojnë me shembuj të tyre.

Përforcim



1. Ç'është komunikimi?
2. Cilat janë elementet kryesore të komunikimit?
3. Cilat janë llojet më të rëndësishme të komunikimit?
4. Çfarë është komunikimi verbal?
5. Në çfarë formash transmetohet ai?
6. Si zhvillohet komunikimi me gojë?
7. Si zhvillohet komunikimi me shkrim?
8. Si arrihet komunikimi joverbal?
9. Çfarë janë treguesit, sinjalet dhe shenjat?
10. Cilat janë degët e gjuhësisë?
11. Vëreni figurat dhe dalloni cilat janë tregues, cilat sinjale e cilat shenja.



12. Çfarë informacioni mund të nxirrni nga treguesit e mëposhtëm?



13. Thoni disa nga sinjalet e zëshme që përdoren shpesh në jetën e përditshme.

- Ç'tregon zëri i pandërprerë i burisë së makinës së urgjencës?
- Po, rënia e ziles në shkollë?
- Çfarë tregojnë dritat e semaforit: e kuqja, e verdha dhe e gjelbra?
- Çfarë tregon drita vezulluese e zjarrfikëses?

Përforcim**14. Çfarë shenjash me dorë do të përdorim për t'i thënë dikujt:**

Afrohu! Ndal! Ik! Ulu! Ngrihu!

Me çfarë lëvizje të kokës pohojmë e me çfarë mohojmë diçka?

**15. Situatë:**

Merita: *Drita, a do të vish në teatër?*

Vëreni figurën.

Kush po flet në telefon?

Kush është bashkëbiseduesi?

Cili është mesazhi që dërgon Merita?

Si e dërgon (cili është mjete i komunikimit)?



KLASIFIKIMI I TINGUJVE

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> klasifikimin e tingujve (në zanore dhe në bashkëtingëllore). 	<ul style="list-style-type: none"> se ç'është tingulli; të dallojmë tingullin nga shkronja; të bëjmë ndarjen e tingujve në zanore dhe në bashkëtingëllore; të identifikojmë dhe të bëjmë dallimin e tyre; se me tinguj krijojmë fjalë.

Njerëzit komunikojnë me anë të gjuhës së folur dhe të gjuhës së shkruar. Gjatë të folurit, shqiptojmë tinguj njërin pas tjetrit me intonacion të caktuar. Të folurit e shkruajmë me shkronja (dore, shtypi, të vogla e të mëdha) dhe me shenja të pikësimit.

Me mënyrën e formimit të tingujve, me klasifikimin e tyre dhe me ndryshimet që pësojnë tingujt gjatë të folurit merret **fonetika**.

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Shqiptoni me zë tingujt:

- a) i, u, o, a, ë, y, e;
- b) t, p, k, f, m, n, d.
- A themi ndonjë gjë kur i shqiptojmë tingujt veç e veç?
- Po kur i bashkojmë tingujt në fjalë, si p.sh.: *nënë, libër, laps, shkollë* etj., a shprehim diçka?
- Çfarë dallimi vëreni ndërmjet tingujve të grupit **a** dhe tingujve të grupit **b**?

Shpjegim

Tingulli është njësi më e vogël e të folurit (ligjërimin), që nuk mund të ndahet më tej dhe kur përdoret i veçuar nuk ka kuptim të mëvetësishëm. Tingulli është pjesë e rrokjes që shqiptohet me një nyjtim.

- Shkronjat e grupit të parë (a) i lexojmë: i, u, o, a, ë, y, e;
- Shkronjat e grupit të dytë (b) i lexojmë: të, pë, kë, fë, më, në, dë.

Gjatë nyjetimit të tingujve të grupit **a** ajri del lirisht nga goja, pa ndonjë pengesë. Në shqiptimin e tingujve të grupit **b** krijohen pengesa. Tingujt e grupit **a** janë **zanore**, ndërsa tingujt e grupit **b** janë **bashkëtingëllore**.





Mbani mend



Tingujt e të folurit në të gjitha gjuhët, si edhe në gjuhën shqipe, ndahen në dy grupe të mëdha, në:

- a) **zanore** (vokale) dhe
- b) **bashkëtingëllore** (konsonante).

I quajmë zanore (za - zani; zan+ore) sepse mund të shqiptohen më vete, pa pasur nevojë për të nyjëtuar ndonjë tingull tjetër. I quajmë bashkëtingëllore (bashkë+tingull+ore) sepse nuk mund t'i artikulojmë si të mëvetësishme, por vetëm së bashku me ndonjë zanore para ose pas tyre.


Tanimë e dimë se zanoret mund t'i nyjëtojmë pa ndonjë tingull tjetër, ndërsa bashkëtingëlloret nuk shqiptohen më vete. Midis tyre ka edhe disa dallime të tjera:

1. Kur shqiptojmë zanore, ajri del lirisht nga goja pa hasur në pengesa në aparatit e të folurit. Kur shqiptojmë bashkëtingëllore ajri has pengesa në vende të ndryshme të gojës (buzë, gjuhë, dhëmbë, qiellzë etj.).
2. Zanoret janë të zëshme, ndërsa bashkëtingëlloret janë më pak të zëshme, përkatësisht janë zhurma.
3. Zanoret janë tinguj rrokjeformues, të cilat formojnë kulmin e rrokjes; ndërsa bashkëtingëlloret hyjnë në përbërjen e rrokjes, por ato vetvetiu (pa zanore) në gjuhën shqipe nuk mund të krijojnë rrokje. Andaj, numri i rrokjeve në fjalë përcaktohet nga numri i zanoreve. D.m.th. sa zanore ka në një fjalë, aq rrokje kemi në të.

Gjuha standarde shqipe ka 36 tinguj themelorë (fonema):

- a) 7 zanore: **a, e, ë, o, i, y, u**; dhe
- b) 29 bashkëtingëllore: **b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, j, k, l, ll, m, n, nj, p, q, r, rr, s, sh, t, th, v, x, xh, z, zh**.

Vendet e nyjëtimit të bashkëtingëlloreve në gjuhë të ndryshme: 1. dybuzoret, 2. buzore-dhëmboret (majedhëmboret), 3. ndërhdëmboret, 4. dhëmboret, 5. pasdhëmboret, 6. alveolaret, 7. kakuminalet, 8. qiellzo-alveolaret, 9. qiellzoret, 10. velaret, 11. uvularet, 12. faringalet, 13. glotalet (laringalet).



Aktivitet ndërveprues (interaktiv)


Lexojeni me zë fjalinë:

Ne jemi nxënës të klasës së gjashtë.

- Sa zanore dhe sa bashkëtingëllore ka kjo fjali?
- Si janë radhitur tingujt?
- A janë bashkuar në grupe?
- Çfarë kanë krijuar tingujt e radhitur në grupe?
- A kanë kuptim të mëvetësishëm tingujt?

Nga përgjigjet e pyetjeve të mësipërme, mund të nxjerrim si përfundim se:

Gjuha e folur (ligjërimi) paraqitet si një rrjedhë tingullore. Rrjedha e të folurit nuk është e pandërprerë. Kjo ndodh për nevojat kuptimore e sintaksore si dhe për frymëmarrje. Tingujt shërbejnë si lëndë ndërtimi për njësitë më të mëdha. D.m.th. zanoret dhe bashkëtingëlloret i shqiptojmë njëri pas tjetrit, duke krijuar fjalë; pastaj fjalët i lidhim midis tyre dhe krijojmë fjali. Me bashkimin e fjalive formojmë paragrafë e me ndërlidhjen e tyre krijojmë tekst. Gjatë të folurit, tingujve ua mbishtresojmë edhe theksin dhe intonacionin.

Toskërishtja dhe shqipja standarde kanë vetëm zanore gojore, ndërsa gegërishtja, përveç zanoreve gojore, ka edhe zanore hundore, si pë – pëni, drë – drëni etj. Te zanoret gojore i gjithë ajri del vetëm nga goja, ndërsa te zanoret hundore një pjesë e ajrit del edhe nga vrimat e hundës.

Në toskërishten dhe në shqipen standarde zanoret shqiptohen me gjatësi të shkurtër ose të mesme, ndërsa në gegërishten, në kundërvënje me zanoret e shkurtra kemi edhe serinë e zanoreve të gjata. P.sh.:

Në gegërishte	Në shqipen standarde
<i>plak</i> (gj. m.) ~ <i>plaak</i> (gj. f.)	<i>plak</i> (gj. m.) ~ <i>plakë</i> (gj. f.)
<i>oxhak</i> (njëjës) ~ <i>oxhaak</i> (shumës)	<i>oxhak</i> (njëjës) ~ <i>oxhakë</i> (shumës)
<i>shok</i> (njëjës) ~ <i>shook</i> (shumës)	<i>shok</i> (njëjës) ~ <i>shokë</i> (shumës)
<i>kos</i> (kosi) ~ <i>koos</i> (kosa)	<i>kos</i> (kosi) ~ <i>kosë</i> (kosa)

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)


Lexojeni këtë poezi të shkurtër. Çfarë na mëson ajo?

Fjala

*Sa shumë fjalë ka në këtë botë,
t'i numërosh është punë e kotë.*

*Por, për çudi, kanë veç një lojë:
hyjnë nëpër vesh e dalin nëpër gojë.*

Kur tingujt vargëzohet njëri pas tjetrit dhe së bashku krijojnë fjalë, quhen fonema. Fonemat i shënojmë me shkronja. Me kombinimin e 36 fonemave të shqipes janë krijuar mijëra fjalë. Fjalori i madh i shqipes ka 100 mijë fjalë.



Përforcim



1. Si komunikojnë njerëzit?
2. Ç'është fonetika?
3. Si i ndajmë tingujt e të folurit?
4. A kanë kuptim më vete tingujt kur përdoren më vete (të izoluar)?
5. Sa zanore dhe sa bashkëtingëllore ka shqipja standarde?
6. Çfarë dallimi ka ndërmjet zanoreve dhe bashkëtingëlloreve?
7. Një nxënës-e le ta thotë alfabetin e Gjuhës shqipe. Nxënësit e tjerë dëgjojnë me vëmendje, mbajnë shënime dhe në fund japin vlerësime për mënyrën e shqiptimit të tingujve. Vëmendjen duhet ta përqendrojnë sidomos në shqiptimin e zanores y; bashkëtingëlloreve q, gj e ç, xh; r dhe rr.
8. A krijojnë fjalë të kuptimshme çdo kombinim i tingujve?
9. Shumica e tingujve formohen:
 - a) në pjesën e prapme të gojës;
 - b) në pjesën e mesme të gojës, ose
 - c) në pjesën e përparme të gojës.
10. Radhitni siç duhet tingujt (shkronjat) që të krijoni fjalë:

tinguj	fjalë
g, i, t, n, ll, u	
o, r, e, n, a, z	
a, a, r, t, m, i, s, r	
s, x, ë, ë, n, n	

11. Vargëzoni siç duhet fjalët që të krijoni fjali:

fjalë	fjali
zellshëm, ne, të, jemi, nxënës	
e bukur, është, më, stina, pranvera	
është, i mirë, shoku, më, libri	
mendjen, ndriçon, e njeriut, dituria	

12. Shqipto çiftet e fjalëve të mëposhtme. Thuaj kuptimin e secilës fjalë. Pse kanë kuptim të ndryshëm?

hallë - halë
 mal - mall
 arrë - arë
 pulë - pullë
 hedh - hell
 muaj - luaj
 dru - tru
 ruaj - rruaj



RREGULLAT DREJTSHKRIMORE PËR PËRDORIMIN E Ë-SË FUNDORE

Do të mësojmë për:

- rregullat drejtshkrimore për përdorimin e ë-së fundore.

Do të dimë:

- të zbatojmë rregullat drejtshkrimore për përdorimin e ë-së fundore.

Përdorimi i ë-së është problematik për drejtshkrimin si dhe për drejtshqiptimin e Gjuhës shqipe. Gabime gjejmë në shkrimin e ë-së së patheksuar, sidomos kur gjendet në fundin absolut të fjalës. Nxënësit bëjnë shpesh gabime gjatë përdorimit të kësaj shkronje. Shpeshherë ë-ja nuk po shkruhet në fund të fjalës aty ku duhet të shkruhet, ose shkruhet aty ku nuk duhet.

Ë-ja e patheksuar fundore në gjuhën shqipe kryen disa funksione:

- a) ajo shërben si tregues gramatikor i gjinisë femërore: *ditë, klasë, punë, plak - plakë, zog - zogë*;
- b) si tregues i shumësit: (një) *artist - (dy, shumë) artistë, (një) shok - (dy) shokë, (një) sportist - (dy) sportistë; (një) punëtor - (dy) punëtorë, (një) shqiptar - (dy) shqiptarë, (një) mekanik - (dy) mekanikë* etj.
- c) për të bërë dallimin kuptimor të disa fjalëve, si: *kos - kosë, lug - lugë, shpat - shpatë, lajm (emër) - lajmë (folje), ar (metal) - arë (tokë)* etj.

Kjo shumësi vlerash e ë-së fundore në shkrimin e shqipes standarde është e domosdoshme të ruhet, edhe pse prirja e përgjithshme e shqiptimit të këtij tingulli në fund të fjalës, shkon drejt reduktimit, drejt rënies së saj; pra mosshqiptimit.

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet një sërë shembujsh me fjalë që shkruhen me zanoren -ë në një pozicion fundor: *nënë, dajë, i mirë, besnikë (shumës), lehtë, ftohtë, ynë, të tutë, pesë, shtatë, mbajmë, të punojë*. Grupet kanë për detyrë në darrasën e zezë t'i ndajnë fjalët nëpër kolona sipas përkatësisë në klasat e fjalëve (emra, mbiemra,...). Në bazë të shembujve, nxënësve u tregohet se ë-ja fundore shkruhet tek emrat, mbiemrat, ndajfoljet, përemrat pronorë, numërorët, foljet. Në fund, nxënësit i shqiptojnë drejt fjalët dhe e mësojnë drejtshkrimin e ë-së fundore.



Rregulla për shkrimin e ë-së në fund të fjalës

Për të dhënë udhëzime, ndihmuar, madje edhe për të përvetësuar përdorimin e drejtë të ë-së, po sjellim disa rregulla të përdorimit të kësaj shkronje në fundin absolut të fjalës:

- a) Shkruhen me -ë fundore emrat femërorë në trajtën e pashquar, si *bukë, fjalë, vajzë, mollë, shkollë, fletë, lopë, borë, punë, zhurmë* etj.
- b) Shkruhen me -ë fundore disa emra mashkullorë në trajtën e pashquar (që kanë qenë të gjinisë asnjësore), si: *atë, burrë, djalë, gjumë, kalë, lëmë, lumë; ballë, brumë, djathë, drithë, dyllë, dhallë, dhjamë, gjalpë, mjaltë, ujë*, etj.; si edhe emrat mashkullorë *babë, dajë, gegë, toskë* etj.; *Kolë, Lekë* etj. (që nuk kanë qenë të gjinisë asnjësore).
- c) Shkruhen me -ë fundore mbiemrat dhe ndajfoljet e tipit (*i, e*) *butë - butë, (i, e) ftohtë - ftohtë, (i, e) gjallë - gjallë, (i, e) gjatë - gjatë, (i, e) lehtë - lehtë, (i, e) mirë - mirë, (i, e) ngrohtë - ngrohtë* etj.

Në çiftet e fjalëve më poshtë, mbiemrat shkruhen me -ë, ndajfoljet pa -ë: (*i, e*) *drejtë - drejt, drejtpërdrejt, drejtshkrim; (i, e) fortë - fort, (i, e) kotë - kot, (i, e) lartë - lart, i lartpërmendur; (i, e) lightë - lightë, (i, e) mbrapshtë - mbrapshtë, (i, e) plotë - plot, i plotfuqishëm; (i, e) shpejtë - shpejt, (i, e) thjeshtë - thjeshtë, (i, e) vërtetë - vërtet* etj.

- ç) Me -ë fundore shkruhen edhe shumica e numërorëve (përveç dy, tre (gj. m.) – tri (gj. f.), katër; njëzet, dyzet, qind, milion etj.), si *pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë, ..., nëntëmbëdhjetë; mijë* etj., si dhe mbiemrat prejnumërorë - që më parë quheshin numërorë rreshtorë (me përjashtim (*i, e*) *katërt*), si p.sh.: (*i, e*) *parë, (i, e) dytë, (i, e) tretë, (i, e) pestë ...*, (*i, e*) *trembëdhjetë ...*, (*i, e*) *njëzetë ...*, (*i, e*) *gjashtëdhjetë, (i, e) milionë* etj.

- d) E formojnë shumësin me mbaresën -ë një pjesë e madhe e emrave dhe e mbiemrave mashkullorë, si: *fshatarë, ushtarë, detarë, shkrimtarë, oficerë, inxhinierë, artistë, afaristë, punëtorë, dasmorë, lakrorë, fishekë, dyshekë, mjekë, brirë, drerë, frerë, studentë* etj.

- dh) Shkruhen me -ë fundore pjesoret e foljeve që mbarojnë me temë në zanore ose me sonoret -l, -ll, -r, -rr dhe disa mbiemra të nyjshëm të formuar prej tyre, si: (kam) *mjelë* (jo: mjelur), *vjelë* (jo: vjelur), *dalë* (jo: dalur); *mbjellë* (jo: mbjellur), *sjellë* (jo: sjellur); (kam) *parë, qarë, blerë, bërë, pirë, fryrë; marrë, nxjerrë* etj.; (*i, e*) *bërë, (i, e) pirë, (i, e) mbjellë, (i, e) nxjerrë* etj. Me -ë fundore shkruhen edhe pjesoret e tipit: (kam) *dhënë, ngrënë, qenë, thënë, vënë, zënë* etj.

Detyra



Formoni shumësin e emrave të dhënë:

<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>	<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
artist		arsimtar	
drejtor		formular	
mjek		dibran	
fjalor		shkupjan	
anëtar		tetovar	



Shënoni me ✓ fjalën e shkruar saktë dhe me × fjalën e shkruar gabimisht:

(ai, ajo)	të punoj		të punon		të punojë	
(ai, ajo)	të shkoj		të shkon		të shkojë	
(ai, ajo)	të mësoj		të mëson		të mësojë	
(ai, ajo)	të lexoj		të lexon		të lexojë	
(ai, ajo)	të shkruaj		të shkruan		të shkruajë	
(ai, ajo)	të shkoj		të shkon		të shkojë	



Shënoni me ✓ fjalën e shkruar saktë dhe me × fjalën e shkruar gabimisht:

dor		(i, e) bardhë		dymbëdhjet	
borë		(i, e) zez		kërkojm	
dardh		pastërtin		puntor	
drejtshkrimë		bukurinë		shtëpisë	
drejtshqiptimë		dituris		përparimë	
(i, e) holl		shtëpin		lirin	
drejtpërdrejtë		televizorë		filmë	



Teksti ka shumë gabime në shkrimin e ë-së fundore. Rishkruajeni atë pa gabime.

MOLLA E LA FONTENIT

Poeti francezë, La Fonteni, kishte zakonë të haj çdo mëngjesë nga një mollë të pjekurë. Kështu, një ditë la mollën që të ftohejë mbi tavolinë dhe vetë shkoi të kërkojë një libër në bibliotekë.

Ndërkohë, një mikë i tij hyri në dhomë, sheh mollën, e merrë dhe e ha. Kur kthehet La Fonteni, vëren se mollën nuk ishte aty dhe kuptonë se ç'kishte ngjar. Atëherë i kthehet me dhembje mikutë:

- Ah, kushë e paska ngrën mollën që gjendej mbi tavolinë?
- Unë jo, - përgjigjetë miku....
- Shumë mirë, miku im i dashurë, tha La Fonteni. Mollën e kam bërë me arsenikë për t'i helmuar minjtë.
- Ah, i mjeri unë?! - klithi miku - qenka helmuarë!
- Mos u frikëso, mik i dashur, - tha La Fonteni duke qeshur.
- Kjo ishte vetëm një shaka. Desha të di se kushë e ka ngrën mollënë.



NDARJA E BASHKËTINGËLLOREVE SIPAS SHKALLËS SË ZËSHMËRISË

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> ndarjen e bashkëtingëlloreve sipas shkallës së zëshmerisë (të zëshme dhe të pazëshme). 	<ul style="list-style-type: none"> ndarjen e tingujve për nga shkalla e zëshmerisë; klasifikimin e bashkëtingëlloreve sipas zëshmerisë (të tingullta, të zhurmëta); të tregojmë shembuj të çifteve të përbëra nga bashkëtingëllore të zëshme dhe të pazëshme (të shurdhëta).

Sipas shkallës së zëshmerisë, 29 bashkëtingëlloret e shqipes ndahen në:

- 8 bashkëtingëllore **të tingullta** (sonante, sonore): m, n, nj, j, l, ll, r, rr; dhe
- 21 bashkëtingëllore **të zhurmëta**: b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, k, p, q, s, sh, t, th, v, x, xh, z, zh.

Po të radhisim bashkëtingëlloret sipas shkallës së zëshmerisë, duke filluar nga më të zëshmet, kemi këtë renditje:

- bashkëtingëllore të tingullta,
- bashkëtingëllore të zëshme, dhe
- bashkëtingëllore të pazëshme (të shurdhëta).

Sipas pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes së tejzave të zërit në nyjëtimin e tyre, 21 bashkëtingëlloret e zhurmëta të shqipes ndahen në:

- bashkëtingëllore **të zëshme** (10): b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh;
- bashkëtingëllore **të pazëshme** (të shurdhëta, 11): p, t, th, k, q, f, c, ç, s, sh, h.

Bashkëtingëlloret e zëshme dëgjohen më mirë, ndërsa bashkëtingëlloret e pazëshme (të shurdhëta) dëgjohen dobët ose fare pak. Ato dallohen edhe se në nyjëtimin e bashkëtingëlloreve të zëshme tejzat e zërit tendosen dhe dridhen. Përkundrazi, te bashkëtingëlloret e pazëshme (e shurdhëta) tejzat e zërit nuk tendosen dhe nuk dridhen.

Dridhjen e tejzave mund ta hetojmë duke e kapur fikthin (arrëzën e fytit, mollëzën e fytit) nga njëra anë me gishtin e madh dhe nga ana tjetër me dy gishtat e tjerë. Nëse gjatë nyjëtimin të një bashkëtingëlloreje do të ndiejmë dridhje të pjesës që prekim ose një gumëzhimë, atëherë bashkëtingëllorja është e zëshme; nëse nuk do të ndiejmë as dridhje, as gumëzhimë; atëherë bashkëtingëllorja është e shurdhët.



Dhjetë bashkëtingëlloret e zëshme kanë 10 gjegjëset e tyre të pazëshme e anasjelltas. Vetëm bashkëtingëlloerja e shurdhët [h] nuk ka përkatëse të zëshme. Këto çifte bashkëtingëlloresh shqiptohen në të njëjtin vend e në të njëjtën mënyrë, me të vetmin dallim se te bashkëtingëlloret e zëshme tejzat e zërit tendosen dhe dridhen, ndërsa te bashkëtingëlloret e pazëshme tejzat e zërit janë të labërguara (të lëshuara) dhe nuk dridhen. Këto çifte bashkëtingëlloresh paraqiten në këtë formë tabelore:

të zëshme (10)	b	d	dh	g	gj	v	x	xh	z	zh	
të pazëshme (11)	p	t	th	k	q	f	c	ç	s	sh	h

Çiftet e bashkëtingëlloreve të zëshme e të pazëshme

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Mësimdhënësi pret me gërshtë 21 fleta të vogla letre. Në çdo fletë shkruan nga një bashkëtingëllore të zëshme ose të pazëshme. Çdo nxënësi i jepet nga një fletëz. Mësimdhënësi/ja shkruan në dërrasën e zeze tabelën e zbrazët të çifteve të bashkëtingëlloreve të zëshme dhe të pazëshme. Në tabelë shënon vetëm njëren bashkëtingëllore (të zëshme ose të shurdhët). Nxënësi që e ka fletëzën me atë shkronjë e shqipton tingullin. Pas tij e shqipton çiftin e asaj bashkëtingëlloreje nxënësi që e ka fletëzën përkatëse. P.sh.: nxënësi që ka fletëzën me shkronjën B e shqipton këtë tingull, e menjëherë pas tij ai që ka fletëzën me shkronjën P e shqipton p-në dhe kështu me radhë deri në H-në e shurdhët. Ky ushtrim në çifte përsëritet disa herë.

Më pas nxënësit vizatojnë një tabelë në të cilën çiftit i mungon njëra bashkëtingëllore. Nxënësit kanë për detyrë ta plotësojnë tabelën dhe ta kontrollojnë së bashku.

Përforcim

1. Si ndahen bashkëtingëlloret sipas zëshmërisë?

2. Bashkëtingëlloret r, rr janë:

- të pazëshme (të shurdhëta);
- të zëshme;
- të tingullta (sonante).

3. Bashkëtingëlloret b, g janë:

- të pazëshme (të shurdhëta);
- të zëshme;
- të tingullta (sonante).





Përforcim



4. Bashkëtingëlloret f, th janë:

- të pazëshme (të shurdhëta);
- të zëshme;
- të tingullta (sonante).

5. Bashkëtingëllorja më e pazëshme është:

- m;
- k;
- h.

6. Tingujt e emrit dhe të mbiemrit tënd ndani në :

- bashkëtingëllore të tingullta: _____;
- bashkëtingëllore të zëshme: _____;
- bashkëtingëllore të pazëshme: _____.

7. Plotësojeni tabelën:

të zëshme														
të pazëshme														



NDËRRIMET FONETIKE

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> ndërrimet fonetike: ndikimi i tingujve mbi njëri-tjetrin, zëshmimin dhe shurdhimin e tingujve. 	<ul style="list-style-type: none"> se ç'janë dhe pse ndodhin ndërrimet fonetike gjatë të folurit; cilat janë ndërrimet më të shpeshta fonetike; si ndikojnë tingujt në njëri-tjetrin gjatë të folurit.

Prirja e përgjithshme e kombinimit të tingujve gjatë të folurit është **ekonomizimi i gjuhës** dhe **lehtësimi i shqiptimit**. Duke nyjëtuar tingujt, njeriu dëshiron që sa më pak mund të arrijë efekte maksimale. Pikërisht për këtë, gjatë kombinimit të tingujve të folurit përpiqemi që për sa është e mundur t'u shmangemi lëvizjeve nyjëtimore që nuk janë të domosdoshme për të na kuptuar bashkëbiseduesi. Pra, ekonomizimi i gjuhës (që e quajmë edhe ekonomia e gjuhës) udhëhiqet nga ligji “sa më pak mund”.

Përgjithësisht, takimet e dy bashkëtingëlloreve apo të dy zanoreve të njëjta nuk shqiptohen me përpikëri, por zakonisht me një zgjatje më të madhe sesa të tingujve kur nuk ka dyzime të tilla. P.sh.: *fjalët i paarsyeshëm, i paaftë, joobjektiv; kënddrejtë, nënndarje, mossulmim, mishshitës; i argjendte, i njëqindte, mendte, nuk mundte, tundte* i shkruajmë kështu, por nuk i shqiptojmë me dy **aa, oo, dd, nn, ss, shsh, dt**; por me një **a, o** të gjatë; me një **d, n, s, sh, t** për shkak të shqiptimit më të lehtë.

Dukuri më të shpeshta që shfaqen gjatë kombinimit të tingujve në shqipen e folur janë: **akomodimi** (përshtatja) e tingujve, **përngjashmimi** (asimilimi), **shpërngjashmimi** (disimilimi), **zëshmimi** (sonorizimi) i tingujve, **shurdhimi** (desonorizimi) i tingujve, **metateza** (vendkëmbimi), **shtimi** dhe **rënia** e tingujve, **shkrirja** e tingujve etj.

Ndikimi i tingujve mbi njëri-tjetrin

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Shqiptoni ngadalë fjalët:

na - nga

gisht - gur

amebë - amvise

Mendoni dhe përgjigjuni

Si e shqiptuat **n**-në te fjala *na* e si te fjala *nga*?

Si e shqiptuat **g**-në te fjala *gisht* e si te fjala *gur*?

Si e shqiptuat **m**-në te fjala *amebë* e si te fjala *amvise*?





Shpjegim



Te fjalët *n+a* dhe *n+g+a* kemi *n* në fillim të fjalës. Por, *n*-në te fjala *n+a* e shqiptojmë më të përparme, ndërsa *n*-në te fjala *n+g+a* më të prapme. Në fjalën *g+i+sh+t*, *g*-ja është më e përparme, ndërsa në fjalën *g+u+r* më e prapme. Në fjalët *a+m+e+b+ë* dhe *a+m+v+i+s+e*, *m*-ja e fjalës së parë është dybuzore, ndërsa *m*-ja në fjalën e dytë shqiptohet si buzore-dhëmbore.

Pse ndodh kjo?

Kur flasim, tingujt nuk i shqiptojmë të izoluar, por njërin pas tjetrit. Prandaj, në rrjedhën e të folurit, tingujt ndikojnë njëri në tjetrin. Ata përshtaten e shqiptohen në variante të ndryshme, aq sa mund të kalojnë në ndonjë tingull krejtësisht tjetër.

Organet e të folurit lëvizin shumë shpejt nga pozita e shqiptimit të tingullit të parë në pozitën e tingullit të dytë, pastaj $2 > 3 > 4 > 5 > 6$ etj., për të shqiptuar tinguj në të qindta të sekondës. Prandaj, faza përfundimtare e nyjëtimit të një tingulli është edhe fazë nistore e nyjëtimit të tingullit pasues. P.sh.: kur shqiptojmë fjalën *a+m+v+i+s+e*, duke e përfunduar së shqiptuari *a*-në fillojmë ta shqiptojmë *m*-në, duke e përfunduar së shqiptuari *m*-në fillojmë ta shqiptojmë *v*-në e kështu me radhë.

Për këtë arsye, nyjëtimi themelor i çdo tingulli merr nuanca plotësuese, varësisht nga rrethimi tingullor. Pra, organet e të folurit bëjnë përshtatjen e tingujve, veçmas të tingujve fqinjë. Ndikimi i tingujve fqinjë ngjan me përzierjen e ngjyrave të ujit kur janë në takim, të paraqitur si më poshtë:



Ndërrimet kombinatorë dhe pozicionale të tingujve janë të rëndësishme që t'i dimë për përvetësuar drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e shqipes standarde.

ZËSHMIMI DHE SHURDHIMI I BASHKËTINGËLLOREVE

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> zëshmimin dhe shurdhimin e bashkëtingëlloreve. 	<ul style="list-style-type: none"> të tregojmë, të shpjegojmë dhe të japim shembuj të zëshmimit dhe të shurdhimit të bashkëtingëlloreve gjatë të folurit; përmes shembujve të mësojmë se zëshmimi dhe shurdhimi janë normë drejtshqiptimore, ndërsa vetëm në raste të rralla edhe normë drejtshkrimore.

Zëshmim quajmë shndërrimin e bashkëtingëllores së pazëshme në çiftin e saj të zëshëm. Shurdhim quajmë kalimin e bashkëtingëllores së zëshme në çiftin e saj të pazëshëm. Pra, në gjuhën shqipe kemi dhjetë çifte bashkëtingëlloresh që shpeshherë ndërkëmbehen me njëra-tjetrën:

- zëshmim kemi kur: p > b, t > d, th > dh, k > g, q > gj, f > v, c > x, ç > xh, s > z, sh > zh.
- shurdhim kemi kur: b > p, d > t, dh > th, g > k, gj > q, v > f, x > c, xh > ç, z > s, zh > sh.

Zëshmimi dhe shurdhimi i bashkëtingëlloreve mund të paraqitet edhe në formë tabelore:

të zëshme (10)	b	d	dh	g	gj	v	x	xh	z	zh	
	↑	↑	↑	zëshmim				↑	↑	↑	
të shurdhëta (11)	p	t	th	k	q	f	c	ç	s	sh	h

të zëshme (10)	b	d	dh	g	gj	v	x	xh	z	zh	
	↓	↓	↓	shurdhim				↓	↓	↓	
të shurdhëta (11)	p	t	th	k	q	f	c	ç	s	sh	h

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Nxënësit lexojnë në tabelë disa shembuj të përngjashmimit (asimilimit) të bashkëtingëlloreve dhe diskutojnë për mënyrën e shqiptimit të tyre, d.m.th. si shqiptohen bashkëtingëlloret e zëshme dhe ato të pazëshme kur janë pranë njëra-tjetrës, p.sh.: *ekzistoj - egzistoj, s'di - z'di* etj. Nxënësit përfundojnë se për shkak të përshtatjes së tingujve në zëshmëri gjatë të folurit, ndodh përngjashmimi (asimilimi) i bashkëtingëlloreve (njëjtësimi në zëshmëri).



Përforcim



1. Pse bëjmë ndërrime tingullore të fjalëve kur flasim?
2. Ç'është ekonomizimi i gjuhës dhe lehtësimi i shqiptimit?
3. Cilat ndërrime të tingujve janë më të shpeshta në shqipen e folur?
4. A kanë ndikim te ti shokët dhe shoqet me të cilat shoqëroheni?
5. A ndikojnë fqinjët për të mirë ose për të keq te njëri-tjetri?
6. A ndikojnë njëri në tjetrin edhe tingujt që janë bashkë, afër njëri-tjetrit?
7. A vlen edhe për tingujt thënia popullore “Më trego me kë rri, të të tregoj se kush je”?
8. Shpeshherë themi:

ka	në	nga
shpi	vend	shtëpi
kumëll	të	kumbull
ven	formës	vend
shtir	së	vështirë
pi	plotë	prej
fmi	e	fëmijë
shloj	të drejtë të fjalës	lëshoj

Shtoni edhe ju ndonjë fjalë të tillë që nuk e shqiptojmë të plotë.

9. Pse i shkurtojmë fjalët? Pse duam të flasim me fjalë e me fjali sa më shkurtra?



RREGULLAT DREJTSHQIPTIMORE E DREJTSHKRIMORE NË LIDHJE ME NDËRRIMET FONETIKE

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> rregullat drejtshqiptimore e drejtshkrimore në lidhje me ndërrimet fonetike. 	<ul style="list-style-type: none"> të zbatojmë rregullat drejtshqiptimore e drejtshkrimore për zëshmimin dhe shurdhimin e bashkëtingëlloreve në fjalë të caktuara; të përdorim drejt bashkëtingëlloret e zëshme e të shurdhëta gjatë të folurit dhe gjatë të shkruarit.

T'ju rikujtojmë se bashkëtingëlloret shqiptohen me ose pa pjesëmarrjen e tejzave. Kur tejzat e zërit dridhen, kemi bashkëtingëllore të zëshme; kur tejzat e zërit nuk dridhen kemi bashkëtingëllore të pazëshme (të shurdhëta).

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)

Mësimdhënësi i shkruan në tabelë fjalët: *humbte, humbka, humbsha; i elbtë, mundte, mundka, mundsha, i mundshëm; vendqëndrim, vendstrehim, vendkalim; mbliidhte, lagte, lagka; digjte, ndizte, ndezsha*. I pyet nxënësit dhe pret përgjigjet e tyre:

- A janë shkruar drejt këto fjalë?
- A i shqiptojmë siç janë shkruar?
- Si i shqiptojmë ato?
- Pse nuk i shqiptojmë siç janë shkruar?
- Pse e kemi të vështirë (gati të pamundur) t'i shqiptojmë njëren pas tjetrës një bashkëtingëllore të zëshme + një të pazëshme ose një të pazëshme + një të zëshme?



Mjaft i përhapur në të gjitha gjuhët është përngjashmimi (asimilimi) i bashkëtingëlloreve sipas zëshmerisë. Kështu, në grupet prej dy bashkëtingëlloresh: e zëshme + e shurdhët ose e shurdhët + e zëshme bëhen ose të dyja të shurdhëta, ose të dyja të zëshme.





Ky njëjtësim (unifikim) në zëshmërinë e tingujve bëhet në të gjitha gjuhët e botës, sepse organet e të folurit dhe mekanizmi i të folurit është i njëjtë. Kjo përshtatje në zëshmërinë e bashkëtingëlloreve shpjegohet me atë që në grupet bashkëtingëllore e *zëshme + e shurdhët* dhe anasjelltas është e vështirë të kombinohet dridhja e tejkave të bashkëtingëllorja e zëshme me ndërprerjen e dridhjeve të bashkëtingëllorja e shurdhët, kështu që dridhja e tejkave vijon edhe gjatë njëjtimit të bashkëtingëllores së dytë të shurdhët dhe anasjelltas. Në rastin e parë ndodh zëshmimi, ndërsa në rastin e dytë shurdhimi i bashkëtingëlloreve. Pra, dridhja ose mungesa e dridhjes së tejkave përfshin dy bashkëtingëlloret në takim (në kontakt).

Rregull i përgjithshëm i përshtatjes në zëshmëri të bashkëtingëlloreve të shqipes (si edhe i shumë gjuhëve të tjera) është: kur shqiptohen njëra pas tjetrës, ***bashkëtingëllorja e shurdhët para të zëshmes zëshmohet, ndërsa bashkëtingëllorja e zëshme para të shurdhëtës shurdhohet.***

Ky ligj i përshtatjes në zëshmëri realizohet në shqiptim, por nuk pasqyrohet në shkrim. Krahaso formën drejtshkrimore me shqiptimin:

Zëshmimi i bashkëtingëlloreve

	 shkruhet	 shqiptohet
s > z	s'di	[z'di]
	s'dua	[z'dua]
	s'dëgjoj	[z'dëgjoj]
	s'bën	[z'bën]
	s'guxoj	[z'guzoj]
	s'gjej	[z'gjej]
	s'vjen	[z'vjen]
	asgjë	[azgjë]
	mesditë	[mezdité]
	mesdhetar	[mezdhetar]
k > g	ekzistencë	[egzistencë]
	ekzekutiv	[egzekutiv]

Shurdhimi i bashkëtingëlloreve

	shkruhet	shqiptohet
d > t	i njëmendtë	[i njëmenttë]
	e argjendtë	[e argjenttë]
	i njëqinttë	[i njëqinttë]
b > p	absolut	[apsolut]
	absolvent	[apsolvent]
	abstenim	[apstenim]



Drejtpërdorimi i bashkëtingëlloreve të zëshme e të shurdhëta

Sipas pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes së zërit, bashkëtingëlloret, siç është përmendur edhe më parë, ndahen në të zëshme dhe në të shurdhëta. Bashkëtingëlloret e zëshme **b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh**, kur gjenden në fund të fjalës (në toskërishten) dhe para bashkëtingëlloreve të shurdhëta, në ligjërim kanë prirje të shurdhohen, përkatësisht ta humbin zëshmerinë dhe të kalojnë në përgjegjëset e tyre të pazëshme: $b > p$, $d > t$, $dh > th$, $g > k$, $gj > q$, $v > f$, $x > c$, $xh > ç$, $z > s$ dhe $zh > sh$. Këto nuk janë fonema më vete, por variante pozicionale (kur gjenden në fund të fjalës) ose kombinatore (të zëshmet kur gjenden para të shurdhëtave) të të njëjtës fonemë.

Pavarësisht nga pozita në fjalë (në fund, në mes apo në fillim të fjalës), ose nga rrethimi tingullor (përpara apo prapa çdo zanoreje a bashkëtingëlloreje) në ligjërimin letrar përgjithësisht shkruhen si të zëshme, si p.sh.: *elb, gjemb, korb, rob; fund, kënd, standard, shkund; bredh, ndodh, zbardh, ndrydh; burg, djeg, larg, lëng, i lig, varg; qengj, mos e digj, ligj, u përgjigj; hov, borxh, brez, çamçakëz, dorëz, filiz, gaz, ndez, njerëz, oriz, pullaz, garazh* etj.

Detyrë



Shënoni me ✓ fjalën e shkruar saktë dhe me ✗ fjalën e shkruar gabimisht:



zog		zok	
vend		vënt	
brek		breg	
kuvënt		kuvend	
gaz		gas	
prak		prag	
shteg		shtek	
autobus		autobuz	



Detyra



Kur në formim fjalësh ose trajtash takohen një **d** me një **t**, shkruhen të dyja këto bashkëtingëllore (dt), por shqiptohen të përngjashmuara. Në kolonën e djathtë të tabelës, shkruajeni ashtu siç e shqiptojmë grupin **dt**:

 shkruajmë	 shqiptojmë
unazë e argjendtë	
ngjarje e njëmendtë	
i njëqindti	
(i, e) pesëqindtë	
m'u morën mendtë	
ai po e bindte	
po endte pëlhurën	
lindte shumë këlysh	
e shkundte batanijen	



Shënoni me ✓ fjalën e shkruar saktë dhe me ✗ fjalën e shkruar gabimisht:

(i, e) treqinttë		(i, e) treqindtë	
(e) përmendte		(e) përmentte	
(e) përkuntte		(e) përkundte	
(e) tundte		(e) tuntte	
(nuk) muntte		(nuk) mundte	



Shkruani **s** ose **z** që mungon në fjalët:

bara_ - bara_i

barka_ - barka_i

fshehta_ - fshehta_i

hapta_ - hapta_i

rishta_ - rishta_i



Formoni formën mohore të foljeve *di, dua, dal, bëj, gjej* me pjesëzën e mohimit *s'* (= nuk). Shënoni si shkruhen e si shqiptohen.

	folje	shkruajmë	shqiptojmë
s'	di		
s'	dua		
s'	dal		
s'	bëj		
s'	gjej		

PËRSHTATJA NË ZËSHMËRI E BASHKËTINGËLLOREVE SH-/ZH-/Ç-NISTORE ME TINGUJT QË VIJNË PAS

Do të mësojmë për:

- përshtatjen në zëshmëri të bashkëtingëlloreve sh-/zh-/ç- nistore me tingujt që vijnë pas.

Do të dimë:

- të zbatojmë rregullat drejtshqiptimore e drejtshkrimore për përshtatjen në zëshmëri të bashkëtingëlloreve sh-/zh-/ç- nistore me tingujt që vijnë pas.

Edhe përdorimi i tingujve *sh-/zh* dhe *ç-* nistorë, që përfaqësojnë një parashtesë të vetme të shfaqur në tri variante fonetike, kushtëzohet nga zëshmëria e tingullit që pason. Kështu, është normë drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore që:

- Bashkëtingëllorja e pazëshme **sh** të përdoret para të shurdhëtave: *shfaq, shkull, shfaros, shfrytëzoj, shkarkoj, shkatërroj, shkoq, shkreh, shkrep; shpjegoj, shpif, shpoj, shprish, shporr; shtjelloj, shtrydh* etj.
- Bashkëtingëllorja e zëshme **zh** të përdoret para të zëshmeve, si në fjalët: *zhvendos, zhduk, zhbllokoj; zhdredh; zhgënjej, zhgërryey; zhvilloj, zhvleftësim* etj.
- **Ç-**ja të përdoret para zanoreve dhe bashkëtingëlloreve të tingullta (me pak përjashtime): *çarmatos, çliroj, çlodhem, çregjistrim, çrrënjos, (i, e) çrregullt, çmend, (i, e) çmendur, çmos, çnjerëzor* etj.

Si parashtesë e njëjtë (me tri variante fonetike: *sh-/zh-/ç-*) shërben kryesisht për të formuar folje prej foljesh, duke i dhënë asaj kuptim të kundërt, p.sh. *çarmatos* (armatos), *çënjtem* (ënjtem), *çorganizoj* (organizoj); *shpalos* (palos), *shthur* (thur); *zhduk, zhdukem* (dukem), *zhvendos* (vendos), *zhvesh* (vesh), (i, e) *zhdrejtë* (i, e drejtë) etj. Ky tip është produktiv dhe aktiv në shqipen standarde.

Te një numër foljesh, kjo parashtesë shpreh intensitetin e veprimit të shoqëruar edhe me ngjyrimë të reja kuptimore, p.sh. *çliroj* (khs. liroj), *shkëmbej* (khs. këmbej), *shkëput* (khs. këput), *shndërroj* (ndërroj), *shpërndaj* (khs. përndaj) etj.

Detyrë


Qarkoni (rrethoni) shkronjën (a ose b) para fjalës së shkruar drejt:

a) shpjegoj b) spjegoj	a) çfaqje b) shfaqje	a) shkujdesem b) çkujdesem
a) çpikje b) shpikje	a) zhvendos b) çvendos	a) sbardh b) zbardh
a) smadhoj b) zmadhoj	a) çkatërroj b) shkatërroj	a) zhduk b) shduk

Detyrë



Formoni fjalë me kuptim të kundërt (antonime), duke shtuar parashtesën *sh-*, *zh-* ose *ç-*:

(i, e) drejtë	___ drejtë
nderoj	___nderoj
orientoj	___orientoj
qetësoj	___qetësoj
qep	___qep
rregulloj	___rregulloj
bëj	___bëj
fryj	___fryj
akordoj	___akordoj
vlerësoj	___vlerësoj
montoj	___montoj



1. Vargun e vjershës *“Ujku dhe Qengji”* të Naim Frashërit rishkruajeni në anën e djathtë. Fjalët që nuk përkojnë me gjuhën letrare, ktheni në formën standarde:

Ujku pa fe	
Erth në kope	
Dhe, si s'pa qën,	
U fut nër dhën,	
Një qënq zuri	
Zëmërguri.	
Qëngji i tha:	
"Ore vëlla?	
E po përse?	
As më rrëfe	
Se ç'faj të kam?	
I vogël jam."	





THEKSI

Do të mësojmë për:

- theksin në gjuhën shqipe.

Do të dimë:

- se ç'është theksi dhe si ta shënojmë atë.

Fjalët përbëhen nga rrokjet, që në rrjedhën e të folurit nuk shqiptohen të gjitha njëjloj. Kur shqiptojmë fjalë të ndryshme me dy a më shumë rrokje, vëmë re se njëra prej tyre dallohet nga të tjerat. Ky dallim bëhet me anë të theksit. Thjesht, theksi është spikatje e njërës rrokje të fjalës. Pra, **theksi është të spikaturit e rrokjes me anë të forcës, të gjatësisë dhe të lartësisë së tonit.**

Rrokja që veçohet nga të tjerat dhe që dëgjohe më shumë është rrokje e theksuar, ndërsa ato që nuk veçohen e që dëgjohe më pak janë rrokje të patheksuara. Kjo mund të hetohet nëse krahasojmë zanoret e theksuara nga të patheksuarat në fjalët: *shkóllë, punëtór, përparimtár, líbër, njerí, lexój, dritáre, studént, pranvére* etj. Nga këta shembuj vërejmë se rrokja e theksuar është më e zëshme dhe shqiptohet me forcë, me lartësi dhe me gjatësi më të madhe të zërit.

P.sh.: te fjala **shkóllë, ó**-ja shqiptohet me forcë, me lartësi dhe me gjatësi më të madhe sesa ë-ja. Pra, theksi është në rrokjen e parafundit. Te fjala **përparimtár, á**-ja shqiptohet me forcë, me lartësi dhe me gjatësi më të madhe sesa zanoret e patheksuara ë, a, i. Theksi është në rrokjen e fundit.

Si e shënojmë theksin?

Në gjuhën shqipe theksohen vetëm zanoret, jo edhe bashkëtingëlloret. Të theksuara si edhe të patheksuara mund të jenë të gjitha zanoret e shqipes. Zanoren e theksuar e shënojmë me shenjën ' , që e vëmë mbi shkronjën për zanore, si p.sh.: **á, é, í, ú, ó**. Zanoreve të patheksuara nuk u shënojmë asnjë shenjë plotësuese.



Detyrë



Shënoni me ✓ fjalën e theksuar saktë dhe me ✗ fjalën e theksuar gabimisht:

vájza		vajzá	
djáli		djalí	
líbri		librí	
shkollá		shkólla	
shqíptar		shqiptár	



Shpjegoni kuptimin e fjalës së kolonës së parë (me theks në rrokjen parafundore) dhe kuptimin e çiftit minimal të fjalës në kolonën e dytë (me theks në rrokjen fundore):

líri	lirí
bári	barí
ári	arí
argjentári	argjentarí
punëtóri	punëtorí
drejtóri	drejtorí

Thoni edhe ndonjë çift të tillë fjalësh.

Çfarë mund të përfundojmë nga këta shembuj?

Në fjalët e mësipërme, dhe në pak fjalë të tjera, theksi i fjalës ka funksion kuptimdalues (kuptimor, semantik), meqë vendosja e theksit në rrokjen parafundore apo në rrokjen fundore) te disa çifte minimale fjalësh krijon fjalë me kuptime të ndryshme.

VENDI I THEKSIT NË FJALËT E GJUHËS SHQIPE

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> vendin e theksit në fjalët e Gjuhës shqipe (fundor, parafundor dhe tejfundor). 	<ul style="list-style-type: none"> të mësojmë vendin e theksit në gjuhën shqipe (fundor, parafundor dhe tejfundor); t'i theksojmë drejt fjalët (njërrokëshe, dyrrrokëshe e shumërrrokëshe).

Shqipja nuk është gjuhë pa rregulla të theksimit të fjalëve. Shpeshherë është thënë e shkruar se nuk ka rregullsi në theksimin e fjalëve në gjuhën shqipe; se vendi i theksit në fjalë është i papërcaktuar etj. Ky pohim nuk qëndron as për shqipen e as për cilëndo gjuhë tjetër. Çdo gjuhë është krijuar mbi sistemin e rregullave fonetike, morfologjike, leksikore dhe sintaksore. Rrjedhimisht, edhe në theksimin e fjalëve në shqipen ka rregullsi, ndërsa detyra jonë është që t'i zbulojmë, t'i përshkruajmë e t'i shpjegojmë këto rregulla.

Në të vërtetë, theksimi i fjalëve në shqipen nuk mund të përfshihet me një rregull të vetëm, si në disa gjuhë të tjera. Fjala vjen, në maqedonishte theksi bie rregullisht në rrokjen e tretë nga fundi i fjalës; në frëngjishte, në turqishte – në rrokjen e fundit etj.

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Nxënësit dëgjojnë një audio incizim, në të cilin folësi thekson fjalët dyrrrokëshe dhe trirrokëshe një herë gabimisht dhe një herë drejt (në mungesë të audio incizim mundet edhe mësimdhënës-i/ja). Diskutojnë për dallimet mes dy theksimeve të po të njëjtëve fjalë. Pastaj dëgjojnë përsëri dhe analizojnë. Atyre u shpjegohet se dallimet janë për shkak të theksimit të ndryshëm të të njëjtës fjalë. Më pas, shembujt shkruhen në tabelë.

Mësimdhënës-i/ja lexon shembujt, duke i theksuar drejt dhe u kërkon nxënësve ta shënojnë ngritjen e zërit, theksimin e një rrokjeje në fjalë. Në pjesën e fundit, mësimdhënës-i/ja shpjegon ku bie theksi në fjalët e Gjuhës shqipe (të shënuara më poshtë).

Më pas nxënësit marrin një listë me fjalë dyrrrokëshe dhe trirrokëshe që duhet t'i shkruajnë të ndara në rrokje dhe të shënojnë theksin mbi zanoren e theksuar. Në fund, nxënësit i lexojnë me zë fjalët nga lista, duke i theksuar drejt.

Kur flasim shqip theksojmë rrokjet fundore, parafundore ose tejfundore të fjalëve. Pra, në shqipen theksi bie:

1. **Në pozitë fundore** (në rrokjen e fundit, në rrokjen e parë nga fundi i fjalës): *njerí, qirí, qytét, lirí, babá, shtëpí, barí, folé, puním; shqiptár, tetovár, shkrimtár, gojëtar, shkupján, dibrán, artist; mësój, lexój, shikój, mendój* etj. Te foljet, theksi bie rregullisht mbi zanoren e fundit të temës.

2. **Në pozitë parafundore** (në rrokjen e dytë nga fund): *mótër, aníje, déle, lúle, bésë, shkóllë, fúshë, dárdhë, émër, fémër, létër, móllë, púlë* etj. Shqipja ka prirje për theksimin e zanoreve parafundore.

3. **Në pozitë tejfundore** (në rrokjen e tretë, rrallë edhe në të katërtën nga fundi i fjalës): *flútura, kúmbulla, plúhuri, fúshave, ndëshemi, fshehúrazi; punúakëshim, punúakemi* etj.



RREGULLAT E THEKSIMIT TË FJALËVE

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> rregullat e theksimit të fjalëve në gjuhën shqipe (në fjalët e parme, të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura). 	<ul style="list-style-type: none"> rregullat e theksimit të fjalëve në gjuhën shqipe (në fjalët e parme, të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura). t'i theksojmë drejt fjalët shqipe (të parme, të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura) si dhe fjalët e huazuara.

Për theksimin e drejtë të fjalëve në gjuhën shqipe kemi disa rregulla. Më të rëndësishmet janë:

- Në fjalët njerrokëshe theksi bie mbi zanoren e vetme të fjalës: mík, qén, dét, lís, mál, plák, fúnd, ménd, dréjt, trím, gúr, rrúsh, drú, shkój, mbjéll, sjéll, dál, há, pí etj.
- Në fjalët e parme theksi bie në rrënjën e fjalës (e jo në mbaresë), si në fjalët: djálë, djál-i, djál-in, djál-it, djém, djém-të, djémsh, djém-ve; újk-u, újk-ut, újk-un, újq-it, újq-ve, újq-ish; qén-i, qén-in, qén-it, qén-të, qénsh, qén-ve etj.
- Në fjalët e formuara me prapashtesim (përveç prapashtesave -as, -ës dhe -je), theksi vendoset në prapashtesë. Krahaso theksin në fjalët: fshát - fshatár, qytét - qytetár, dét - detár, údhë - udhëtár, lúftë - luftëtár, lákër- lakrór, dásëm - dasmór, mál - malór, ákull - akullóre, rrégull - rregullóre, bótë - botëror; púnë - puním, punëtór, punëtorí etj.
- Në fjalët e formuara me parashtesa, theksi vendoset në rrënjë. P.sh.: përplás, përpunój, stërgjýsh, mosbesím, përmbyll, mospërfillje, mbishkrím, nënkuptój, paramendím etj.
- Në fjalët e përbëra (kompozita), theksi vendoset në elementin e dytë formues, si në fjalët: botëkuptím, mirësjéllje, kryeqytét, jetëgjátë, vetëshërbím, syshkrúar, udhëhégës etj.
- Në fjalët e përngjitura, theksi bie në elementin e fundit formues. P.sh.: tungjatjéta, vërëj, atëhërë, farefis, gjëegjézë, lamtumírë; numërorët prej 11 deri më 19 (njëmbëdhjété, dymbëdhjété,...), njëqínd, dyqínd etj.

Mbani mend

Regulla e përgjithshme e theksimit të fjalëve në gjuhën shqipe mund të përcaktohet si:

Në gjuhën shqipe theksi i fjalës vendoset në zanoren e fundit të parrëguar të temës fjalëformuese.

Rregulla më e thjeshtë e më praktike e theksimit të fjalëve në gjuhën shqipe është:

- Theksoji fjalët e shqipes ose të huaja në rrokjen e fundit të fjalës, në qoftë se zanorja fundore nuk është e shkurtër (e rrëguar).**
- Theksoji fjalët e shqipes ose të huaja në rrokjen e parafundit, në qoftë se zanorja fundore është e shkurtër.**

*rrëgjim - shkurtim, rrudhje, tkurrje, zvogëlim, dobësim.



Detyrë



Shënoni theksin e duhur në fjalët:

shkoj, rri, laps, dy, shoh, top, shah, lum, mur, sot, dhëmb, pak, bëj, çaj, qaj.

Pse theksohen kështu? Çfarë konstatoi: _____
_____.



Vini theksin e duhur në fjalët:

art - artist, futboll - futbollist, sport - sportist, mjeshtër - mjeshtri, drejtor - drejtoreshë, zonjë - zonjushë, i ëmbël - ëmbëlsi, ëmbëlsirë, ëmbëlsoj, (i, e) ëmbëlsuar; djalë - djalëri, djalosh; mend - mendoj, mendim, mendar; flakë - flakëroj, shteg - shtegtoj, frikë - frikësoj, frikësim, (i, e) frikësuar; dorë - dorëzoj, dorëzim, dorëzues; fund - fundos, hekur - hekuros, hekuranë; fjalë - fjalos, fjalim, fjalor.

Pse theksohen kështu? Çfarë rregulli mund të jepni: _____
_____.



Shënoni theksin e duhur në fjalët:

përdor, përpjekje, përfundoj, përmirësim, përshkruaj, mbikalim, nënkallim, rilexoj.

Pse theksohen kështu? Çfarë konstatoi? _____
_____.



Vini theksin e duhur në fjalët:

bukëpjekës, hekurudhë, vendbanim, bashkëpunëtor, drejtshkrim, mirëmbaj, buzëqesh, zëvendës.

Pse theksohen kështu? Çfarë konstatoi? _____
_____.



Vini theksin e duhur në fjalët:

dalëngadalë, ndonjëherë, gjithmonë, anëmbanë, atëherë, menjëherë.

Pse theksohen kështu? Shkruaje rregullin: _____
_____.



Vini theksin në paradigmen e lakimit të emrit **libër**:

	numri njëjës			numri shumës	
	trajta e pashquar	trajta e shquar		trajta e pashquar	trajta e shquar
E.	(një) libër	libri	E.	(disa) libra	librat
Gj.	i, e (një) libri	i, e librit	Gj.	i, e (disa) librave	i, e librave
Dh.	(një) libri	librit	Dh.	(disa) librave	librave
K.	(një) libër	librin	K.	(disa) libra	librat
Rr.	prej (një) libri	(prej) librit	Rr.	prej (disa) librash	(prej) librave



Mendoni dhe përgjigjuni

A lëviz theksi nga një zanore në tjetrën gjatë lakimit të emrave, apo mbetet në po të njëjtën zanore? **Kur fjala merr mbaresa, theksi nuk lëviz.** Te të gjitha rastet theksi është te rrokja *li* (d.m.th. te zanorja *i*: *libër, libri, librit, librin, libra, librave, librat, librash*).



Çfarë përfundoni?

Theksi i shqipes qëndron i palëvizshëm gjatë lakimit të emrave. Ai e ruan pozicionin e tij të formës përfaqësuese (formës bazë të emrit) – trajta e pashquar e rasës emërore në numrin njëjës. Prandaj, në formën e emërores **libër** kemi theks parafundor, ndërsa në disa rase të tjera, si **librave** shndërrohet në fjalë me theks tejfundor.

Detyrë



Vini theksin në paradigmen e zgjedhimit të foljes **mësoj** (në kohën e tashme të mënyrës dëftore në formën veprorë).

	mësoj	
	<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
veta I	mësoj	mësojmë
veta II	mëson	mësoni
veta III	mëson	mësojnë

Mendoni dhe përgjigjuni

A lëviz theksi nga një zanore në tjetrën gjatë zgjedhimit të foljeve, apo mbetet në po të njëjtën zanore?



Çfarë konstatojmë?

Theksi i shqipes qëndron i palëvizshëm edhe gjatë zgjedhimit të foljeve. Ai e ruan pozicionin e tij të formës përfaqësuese (formave bazë të foljes) - atë të vetës së parë numër njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore. **Kur fjala merr mbaresa, theksi nuk lëviz.** Te të gjitha rastet theksi është te rrokja - **ój** (d.m.th. te zanorja **ó**: *mësój, mësón, mësójmë, mësóni, mësójnë; mësója, mësóva* etj.

Te togjet e zanoreve, theksi bie mbi zanoren e parë të togut: (*kam*) *mësúar, (kisha) mësúar*; *i edukúar, grúa, përrúa, thúa, mësúes, i dëgjúeshëm, díell, qíell, fýell, përkthýes* etj.

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)


Nxënësit punojnë në çifte. U jepet një tekst, e lexojnë dhe prej tij nxjerrin dhjetë fjalë sipas zgjedhjes së tyre. I ndajnë fjalët në rrokje. I shqiptojnë ato dhe vërejnë se cila rrokje është e theksuar. E shënojnë me shenjën e theksimit dhe diskutojnë nëse theksimi ndryshon në varësi të asaj nëse fjala merr një prapashtesë ose pëson ndonjë ndryshim tjetër. Përfundimet për karakteristikat nxënësit i nxjerrin vetë sipas udhëzimeve të mësimdhënës-it/es dhe i shkruajnë në tabelë.

Detyrë


Shënoni me ✓ theksimin e drejtë dhe me ✗ theksimin jo të drejtë të së njëjtës fjalë:

<i>në toskërishte</i>		<i>në gegërishte</i>	
njerí		njéri	
verí		véri	
qirí		qíri	
teneqé		tenéqe	
babá		bába	
pashá		pásha	

Çfarë mund të përfundojmë nga këta shembuj?

Në karakterin e theksit shqipja dialektore (gege e toske) dhe standarde është mjaft unike. Dallim kemi te disa fjalë që në gegërishte shqiptohen me theks parafundor, ndërsa në toskërishte me theks fundor. Në shqipen standarde, shqiptimi i këtyre fjalëve me theks fundor është normë letrare.

Si i theksojmë fjalët e huazuara?

Fjalët e huazuara i kemi përshtatur me natyrën e theksit të shqipes: ato shqiptohen ose me theks parafundor ose me theks fundor. Pra, përgjithësisht edhe fjalët e huazuara në shqipen shqiptohen ose me theks parafundor ose me theks fundor. P.sh. te sllavizmat dialektorë në gjuhën shqipe theksi nga rrokja e tretë zhvendoset në rrokjen e dytë, si sll. *névolja* - shq. *nevóje*, sll. *lópata* - shq. *lopátë*, sll. *lédina* - shq. *ledínë* etj. Në përgjithësi, te orientalizmat (turqizmat) ruhet theksimi fundor (si në gjuhën e burimit): *sefá*, *belá*, *sevdá*, *kalá*, *e xhumá*, *dynjá*, *hatá*, *xhamí*, *bojaxhí*, *teneqexhí*, *rahmetlí*, *sheherlí* etj.



Ushtrime



Ushtrimi 1:

• Vini shenjën e theksit mbi zanoren e theksuar të fjalëve:
drejtor, drejtoreshë, lexoj, përmirësoj, njeri, qytet, punëtor, nxënës, pesëmbëdhjetë, arsimtar, shkollë, fletore, shtëpi, qiri, lule, kumbull, dituri, vrapoj, shkruaj, shkrimtar, gjuhë, trembëdhjetë.



Ushtrimi 2:

• Fjalët njeri, qiri, veri, teneqe, bakllava, baba, Fatime, Xhemile i shqiptoni me theks në zanoren e fundit apo të parafundit? Si duhet theksuar këto në shqipen standarde?



Ushtrimi 3:

• Vini theksin e nevojshëm te format e rasore të emrave:
- *mal, mali, malit, malin, male, malet, maleve, malesh;*
- *flutur, flutura, fluturat, fluture, fluturës, fluturën, fluturave, fluturash;*
- *qytetar, qytetari, qytetarit, qytetarin, qytetarë, qytetarët, qytetarësh, qytetarëve.*



Ushtrimi 4:

• Vini theksin e nevojshëm te disa forma të zgjedhimit të foljeve:
- *laj, lan, lajmë, lani, lajnë; lava, lave, lau, laja, (kam, jam) larë;*
- *punoj, punon, punojmë, punoni, punojnë; punoja, punoje, punaje, punonte, punonim, punonit, punonin; punova, punove, punoi, punuam, punuat, punuan; kam punuar.*

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Lexim shprehës të tekstit me theks dhe intonacion të duhur. Nxënësit në mënyrë të pavarur zgjedhin një tekst (të çfarëdo stili), e lexojnë para klasës, duke respektuar rregullat e theksit që kanë mësuar. Për detyrë kanë të dëgjojnë me vëmendeje, të mbajnë shënime për theksimin e fjalëve si dhe intonacionin e fjalive dhe t'i japin komente njëri-tjetrit pas çdo leximi.

Kini kujdes



Kur flasim, fjalët shërbyese (pjesëzat, lidhëzat, nyjat e përparme, trajtat e shkurtra të përemrave vetorë, parafjalët etj.) i shqiptojmë me një theks të vetëm (në një tërësi theksore, unitet theksor), sikur të jenë një fjalë e vetme me fjalët emërtuese (emrat, mbiemrat, foljet, përemrat, numërorët, ndajfoljet). Për shembull:

Shkruajmë: Një lepur i ri zemërak u ul nga mali në fushë dhe hyri në një pemishtë, ku gjeti të gjitha të mirat.

Fjalët i shkruajmë ndaras sipas parimit morfologjik të drejtshkrimit.

Lexojmë: *Njëulëpur iuri zemërák uul ngaumáli nëufúshë dheuhýri nëunjëupemíshhtë / kuugjéti tëugjíthautëumirat.*

Lidhjet e fjalëve shërbyese me fjalët kuptimplota i shqiptojmë bashkë dhe me një theks të vetëm sipas rregullave drejtshqiptimore.

Diktim



Në plazhin e Durrësit

Pas vendosjes në hotel, fëmijët dolën në plazh.

- Uaa, sa i pafund qenka ky plazh! – u befasua Arta.
- Ejani të notojmë të gjithë! – propozoi Luljeta.
- Do të notojmë dhe do të luajmë me top, - tha Genci.
- Pas lojës, do të ndërtojmë një kala të madhe me rërë, - propozoi Iliri.
- E si duket një kala e vërtetë? – pyeti Shpresa?
- Në mbrëmje do ta vizitojmë kalanë e vjetër të Durrësit, - tha Taulanti.





PJESËT E LIGJËRATËS

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
Pjesët e ligjëratës dhe ndarjen e fjalëve në: <ul style="list-style-type: none"> fjalë të ndryshueshme; fjalë të pandryshueshme. 	<ul style="list-style-type: none"> t'i identifikojmë pjesët e ligjëratës në gjuhën shqipe; t'i klasifikojmë në mënyrë të drejtë fjalët në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Gjuha shqipe ka **dhjetë** pjesë të ligjëratës, e ato janë: **emri, mbiemri, numërori, përemri, folja, ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza dhe pasthirrma**.

Disa nga këto pjesë të ligjëratës gjatë përdorimit të tyre në fjali pësojnë ndryshime, ndërsa disa prej tyre mbeten të pandryshuara.

Fjalë të ndryshueshme dhe fjalë të pandryshueshme

Ta lexojmë këtë tekst:

Arta, Nita dhe Drita janë tri shoqe shumë të mira. Ato mësojnë bashkë në një klasë. Prej mëngjesit e deri në mbrëmje ato nuk ndahen sepse duhen vërtet. Madje edhe shoqet e tjera u mbanin zili.

Ky tekst është shkruar prej fjalësh të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

- Emri, folja, përemri, mbiemri** dhe **numërori** janë pjesë të ndryshueshme të ligjëratës.
- Ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza** dhe **pasthirrma** janë pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.

Sipas veçorive morfologjike, fjalët grupohen në fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Fjalë të ndryshueshme quhen fjalët të cilat gjatë përdorimit ndryshojnë formën e tyre. Këto fjalë, në vete kanë disa veçori gramatikore, të cilat ndryshojnë.

Siç thamë më sipër, kemi **pesë** pjesë të ndryshueshme të ligjëratës dhe nëse marrim për shembull **emrin**, ai ndryshon sipas kategorive gramatikore që i ka, e ato janë: kategoria e **numrit**, e **gjinisë**, e **rasës** dhe kategoria e **shquarsisë** dhe e **pashquarsisë**; **mbiemri** ka kategoritë gramatikore të **gjinisë**, **numrit**, **rasës** dhe **shkallës**; **folja** ka **vetën**, **numrin**, **kohën**, **mënyrën**, **zgjedhimin** dhe **formën**; **numërori** ndryshon sipas **gjinisë** dhe sipas **rasës**, ndërsa **përemri** ka kategoritë gramatikore të **vetës**, **numrit** dhe **rasës**.



Shembull:

Emër: *laps, lapsi, lapsin, lapsit, lapsave...*

Mbiemër: *i ri, e re, të rinj, më e re...*

Folje: *lexoj, lexova, lexonte, lexuam...*

Përemër: *unë, ajo, ata, atyre...*

Numëror: *tre, tri...*

mbiemri

emri

Fjalë të ndryshueshme

folja

përemri

numërori

Fjalët që nuk ndryshojnë formën e tyre gjatë përdorimit, quhen **fjalë të pandryshueshme**. Në këtë grup fjalësh bëjnë pjesë **ndajfolja, lidhëza, parafjala, pasthirrma** dhe **pjesëza**.

Shembull:

Ndajfolje: *këtu, atje, nesër, shumë...*

Parafjalë: *nga, tek, në, nëpër, prej...*

Lidhëza: *dhe, por, ose, sepse...*

Pjesëza: *mos, nuk, s', ja, jo, pa...*

Pasthirrma: *oh, ah, moj, more...*

parafjala

ndajfolja

Fjalë të pandryshueshme

lidhëza

pjesëza

pasthirrma

Detyrë



Vendosni fjalët e dhëna në vendin e duhur:

ai, ata, asaj

mësoj, lexova, do të shkoj

nxënës, klasë, fletore

i mirë, e madhe, e bukur

po, mos, ja, vallë

oh, obobo, uf, ore

tri, tre, të tria

mirë, keq, shpejt, ngadalë

tek, nga, me, prej

se, dhe, prandaj, por

Fjalë të ndryshueshme		Fjalë të pandryshueshme	
Emër		Ndajfolje	
Mbiemër		Parafjalë	
Përemër		Lidhëz	
Folje		Pjesëz	
Numëror		Pasthirrmë	



Detyrë



Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet dy fletë me ngjyra të ndryshme. Në fletën me ngjyrë të kuqe shënojnë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës, ndërsa në fletën e kaltër shënojnë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës. Secili grup prezanton para të tjerëve punën e bërë dhe në fund diskutohet për rolin e tyre në fjali.



Lidhuni në internet në adresën: <https://wordwall.net/resource/35192432/klasat-e-fjal%C3%ABve> dhe gjeni klasat e fjalëve.

Përforcim



1. Si i dallojmë fjalët e ndryshueshme nga fjalët e pandryshueshme?
2. Cilat janë fjalë të ndryshueshme?
3. Cilat janë fjalë të pandryshueshme?
4. Ndajini fjalët e mëposhtme në fjalë të ndryshueshme dhe në fjalë të pandryshueshme:
herët, mëngjes, nga, çel, ajo, lulja, oh, ndonëse, e kuqe, para, drejt, shkoj, këtë, me, tre, mbi, përse, mos, e gëzuar, tabelë, i dyti, ju, nuk.
5. Lidhni fjalët e mëposhtme me klasën ku bëjnë pjesë:

obobo	emër
sot	mbiemër
nxënëse	numëror
po	përemër
i mirë	folje
tre	ndajfolje
ne	parafjalë
shkruaj	lidhës
mbi	pjesëz
sepse	pasthirmë



EMRI

Do të mësojmë për:

- emrin; kuptimin, veçoritë gramatikore;
- llojet e emrave: të përgjithshëm, të përveçëm; emra konkretë dhe abstraktë; përmbledhës dhe të lëndës.

Do të dimë:

- kuptimin e emrit dhe veçoritë gramatikore të tij;
- t'i identifikojmë llojet e emrave: të përgjithshëm, të përveçëm; konkretë dhe abstraktë; përmbledhës dhe të lëndës.

KUPTIMI I EMRIT

Veçoritë e tij gramatikore

Nxënësit e shkollës sonë gjatë **verës** me **vullnet** lexojnë **libra**.

Fjalët me shkronja më të trasha dhe më të zeza emërtojnë:

nxënës → qenie e gjallë (frymor)

vullnet → cilësi

shkollë → send konkret (objekt)

libër → send konkret

verë → dukuri e realitetit (stinë)

Emër është fjala që emërton ndonjë qenie të gjallë, send, dukuri, cilësi, veprim ose gjë abstrakte.


Nga pikëpamja kuptimore, në klasën e emrave përfshihen fjalë të ndryshme që mund të emërtojnë **veta e frymorë** të tjerë (*njeri, burrë, grua; flutur, dele, kalë*), **sende konkrete** (*gur, dru, shtëpi, qytet, mal*), **dukuri të realitetit** (*dimër, furtunë, tërmet, shi, borë*), **cilësi** (*bukuri, dashuri, mirësi, shkathtësi*), **veprime ose gjendje** (*ecje, drejtim, lodhje, përkrahje, zemërim*), **nocione abstrakte** (*e mira, e vërteta, e keqja*).

Emrat mund të jenë në numrin njëjës ose në numrin shumës. Çdo emër ka një gjini të caktuar. Emrat mund të jenë në trajtë të shquar ose të pashquar dhe të përdoren në rase të ndryshme. Prandaj themi që emrat kanë kategoritë gramatikore të **gjinisë, të numrit, të rasës dhe të trajtës** apo të shquarsisë e të pashquarsisë.

Llojet e emrave

Sipas kuptimit që kanë, gjithë emrat e Gjuhës shqipe ndahen, së pari, në **emra të përgjithshëm** dhe **emra të përveçëm**. Emrat e përgjithshëm ndahen në *emra konkretë* e *emra abstraktë*. Në radhën e emrave të përgjithshëm, si grupe më vete dallohen *emrat përmbledhës* dhe *emrat e lëndës*.

Në vijim është dhënë skemë grafike e kësaj ndarjeje.



Emra të përgjithshëm dhe të përveçëm

Emri **mal** tregon një vend shumë të ngritur mbi sipërfaqen e tokës dhe që është më i lartë se kodra. Të tilla në vendin tonë dhe në botë ka shumë dhe të gjitha në gjuhën shqipe emërtohen njësoj me **emrin e përgjithshëm: mal**.

Kur themi **Sharri**, kemi parasysh një mal të caktuar, të cilit i është vënë një emër për ta dalluar nga malet e tjera, prandaj themi se ky është **emër i përveçëm**.

Po kështu mund të themi edhe për emrat e njerëzve, të qyteteve, të lumenjve etj.

Emra të përgjithshëm

djalë – djem

lumë – lumenj

Emra të përveçëm

Agimi, Petriti

Vardari, Drini

Emrat e përgjithshëm emërtojnë frymorë ose sende të të njëjtit lloj. Për shembull: *dele, ujk, nxënës, nënë, baba, fletore, traktor, mendim, fitore, guxim, urdhër* etj. Këta përbëjnë shumicën e emrave. Emrat e përgjithshëm gjithnjë shkruhen me shkronjë të vogël.

Emrat e përveçëm janë fjalë që emërtojnë një prej frymorëve ose sendeve, duke e dalluar nga të tjerët. Në krahasim me të përgjithshmit, emrat e përveçëm janë më të paktë.

Në emra të përveçëm përfshihen:

- **emrat dhe llagapet e njerëzve:** *Vjollcë, Flutur, Genc, Asdreni, Migjeni* etj.;

- **emrat e kafshëve:** *Bubi, Laro, Murro* etj.;

- **emrat gjeografikë** (të lumenjve, maleve, deteve, shteteve, qyteteve, shesheve, rrugëve etj.): *Shkumbin, Sharr, Adriatik, Tetovë, sheshi “Skënderbeu”, rruga “Hasan Prishtina”* etj.;



- **emrat e periudhave dhe ngjarjeve historike:** Kongresi i Manastirit, Rilindja, Revolucioni i Tetorit etj.;

- **emrat e institucioneve, të organizatave, të ndërmarrjeve** etj.: Fakulteti i Gjuhës dhe i Letërsisë, Ministria e Arsimit, kompania “Ekolog” etj.

- **titujt e veprave letrare, të gazetave e të revistave:** “Bagëti e bujqësi”, “Koha”, revista “Studime filologjike” etj.;

- **emrat e trupave qiellorë:** Marsi, Jupiteri, Hëna, Arusha e Vogël etj.

Shumë emra të përveçëm njerëzish ose vendesh kanë dalë prej emrave të përgjithshëm: Bukuri, Gëzim, Lule, Sokol, Vjollcë, Frashër, etj., por dallojnë prej tyre sepse, siç e keni vënë re, emrat e përveçëm shkruhen gjithmonë me shkronjë të madhe.

Detyrë



Emrat e nënvizuar vendosi në tabelë në kolonën përkatëse:

Një ditë Miri doli të shëtiste në park bashkë me shokun e tij Benin. Atje takoi shogën e tij, Adelën. Ajo kishte marrë me vete edhe qenin e saj Bubin.

Emra të përgjithshëm	Emra të përveçëm

Lidhuni në internet dhe ndiqeni mësimin “Emrat e përgjithshëm dhe emrat e përveçëm” në vjegëzën: https://www.youtube.com/watch?v=TdED_2dPHy4

Emra konkretë dhe abstraktë

Në radhën e emrave të përgjithshëm, si dy grupe të veçanta, dallohen **emrat konkretë** dhe **abstraktë**.

Emrat konkretë shënojnë frymorë dhe sende të numërueshme, që mund të numërohen: libër, mal, lopë, qytet, njeri, shkollë, shtëpi etj. Këta emra mund të marrin numërorë themelorë: një njeri, dy njerëz, një shkollë, tri shkolla, një qytet, katër qytete etj.

Emrat abstraktë janë fjalë që tregojnë veprime, gjendje, cilësi, veçori dhe nocione abstrakte: durim, dyshim, gjelbërim, trimëri, art, kujtesë, liri, lavdi etj. Këta emra zakonisht nuk mund të përdoren në shumës, e as të marrin ndonjë numër themelorë. Kjo më së miri shihet tek emrat që emërtojnë cilësi ose veçori abstrakte: bukuri, egërsi, krenari, mendjemadhësi, zemërgjerësi etj.


Emrat abstraktë, me përjashtim të disa fjalëve, përfshihen në kategorinë e emrave të panumërueshëm, që nuk mund të numërohen.



Detyrë



Lidh secilin nga emrat me grupin të cilit i takon.



Emrat përmbledhës

Midis emrave të përgjithshëm, si grup i veçantë për shkak të veçorive të tyre leksikore e gramatikore, dallohen emrat përmbledhës.

Emrat përmbledhës emërtojnë një tërësi vetash, kafshësh ose sendesh të një lloji, në formën e numrit njëjës, e cila nga pikëpamja sasiore është e panumërueshme (*rinia, djalëria, graria, pleqëria, bota* etj.). Për shembull: *Te sheshi, në mes të fshatit, ishte mbledhur rinia. Graria fliste me gëzim.*

Sipas kontekstit, shpeshherë i njëjti emër mund të ketë kuptimin edhe të një emri abstrakt, edhe të një emri përmbledhës: *djalëri* a) mosha kur njeriu është djalë; b) tërë djemtë e një vendi; *vajzëri* a) mosha përkatëse; b) tërë vajzat e një vendi.

Emrat e lëndës

Në radhën e emrave të përgjithshëm që emërtojnë sende të panumërueshme, si grup më vete dallohen edhe emrat e lëndës. Janë të ngjashëm me emrat përmbledhës.

Nga kuptimi i tyre leksikor emrat e lëndës janë fjalë që emërtojnë prodhime ushqimore, kultura bujqësore, metale e minerale, produkte kimike etj.: *djathë, dhallë, gjizë, kos, mjaltë, qumësht, duhan, grurë, kashtë, të lashtat, të korrat, benzinë, hekur, qymyr, vajguri* etj.

Emrat e lëndës përdoren vetëm në një numër; shumica kanë vetëm formën e numrit njëjës, e disa vetëm atë të shumësit.

Këta emra, edhe pse tregojnë një lëndë që nuk mund të numërohet, ajo mund të matet e të peshohet. Kështu, emrat e lëndës përcaktohen nga fjalë që tregojnë një sasi të pacaktuar, si *shumë, pak, ca: shumë qymyr, pak djathë, ca duhan, pak benzinë* etj.

Detyrë



Emrat e dhënë vendosi në tabelë në kolonën përkatëse:

		Emra përmblëdhës	Emra të lëndës
bota	misër	<input type="text"/>	<input type="text"/>
qumësht	rinia	<input type="text"/>	<input type="text"/>
vajzëria	bakër	<input type="text"/>	<input type="text"/>
të vjela	vajguri	<input type="text"/>	<input type="text"/>
djalëria	graria	<input type="text"/>	<input type="text"/>

Përforcim



Detyra 1: Shkruani fjali duke i kombinuar elementet e dhëna në këtë tabelë. P.sh.:

- Djali quhet Agron;
- Qeni quhet Lesi.

Emrat	njerëz	kafshë	sende	vende
Të përgjithshëm	djalë vajzë fëmijë baba nënë vëlla motër teze hallë gjyshe	qen mace dele qengj papagall lopë	kukull robot	qytet fshat shtet lagje lumë liqen
Të përveçëm	Agron Besa Beni Dritan Luljeta Besnik Laura Shpresa Miranda Hanife	Lesi Keti Bela Riki Koko Lara	Barbi Robi	Shkup Ladorishtë Gjermani Gazi Babë Vardar Ohër



Përforcim



Detyra 2: Lidh secilin nga emrat e përgjithshëm me një emër të përveçëm.

- | | | |
|-----------|----------------------------------|-------------------|
| Shtet | <input checked="" type="radio"/> | “Lugjet e verdha” |
| Qen | <input type="radio"/> | Struga |
| Mace | <input type="radio"/> | Sharr |
| Libër | <input type="radio"/> | Gëzim |
| Qytet | <input type="radio"/> | Anglia |
| Mal | <input type="radio"/> | Keti |
| Shkrimtar | <input type="radio"/> | Dafina |
| Djalë | <input type="radio"/> | Ismail Kadare |
| Rrugë | <input type="radio"/> | Lesi |
| Vajzë | <input type="radio"/> | “Xhon Kenedi” |

Detyra 3: Nënvizoni emrat e përgjithshëm, ndërsa shkruajini me shkronjë të madhe emrat e përveçëm:

domate, pyll, tetovë, maçok, tomi, dhëmb, sharri, mollë, këmishë, brazil, tavolinë, shtëpi, fletore, afërdita, derë, dibra, laps, klasë, mësuese.

Detyra 4: Në secilin grup emrash gjendet një emër abstrakt. Nënvizojeni atë:

derë, lodhje, fletë

libër, laps, mendim


mërzi, telefon, lule

televizor, trimëri, shkollë

top, bankë, dëshirë

habi, kompjuter, dhomë

Detyra 5: Lidh secilin nga emrat me grupin të cilit i takon.



KATEGORITË GRAMATIKORE TË EMRIT

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> • kategoritë gramatikore të emrit: gjinia, numri, trajta dhe rasa. 	<ul style="list-style-type: none"> • t'i identifikojmë format e emrave në gjini, numër, rasë dhe trajtë; • t'i dallojmë emrat ambigjenë.

Emri ka kategoritë gramatikore: **të gjinisë, të numrit, të rasës** dhe **të trajtës** (të shquarsisë dhe të pashquarsisë).

Gjinia e emrit

Emrat në gjuhën shqipe ndahen në tri gjini: në gjininë **mashkullore, femërore** dhe gjininë **asnjanëse**. Shumica e tyre janë të gjinisë mashkullore ose femërore; vetëm një pakicë emrash janë të gjinisë asnjanëse.

Detyrë



Lexoni emrat e mëposhtëm:



laps - lapsi



kompjuter - kompjuteri



libër - libri



ujk - ujku



shah - shahu



ari - ariu



shkollë - shkoll**a**



mollë - moll**a**



orë - or**a**



lule - lul**ja**



shtëpi - shtëpi**a**



piano - piano**ja**

Çfarë mund të vërejmë?

Emrat që mbarojnë në cilëndo qoftë bashkëtingëllore, përveç me *k, g, h*, ndërsa në trajtën e shquar marrin mbaresën *-i* janë të gjinisë mashkullore. Gjithashtu, të gjinisë mashkullore janë edhe emrat që mbarojnë në *k, g, h*, që në trajtë të shquar marrin mbaresën shquese *-u*.

Emrat e gjinisë femërore mbarojnë në zanore, ndërsa në trajtën e shquar marrin mbaresat shquese *-a*, ose *-ja*.



Mbani mend

Emrat që në trajtën e shquar njëjës marrin mbaresat **-i** ose **-u** janë të **gjinisë mashkullore**.

Emrat që në trajtën e shquar njëjës marrin mbaresat **-a** ose **-ja** janë të **gjinisë femërore**.



Të gjinisë asnjësore janë:

- disa emra të prejardhur nga folje. Këta quhen *emra prejfoljorë*, më saktësisht *emra prejpjesorë* dhe
- disa emra të prejardhur nga mbiemra, që quhen *emra prejmbiemrorë*.

folje → emër i gjinisë asnjësore	mbiemër → emër i gjinisë asnjësore
<i>mësoj - të mësuarit</i>	<i>i zi - të zitë</i>
<i>këndoju - të kënduarit</i>	<i>i kuq - të kuqtë</i>
<i>eci - të ecurit</i>	<i>i verdhë - të verdhët</i>
<i>lexoj - të lexuarit</i>	<i>i ftohtë - të ftohtët</i>
<i>flas - të folurit</i>	<i>i bardhë - të bardhët</i>

Formimi i emrave të gjinisë femërore

Emrat femërorë të frymorëve formohen duke u shtuar prapashtesa emrave mashkullore:

1. **Me mënyrën leksikore**, d.m.th. me anë fjalësh me rrënjë të ndryshme: *burrë - grua*, *vëlla - motër*, *djalë - vajzë*, *dajë - teze*, *nip - mbesë*, *dele - dash*, *gjel - pulë*;

2. **Me anë prapashtesash**, të cilat zakonisht i shtohen temës së emrit të gjinisë mashkullore:

- me prapashtesën **-e**: *gjysh - gjyshe*, *mik - mike*, *mjek - mjekë*; *shok - shoqe* etj.; *dibran - dibrane*, *fshatar - fshatare*, *nxënës - nxënëse*, *punëtor - punëtore* etj.;
- me prapashtesën **-eshë**: *doktor - doktoreshë*, *mbret - mbretëreshë*, *luan - luaneshë*;
- me prapashtesën **-ë**: *plak - plakë*, *kunat - kunatë*, *krushk - krushkë*;
- me prapashtesën **-ushë**: *ari - arushë*, *dre - drenushë*.

Emra të dygjinishëm (ambigjenë)

Shumica e emrave në gjuhën shqipe përdoren në një gjini të caktuar, si në njëjës, ashtu edhe në shumës. Vetëm në disa tipa shumësi me prapashtesa ndodh ndërrimi i gjinisë nga mashkullore në femërore. Kështu formohet një grup i veçantë emrash të dygjinishëm, që qëndron midis gjinisë mashkullore dhe femërore. Në këtë grup bëjnë pjesë emrat mashkullore që:

- formojnë temën e shumësit me prapashtesën **-e**: *mal- male*, *qytet - qytete*, *mendim - mendime*, *vend - vende*, *vendim - vendime*;
- formojnë shumësin me prapashtesën **-ra**: *fshat - fshatra*, *mall - mallra*.

Detyrë



Thoni trajtën e shquar të këtyre emrave:

dhëmb, dhomë, dhuratë, adhurim, dardhë, udhë, gjak, gjemb, gjeth, gjoks, gjuhë, lule, lis, lojë, lakuriq, pulë, llambë, llullë, mollë, pyll, njeri, zonjë, rreth, rrugë, rreze, rrezik, shaka, shok, shekull, thanë, thatësi, thelb, thikë, thirrje, xhezve, xhep, ylber, yndyrë, zhurmë.



Formoni trajtën e pashquar të këtyre emrave:

televizori, Arbeni, libri, topi, Teuta, plaku, ora, qershia, radioja, nëna, tigri, luga, natyra, fustani, mësuësja, dardha, zjarri, dielli, miu, shtëpia, këmisha, mali, peshku, gjuha, bregu.



Formoni emra të gjinisë asnjësore nga foljet dhe mbiemrat e dhënë:

- (mësoj) është i domosdoshëm.
- U ngri nga (i ftohtë).
- (këndo) nuk është aspak i lehtë.
- Hoqi (i zi) e ullirit.
- (eci) është i dobishëm për shëndetin.
- (lexoj) para gjumit ndihmon për gjumë të rehatshëm.
- Ndaj (i bardhë) nga (i verdhë) e vezës.
- (fle) është i dobishëm



Nxënësit ndahen në çifte dhe u jepen disa fjali që përmbajnë emra, disa prej të cilëve janë emra ambigjenë (të dygjimshëm), p.sh.: *Mali i lartë qëndronte krenar mbi lumë; **Malet e larta** dukeshin nga larg; **Mendimi i ri** jep edhe shpesë të re; Të gjithë shprehën **mendime të reja**. Prodhimtaria është një **biznes i rëndësishëm**; Viteve të fundit janë zhvilluar **biznese të rëndësishme**.*

Në fletë janë shënuar me shkronja të hijezuara: mal i lartë; malet e larta; mendim i ri; mendime të reja; biznes i rëndësishëm, biznese të rëndësishme. Nxënësit kanë për detyrë ta përcaktojnë gjininë e emrave dhe të diskutojnë për këtë. Ata vijnë në përfundim se disa emra të caktuar në gjuhën shqipe janë të dygjimshëm.

NUMRI I EMRIT

Detyrë



Çfarë shohim në këto fotografi? T'i emërtojmë së bashku.



një libër
libri



shumë libra
librat



një laps
lapsi



dy lapsa
lapsat



një çantë
çanta



tri çanta
çantat



një lule
lulja



disa lule
lulet

Mendoni dhe përgjigjuni

Krahasoni çiftet e emrave të dhënë më lart në numrin njëjës dhe në shumës.
Çfarë vëreni?



Emrat kanë **dy** numra: **numrin njëjës** dhe **numrin shumës**.

Emri është në numrin njëjës kur emërton një njeri, një kafshë a një send.

Në numrin shumës emri tregon dy a më shumë njerëz, kafshë a gjëra.

Edhe në numrin shumës, emri ka trajtën e pashquar dhe të shquar.

Emrat e përveçëm: emrat e njerëzve, të vendeve etj. nuk kanë numër shumës.

Si formohet numri shumës?

1. Disa emra kanë formë të njëjtë, si në njëjës ashtu edhe në shumës. P.sh.:

njëjës	shumës
<i>një nxënës</i>	<i>shumë nxënës</i>
<i>një mësues</i>	<i>shumë mësues</i>
<i>një mace</i>	<i>shumë mace</i>
<i>një shtëpi</i>	<i>shumë shtëpi</i>
<i>një orë</i>	<i>shumë orë</i>

2. Por, shumica e emrave shumësin e formojnë në dy mënyra:

- me prapashtesa dhe
- me ndërrime fonemash (tingujsh).

a) **Formimi i shumësit me prapashtesat:** -e, -a, -ë, -nj, -ër, -enj, -inj, -ra.

njëjës – shumës <i>një - shumë</i>	njëjës – shumës <i>një - shumë</i>
<i>gabim – gabime</i>	<i>ari - arinj</i>
<i>stacion – stacione</i>	<i>lumë – lumenj</i>
<i>mal – male</i>	<i>vëlla – vëllezër</i>
<i>vajzë – vajza</i>	<i>numër – numra</i>
<i>top – topa</i>	<i>pulë – pula</i>
<i>emër – emra</i>	<i>kushëri – kushërinj</i>
<i>motër – motra</i>	<i>shqiptar – shqiptarë</i>
<i>arsimtar – arsimtarë</i>	<i>fshat – fshatra</i>
<i>shok – shokë</i>	<i>njeri - njerëz</i>

Detyrë

Thoni këta emra në të dy format.

p.sh.; një gabim - shumë gabime

b) **Formimi i shumësit me ndërrime fonemash:** a > e, k > q, g > gj; r, l, ll > j + e.

njëjës – shumës <i>një - shumë</i>	njëjës – shumës <i>një - shumë</i>
<i>plak – pleq</i>	<i>popull – popuj</i>
<i>armik – armiq</i>	<i>bir – bij</i>
<i>bujk – bujq</i>	<i>mashkull – meshkuj</i>
<i>mik – miq</i>	<i>dash – desh</i>
<i>peshk – peshq</i>	<i>natë – net</i>
<i>zog – zogj</i>	<i>rreth – rrathë</i>
<i>treg – tregje</i>	<i>vit - vjet</i>

Detyrë

Thoni këta emra në të dy format.

p.sh.; një plak - dy pleq



Ushtrime



Me emrat: *libër, fletore, laps, shtëpi, gomë, mace* formoni fjali sipas shembullit më poshtë:

Unë kam një shok. - Ti ke dy shokë.

Unë kam një libër. - Ti ke dy libra.

Unë kam një laps. - Ti ke shumë lapsa.

Detyrë



Formoni shumësin e emrave:

këmbë, arkë, popull, sportist, mollë, rrezik, ulli, mik, lule, aparat, dollap, portokall, lumë, avull, breg, zile, lexues, ftua, muaj, kat, bilbil, shkallë, radio, gjarpër, shtëpi.

P.sh.: një këmbë - dy këmbë



Ndajini emrat në dy grupe: njëjës dhe shumës.

vite, analizë, kanale, qilim, mure, dallëndyshe, zemër, divan, laboratorë, gjemb, lapsa, vizatime, kolltukë, duar, pasqyrë, jorgan.

Emra në numrin njëjës

Emra në numrin shumës

TRAJTA E EMRIT

Me trajtë të emrit kuptojmë pashquarsinë dhe shquarsinë e emrit, e që përbëjnë një kategori gramatikore të veçantë të tij.

Emrat, si në njëjës ashtu edhe në shumës, përdoren në dy trajta:

- a) në *trajtë të pashquar* dhe
- b) në *trajtë të shquar*.

Emri në trajtën e pashquar tregon qenie, sende ose dukuri në mënyrë të përgjithësuar, të papërcaktuar. P.sh.: *një nxënës, një punëtor, një mendim, një mace, një laps* etj.

Emri në trajtën e shquar tregon qenie, sende ose dukuri të veçuara nga gjërat e tjera të llojit të vet. P.sh.: *nxënësi, punëtori, mendimi, macja, lapsi* etj.

Formë përfaqësuese apo bazë e emrit është trajta e pashquar, numri njëjës, rasa emërore: *djalë, vajzë, shkollë, lule, letër, njeri, kompjuter, lepur, qen, piano* etj.

Trajta e shquar e emrit formohet duke i shtuar formës përfaqësuese nyjën shquese, përkatësisht mbaresën:

- a) për emrat e gjinisë mashkullore **-i** ose **-u** dhe
- b) për emrat e gjinisë femërore **-a** ose **-ja**.

Për emrat e gjinisë asnjane dhe për shumësin e të dy gjinive shtojmë mbaresën **-t(ë)**.

Nëse këtë e paraqesim në formë tabelore, do të fitojmë këtë skemë:

<i>gjinia mashkullore - njëjës</i>	<i>gjinia femërore - njëjës</i>	<i>gjinia mashkullore e femërore - shumës dhe gjinia asnjane</i>
-i, -u	-a, -ja	-t(ë)

Detyrë



Shkruani trajtën e shquar ose të pashquar të këtyre emrave në njëjës ose në shumës.

dritare - _____ lapsa - _____ mjekë - _____

mali - _____ punëtor - _____ aeroplani - _____

shtëpia - _____ libër - _____ palltoja - _____

studentë - _____ dyqane - _____ çantë - _____

klasë - _____ rruga - _____ banka - _____



RASAT E EMRIT

Detyrë



Lexojeni këtë anekdotë. Gjeni dhe nënvizoni emrat.

Një ditë një mik i Nasradinit shkoi në shtëpi të këtij për t'i kërkuar të holla hua. Nasradini ishte shtrirë në kanape dhe po pushonte. Si ndenjën pak, miku i thotë Nasradinit.

- Të kam pasur mik dhe do të kem për jetë. Si mik të ngushtë që të kam, të lutem të më japësh ca para për një afat të shkurtër.
- Nasradini menjëherë i tha:
- Para nuk mund të të jap, por meqë je miku im, afat të jap sa të duash.

Shpjegim

Emri në fjali mund të përdoret si *kryefjalë*, si *pjesë plotësuese e kryefjalës* ose *e kallëzuesit*, *kundrinë e drejtë* ose *e zhdrejtë*, *përcaktor*, *rrethanor*, *ndajshim* etj. Në varësi nga kjo ndryshon edhe forma e tij. Në këtë anekdotë, emri Nasradin është përdorur:



1. Si kryefjalë: (*kush?*, *cili?*) **Nasradini**.
2. Si pjesë plotësuese e kryefjalës: Miku (*i kujt?*, *i cilit?*) **i Nasradinit**.
3. Si pjesë plotësuese e kallëzuesit: Miku e takoi (*kë?*, *cilin?*) **Nasradinin**.

Format e ndryshme që merr emri, duke u lidhur me fjalë të tjera në fjali, quhen **rasa**. Ndryshimi i emrit nëpër rasa quhet **lakim**.

Gjuha standarde shqipe ka pesë rasa:

1. emërore;
2. gjinore;
3. dhanore;
4. kallëzore;
5. rrjedhore.

Mendoni dhe përgjigjuni

- Çfarë do të ndodhte po të mos kishte rasa në gjuhën shqipe?
- Cila gjuhë nuk ka rasa?





Rasa emërore

Siç dihet, rasa emërore, trajta e pashquar, numri njëjës është tema bazë e emrit. Format e kësaj rase i kemi mësuar kur kemi bërë fjalë për gjininë dhe shquarsinë e emrave, ku kemi thënë që emri, në rasën emërore në trajtën e shquar merr këto mbaresa:

- a) për gjininë mashkullore **-i** ose **-u** (*laps-i, mal-i, nxënës-i; shok-u, mik-u, breg-u*);
- b) për gjininë femërore **-a** ose **-ja** (*klasë-a, bankë-a, fletor-e, -ja, lul-e, -ja*).

Në numrin shumës për emrat e të dy gjinive prapavendosim mbaresën **-t(ë)** (*lapsa-t, shokë-t; klasa-t, lule-t, shtëpi-të, kuti-të*).

Rasa emërore zakonisht përdoret pa parafjalë, por shpesh mund të shoqërohet edhe me parafjalët **nga, te, tek**.

Kjo rasë gjithnjë gjendet me përemrat pyetës: **kush?; cili?; cila?** për njëjës dhe **cilët?, cilat?** për numrin shumës.

Rasat nuk mund të përvetësohen në mënyrë të shkëputur nga konteksti që kanë në fjali, por duhet ta vështrojmë nga forma e saj dhe nga funksioni që kryen në fjali. Secila rasë ka dy e më shumë funksione. Pra, duhet ta ndërlihim formën e fjalës me funksionin që e kryen në fjali. P.sh.:

Mësuesi ia dha librin nxënësit.

- 1 2 3

- 1 - emër në rasën emërore - **kryefjalë e fjalisë,**
- 2 - emër në rasën kallëzore - **kundrinë e drejtë,**
- 3 - emër në rasën dhanore - **kundrinë e zhdrejtë.**

Rasa gjinore

Rasa gjinore çdo herë është e njëjtë me dhanoren, e nganjëherë edhe me rrjedhoren; por dallohet ngase kurdoherë gjinorea i paraprin një nyjë e përparme: **i, e, të, së**. Rasa gjinore çdo herë është e varur.

Emri në këtë rasë gjendet me pyetjet **i, e kujt?; i, e cilit?; i, e cilës?; i, e cilëve?; i, e cilave?** dhe gjithnjë përdoret pa parafjalë.

P.sh.: *Ngjyrat e kujt? e cilit? – Ngjyrat e trëndafilit. Gjethet e kujt? e cilit? – Gjethet e lules* për numrin njëjës dhe *Ngjyrat e trëndafilave; Gjethet e luleve* për numrin shumës.

Detyrë



Plotësoni fjalitë me emra në rasën gjinore.

në numrin njëjës

- Ngjyrat trëndafil.....
- Gjethet lule.....
- Librat nxënësi.....
- Ditët javë.....
- Gishtat dorë.....
- Ditët festë.....
- Pantallonat çuni.....
- Lodrat fëmijë.....

në numrin shumës

- Ngjyrat trëndafila.....
- Gjethet lule.....
- Librat nxënës.....
- Këngët zogj.....
- Gishtat duar.....
- Ditët festa.....
- Pantallonat çuna.....
- Lodrat fëmijë.....



Rasa dhanore

Emri në rasën dhanore përdoret kur është kundrinë e zhdrejtë e një foljeje dhe shoqërohet me një trajtë të shkurtër. Foljet më të shpeshta që hasen me këtë rasë janë: *jap, pëlqej, bie, tregoj, them, dhemb* etj. Kjo rasë gjendet me pyetjet: *kujt?, cilit?, cilës?, cilëve? cilave?*

Për nga forma, rasa dhanore është plotësisht e njëjtë me emrin në rasën gjinore me përjashtim të nyjës së parme (**i, e, të, së**). D.m.th. trajtat e emrave që i mësuam më parë plotësisht përputhen me rasën dhanore, por pa nyjat e përparme. Gjithashtu duhet të dimë se kjo rasë nuk shoqërohet me parafjalë.

Zakonisht rasa dhanore shoqërohet me një trajtë të shkurtër, që vendoset diku para emrit, e më shpesh para foljes. Ato janë **mua më, ty të, atij i; neve na, juve ju, atyre u**. Për shembull: ***Mua më pëlqen, ty të pëlqen, atij i pëlqen; neve na pëlqen, juve ju pëlqen, atyre u pëlqen.***

Detyrë



Ndërtoni fjali me foljet *tregon, thotë, dhemb*.

Rasa kallëzore

Rasa kallëzore ka dy forma: pa parafjalë dhe me parafjalë. Funkcioni kryesor i rasës kallëzore pa parafjalë është për të treguar frymorin ose sendin të cilin e përfshin veprimi i foljes.

Në sintaksë kjo gjymtyrë e fjalisë quhet kundrinë e drejtë. Format me parafjalë përdoren jo për të treguar objektin themelor të fjalisë, por për të plotësuar një gjymtyrë të saj. Kallëzorja e shqipes i merr këto parafjalë: **në, mbi, nën, me, pa, për** etj.

Kjo rasë gjendet me pyetjet: **kë?, cilin?, cilën?, cilët?, cilat?**

Rasa kallëzore shumë shpesh përdoret në bashkëvajtje me trajtat e shkurtra të përemrave vetorë të rasës kallëzore: **mua më, ty të, atë e** - për njëjës dhe **ne na, ju ju, ata i, ato i** - për numrin shumës. Për shembull: ***mua më pyeti, ty të pyeti, atë e pyeti; ne na pyeti, ju ju pyeti, ata i pyeti, ato i pyeti.***

Detyrë



Ndërtoni fjali me foljet *pa, do, këshillon*.



Rasa rrjedhore

Rasa rrjedhore kryen funksione të ndryshme. Zakonisht tregon frymorin ose sendin prej të cilit rrjedh, largohet ose ndahet diçka. Ajo veç kësaj, mund të tregojë edhe shkakun, mjetin, vendin ose kohën e veprimit.

Rrjedhorja përdoret me parafjalë dhe pa parafjalë.

Siç dihet, rasa rrjedhore ngërthen në vete një numër të madh parafjalësh, si: **prej, ndaj, kundër, majë, rreth, buzë, rrëzë, midis; afër, larg, drejt, krahas; përveç, sipas** etj. P.sh.: *Erdhën prej fshatit. Delegacioni i Maqedonisë sot kthehet prej Bullgarisë. Treni nisjet prej Selanikut në orën tetë. Disa prej shokëve do të bëhen mjekë. U zgjua prej gjumit. Kjo shtëpi është bërë prej gurësh. E dallova prej zërit.*

Kjo rasë gjendet me pyetjet: **prej kujt?, prej cilit?, prej cilës?, prej cilëve?, prej cilave?**

Për nga forma, rrjedhorja është shumë e përafërt me rasën gjinore e dhanore. Dallimi i vetëm është te numri shumës, trajta e pashquar, ku të gjithë emrat marrin mbaresën **-sh**.

Detyrë



Në fjalitë e poshtëshënuara gjeni dhe nënvizoni emrat e rasës rrjedhore.

- Ai punonte prej mëngjesit deri në mbrëmje.
- Kashta u dogj prej vapës.
- E kam kujtim prej nënës.
- Treni udhëtonte me shpejtësi prej 80 km në orë.
- Mori letër prej motrës.
- Gjoni ka qëndrim korrekt ndaj punës.
- Të parët tanë luftuan kundër armikut.
- Sipas projektit janë paraparë 8 dhoma.
- Ajo flet sipas dëshirës.
- Buzë detit u ndërtua një hotel.
- Ai erdhi afër dritares.
- Ata i ngritën çadtrat pranë lumit.
- Viçi rrinte larg lopës.



Përforcim



Detyra 1. Përdoreni emrin **gjysh** nëpër rase në këtë tekst.

- (kush?, cili?) na foli për të kaluarën tonë të lavdishme.
- Rrëfimi (i kujt?, i cilit?) na pëlqeu shumë.
- Ne iu lutëm (kujt?, cilit?) të na tregonte edhe një përrallë tjetër.
- Në fund e falënderuam (kë?, cilin?) dhe iu lutëm të vinte përsëri.
- Nuk na bëhej të largoheshim (prej kujt?, prej cilit?)

Detyra 2. Lakojeni emrin **Blertë** sipas kërkesave të tekstit.

- (kush?, cila?) është nxënëse.
- Babai (i kujt?, i cilës?) është mjek, ndërsa nëna (e kujt?, e cilës?) është mësuese.
- (kujt?, cilës?) i pëlqejnë shumë çokollatat.
- (kë?, cilën?) e duan të gjitha shoqet.
- (prej kujt?, prej cilës?) Prej mora një letër.

Detyra. Gjeni emrat në fjalitë e dhëna më poshtë dhe përcaktoni rasat e tyre.

P.sh.: Mentori mori prej bankës vizoren e Vjollcës dhe ia dha Gazmendit.

(kush)	Mentori - rase emërore
(prej ku?)	prej bankës - rase rrjedhore
(kë? cilën?)	vizoren - rase kallëzore
(e kujt?)	e Vjollcës - rase gjinore
(kujt?)	Gazmendit - rase dhanore

- Agimi e zuri fluturën dhe ia tregoi Vjollcës.
- Zana e pa qenin e Dianës në parkun e qytetit.
- Babai doli nga shtëpia e mësuesit dhe i hipi veturës.
- Mësuesja nxori nga xhepi i palltos stilolapsin dhe ia dha koleges.
- Nëpunësi mori prej dollapit makinën e shkrimit dhe e la mbi tavolinë.



MBIEMRI

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> • llojet e mbiemrave: të nyjshëm dhe të panyjshëm; cilësorë dhe marrëdhëniore; • kategoritë gramatikore të mbiemrave: gjinia, numri dhe rasia; • shkallët e mbiemrave: pohore, krahasore dhe sipërore. 	<ul style="list-style-type: none"> • të përdorim drejt mbiemrat në të shprehurit me gojë dhe me shkrim; • të identifikojmë dhe përdorim drejt mbiemrat cilësorë; • të ndërtojmë fjali emër me mbiemër që të përputhen në gjini, numër dhe rasë; • të përdorim drejt shkallët krahasore dhe sipërore.

Lexojeni këtë fjali. Çfarë janë fjalët me të zeza?

*E ëma e Agronit ishte **energjike** dhe **e zgjuar**, **e butë** dhe **e ëmbël**.*

Fjalët që tregojnë cilësinë e emrave dhe plotësojnë kuptimin e tyre quhen **mbiemra**.

Mbiemri përshtatet në gjini, në numër e rasë me emrin të cilin e përcakton. Ai ka kategoritë gramatikore të **gjinisë**, të **numrit**; ndërsa mbiemrat e nyjshëm edhe kategorinë e **rasës**. Veç kësaj, mbiemri ka edhe kategorinë e **shkallës**, të cilën emri nuk e ka.

Përshtatja e mbiemrit me emrin

Mbiemri merr gjininë, numrin dhe rasën e emrit të cilin e përcakton.

Klasifikimi i mbiemrave

Mbiemrat klasifikohen sipas dy kritereve:

- 1) sipas **kuptimit leksikor** dhe
- 2) sipas **veçorive morfologjike**.

Sipas *kuptimit leksikor*, mbiemrat ndahen në dy grupe:

- **mbiemra cilësorë** dhe
- **mbiemra marrëdhëniore**.

Mbiemrat cilësorë tregojnë veti a cilësi që kapen drejtpërdrejt nga shqisat tona, si:

ngjyrë: *e bardhë, e kuqe, e gjelbër;*

formë ose madhësi: *e vogël, e madhe, e gjatë, e hollë, e rrumbullakët;*

shije: *e ëmbël, e shijshme, e hidhur, e thartë;*

veti fizike ose gjendje shpirtërore: *e butë, e re, e njomë, e lumtur;*

cilësi karakteri ose mendore: *besnike, dinake, e zgjuar, e turpshme.*



Mbiemrat marrëdhëniorë tregojnë tiparin a llojin e sendit, si:

- **lëndën nga e cila përbëhet sendi:** *bluzë e pambuktë, unazë e artë, derë e hekur;*
- **kujt i përket sendi:** *shtëpi atërore, plane shtetërore, trup qiellor;*
- **marrëdhënien e një sendi me një veprim:** *gisht tregues, makinë korrëse;*
- **marrëdhënien e një sendi me një çast kohor:** *gazetë e sotme, ngjarje e djeshme;*
- **marrëdhënien e një sendi me një pikë hapësinore:** *pamje e jashtme, kati i sipërm;*
- **marrëdhënien e një sendi me një numër:** *viti i dytë, kati i tretë, radha e tetë.*

Një prej veçorive morfologjike që i karakterizon mbiemrat e Gjuhës shqipe është nyjzimi. Sipas kësaj veçorie, mbiemrat ndahen në dy grupe: **të nyjshëm** dhe **të panyjshëm**.

Mbiemrat e nyjshëm i kanë nyjat **i, e, të** në rasën emërore; kurse mbiemrat e panyjshëm nuk kanë një të paravendosur. Nyja të mbiemrat e nyjshëm është pjesë përbërëse e tyre dhe nuk mund të mungojë në asnjë rast.

Mbiemrat në gjuhën shqipe zakonisht përdoren pas emrave. P.sh.: *djalë i mirë, vajzë e sjellshme, lule e bukur, shkollë e madhe* etj., ndërsa çdo emër mund të lidhet me një ose me dy mbiemra.

Detyrë



Rishkruani mbiemrat: *i mirë, e bukur, magjike, i gëzuar, simpatike, tërheqës, të mrekullueshëm, gazmor, i lumtur, mendjehollë* në kolonat përkatëse.

mbiemra të nyjshëm

mbiemra të panyjshëm



Rishkruani mbiemrat: *i bardhë, e kuqe, i leshtë, e artë, katrore, e bukur, e sotme, i dytë, i thartë, besnik* në kolonat përkatëse.

mbiemra cilësorë

mbiemra marrëdhëniorë



Gjinia e mbiemrit

Mbiemrat e nyjshëm e bëjnë gjininë femërore nga gjinia mashkullore në disa mënyra:

- duke ndryshuar vetëm nyjën e përparme, p.sh.: *një top i vogël* - *një gotë e vogël*;
- duke e ndryshuar nyjën e përparme e duke marrë mbaresën -e: *një yll i kuq* - *një shami e kuqe*;
- duke ndryshuar nyjën e përparme dhe zanoren e temës: *një djalë i ri* - *një vajzë e re*; *një dash i zi* - *një dele e zezë*.

Mbiemrat e panyjshëm e bëjnë gjininë femërore nga gjinia mashkullore në dy mënyra:

- duke marrë mbaresën -e: *njeri dinak* - *dhelpër dinake*; *pushim veror* - *fruta verore*;
- një numër mbiemrash nuk e ndryshojnë fare formën e gjinisë mashkullore, p.sh.: *babë zemërbardhë* - *nënë zemërbardhë*; *vëlla dorëlibër* - *motër dorëlibër*.

Detyrë



Mbiemrat e dhënë të gjinisë mashkullore ktheni në gjininë femërore. *i bashkuar, fisnik, i këputur, zemërgjerë, i pandarë, i përparshëm, ujqor, vjeshtor, popullor, kryeneç, i papërdorshëm, malor, shkollor, i zi, i ri, i dendur, dembel.*

Numri i mbiemrit

Numri i mbiemrit varet nga numri i emrit të cilit i përket. Kjo do të thotë se kur emri është në njëjës, edhe mbiemri duhet të jetë në njëjës. Kur emri është në shumës, edhe mbiemri duhet të përdoret në shumës.

Formimi i shumësit të mbiemrave të nyjshëm të gjinisë mashkullore

Mbiemrat e nyjshëm të gjinisë mashkullore shumësin e bëjnë në tri mënyra:

1. duke e shndërruar vetëm nyjën i në të. P.sh.:

një libër i mirë - *disa libra të mirë*
një djalë i zellshëm - *disa djem të zellshëm*

2. duke ndryshuar nyjën i në të dhe duke marrë mbaresën -nj:

një djalë i ri - *disa djem të rinj*
një laps i zi - *disa lapsa të zinj*

3. duke e bërë shumës nyjën dhe duke e ndryshuar rrënjën e mbiemrit:

një njeri i madh - *disa njerëz të mëdhenj*
një njeri i vogël - *disa njerëz të vegjël*
një njeri i keq - *disa njerëz të këqij*
një njeri i lig - *disa njerëz të ligj*



Formimi i shumësit të mbiemrave të nyjshëm të gjinisë femërore

Edhe mbiemrat e nyjshëm të gjinisë femërore shumësin e bëjnë nga forma e njëjës në tri mënyra:

1. duke bërë shumës nyjën e në të:

një punë e këndshme - disa punë të këndshme

një notë e kalueshme - disa nota të kalueshme

2. duke bërë shumës nyjën e në të dhe duke marrë mbaresën -a:

një vjershë e bukur - disa vjersha të bukura

një statujë e drunjte - disa statuja të drunjta

3. duke bërë shumës nyjën dhe duke ndryshuar rrënjën:

një fjalë e keqe - disa fjalë të këqija

një shtëpi e madhe - disa shtëpi të mëdha

një shkollë e re - disa shkolla të reja

Detyrë



Shkruani këta mbiemra në numrin shumës.

e qetë -	i lumtur -
i kënaqur -	e pikëlluar -
e hidhëruar -	e madhe -
i kuq -	i zi -
e tmerrshme -	i vetëm -
bardhoshe -	dinak -
ushtarak -	përtace -

Detyrë



Shkruani këta mbiemra në numrin njëjës.

të bardha -	të rinj -
të mirë -	të mëdhenj -
të vjetra -	të pambukta -
të gjatë -	të vegjël -
të vështira -	të gabuara -

Kategoria e rasës te mbiemrat

Mbiemrat e panyjshëm kur vendosen pas emrit që e përcaktojnë, nuk pësojnë ndonjë ndryshim në rasë, domethënë nuk lakohen. P.sh.:

*një djalë **punëtor**, i një djali **punëtor**;*

*djali **punëtor**, i djalit **punëtor**;*

*një vajzë **punëtore**, i një vajzeje **punëtore**;*

*vajza **punëtore**, i vajzës **punëtore** etj.*

E njëjta gjë ndodh edhe me trupin e mbiemrave të nyjshëm, por këta sipas rasës ndryshojnë nyjën, e cila është pjesë e pandashme e mbiemrit.

Lakimi i një emri me një mbiemër të nyjshëm

Gjinia mashkullore

Numri	Rasa	Emri i pashquar	Emri i shquar
Njëjës	E. Gj. Dh. K. Rr.	(një) shok i mirë i (e) (një) shoku të mirë (një) shoku të mirë (një) shok të mirë (një) shoku të mirë	shoku i mirë i (e) shokut të mirë shokut të mirë shokun e mirë shokut të mirë
Shumës	E. Gj. Dh. K. Rr.	(ca) shokë të mirë i (e) (ca) shokëve të mirë (ca) shokëve të mirë (ca) shokë të mirë (ca) shokësh të mirë	shokët e mirë i (e) shokëve të mirë shokëve të mirë shokët e mirë shokëve të mirë

Gjinia femërore

Numri	Rasa	Emri i pashquar	Emri i shquar
Njëjës	E. Gj. Dh. K. Rr.	(një) vajzë e bukur i (e) (një) vajze të bukur (një) vajze të bukur (një) vajzë të bukur (një) vajze të bukur	vajza e bukur i (e) vajzës së bukur vajzës së bukur vajzën e bukur vajzës së bukur
Shumës	E. Gj. Dh. K. Rr.	(ca) vajza të bukura i (e) (ca) vajzave të bukura (ca) vajzave të bukura (ca) vajza të bukura (ca) vajzash të bukura	vajzat e bukura i (e) vajzave të bukura vajzave të bukura vajzat e bukura vajzave të bukura



Detyrë



Lakoni emrat me mbiemra sipas tabelës së dhënë.

- një kalendar i ri;
- një veturë e re;
- një trëndafil i kuq;
- një çantë e kuqe.

Kategoria e shkallës te mbiemrat

Cilësia e sendeve mund të shprehet në mënyrë të shkallëzuar. P.sh.:

Liqeni është i madh.

Deti është më i madh.

Oqeani është shumë i madh.

Pra, mbiemri ka tri shkallë: *shkallën pohore, krahasore dhe sipërore.*

1. **Shkalla pohore** është shkalla bazë e mbiemrit dhe emërton tiparin e sendit, jashtë çdo krahasimi. P.sh.: *i mirë, e bardhë, të verdhë* etj.

2. **Shkalla krahasore** tregon se cilësia e dhënë krahasohet me vetveten ose me një cilësi tjetër. P.sh.:

Mësuesi ishte po aq i rreptë, sa edhe i mirë.

Ajo është më e re se motra ime.

Sa më shumë largohej treni, aq më i vogël dukej.

Ai ishte më i riu dhe më i miri nga ne.

3. **Shkalla sipërore** e mbiemrit tregon se cilësia e dhënë është në një shkallë shumë të lartë, jashtë çdo krahasimi. Rëndom, shkalla sipërore formohet me ndajfoljet: *shumë, jashtëzakonisht, mjaft, tepër, fort, krejt, fare, absolutisht* etj. P.sh.:

Midis reve dukej qielli shumë i kaltër.

Kjo fjalë ka domethënie jashtëzakonisht të madhe.

Stacioni është fare i ri.

Oborri tani iu duk shumë-shumë i vogël.

Detyrë



Mbiemrat në kllapa vini në shkallën krahasore.

- Sot dita është (e bukur) se dje.
- Vetura ime është (e shpejtë) se vetura jote.
- Rrushi i zi është (i ëmbël) se rrushi i bardhë.
- Dhoma e ditës është (e madhe) se dhoma e gjumit.
- Denisi është (i gjatë) se Agimi.



Detyrë



Mbiemrat në kllapa vini në shkallën sipërore.

- Arta ka një shoqe (e mirë).
- Merita është (e bukur).
- Banesa jonë ka një ballkon(i madh).
- Blendi ka një qen (i rrezikshëm).
- Në muajin korrik ditët janë (e nxehtë)

Përforcim

Detyrë: Lidhni emrat e kolonës së parë me mbiemrat e kolonës së dytë.



shkollë	i sjellshëm
lule	besnik
vajzë	e pastër
gjuhë	e re
djalë	e bukur
nxënës	punëtore
klasë	amtare
mollë	i mirë
nënë	e ëmbël
qen	e dashur
dhelpër	i nderuar
mik	dinake

Detyrë: Bëni radhitjen e duhur të emrit me mbiemrin.

- besnik djalë - _____ e bukur vajzë - _____
- dimëror kostum - _____ i lexuar libër - _____
- shoqe e nderuara - _____ i lartë mal - _____
- amtare gjuhë - _____ e bardhë bluzë - _____
- nënë e dashura - _____ javore gazetë - _____

Detyrë: Gjeni dhe nënvizoni mbiemrat që tregojnë cilësinë e portokallit.

Portokalli është një pemë freskuese. Druri i tij është i lëmuar, me degë të holla e me gjemba të gjatë. Gjethet i ka të mëdha. Ngjyra e tyre është e gjelbër dhe e errët. Kokrra e portokallit është e rrumbullakët e me bisht të shkurtër. Kur piqet, merr ngjyrë të verdhë dhe lëngu i ëmbëlsohet. Portokalli është pemë detare, ajo kërkon klimë të butë e të ngrohtë. Dimri i ftohtë e dëmton këtë pemë frutore, të pasur me vitamina.



Përforcim



Detyrë: Zgjidhe njërën nga trajtat e dhëna të mbiemrit dhe vendose në fjali.

- | | |
|------------------------|-----------------------------------------------|
| Klasa është | 1. (i madh, e madhe, të mëdhenj, të mëdha) |
| Klasat janë | |
| Muri është | 2. (i bardhë, e bardhë, të bardhë, të bardha) |
| Muret janë | |
| Bleta është | 3. (punëtor, punëtorë, punëtore) |
| Bletët janë | |
| Trëndafili është | 4. (i kuq, e kuqe, të kuq, të kuqe) |
| Trëndafilat janë | |
| Libri është | 5. (i ri, e re, të rinj, të reja) |
| Librat janë | |
| Lulja është | 6. (i bukur, e bukur, të bukur, të bukura) |
| Lulet janë | |
| Stilolapsi është | 7. (i zi, e zezë, të zinj, të zeza) |
| Stilolapsat janë | |
| Ora është | 8. (i vogël, e vogël, të vegjël, të vogla) |
| Orët janë | |

PËREMRI VETOR

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> • kategoritë gramatikore të përemrave vetorë: veta, numri, gjinia dhe rasa; • trajtat e shkurtra; • kategoritë gramatikore të përemrave dëftorë: gjinia, numri dhe rasa. 	<ul style="list-style-type: none"> • të njohim rolin e përemrave vetorë në fjali; • t'i identifikojmë përemrat vetorë në njëjës dhe shumës në një tekst të caktuar; • t'i përdorim drejt trajtat e shkurtra të përemrave vetorë në situata konkrete; • të njohim dhe t'i identifikojmë përemrat dëftorë ai, ajo - ata, ato nga përemrat vetorë të vetës së tretë ai, ajo - ata, ato.

Përemra vetorë janë fjalët që tregojnë veta të ndryshme. Ata kanë tri veta.

Përemrat vetorë të vetës së parë: njëjës *unë*, shumës *ne*, tregojnë vetën që flet, përkatësisht një grup vetash ku bën pjesë edhe folësi.

Përemrat vetorë të vetës së dytë: njëjës *ti*, shumës *ju*, tregojnë vetën me të cilën flasim, bashkëbiseduesin, përkatësisht bashkëbiseduesit.

Përemrat *ai, ajo* njëjës dhe *ata, ato* shumës janë të vetës së tretë dhe tregojnë frymorët dhe sendet për të cilët bëhet fjalë.

Përemrat vetorë të vetës së parë dhe të dytë (*unë, ti; ne, ju*) përdoren për të dy gjinitë dhe vetëm për njerëz, kurse ata të vetës së tretë (*ai, ajo; ata, ato*) kanë forma të veçanta për gjini të ndryshme dhe përdoren edhe për kafshë e sende.

Ushtrim



Gjeni dhe nënvizoni përemrat vetorë në tekstin e mëposhtëm.

Unë jam Beni. Ne banojmë në qendër të qytetit. Unë para një viti mbarova klasën e pestë me rezultate shumë të mira. Babai u gëzua shumë.

Ai nuk dinte ç'të bënte, kurse mami sa s'fluturonte nga gëzimi. Ajo më puthte vazhdimisht...

Babi dhe mami donin të më blinin një dhuratë.

Unë u thashë:

- Ju më mirë më blini një top...

- E di unë, gjithmonë top do ti, - tha mami.

Ata ecnin para dhe unë mbeta prapa. Mami kundërshtonte. Më në fund ajo më bleu dy libra me përralla, por edhe një top. Unë u gëzova shumë.



Përemrat vetorë të vetës së tretë e kanë si kategorinë e **gjinisë**, ashtu edhe atë të numrit: *ai, ajo - ata, ato*; ndërsa kategorinë e **rasës** e kanë të gjithë përemrat vetorë.

Pasqyra e lakimit të përemrave vetorë

Numri	Rasa	Veta e parë	Veta e dytë	Veta e tretë	
				Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
njëjës	Emërore	unë	ti	ai	ajo
	Gjinore	---	---	i atij	i asaj
	Dhanore	mua, më	ty, të	atij, i	asaj, i
	Kallëzore	mua, më	ty, të	atë, e	atë, e
	Rrjedhore	(prej) meje	(prej) teje	(prej) atij	(prej) asaj

Numri	Rasa	Veta e parë	Veta e dytë	Veta e tretë	
				Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
shumës	Emërore	ne	ju	ata	ato
	Gjinore	---	---	i atyre	i atyre
	Dhanore	neve, na	juve, ju	atyre, u	atyre, u
	Kallëzore	ne, na	ju, ju	ata, i	ato, i
	Rrjedhore	(prej) nesh	(prej) jush	(prej) atyre	(prej) atyre

Çfarë përfundimesh mund të nxjerrim nga kjo tabelë?

1. Në rasat dhanore dhe kallëzore përemrat kanë dy trajta: një trajtë të plotë e një trajtë të shkurtër.
2. Për të gjetur rasat e përemrave vetorë, ashtu si edhe për emrat, përdorim pyetjet: *kush?; i, e kujt?, kujt?, kë?, prej kujt?, cili?* etj.
3. Trajtat e shkurtra të vetës së parë e të dytë (njëjës e shumës) në rasat dhanore e kallëzore janë të njëjta.
4. Veta e parë dhe e dytë e përemrave vetorë nuk përdoren në rasën gjinore.
5. Në rasat kallëzore dhe rrjedhore të vetës së tretë përdoren dhe trajtat e paplota, pa zanoren **-a** të fillimit. Këto trajta përdoren pas parafjalëve, p.sh.: *me të, foli me të, prej saj, para tij, kundër tyre, për ta...*

Detyrë

Zëvendësoni përemrat vetorë me emrat përkatës.

Në strehën e shtëpisë sonë dallëndyshet bëjnë folenë vit për vit. **Ato** shkojnë e vijnë me shpejtësi, punojnë pa u lodhur.

Blerta i do shumë dallëndyshet. **Ajo** kënaqet kur u shikon gushën e larme. Një ditë Blerta pa një dallëndyshe të vogël. **Ajo** u përpoq të fluturonte, por ra në tokë. Blerta pa macen. **Ajo** donte ta kapte. Por gjyshja i bërtiti:

- Pëst, moj Pambuke!

Macja e ka frikë **atë**. Blerta mori shkallën. **Ajo** hipi në shkallë duke e mbajtur me kujdes dallëndyshen e vogël në njëren dorë, dhe e vuri **atë** ngadalë në fole.


Trajtat e shkurtra të përemrit vetor

Krahas trajtave të plota, në rasat dhanore e kallëzore përemrat vetorë kanë edhe trajta të shkurtra.

Trajtat e shkurtra janë të patheksuara dhe vihen gjithmonë pranë foljes.

*Nëna e përcjell **djalin** deri te shkolla, e puth **atë** në ballë dhe e porositi të mësojë mirë.*

Pra, përemri **atë** dhe vetë trajta e shkurtër **e** zënë vendin e emrit **djalin**.

Trajtat e shkurtra qëndrojnë pranë foljes. Zakonisht ato vendosen para saj, por mund t'i ngjiten pas ose të futen në trup të saj. P.sh.:

- **E** mora librin.

- **Merre** librin.

- **Merreni** librin.

Trajtat e shkurtra të vetës së parë dhe të dytë (njëjës e shumës) në dhanore e kallëzore janë të njëllajta:

Dhanore: më, të, i, na, ju, u

Kallëzore: më, të, e, na, ju, i

Për të dalluar rasën e tyre përdorim pyetjet: **kujt?** ose **cilit?** (për dhanoren) **kë?** ose **cilin?** (për kallëzoren). P.sh.:

(**kujt?**) **Mua më** dhanë fletëlavdërimin (**ty të; juve ju**).

(**kë?**) **Mua më** lavdëruan (**ty të, ju ju**).

Në vetën e tretë trajtat e shkurtra janë të njëllajta për të dyja gjinitë:

(**kujt?**) - (**atij, asaj**) i;

(**kë?**) - (**atë**) e.

Detyrë

(me shkrim): Shkruani një tekst sipas shembullit të dhënë më poshtë.

- Agimin e kam shok. Me **të** mësojmë bashkë. **Ai** banon afër meje.

Mua më viziton shpesh **ai**. Ndonjëherë marr lojëra kompjuteri prej **tij**.

- Zanën e kam shoqe. Me **të** jemi njohur në pushime. **Ajo** ...



PËREMRI DËFTOR

Përemri dëftor shërben për të treguar frymorë ose sende që ndodhen afër ose larg folësit. Ata përdoren bashkë me emrin ose e zëvendësojnë atë.

Përemrat dëftorë janë:

Për afër: ky, kjo, këta, këto; i këtillë, e këtillë, të këtillë, të këtilla; i tillë, e tillë.

Për larg: ai, ajo, ata, ato; i atillë, e atillë, të atillë, të atilla.

Përemrat dëftorë ndryshojnë sipas gjinisë, numrit dhe rasës. P.sh.:

- **Ky** djalë është shumë punëtor.
- **Kjo** vajzë ndihmon shoqet.
- **Ajo** rrugë duhet asfaltuar.
- **Ato** parcela do të mbillen me oriz.
- **Ky** libër është i mirë.
- **Këtë** libër sapo e lexova.

Përemrat dëftorë **ky, kjo, ai, ajo** lakohen si përemrat vetorë **ai, ajo**.

Përemrat dëftorë **i këtillë, e këtillë** etj. lakohen si mbiemrat e nyjshëm: *një djalë i këtillë, i një djali të këtillë* etj.

Në vazhdim po japim lakimin e përemrave dëftorë **ky, kjo, këta, këto**:

Rasa	ky		kjo	
Emërore	ky	<i>ky nxënës</i>	kjo	<i>kjo nxënëse</i>
Gjinore	i (e) këtij	<i>i (e) këtij nxënësi</i>	i (e) kësaj	<i>i (e) kësaj nxënëseje</i>
Dhanore	këtij	<i>këtij nxënësi</i>	kësaj	<i>kësaj nxënëseje</i>
Kallëzore	këtë	<i>këtë nxënës</i>	këtë	<i>këtë nxënëse</i>
Rrjedhore	prej këtij	<i>prej këtij nxënësi</i>	prej kësaj	<i>prej kësaj nxënëseje</i>

Rasa	këta		këto	
Emërore	këta	<i>këta nxënës</i>	këto	<i>këto nxënëse</i>
Gjinore	i (e) këtyre	<i>i (e) këtyre nxënësve</i>	i (e) këtyre	<i>i (e) këtyre nxënëseve</i>
Dhanore	këtyre	<i>këtyre nxënësve</i>	këtyre	<i>këtyre nxënëseve</i>
Kallëzore	këta	<i>këta nxënës</i>	këto	<i>këto nxënëse</i>
Rrjedhore	prej këtyre	<i>prej këtyre nxënësve</i>	prej këtyre	<i>prej këtyre nxënëseve</i>



Detyrë



Gjeni dhe nënvizoni përemrat dëftorë në fjalitë e mëposhtme.

- S' duhet harruar se në këtë shkollë Sokoli kishte mësuar katër vjet.
- A nuk beson ti se këta djem mund të fitojnë në këtë ndeshje futbollit?
- Ai shi vere nuk ra gjatë.
- Ky qe sulmi i tyre i parë.
- Kjo është toka jonë.
- Ç'arkitekt mund ta kishte projektuar këtë kështjellë?



Në vend të pikave vini përemrin dëftor që mungon.

- Në mënyrë duhet të mësojmë.
- fjalë i mbajmë në mendje gjithmonë.
- Kuptohet se ai s' do të kursejë asgjë në punë.
- Ata nisën të diskutonin për gjë.
- Me mjete ne duhet të fitojmë patjetër.

Si t'i dallojmë përemrat vetorë ai, ajo; ata, ato nga përemrat dëftorë për larg ai, ajo; ata, ato?

Siç e keni vënë re fjalët ai, ajo; ata ato shërbejnë edhe si përemra vetorë edhe si përemra dëftorë.

Këta **përemra** janë **vetorë** kur:

- zëvendësojnë një emër të përmendur më parë: **Nxënësit** janë në klasë. **Ata** e ndjekin mësimin e Gjuhës shqipe.
- kur përdoren pa **a**-nistore: Zana kishte dëshirë të luante me **to**. (ato)

Janë **përemra dëftorë** kur:

- mund të zëvendësohen nga përemrat e tjerë dëftorë, si: *ky, kjo; këta, këto*. P.sh.: *Merre **atë** (merre **këtë**)*.
- e përcaktojnë një emër, pra përdoren në fjali pranë emrit: *Petriti luan tërë ditën me **atë shokun** që e ka në klasë. Unë jam **ai djali** që e takove dje në dyqan.*

Detyrë



Dalloni përemrat **ai, ajo** dhe **ata, ato** në cilat raste përdoren si përemra vetorë, e në cilat si përemra dëftorë. Shkruani në vendet e zbrazëta.

- Ajo** këndon shumë bukur.
- Ajo vajzë** këndon shumë bukur.
- Ai djalë** quhet Blerim.
- Ai** shkon në shkollë.
- Ata** janë nxënës.
- Me **ta** mësojmë edhe ne.
- Ato vajza** janë shumë të sjellshme.
- Ai Dritani** mëson mirë.
- Ti je **ajo vajza** që u takuam në autobus?
- Unë nuk flas me **të**.


Detyrë


Zëvendësoni fjalët me shkronja të pjerrëta me përemra vetorë.

Taulanti jetoj larg *prindërve të tij* një kohë të gjatë.

Arbeni ia kushton të dielat *gjyshit të vet*.

Kishim vendosur që të mos u flisnim *shokëve*.

Nënë e bijë u qenë përveshur punëve në kuzhinë.

Dafina, e rrëmbyer nga puna, e harroi *vogëlushin*.



FOLJA

Do të mësojmë për:

- foljet dhe kuptimin e tyre;
- klasifikimin e foljeve në zgjedhime: zgjedhimi i parë, i dytë, i tretë dhe folje të parregullta;
- kategoritë gramatikore të foljeve: koha, veta, numri, zgjedhimi dhe diateza;
- ndarjen e kohëve të foljeve sipas ndërtimit: të thjeshta dhe të përbëra;
- kohën e tashme; kohën e pakryer; kohën e kryer të thjeshtë dhe kohën e ardhme.

Do të dimë:

- t'i dallojmë foljet sipas kuptimit: veprim ose gjendje;
- t'i dallojmë trajtat e foljeve sipas kategorive gramatikore të: mënyrës, kohës, vetës, numrit dhe diatezës;
- ta identifikojmë trajtën përfaqësuese të foljes: veta e parë, numri njëjës, koha e tashme, mënyra dëftore, forma veprore;
- t'i dallojmë kohët e thjeshta dhe kohët e përbëra;
- t'i zgjedhojmë foljet në kohën e tashme, të pakryer, të kryerën e thjeshtë dhe në kohën e ardhme.

Lexojeni këtë tregim. Thoni çfarë shprehin fjalët më të zeza?

Një njeri kishte një pulë, e cila çdo ditë i bënte nga një vezë të artë. Një ditë u ndal dhe po mendonte. Përse të pres çdo ditë të më bëjë vetëm nga një vezë. Më mirë ta ther dhe sigurisht ajo brenda është plot me vezë të arta dhe aty fsheh pasuri të madhe ari. Lakmuesi e mori pulën dhe e preu, e hapi brenda dhe pa se ajo ishte e njëjtë si edhe pulat e rëndomta. Kështu njeriu, duke dashur përnjëherë të pasurohej, e humbi edhe atë pasuri që kishte.

Fjalët me shkronja të zeza në këtë tregim janë folje.

Folja është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës që tregon një veprim ose një gjendje.

Kategoritë gramatikore të foljes janë: veta, numri, mënyra, koha dhe diateza.

Veta. Folja i ka tri veta: vetën e parë (*unë mësoj – ne mësojmë*), vetën e dytë (*ti mëson – ju mësoni*) dhe vetën e tretë (*ai, ajo mëson – ata, ato mësojnë*).

Numri. Kategoria e numrit të folja varet nga numri i asaj/atij që e kryen veprimin. P.sh. *Vajza punoi shumë. Vajzat punuan shumë.*

Mënyra. Në gjuhën shqipe janë **gjashtë mënyra të foljes**: *dëftore* (mësoj), *lidhore* (të mësoj), *habitore* (mësuakam), *kushtore* (do të mësoja), *dëshirore* (mësofsha) dhe *urdhërore* (mëso).



Koha. Kohët themelore të foljes janë: *e tashmja* (lexoj), *e shkuara* (kam lexuar) dhe *e ardhmja* (do të lexoj).

Diateza. Lidhja midis veprimit dhe asaj/atij që e kryen veprimin i ka dy forma. **Formën veprare mësoj dhe formën joveprare: mësohem, u mësova, jam mësuar.**

Meqë foljet përbëjnë një grup të madh fjalësh që kryejnë funksione të ndryshme, e nga ana tjetër janë shumë të rëndësishme gjatë komunikimit, ato kanë disa ndarje me të cilat do të njihemi në vijim.

Klasifikimi i foljeve sipas funksionit dhe kuptimit

Sipas këtij klasifikimi, foljet ndahen në: **folje me kuptim të plotë leksikor, folje ndihmëse dhe folje gjysmëndihmëse.**

Folje ndihmëse në gjuhën shqipe janë foljet *kam* dhe *jam*, të cilat përveç funksionit ndihmës, kanë edhe funksion të pavarur. Kështu, kur themi: *Unë kam shumë shokë*, ose *Unë jam në klasë*, foljet **kam** dhe **jam** nuk janë ndihmëse. Këto janë ndihmëse vetëm kur shërbejnë për të formuar kohë të përbëra, si: *kam ardhur, kisha shkuar, pata thënë; jam nisur, qe lodhur* etj.

Foljet gjysmëndihmëse (modale) shprehin mundësinë e kryerjes së veprimit. Funksionin e foljeve modale në gjuhën shqipe e kryejnë foljet **mund, duhet** dhe **do**. P.sh.: *mund të mësoj, duhet të mësoj, do mësuar* etj.

Sipas mundësisë për të marrë kundrinë të drejtë në fjali, foljet ndahen në **kalimtare dhe jokalimtare**.

Folja është **kalimtare** në rastet kur ajo merr kundrinë të drejtë, përkatësisht kur veprimi nuk mbetet tek ai që e kryen, por bie mbi një person a send tjetër. P.sh. *Nita e përqafoi nënën e saj. Unë e lexova librin*.

Te foljet **jokalimtare** veprimi mbetet tek ai që e kryen, pra folja nuk merr kundrinë të drejtë, p.sh.: *eci, rri, dal, shkoj, vrapoj* etj. *Arlinda vrapon çdo ditë. Unë eci çdo mëngjes*.

Foljet me kuptim të plotë leksikor përbëjnë grupin më të madh të foljeve. Ato ndahen në tri zgjedhime.

Klasifikimi i foljeve në zgjedhime

Foljet ndahen në tri zgjedhime:

Në zgjedhimin e parë përfshihen foljet që mbarojnë me zanore dhe në vetën e parë njëjës të kohës së tashme marrin mbaresën **-j** (*punoj, shkruaj, rrëfej*).

Këto folje, gjatë zgjedhimit marrin mbaresat **-j, -n, -n** për njëjës dhe **-jmë, -ni, -jnë** për shumës.

Si trajtë përfaqësuese e foljes shërben veta e parë njëjës e kohës së tashme e mënyrës dëftore në formën veprare.

Në zgjedhimin e dytë përfshihen foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore dhe në trajtën përfaqësuese nuk marrin mbaresë, si: *hap, mat, mbyll, vendos* etj.

Në zgjedhimin e tretë përfshihen foljet që në trajtën përfaqësuese mbarojnë me zanore dhe nuk marrin mbaresë: *vë, zë, di* etj.

Përveç këtyre foljeve, në gjuhën shqipe kemi edhe folje që nuk mund të kategorizohen në këto tri zgjedhime dhe i quajmë folje të parregullta.

Foljet e parregullta janë ato folje që nuk iu përmbahen rregullave të trajtimit të foljeve nëpër kohë, e as nëpër kategoritë e tjera gramatikore, prandaj këto folje formojnë një grup më vete. Gjuha shqipe ka pak folje të parregullta, e ato janë:

<i>Koha e tashme</i>	<i>Koha e kryer e thjeshtë</i>	<i>Pjesorja e foljes</i>
<i>kam</i>	<i>pata</i>	<i>(kam) pasur</i>
<i>jam</i>	<i>qeshë</i>	<i>(kam) qenë</i>
<i>bie</i>	<i>prura</i>	<i>(kam) prurë</i>
<i>bie</i>	<i>rashë</i>	<i>(kam) rënë</i>
<i>ha</i>	<i>hëngra</i>	<i>(kam) ngrënë</i>
<i>jap</i>	<i>dhashë</i>	<i>(kam) dhënë</i>
<i>rri</i>	<i>ndenja</i>	<i>(kam) ndenjtur</i>
<i>shoh</i>	<i>pashë</i>	<i>(kam) parë</i>
<i>vij</i>	<i>erdha</i>	<i>(kam) ardhur</i>
<i>them</i>	<i>thashë</i>	<i>(kam) thënë</i>
<i>dua</i>	<i>desha</i>	<i>(kam) dashur</i>
<i>lë</i>	<i>lashë</i>	<i>(kam) lënë</i>
<i>vdes</i>	<i>vdiqa</i>	<i>(kam) vdekur</i>
<i>vete</i>	<i>vajta</i>	<i>(kam) vajtur</i>

Kohët e foljeve

Shikoni ilustrimet, lexoni fjalitë nën to, gjeni foljet dhe mendoni se për cilën kohë bëhet fjalë në çdo fjali.



Qeshë i vogël



Tani jam nxënës.



Do të bëhem mjek.

Shpjegim

Fjalja e parë tregon një gjendje të kohës së shkuar. Fjalja e dytë tregon gjendjen e tashme. E treta paraqet gjendje apo veprim që do të bëhet në të ardhmen.

Koha e foljes tregon se kur kryhet veprimi. Për ta përcaktuar më mirë kohën e foljes, bëni pyetjen - **kur?**





Mbani mend

Folja ka tri kohë kryesore, që janë: **koha e tashme**, **koha e shkuar** dhe **koha e ardhme**.



Kohët e thjeshta dhe kohët e përbëra

Për nga struktura, kohët e foljes janë të thjeshta (sintetike) dhe të përbëra (analitike). Të thjeshta janë: **e tashmja** (*mësoj*), **e pakryera** (*mësoja*), **e kryera e thjeshtë** (*mësova*) dhe **e ardhmja** (*do të mësoj*). Ato formohen kryesisht me mbaresa që i shtohen foljes.

Kohët e përbëra janë: **e kryera** (*kam mësuar*), **më se e kryera** (*kisha mësuar*), **e kryera e tejshkuar** (*pata mësuar*), **e ardhmja e përparme** (*do të kem mësuar*). Këto formohen me foljen ndihmëse **kam** ose **jam** dhe **pjesoren e foljes**.

Ushtrim



Në tekstin e mëposhtëm gjeni foljet dhe përcaktoni kohët e kryerjes së veprimit.

U ngrita shpejt, bëra gjimnastikën e mëngjesit, rregullova shtratin, u pastrova dhe u veshja. Pastaj hëngra mëngjes dhe erdha në shkollë. Tani dëgjoj mësuesin, shkruaj dhe lexoj. Pas mësimit do të shkoj në shtëpi, do të ha drekë, do të pushoj pak dhe pastaj do t'i bëj detyrat. Më vonë do t'i ndihmoj babait dhe do të luaj me shokët e mi.

Koha e tashme

Detyrë



Thuaj ç'bën ti gjatë ditës? (prej mëngjesit e deri në mbrëmje).

Koha e tashme e mënyrës dëftore shpreh një veprim, një dukuri që kryhet ose zhvillohet në të njëjtën kohë me çastin e ligjërimit.

Koha e tashme ka vetëm një formë. P. sh.: *Nora punon në kopsht*. Ose: *Nora dhe Besa po punojnë në kopsht*. Në shembullin e dytë, me pjesëzën **po** dëshmohet se puna apo veprimi kryhet para syve tanë, në çastin kur flasim. Por në shembujt: *Nxënësi lexon çdo ditë*. *Ai mëson në shkollë fillore*; folja e kohës së tashme tregon një veprim që përsëritet. Ja paradigma e zgjedhimit të foljeve **jam** dhe **kam**.



jam	
Unë jam	Ne jemi
Ti je	Ju jeni
Ai është	Ata janë

kam	
Unë kam	Ne kemi
Ti ke	Ju keni
Ai ka	Ata kanë

Detyrë



Krahasoni mbaresat vetore të foljeve në të tri zgjedhimet.

zgjedhimi i parë				zgjedhimi i dytë				zgjedhimi i tretë			
mësoj				përgatit				di			
njëjës		shumës		njëjës		shumës		njëjës		shumës	
Unë	mësoj	Ne	mësojmë	Unë	përgatit	Ne	përgatitim	Unë	di	Ne	dimë
Ti	mëson	Ju	mësoni	Ti	përgatit	Ju	përgatitni	Ti	di	Ju	dini
Ai/Ajo	mëson	Ata/Ato	mësojnë	Ai/Ajo	përgatit	Ata/Ato	përgatitin	Ai/Ajo	di	Ata/Ato	dinë
	njëjës	shumës			njëjës	shumës			njëjës	shumës	
veta I	-j	-jmë		veta I	-#	-im		veta I	-#	-më	
veta II	-n	-ni		veta II	-#	-ni		veta II	-#	-ni	
veta III	-n	-jnë		veta III	-#	-in		veta III	-#	-në	



Krijoni fjali me foljet: punoj, mësoj, lexoj, shkruaj, luaj, hyj, hap, dal, jap, dua.

Koha e shkuar

E shkuara ka pesë nënndarje:

1. e pakryera;
2. e kryera e thjeshtë;
3. e kryera, që shprehin veprime të kryera para çastit kur flasim;
4. më se e kryera dhe
5. e kryera e tejshkuar, që shprehin veprime para një çasti të caktuar të së shkuarës, përkatësisht të një të kaluarë të largët.

Koha e pakryer

Koha e pakryer tregon një veprim të zgjatur a të përsëritur herë pas here brenda një kohe të caktuar të së shkuarës e që ka përfunduar para çastit të ligjëritimit pa ditur fillimin dhe mbarimin e tij.

Koha e pakryer përdoret edhe me pjesëzën "po", por kjo pjesëz nuk është aq e domosdoshme sa në të tashmen e dëftores.



kam				jam				lexoj			
njëjës		shumës		njëjës		shumës		njëjës		shumës	
Unë	kisha	Ne	kishim	Unë	isha	Ne	ishim	Unë	lexoja	Ne	lexonim
Ti	kishe	Ju	kishit	Ti	ishe	Ju	ishit	Ti	lexoje	Ju	lexonit
Ai/Ajo	kishte	Ata/Ato	kishin	Ai/Ajo	ishte	Ata/Ato	ishin	Ai/Ajo	lexonte	Ata/Ato	lexonin

Të gjitha foljet, duke i përfshirë edhe foljet e parregullta, në të pakryerën e veprës, marrin këto mbaresa vetore:

	njëjës	shumës
veta I	-ja	-nim
veta II	-je	-nit
veta III	-nte(-te)	-nin

Që të keni një pasqyrë më të qartë, në vazhdim po japim edhe disa folje të tjera në kohën e pakryer:

shkoj - *shkoja, shkoje, shkonte; shkonim, shkonit, shkonin.*

hap - *hapja, hapje, hapte; hapnim, hapnit, hapnin.*

di - *dija, dije, dinte; dinim, dinit, dinin.*

dua - *doja, doje, donte; donim, donit, donin.*

Në formën joveprorë, foljet marrin këto mbaresa vetore:

	njëjës	shumës
veta I	-esha	-eshim
veta II	-eshe	-eshit
veta III	-(h)ej	-eshin

Për shembull:

lahem - *lahesha, laheshe, lahej; laheshim, laheshit, laheshin.*

bëhem - *bëhesha, bëheshe, bëhej; bëheshim, bëheshit, bëheshin.*

lodhem - *lodhesha, lodheshe, lodhej; lodheshim, lodheshit, lodheshin.*

ulem - *ulesha, uleshe, ulej; uleshim, uleshit, uleshin.*

Ushtrim



Gjeni dhe nënvizoni foljet e kohës së pakryer.

Atëherë, kur shkoja unë në shkollë, nuk kishte shkolla tetëvjeçare nëpër fshatra, prandaj çdo ditë udhëtonim nga disa kilometra më këmbë. Shpesh kur binte borë e madhe, nuk mund të shkonim në shkollë derisa shkrihej bora. Mësonim në kushte të vështira. Nuk kishte as libra si sot, por merrnim shënime nga arsimtarët. Posa ktheheshim në shtëpi, i bënim detyrat e pastaj u ndihmonim prindërve. Në mbrëmje mblidheshim përreth gjyshit, e ai fillonte të na tregonte përralla derisa na zinte gjumi.

Koha e kryer e thjeshtë

Detyrë



Në cilën kohë është kryer veprimi i shprehur nga foljet e dhëna me shkronja më të zeza.

Plaku i urtë

Një plak nëntëdhjetë vjeç po mihte dheun e po mbillte një hardhi. Një mik i tij shkoj atje, e pa dhe e pyeti: "Ke shpresë ti të rrosh e të hash pemë nga kjo?"

"Jo - tha plaku - por mbollën të tjerët, hëngrëm ne, tani mbjellim ne që të hanë të tjerët."

Shpjegim

Funksioni kryesor i kohës së kryer të thjeshtë (aoristit) është që të tregojë një veprim ose gjendje të përfunduar në një kohë të shkuar, d.m.th. para momentit të të folurit, zakonisht në praninë e personit që e tregon.



Koha e kryer e thjeshtë tregon një veprim që ka përfunduar.

Foljet në kohën e kryer të thjeshtë marrin këto mbaresa vetore?

	njëjës	shumës
veta I	-a	-am/-ëm/-më/-em
veta II	-e	-at/-ët/-të/-et
veta III	-i/-u	-an/-ën/-në/-en

Detyrë



Vëreni zgjedhimin e foljeve të mëposhme. Përpiquni t'i mbani në mend.

jam - qeshë, qe, qe; qemë, qetë, qenë.

kam - pata, pate, pati; patëm, patët, patën.

mësoj - mësova, mësove, mësoi; mësuam, mësuat, mësuam.

shkruaj - shkrova, shkrove, shkroi; shkruam, shkruat, shkruan.

laj - lava, lave, lau; lamë, latë, lanë.

kthej - ktheva, ktheve, ktheu, kthyem, kthyet, kthyen.

gjej - gjeta, gjete, gjeti; gjetëm, gjetët, gjetën.

luaj - luajta, luajte, luajti; luajtëm, luajtët, luajtën.

bëj - bëra, bëre, bëri; bëmë, bëtë, bënë.

hyj - hyra, hyre, hyri; hymë, hytë, hynë.

zë - zura, zure, zuri; zumë, zutë, zunë.

hap - hapa, hape, hapi; hapëm, hapët, hapën.

mbyll - mbylla, mbylle, mbylli; mbyllëm, mbyllët, mbyllën.

dal - dola, dole, doli; dolëm, dolët, dolën.

them - thashë, the, tha; thamë, thatë, thanë.

shoh - pashë, pe, pa; pamë, patë, panë.

vij - erdha, erdhe, erdhi; erdhëm, erdhët, erdhën.

dua - desha, deshe, deshi; deshëm, deshët, deshën.



Në formën joveprore, të gjitha foljeve u paravendoset pjesëza u:

u mësova, u mësove, u mësova; u mësuam, u mësuat, u mësuam.

u lava, u lave, u la; u lamë, u latë, u lanë.

u ktheva, u ktheve, u kthye, u kthyem, u kthyet, u kthyen.

u bëra, u bëre, u bë; u bëmë, u bëtë, u bënë.

Koha e ardhme

Bisedoni



Thoni si do të jetë moti në tri ditët e ardhshme?

Mendoni dhe përgjigjuni

1. Pse quhet kohë e ardhme?
2. Çfarë tregojmë me kohën e ardhme?
3. Si ndërtohet kjo kohë?



Foljet që tregojnë një veprim i cili pritët të kryhet pas çastit kur flasim, janë të kohës së ardhme.

Në vijim po japim paradigmën e disa foljeve:

jam - do të jem, do të jesh, do të jetë; do të jemi, do të jeni, do të jenë.

kam - do të kem, do të kesh, do të ketë; do të kemi, do të keni, do të kenë.

shkoj - do të shkoj, do të shkosh, do të shkojë; do të shkojmë, do të shkoni, do të shkojnë.

shkruaj - do të shkruaj, do të shkruash, do të shkruajë; do të shkruajmë, do të shkruani, do të shkruajnë.

hap - do të hap, do të hapësh, do të hapë; do të hapim, do të hapni, do të hapin.

pi - do të pi, do të pish, do të pijë; do të pijmë, do të pini, do të pinë.

lahem - do të lahem, do të lahesh, do të lahet; do të lahemi, do të laheni, do të lahen.

Ushtrim



(me gojë): Zgjedhoni foljet **lexoj, mësoj, laj, rri** në kohën e ardhme.

Përforcim



1. Gjej cilat nga fjalët e dhëna janë **folje** e cilat janë **emra**. Për **emër** shkruaj shkronjën **E**, ndërsa për **folje F**.

- | | |
|----------------|-----------------|
| - lexoj _____ | - hyj _____ |
| - këndim _____ | - ndalesë _____ |
| - ndaloj _____ | - lexim _____ |
| - dalje _____ | - këndoj _____ |
| - hyrje _____ | - dal _____ |

2. Shkruaj kategoritë gramatikore të foljes.

_____, _____, _____, _____, _____.

3. Shkruaj si ndahen foljet sipas funksionit dhe kuptimit:

- a) _____
- b) _____
- c) _____

4. Sipas mundësisë për të marrë kundrinë të drejtë në fjali, foljet ndahen në:

- a) _____ dhe
- b) _____ .

5. Shkruani zgjedhimet përkatëse në shpjegimet e dhëna më poshtë.

- a) Foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore dhe në trajtën përfaqësuese nuk marrin mbaresë janë të zgjedhimit _____.
- b) Foljet që në trajtën përfaqësuese mbarojnë me zanore dhe nuk marrin mbaresë bëjnë pjesë në zgjedhimin e _____ .
- c) Foljet që mbarojnë me zanore dhe në vetën e parë njëjës të kohës së tashme marrin mbaresën –j përfshihen në zgjedhimin e _____.

6. Kohët kryesore të foljes janë:

- a) _____
- b) _____
- c) _____



Përforcim



7. Radhiti kohët e foljeve në bazë të ndarjes sipas strukturës së tyre.

kohë të thjeshta (sintetike)

kohë të përbëra (analitike)

8. Lexoje fabulën dhe foljet e nënvizuara klasifikoji në kohët përkatëse.

Dhelpra dhe bijtë e saj

Një dhelprë bishtkuqe e kishte ndërtuar strofullën e saj në një grunishtë. Kur shkonte për të kërkuar ushqim, i porosiste të vegjëlit e saj të dëgjonin ç'thoshte bujku. Një ditë të vegjëlit dëgjuan bujkun që i thoshte të birit:

- Gruri u poq. Nesër do të thërrasim fqinjët e do ta korrim. Kur dhelpra u kthye në strofull, dhelprerushët, të trembur, i treguan ç'kishin dëgjuar. Dhelpra plakë buzëqeshi dhe u përgjigj:

- Nuk ka për të ardhur, sepse pritka ndihmën e fqinjve.

Të nesërmen bujku erdhi përsëri në grunishtë. Dhelprerushët dëgjuan që i tha të birit:

- Nesër do të thërrasim ferefisën, sepse fqinjët nuk erdhën të na ndihmojnë.

Të vegjëlit ia treguan këtë s'ëmës. Dhelpra u përgjigj si herët e para.

Ditën e tretë bujku shkoi përsëri në grunishtë. Pa grurin që po shkonte dëm, dhe i tha të birit kokulur:

- Nuk duhet të rrimë më me shpresën e të tjerëve. Nesër do të vimë pa zbardhur dita, do të përveshim krahët dhe do ta korrim vetë.

Kur u kthye dhelpra dhe dëgjoj prej fëmijëve ç'kishte thënë bujku, foli:

- Tani është koha që të largohemi.

Koha e tashme: _____

Koha e pakryer: _____

Koha e kryer e thjeshtë: _____

Koha e ardhme: _____



FJALIA

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> • fjalinë: nocioni/koncepti, përmbajtja; • llojet e fjalive sipas kuptimit; • fjali dëftore; • fjali pyetëse; • fjali nxitëse; • fjali dëshirore; • fjalitë thirrmore. 	<ul style="list-style-type: none"> • ta identifikojmë fjalinë si tërësi logjike fjalësh, si ndërtim të drejtë gramatikor dhe si tërësi të intonacionit; • t'i identifikojmë llojet e fjalive sipas qëllimit të thënies në një tekst të dhënë.

Ç'është fjalia?

Fjalia është një grup fjalësh të lidhura sipas kuptimit me njëra-tjetrën.

Nëse i shkruajmë fjalët: *verore, i kaloi, fshat, Ermira, pushimet, në*.

A është kjo fjali? Sigurisht që jo. Këto janë fjalë të shkëputura, dhe nuk janë të vendosura me lidhje kuptimore. Nëse i vendosim këto fjalë në lidhje kuptimore, do të fitojmë:

Ermira i kaloi pushimet verore në fshat.

Pra, mund të themi që:

- fjalia është një bashkim i dy a më shumë fjalësh;
- fjalët duhet të lidhen nga ana kuptimore;
- fjalia gjithmonë fillon me shkronjë të madhe dhe
- në fund të saj vendoset ndonjë nga shenjat e pikësimit (pikë, pikëçuditje, pikëpyetje).

Nëse të gjitha këto i përmbledhim në një përkufizim të vetëm, do të themi që:

Fjalia është njësia themelore e shprehjes dhe e kuptimit të mendimit.

Ajo përbëhet prej dy a më shumë fjalësh kuptimplota, të bashkuara në një tërësi të vetme kuptimore, gramatikore e intonacionore.



Detyrë



Lidhni grupet e fjalëve që të fitojmë fjali.

Luani është

shndriste mbi fshat.

Detyrat e shtëpisë

Petriti u përhap menjëherë.

Dielli i mëngjesit

nxënës i klasës së gjashtë.

Lajmi se erdhi

i kam bërë qysh dje.

Zana, pasi i lau duart

u ul në tryezë bashkë me shoqet.

Llojet e fjalive sipas kumtimit

Sa herë që flasim ose bëjmë një njoftim, ose bëjmë ndonjë pyetje, ose japim një urdhër a këshillë, ose shprehim një dëshirë, ose shprehim një emocion të veçantë. Të gjitha këto kuptime i shprehim nëpërmjet fjalive të ndryshme. Kështu dallohen disa lloje fjalish: **dëftore**, **pyetëse**, **nxitëse** dhe **dëshirore**.

Veç kësaj, secila prej këtyre fjalive mund të shoqërohet me një intonacion thirrмор, i cili shpreh qëndrimin emocional të folësit ndaj asaj që thuhet. Kështu, fitojmë fjali dëftore-thirrmore, pyetëse-thirrmore, nxitëse-thirrmore dhe dëshirore-thirrmore.

Fjalja dëftore

Fjalja quhet dëftore atëherë kur ajo tregon diçka, jep një mendim, një informacion, arsyesim apo përgjigje. Fjalja dëftore fillon me shkronjë të madhe dhe mbaron me pikë.

Me anë të fjalisë dëftore ne:

- pohojmë ose mohojmë diçka – *Nesër kemi mësim. (pohim); Nesër nuk kemi mësim. (mohim);*
- shprehim mendimet tona. *Mendoj të lexoj edhe pak.*
- i përgjigjemi një pyetjeje. *Po. Unë do të vij me ty.*
- japim një informacion. *Javën tjetër temperaturat do të shënojnë rënie.*
- arsyetojmë një mendim. *Nëse nuk i lajmë dhëmbët, ata do të prishen.*

Përdorimi i foljeve te fjalitë dëftore

Fjalja dëftore e ka foljen përgjithësisht në mënyrën dëftore. Por mund të jetë edhe në mënyrën habitore apo kushtore, ndërsa tek fjalja e nënrenditur, edhe në mënyrën lidhore. P.sh.:



Dëftore – *Lexoja çdo ditë nga pak.*

Habitore – *Paska shumë njerëz sot.*

Kushtore – *Do të ta kisha thënë, po ta dija.*

Lidhore – *Para se të nisësh detyrat, lexo mësimin.*

Rendi i gjymtyrëve

Zakonisht rendi i gjymtyrëve të fjalitë dëftore është i drejtë, por për qëllime artistike mund të përdoret edhe rendi i anasjelltë.

Një enciklopedi e madhe ndodhej mes librave të bibliotekës.

Mes librave të bibliotekës, ndodhej një enciklopedi e madhe.

Intonacioni

Te llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacioni ka rëndësi të madhe. Te fjalitë dëftore, intonacioni është zbritës. Tregon përfundimin e thënies. Toni i zërit është i lartë në fillim të fjalisë dhe vjen duke u ulur drejt fundit. Në fund vendoset pikë. *Fëmijët kishin lexuar shumë libra gjatë pushimeve.*

Fjalitë dëftore-thirrmore

Karakterizohen nga toni më i lartë i cili shpreh emocionin e folësit dhe nga prania e disa fjalëve me vlerë thirrmore, si:

- përemra ose ndajfolje thirrmore (*kush?*, *çfarë?*; *ku?*, *kur?*, *si?*, *sa?*);
- pasthirma ose
- folje në mënyrën habitore. P.sh. *Çfarë ngjyrash paska kjo pikturë!*

Në fund të këtyre fjalive vendoset pikëçuditje.

Fjalë pyetëse

Me anë të fjalive pyetëse pyesim, për të mësuar diçka që është e panjohur për folësin. Zakonisht intonacioni i kësaj fjalie është karakteristik për fjalinë pyetëse dhe është elementi kryesor. Ai është intonacion ngjritës. Pra, është i ulët në fillim dhe vjen duke u ngritur drejt fundit. Ajo fillon me shkronjë të madhe dhe në fund mbaron me pikëpyetje. P.sh.: *Në cilën klasë jeni ju?*

Në krye të fjalisë pyetëse, zakonisht vihen gjymtyrë ose fjalë të cilat shërbejnë për të pyetur, si përemri **kush** dhe ndajfolje pyetëse **kur**, ndërsa pjesëza **vallë** mund të përdoret edhe në mes dhe fund të fjalisë.

Kush jeni ju? (përemër)

Kur u nisët? (ndajfolje)

Mos vallë është radha jonë? (pjesëz)



Kur fjalia pyetëse përshkohet nga ndjenjat e folësit (habi, kënaqësi etj.) atëherë kjo fjali është **pyetëse-thirrmore**, shqiptohet me intonacion pyetës dhe thirrmos dhe në fund të saj vendoset pikëpyetje dhe pikëçuditje. *Ende nuk jeni bërë gati?!*

Dallojmë fjali pyetëse **tërësore** dhe fjali pyetëse **të pjesshme**.

Fjali pyetëse tërësore është kur përgjigjja është me fjalët **po/jo** ose me përsëritjen e fjalisë. P.sh.: *I ke bërë detyrat? (Po.) ose (Po, i kam bërë.); (Jo.) ose (Jo, nuk i kam bërë.) Do të vish me mua? (Po.) ose (Po, do të vij.); (Jo.) ose (Jo, nuk do të vij.)*

Fjalia është pyetëse e pjesshme, në rastin kur përgjigjja është e pasur me informacion. Pra, kur nuk është e thjeshtë vetëm me **po** ose me **jo**.

Kur do të vish? – Do të vij të shtunën. Do të vij të dielën. Do të vij më vonë etj.

Si ishte koha? – Koha ishte e mirë. Koha ishte e keqe. Binte shi etj.

Me cilin po bisedoje? – Me Zanën. Me Petritin. Me shoqet etj.

Ku ndodhen të tjerët? – Të tjerët ndodhen në oborrin e shkollës.

Një lloj i veçantë i pyetjeve janë **pyetjet retorike**, të cilat nuk kanë nevojë për përgjigje pasi nënkuptohet. P.sh.: *E kush e pati mendjen tek ai? Ç'të presësh nga ajo?*

Fjalia nxitëse

Fjalia quhet nxitëse kur folësi, me anë të tyre shpreh një lutje, një këshillë, një kërkesë a një urdhër.

Të lutem mos fol.

Mos rri vonë.

Eja të luajmë bashkë.

Intonacioni te fjalitë nxitëse është zbritës. Sa më i prerë të jetë urdhri, aq më i lartë është toni në fillim të fjalisë.

Folja në fjalitë nxitëse është kryesisht në mënyrën urdhërore. **Dëgjoni me vëmendje çfarë do t'ju them!**

Ajo mund të jetë në mënyrën lidhore ose dëftore në kohën e tashme a në të ardhme, kur shprehim një propozim, një pëlqim apo një lejim për të bërë diçka.

Ju lutem, të rrimë edhe pak!

Shkojmë herën tjetër në mal.

Do të shkosh me vrap deri në shtëpi!

Fjalitë nxitëse mund të jenë **të mirëfillta** dhe **jo të mirëfillta**. Të mirëfillta e shprehin urdhrin në formë të prerë: **Dëgjoni me vëmendje shpjegimin!**

Jo të mirëfillta e shprehin me forma të tjera të nxitjes: **Hajde të luajmë njëherë.**

Fjalitë nxitëse, kur shoqërohen me ndjenjat e folësit, shqiptohen me një intonacion dukshëm thirrmos dhe quhen fjali **nxitëse-thirrmore**. Por ato mund të mos kenë fare folje dhe mund të ndërtohen:



Vetëm me një emër ose grup emëror: - **Qetësi**, - *tha Emira. Dorën e djathtë*, - *tha infermierja*.

Vetëm me një ndajfolje – **Mjaft! Shpejt!**

Vetëm me një pasthirmë – **Hop!** (kërce)

Vetëm me pjesëzën mohuese – **Jo!** (mos e bëj)

Në fund të fjalive nxitëse vihet pikë ose pikëçuditje, në varësi të karakterit thirrmos ose jo të fjalisë.

Fjalja dëshirore

Fjalja është dëshirore kur folësi shpreh një dëshirë, urim ose një mallkim. Fjalja dëshirore fillon gjithmonë me shkronjë të madhe dhe në fund ajo mbaron me pikëçuditje.

Folja në këto fjali zakonisht është në mënyrën dëshirore, por mund të jetë edhe në atë lidhore. P.sh.:

Në mënyrën dëshirore – *E gëzofsh çantën e re! Paçin jetë të gjatë! Qofshin të gëzuar!*

Në mënyrën lidhore. – *Ah, sikur të dilte dielli! Ah, sikur t'i kisha mbaruar me kohë detyrat!*

Për shkak të përmbajtjes së tyre, këto fjali dalin më shpesh si dëshirore-thirrmore:

Të na trashëgohet çifti!

U bëfsh 100 vjeç!

Ju këndoftë zemra!

Detyrë



Lexoje fjalinë dhe shkruaj çfarë lloj fjalie është sipas kumtimit.

- *Sot dita është shumë e bukur.*
- *A i bëre detyrat?*
- *Mirë, le të vijë edhe ai!*
- *Kalofshi mirë!*



Gjeni përgjigjet e sakta. Lidhni me vizë.

Mos u vononi shumë!

Dëftore.

Ata shkuan të gjithë në shëtitje.

Nxitëse-thirrmore.

Le të vijë edhe ai me ne!

Pyetëse.

Kush dëshiron të marrë pjesë?

Dëshirore-thirrmore.

Iu bëftë dita një mijë!

Nxitëse.



Detyrë



Kthe fjalitë dëftore në fjali dëftore-thirrmore.

Këtë verë shumë turistë pushuan në Strugë. (dëftore)

Sa shumë turistë pushuan këtë verë në Strugë! ose

Këtë verë shumë turistë paskan pushuar në Strugë! (dëftore-thirrmore)

Moti sot ishte shumë i bukur.

Nxënësit mësojnë mirë.

Uji i lumit është i ftohtë.

Shkolla jonë është e madhe.

Çanta ime është e rëndë.



Shkruaj përgjigjen. Cila fjali është pyetëse tërësore dhe cila e pjesshme.

Kur do të niset treni? – Tani / Pas pak.

Do të shkojmë me tren? – Po, me tren. / Jo

Si të duket fustani im? – I bukur.

A do të vish edhe ti me ne? – Po, do të vij. / Jo

Ku do të shkojmë? – Në Strugë.

GJYMTYRËT KRYESORE TË FJALISË

kryefjala dhe kallëzuesi

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> • gjymtyrët kryesore; • kryefjalën; • kallëzuesin; • kallëzuesin foljor; • kallëzuesin emëror. 	<ul style="list-style-type: none"> • t'i identifikojmë dhe t'i dallojmë gjymtyrët kryesore të fjalisë; • të shpjegojmë strukturën e një fjalie të thjeshtë dhe funksionin e kallëzuesit dhe të kryefjalës në fjali; • të krijojmë një fjali të thjeshtë me kryefjalë dhe kallëzues; • të njohim dhe dallojmë llojet e kallëzuesit foljor (i thjeshtë, i përbërë); • ta njohim dhe dallojmë kallëzuesin emëror.

Shikoni vizatimet e dhëna dhe lexoni fjalitë



Artani vrapon.



Donika mëson.



Nëna lexon.



Macja fle.

Mendoni dhe përgjigjuni

Në fjalinë e parë flitet për _____

Në fjalinë e dytë flitet për _____

Në fjalinë e tretë flitet për _____

Në fjalinë e katërt flitet për _____





Emrat: **Artani, Donika, nëna** dhe **macja** janë **kryefjalë**.

Pra, **kryefjalë** është fjala për të cilën flitet në fjali.

Si e dallojmë kryefjalën?

Kryefjala gjendet me njëren nga pyetjet: **kush?** (për njerëz), **cili? cila? cilët? cilat?** (për frymorë e gjësende). P.sh. *Kush mëson?* - **Donika**. *Cila fle?* - **macja**.

Kryefjala zakonisht mund të zëvendësohet me përemrat **ai, ajo, ata, ato**.

Mendoni dhe përgjigjuni

Përgjigjuni vetëm me një fjalë:

Çfarë bën Artani? _____

Çfarë bën Donika? _____

Ç'bën nëna? _____

Çfarë bën macja? _____



Fjalët *vrapon, mëson, lexon* dhe *fle* janë **kallëzues**.

Kallëzuesi tregon se ç'thuhet për kryefjalën. Kallëzuesin e gjejmë më lehtë në fjali duke pyetur se *ç'bën?* apo *ç'pëson?* kryefjala.

Detyrë



Lidhni fjalët e kolonës A me ato të kolonës B që të fitoni fjali të thjeshta.

Babai

Nëna

Qengji

Bilbili

Lulja

Zogu

Dielli

cicëron

shkëlqen

punon

gatuan

blegërin

çel

këndon

Për të qeshur

Mësuesi: Në fjalinë "Hajni është arrestuar", ku është kryefjala?

Nxënësi: Në burg, zoti mësues.





Kryefjala

T'i lexojmë fjalitë e dhëna më poshtë:

Një qengj po pinte ujë në një përrua.

(Cili po pinte ujë në një përrua? – **Një qengj**.)

Ujku grabitqar po afrohej drejt qengjit.

(Cili po afrohej drejt qengjit? – **Ujku grabitqar**.)

Ai nuk e kuptoi qëllimin e ujkut.

(Cili nuk e kuptoi qëllimin e ujkut? – **Ai**.)

Ujku iu vërsul qengjit.

(Cili iu vërsul qengjit? – **Ujku**.)

Të gjitha përgjigjet që dolën nga pyetjet e shtruarra janë kryefjalë të fjalive përkatëse.

Kryefjala është gjymtyrë kryesore e fjalisë që tregon frymorin ose sendin që kryen ose pëson një veprim ose gjendje të shprehur nga kallëzuesi. Ajo gjendet me pyetjet: **kush? cili? cila? cilët? cilat?**

Kryefjala gjithmonë është në rasën emërore dhe shprehet me:

1. emër të përveçëm, p.sh.: **Blerina** vizaton një mace;
2. emër të përgjithshëm, p.sh.: **Vajza** lexon një libër me përralla;
3. me përemër (vetor, dëftor, pyetës, i pacaktuar etj.), p.sh.: **Ata** janë shokë të mirë. **Ky** është nxënësi më i mirë i klasës. **Cili** fitoi? **Të gjithë** shkuan në teatër;
4. me grup emëror, p.sh.: **Vëllai yt** është futbollist i mirë. **Vajza e vogël** kërceu nga gëzimi. **Dy shoqet** shkuan në shkollë.

Vendi i kryefjalës: - Kryefjala zakonisht qëndron në krye të fjalisë, para kallëzuesit. Por, ajo mund të zhvendoset brenda fjalisë, pa ia prishur kuptimin asaj. P.sh.:

Andi e mori çantën nga banka. (Kush e mori çantën nga banka? - **Andi**.)

Çantën nga banka e mori **Andi**.

Nga banka, **Andi** e mori çantën.

Mbani mend

KRYEFJALA	- gjymtyrë kryesore e fjalisë
PYETJA	- Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?
SHPREHET ME	- emër, përemër, numëror, grup emëror
KRYEFJALA	- është gjithmonë në rasën emërore





Kallëzuesi

Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë, që tregon një veprim apo gjendje të kryefjalës. Ai gjendet me pyetjet: **ç'bën? ç'është?**

Kryefjala dhe kallëzuesi janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Kështu, po të ndryshojë kryefjala, ndryshon edhe kallëzuesi. Ai përshtatet me kryefjalën në **numër** dhe në **vetë**.

Sipas gjymtyrëve me të cilat shprehet, dallojmë dy lloje të kallëzuesit: **kallëzues emëror** dhe **kallëzues foljor**.

Kallëzuesi foljor ndahet në dy grupe: **kallëzues foljor i thjeshtë** dhe **kallëzues foljor i përbërë**.

Kallëzuesi foljor i thjeshtë shprehet vetëm me një folje, e cila ka kuptim të plotë leksikor dhe mund të jetë në të gjitha kohët, mënyrat, vetat dhe format. P.sh.:

Fëmijët po **kalonin** ditë të gëzuara në fshat.

Ekipi ynë e **mundi** këtë radhë.

Sot, nëna ime **kishte ardhur** në shkollë.

Kallëzuesi foljor i përbërë formohet prej dy pjesësh, përkatësisht prej dy foljesh që kanë kuptimin e një veprimi të vetëm. Folja e parë është folje gjysmëndihmëse ose modale, ndërsa folja e dytë shpreh një veprim në mënyrën lidhore, është formë e pashtjelluar foljore ose emër foljor asnjanes. P.sh.:

- **mund** + folje në mënyrën lidhore: A **mund të vish** sonte?

- **duhet** + folje në mënyrën lidhore: **Duhet të vish** sonte!

- **duhet** + pjesore e foljes: **Duhet parë** kjo punë.

- **do** + pjesore e foljes: Toka **do punuar**.

Nga folje që shprehin:

- fillimin e veprimit + folje në mënyrën lidhore: **Shiu filloi të binte**.

- vazhdimin e veprimit + folje në mënyrën lidhore: **Nxënësi vazhdoi të lexonte**.

- përfundimin e veprimit + emër foljor asnjanes: **Ai mbaroi së lexuari** në orën tre.

Kallëzuesi emëror shprehet me foljen **jam**, të shoqëruar me:

- **jam** + emër: **Unë jam nxënës**.

- **jam** + përemër: **Kush është ky?**

- **jam** + mbiemër: **Ajo është e gëzuar**.

- **jam** + grup emëror: **Kjo ishte mësuesja e re**.



Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën

Kallëzuesi përshtatet me kryefjalën në **vetë** dhe në **numër**. Kështu, po të ndryshojë kryefjala, ndryshon edhe kallëzuesi. P.sh.:

përshtatja në vetë	përshtatja në numër
Unë erdha sot.	Djali ishte pesë vjeç.
Ju erdhët dje.	Djemtë ishin pesë vjeç.
Blerina erdhi pardje.	

Mbani mend

- KALLËZUESI** - gjymtyrë kryesore e fjalisë
- PYETJA** - ç'bën? ç'është?
- SHPREHET ME** - një ose dy folje; jam + emër, përemër, mbiemër
- KALLËZUESI** - qëndron zakonisht pas kryefjalës



Detyrë



Gjej kryefjalën dhe kallëzuesin në fjalitë e mëposhtme dhe shkruaji në vendet përkatëse.

- Diana i shkroi një mesazh urimi Teutës.

Kryefjala _____ Kallëzuesi _____

- Çdo mëngjes postieri i sjell gazetën.

Kryefjala _____ Kallëzuesi _____

- Vëllai im luan basketboll.

Kryefjala _____ Kallëzuesi _____

- Pemët e parkut e pastrojnë ajrin.

Kryefjala _____ Kallëzuesi _____

- Mami ishte e gëzuar për suksesin tim.

Kryefjala _____ Kallëzuesi _____



Nënvizo me të kuqe **kryefjalën emër**, me të kaltër **kryefjalën përemër** dhe me të gjelbër **kryefjalën grup emëror**.

Anita lexon shumë libra.

Ajo i ka qejf librat me tregime.

Unë dua të bëhem shkrimtare për fëmijë.

Piter Pani është personazh magjik.

Gjuha shqipe është gjuhë e bukur.

Personazhet e filmit ishin të imagjinuar.

Përrallat janë shumë të bukura.

Librat janë miqtë tanë më të mirë.



Detyrë



Nënvizo kryefjalën në fjalitë e mëposhtme. Shkruaj pyetjen me të cilën e gjete.

Ne mbollëm lule në parkun e shkollës.

Muzika e filmit ishte e bukur.

Ajo më pëlqeu shumë.

Vajzat e vogla luajnë me kukulla.

Zogjtë fluturojnë në qiell.

Ata këndojnë bukur.

Unë isha i lodhur.



Dallo llojin e kallëzuesit. Vendosi nëpër vendet përkatëse.

jam afruar, ishin ulur, kishin shkuar, u lodhën, lexuan

janë të bukur, ishin të rinj, është mësuese, ishte i lodhur, ishin ata

duhej të vinte, zuri të fliste, mori të këndonte, filloi të binte, vazhdoi të lexonte

kallëzues foljor i thjeshtë	kallëzues foljor i përbërë	kallëzues emëror

FJALIA E THJESHTË

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> • fjalinë e thjeshtë të zgjeruar; • gjymtyrët e dyta; • përcaktorin, kundrinorin dhe rrethanorin. 	<ul style="list-style-type: none"> • të njohim strukturën e fjalisë së thjeshtë të zgjeruar dhe funksionin e gjymtyrëve të dyta; • të krijojmë fjali me lloje të ndryshme fjalësh (emra, përemra e grup emëror) në funksion të kryefjalës.

Fjala e thjeshtë ka në përbërjen e saj vetëm një **kallëzues** të shprehur me folje, i cili mund të jetë **i thjeshtë**, **i përbërë** ose **kallëzues emëror**. P.sh.:

Ne kemi mësim. (fjali e thjeshtë - kallëzues i thjeshtë foljor);

Zana filloi të mësonte herët në mëngjes. (fjali e thjeshtë - kallëzues i përbërë foljor);

Mësuesi ishte i gëzuar atë ditë. (fjali e thjeshtë - kallëzues emëror).

Tri fjalitë e mësipërme, pavarësisht numrit të fjalëve, janë fjali të thjeshta sepse kanë vetëm një kallëzues. Fjala e thjeshtë përbëhet prej disa gjymtyrësh, nga të cilat dy janë kryesore: **kryefjala** dhe **kallëzuesi**. Pikërisht këto formojnë edhe bërthamën e fjalisë.

Gjymtyrë të dyta të fjalisë së thjeshtë janë **përcaktori**, **kundrinori** dhe **rrethanori**. P.sh.:

Diana [kryefjalë] **shpejt** [rrethanor] **u miqësua** [kallëzues] **me të gjithë nxënësit**. [kundrinor]

Fjala e thjeshtë e zgjeruar

Fjala e thjeshtë e zgjeruar kumton një informacion më të plotë sesa fjalia e thjeshtë. Ajo, përveç gjymtyrëve kryesore ka edhe gjymtyrë plotësuese apo të dyta, të cilat e plotësojnë më shumë informacionin. P.sh.

Ja një fjali të thjeshtë të zgjeruar.

Zogjtë [kryefjala] **fluturojnë** [kallëzuesi] **në vjeshtë** [rrethanor] **me gjithë të vegjlit** [kundrinor] **për në vende të nxehta** [rrethanor].

Themi që është fjali e thjeshtë sepse në përbërje të saj ka vetëm një kallëzues (foljen **fluturojnë** – *kallëzues i thjeshtë foljor*). Gjithashtu, kjo fjali ka edhe gjymtyrën tjetër kryesore, pra kryefjalën (**zogjtë**), të shprehur me emër në rasën emërore në shumës.



Përveç gjymtyrëve kryesore, kjo fjali ka edhe gjymtyrë të dyta, prandaj themi se është **fjali e thjeshtë e zgjeruar**:

në vjeshtë [rrethanor kohe i shprehur me emër me parafjalë]

me gjithë të vegjlit [kundrinor i zhdrejtë me parafjalë i shprehur me grup emëror]

për në vende të nxehta [rrethanor vendi i shprehur me grup emëror].

Nëse duam që këtë fjali ta thjeshtojmë, përkatësisht që këtë fjali ta kthejmë në fjali të thjeshtë, atëherë i heqim gjymtyrët e dyta dhe fitojmë fjalinë e thjeshtë: **Zogjtë fluturojnë**.

Grupi i kryefjalës dhe grupi i kallëzuesit

Për të dalluar secilin nga këto grupe, të lexojmë fjalinë e mëposhtme:

Mësuesi shpjegon.

Kush? – **Mësuesi.** – Kryefjalë.

Ç'bën? – **Shpjegon.** – Kallëzues.

Në këtë rast fjalia: **Mësuesi shpjegon** është fjali e thjeshtë. Ajo ka vetëm kryefjalën dhe kallëzuesin. Por këtë fjali ne mund ta zgjerojmë, edhe kryefjalën edhe kallëzuesin, dhe formojmë dy grupe:

Grupin e fjalëve të kryefjalës dhe Grupin e fjalëve të kallëzuesit.

Për shembull:

Mësuesi im e Gjuhës shqipe shpjegon mësimin shumë qartë, ku kemi

grupin e kryefjalës: **Mësuesi im e Gjuhës shqipe** dhe

grupin e kallëzuesit: **shpjegon mësimin shumë qartë**.

Te grupi i kryefjalës kemi kryefjalën: **Mësuesi**, dhe **im i Gjuhës shqipe** gjymtyrë të dyta, që janë **përcaktorë** dhe e plotësojnë ose saktësojnë kuptimin e kryefjalës.

Grupi i kryefjalës është grup emëror (GE):

kryefjalë + përcaktor

Pjesa e dytë e fjalisë **shpjegon mësimin shumë qartë** është grupi i kallëzuesit dhe përbëhet nga **kallëzuesi** (bërthama) dhe gjymtyrët e dyta (kundrinorë, rrethanorë, përcaktorë) dhe që shtojnë informacionin për të.

Shpjegon (kallëzues – bërthamë) **mësimin shumë qartë** (gjymtyrë të dyta).

Grupi i kallëzuesit është grup foljor (GF):

kallëzues + kundrinor, rrethanor, përcaktor



Detyrë



Zvogëlojmë fjalitë e thjeshta të zgjeruara, pa e prishur kuptimin e tyre.

- Miri i vogël shkruan bukur në fletore. – *Miri shkruan.*
- Dritani i lodhur u shtri të pushonte.
- Macja lozonjare kishte fjetur nën stufën e ngrohtë.
- Trëndafilat e kopshtit tim kishin çelur petalet e tyre plot me ngjyra.
- Shoqja ime e klasës lexon një libër me tregime të bukura.



Zgjeroni fjalitë e thjeshta.

- Nxënësi mëson. (*i mirë, çdo ditë*) – *Nxënësi i mirë mëson çdo ditë.*
- Dielli ndriçonte.
- Lulet kishin çelur.
- Shoqet luanin.
- Fëmijët ishin larë.



Veço grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit. Nënvizdo bërthamën e grupit.

Një erë e fortë theu degën e ullirit të vjetër.

GE _____ GF _____

Kënga e zogjve dëgjohej në pyllin e dendur mbi fshat.


GE _____ GF _____

Qeni i vogël nisi të vraponte nëpër barin e njomë të kopshtit.

GE _____ GF _____

Përcaktori

Të rikujtojmë, duke e shikuar dhe duke e analizuar këtë skemë.



Përcaktori është gjymtyrë e dytë e fjalisë, i cili sqaron, saktëson ose përcakton bërthamën e një grupi emëror.

Përcaktori bën pjesë në grupin emëror, i cili është emri bërthamë + përcaktor.

Grupi emëror (GE) = emër bërthamë + përcaktor

Një grup emëror formohet me:

- emër + emër **ditët e dimrit** (ditët bërthamë, e dimrit përcaktor)
- emër + mbiemër **ditët e fundit, djalë punëtor.**
- emër + përemër **këto ditë, dita e saj.**
- emër + numëror **dy ditë**

Vendi i përcaktorit mund të jetë pas emrit bërthamë, por mund të qëndrojë edhe para emrit bërthamë.

T'i dallojmë grupet emërore në fjalitë e dhëna.

Ditët e pranverës po vinin më shpejt këtë vit.

Ditët e pranverës – emër + emër.

(*ditët* – emër bërthamë, *e pranverës* – fjalë plotësuese e emrit bërthamë)

këtë vit – emër + përemër

(*vit* – emër bërthamë, *këtë* – fjalë plotësuese e emrit bërthamë)

Marrim një fjali tjetër.

Çdo fëmijë i pëlqen lodrat.

Çdo fëmijë – emër + përemër

(*fëmijë* – emër bërthamë, *çdo* - fjalë plotësuese e emrit bërthamë)

Fjalët plotësuese që e plotësojnë emrin bërthamë quhen **përcaktorë**.

Përcaktori mund të shprehet me emër, mbiemër, përemër dhe numëror.



Llojet e përcaktorëve

Nga mënyra si lidhen me gjymtyrën që e përcaktojnë, përcaktorët janë tri llojesh:

- përcaktor me përshtatje,
- përcaktor me drejtim dhe
- përcaktor me bashkim.

Përcaktor me përshtatje - saktëson apo përcakton cilësinë e emrit bërthamë. Quhet me përshtatje pasi përshtatet me emrin që përcakton në numër, gjini dhe rasë.

1. Përcaktori me përshtatje shprehet me:

Mbiemër:

të nyjshëm – vajzë e re; shkollë e madhe; shtëpi e bukur.

të panyjshëm - djalë kureshtar; qytet madhështor; vajzë guximtare.

Përemër:

pronor – shalli i tij; libri i saj; shoku ynë.

dëftor – ky djalë; kjo vajzë; këta nxënës.

i pacaktuar – të gjithë mësuesit; të gjitha nxënëset.

pyetës – me cilin shok; me cilën shoqe.

Numëror:

tri vajza; *tre* djem

të dy studentët; *të dyja* studentet

2. Përcaktor me drejtim – quhet me drejtim, sepse gjymtyra nga e cila varet e drejton rasën e përcaktorit.

Përcaktori me drejtim shprehet me emër në:

Rasën emërore me parafjalë: *Vajza nga qyteti* ishte shumë e bukur. *Dritarja nga kopshti* ka shumë dritë.

Rasën gjinore: *Shtëpia e gjyshit* është shumë e ngrohtë. *Lëngu i pjeshkës* më pëlqen.

Rasën kallëzore pa parafjalë: Unë pi çdo ditë një *gotë qumësht*. Ai më dha një *shportë mollë*.

Rasën kallëzore me parafjalë: *Shishja me ujë* ishte mbi tavolinë.

Rasën rrjedhore pa parafjalë: Ai banonte në një *shtëpi guri*. Ai ka *karakter burri*.

Rasën rrjedhore me parafjalë: Më solli *mollë prej Prespe*. *Shtëpia midis pemëve* dukej që larg.

3. Përcaktor me bashkim – shprehet me gjymtyrë që nuk ndryshojnë gjatë përdorimit, si:

Përemra të palakueshëm pyetës: **ç', çfarë? sa? – Ç'plane** që kishte! *Sa kohë* të bukura që ishin!

Përemra të pacaktuar: **asnjë, ndonjë, çdo, ca, shumë, pak** – Nuk mungoi sot *asnjë nxënës*. Në rrugë nuk kishte *shumë njerëz*.

Numërorë që tregojnë sasi sendesh: Në kopsht sivjet mbolla *katër-pesë rrënjë trëndafila*.

Me ndajfolje:

Klasa përballë është e madhe.

Detyrë



Dallo përbërësit e grupit të kryefjalës dhe përbërësit e grupit të kallzuesit.

a) Uji i ëmbël i lumit ujit shलगun.

Grupi i kryefjalës (grup emëror)	Grupi i kallzuesit (Grup foljor)
Uji – bërthama - kryefjala i ëmbël, i liqenit - përcaktorë	Ujit – kallzuesi shलगun – kundrinor i drejtë

b) Degët e tij të gjata e të gjelbra bien mbi ujin e lumit.

Grupi i kryefjalës (grup emëror)	Grupi i kallzuesit (Grup foljor)
Degët – e tij – të gjelbra, të gjata –	bien – mbi ujin e liqenit –



Lidh emrat me përcaktorët emra dhe mbiemra.

emër + emër

rregullat banor kujtime tregimi djathë	dhie i gjyshit i qytetit e klasës të familjes
----------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------

emër + mbiemër.

vajzë park mendimet gjethen klithmës	e çmuara e tharë bukuroshe së fortë i gjelbëruar
--------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------



Plotëso grupet emërore me përcaktorët në kllapa.

(e Blertës; e bregdetit; e gjuhës; e saj; zbavitëse; e bukur)

Mësuesja po kontrollonte detyrat Lexonte shkrimin dhe buzëqeshte. Sa e zonja ishte nxënësja Përshkrimi e bënte të përfytyronte vendet dhe ngjarjet



Babai i Blertës, bën buqeta me lule të freskëta çdo mëngjes, me dëshirën për t'i shpërndarë në këto ditë të veçanta.

Në fjalinë që është dhënë, për të gjetur përcaktorët, fillimisht do të gjejmë grupin emëror. Duke gjetur grupin emëror, dallojmë emrin bërthamë dhe më pas përcaktorin. Tani t'i gjejmë grupet emërore:

- √ **Babai i Blertës** – përcaktor me drejtim, shprehur me emër në rasën gjinore
- √ **buqeta me lule** –
- √ **lule të freskëta** –
- √ **çdo mëngjes** –
- √ **dëshirën për t'i shpërndarë** –
- √ **këto ditë** –
- √ **ditë të veçanta** –


Kundrinori

Kundrinori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që lidhet me foljen. Kundrinorët shprehin frymorë a sende mbi të cilat bie veprimi i kryefjalës. Kundrinori bën pjesë në grupin foljor. Kemi dy lloj kundrinorësh:

1. Kundrinori i drejtë
2. Kundrinori i zhdrejtë.


Kundrinori i zhdrejtë ndahet në kundrinor i zhdrejtë **pa parafjalë** dhe kundrinor i zhdrejtë **me parafjalë**.

Në vazhdim po japim skemën:



1. Kundrinori i drejtë

Të analizojmë së bashku kundrinorin e drejtë



Vendi i kundrinorit të drejtë në fjali

- Kundrinori i drejtë zakonisht qëndron pas foljes: *Dëbora mbuloi malin.* (Cilin?)
- Kundrinori i drejtë mund të qëndrojë edhe para foljes: *Poezinë e recitoi me emocion.* (Cilën?)

Me se shprehet kundrinori i drejtë:

Me emër pa parafjalë në rasën kallëzore: P.sh.

Vajza takoi mësuesen. (Kë takoi? – Mësuesen.);

Me grup emëror: *Era tund degët e pemëve.* (Cilat? – Degët e pemëve.);

Me përemër: *Atë e kam shok të ngushtë.* (Kë?) *Unë po marr këtë, ti merr atë.* (Kë?);

Me trajtë të shkurtër të përemrit vetor të rasës kallëzore kur qëndron para foljes:

E mori për shaka. (Kë? atë e.)



Trajtat e shkurtra si kundrinorë të drejtë

Rasat në të cilat mund të gjendet kundrinori i drejtë i shprehur me trajtë të shkurtër sigurisht që është rasa kallëzore. Të rikujtojmë që përemrat vetorë në rasën kallëzore janë:

mua më, ty të, atë e, ne na, ju ju, ata/ato i

ku trajtat të shkurtra janë shënuar me ngjyrë të kuqe. Pra, kundrinori i drejtë është gjithmonë në rasën kallëzore.

2. Kundrinori i zhdrejtë

Kundrinori i zhdrejtë del në dy forma: **pa parafjalë** dhe **me parafjalë**.

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë: është gjymtyrë e dytë e fjalisë, që tregon objektin të cilit i drejtohet veprimi i shprehur nga folja.

Është gjymtyrë e domosdoshme në fjali.

Ai gjendet me pyetjet: **Kujt?, Cilit?, Cilës?, Cilave?**

P.sh.: Djali i tregoi **nënës** të vërtetën. (Kujt i tregoi? – Nënës – kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë në rasën dhanore).

Me se shprehet kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë?

1. Me emër në rasën dhanore pa parafjalë: *U kishte thënë **shoqeve** të vinin.* (Kujt? - shoqeve).
2. Me grup emëror: *Ai ia merrte **kësaj kënge** me përmallim.* (Kujt? – kësaj kënge)
3. Me përemër: ***Asaj i** pëlqeu ky film.* (Kujt i pëlqeu?).
4. Me trajtë të shkurtër të përemrit vetor në rasën dhanore: *I besoj **mikut**.* (kujt i besoj? – *mikut.* Kujt? – *Atij i*)

T'i rikujtojmë edhe njëherë trajtat e shkurtra të përemrit vetor në rasën dhanore:

(mua) më	(neve) na
(ty) të	(juve) ju
(atij) i	(atyre) u
(asaj) i	

Vendi i kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë.

Ai lëviz lirshëm në fjali.

Qëndron pas foljes: *I fola **Benit** për projektin e ri.*

Qëndron para foljes: ***Fëmijëve** u ishte shtuar gëzimi.*

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë

- Është gjymtyrë e dytë e fjalisë.
- Varet kryesisht nga folja.
- Gjen një përdorim të gjerë e të larmishëm në fjali. U përgjigjet pyetjeve me parafjalë: *Për kë?, Për cilin?, Me kë?, Nga kush?, Nga se?, Me çfarë?, Prej kujt?, Kundër kujt?*
- Pyetja me parafjalë, përgjigjja me parafjalë.
- Gjendet në rasat që marrin parafjalë: *emërore, kallëzore, rrjedhore.*
- Mund të zhvendoset lehtësisht në fjali. P.sh.: **Për lojën** mësuam shumë. Mësuam shumë **për lojën**. (Për kë mësuam shumë? – Për lojë.)

Pra, pyetja bëhet me parafjalë, gjithashtu edhe përgjigjja bëhet me parafjalë. Edhe pse zhvendoset kundrinori i zhdrejtë me parafjalë, fjalisë nuk i humbet kuptimi.

Me se shprehet kundrinori i zhdrejtë me parafjalë?

1. Shprehet me emra me parafjalë në rasat:

Emërore: *Djalit i ra libri nga dora.* (Nga kush? – Nga dora)

Kallëzore: *Ajo kujdeset për motrën.* (Për kë? – Për motrën)

Rrjedhore: *Qëndroi pas mësimit.* (Pas kujt? – Pas mësimit)

2. Me grup emëror: Do të flasim përsëri për këtë çështje. (Për cilën? – Për këtë çështje)

3. Me përemër: Të gjithë u gëzuan shumë për të. (Për kë? – Për të.)

Përforcim

Mësova:

Ç'është kundrinori?
Me se shprehet?
Me cilat pyetje gjendet?
Vendin e kundrinorit në fjali.





Detyrë



Plotësoni fjalitë me një nga kundrinorët e drejtë që janë në kllapa:
(ky dimër do të jetë i butë, E, tokën, atë, qytetin e Krujës).

- Nxënësit vizituan _____
- Dielli ngrohte _____
- Të gjithë e kujtonin _____ me mall.
- _____ thirrën në mbledhje.
- Thonë se _____



Formoni fjali duke lidhur grupin e fjalëve në të majtë me kundrinorët e drejtë në të djathtë.

Djemtë nuk e donin shumë

I ati iu dha

Djemtë nuk e dëgjuan

Një ditë babai u dha

Djemtë nuk e thyen dot

Bashkimi bën

babanë

njëri-tjetrin

shumë këshilla

tufën e thuprave

fuqinë

një tufë me thupra



Nënvizoni kundrinorin e drejtë në fjalitë e mëposhtme dhe thoni me se shprehet.

P.sh.: tokën, kundrinor i drejtë, shprehur me emër në rasën kallëzore, numri njëjës, gjinia femërore, trajta e shquar.

Shiu kishte vaditur tokën. Ta kishte ënda të shikoje ngjyrën e kaltër të qiellit. Retë po sillnin shi mbi male. Toka po fitonte sërish freskinë e saj. Nga dheu dilte një afsh i ngrohtë. Era lëvizte gjethet e pemëve. Toka po priste gjithë gaz pranverën. Këtë ndryshim e prisnin të gjithë me gëzim.



Plotësoni fjalitë me një nga kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë që janë në kllapa: (i...nënës; Atij... i; u ... fjalëve të babait; I)

Djali _____ thirri _____ .

Ai _____ besonte _____ .

_____ dukej si një mrekulli gjithçka që po ndodhte.

_____ nuk po _____ rrihej më aty.



Detyrë



Nënvizo kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë.

Djali i tregoi nënës dëftesën.

Miranda i dërgoi një letër Denisit.

Denisit nuk i kishte mbërritur me kohë letra.

Thuaj diçka që t'iu pëlqejë të gjithëve.



Plotësoni fjalitë me një nga kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë që janë në kllapa: (për nipin, për suksesin, me qenin, prej zhurmës, me njëri-tjetrin, me mësuesin, me djalin).

Gjyshi dhe mësuesi biseduan _____

Plaku fliste lirshëm _____, si _____ e vet.

Ata folën _____ dhe _____ e tij.

Fëmijët argëtoheshin _____

_____ nuk munda ta dëgjoj.



Rrethanori

Rrethanori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që tregon një rrethanë të kryerjes së veprimit. Ai bën pjesë në grupin foljor.

Llojet e rrethanorëve

Ne njohim disa lloje rrethanorësh: **rrethanor vendi, kohe, shkaku, qëllimi, mënyre** dhe **rrethanor sasi**.

Vendi i rrethanorit

Në përgjithësi, rrethanori e ka vendin e lirë në fjali. Ai mund të qëndrojë para ose pas kallëzuesit. Kjo do të thotë që ne mund ta zhvendosim rrethanorin dhe fjalisë nuk i humbet kuptimi.

1. Rrethanori i vendit

Rrethanori i vendit shënon vendin ku kryhet veprimi ose ku zhvillohet një ngjarje.

Ai gjendet me pyetjet: **ku? nga ku? për ku?, prej ku?**

Ai shprehet me:

- ndajfolje – **Atje është ftohtë.**
- emër – **Ai jeton në Ohër.**
- grup emëror – **Nga kjo shkollë kanë dalë nxënës të shkëlqyer.**

2. Rrethanori i kohës

Rrethanori i kohës shënon kohën kur kryhet veprimi ose zhvillohet një ngjarje.

Ai gjendet me pyetjet: **kur? që kur?**

Shprehet me:

- ndajfolje – **Teuta doli vonë nga shtëpia.**
- emër – **Konkursi është të martën.**
- grup emëror – **Në atë çast iu kujtua gjithçka.**
- formë e pashtjelluar – **Pa ardhur ti, nuk shkoj as unë.**

3. Rrethanori i shkakut

Rrethanori i shkakut tregon shkakun që sjell pasojën. Brenda fjalisë ne dallojmë edhe shkakun edhe pasojën.

Pyetjet për ta gjetur këtë rrethanor janë: **pse? për ç'shkak?**

Shprehet me:

- ndajfolje – **Pse erdhe kaq vonë?**
- emër – **Nga lodhja u ul menjëherë.**
- grup emëror – **Nga gëzimi i tepërt filloi të qante.**
- formë e pashtjelluar – **Duke pritur, humba shumë kohë.**



4. Rrethanori i qëllimit

Rrethanori i qëllimit tregon qëllimin e kryerjes së veprimit.

Ai gjendet me pyetjet: **përse? për ç'qëllim?**

Shprehet me:

- ndajfolje – **Përse** nxitoni kaq shumë?
- emër – **Ata** erdhën **për urim**.
- grup emëror – **Ai** përpiqej **për të mirën e nxënësve**.
- formë e pashtjelluar – **Shkoi në Tetovë për të studiuar**.

5. Rrethanori i mënyrës

Rrethanori i mënyrës tregon mënyrën e kryerjes së veprimit.

Ai gjendet me pyetjet: **si? në ç'mënyrë?**

Shprehet me:

- ndajfolje – **Ai** nuk e shprehu **qartë** mendimin e tij.
- emër – **Arbeni** u afrua **me gëzim**.
- grup emëror – **Ajo** e shikonte **me një vështrim të butë**.
- formë e pashtjelluar – **Ecte duke kënduar. Ecte pa shikuar rrugën**.

6. Rrethanori i sasisë

Rrethanori i sasisë tregon një sasi të caktuar në masë.

Ai gjendet me pyetjen: **sa?**

Shprehet me:

- ndajfolje – **Agimi** lexon **shumë**.
- grup emëror – **Vizita** zgjati **2 orë**.

Kur jemi te rrethanori duhet të bëjmë kujdes të mos ngatërrojmë rrethanorin e sasisë me kundrinorin e drejtë. Të shohim shembujt e mëposhtëm dhe të bëjmë dallimin mes tyre.

*Ata qëndruan **dhjetë ditë** në plazh.*

Sa qëndruan ata në plazh? – **dhjetë ditë**.

Dhjetë ditë – *Rrethanor sasië.*

Në duar mbante **disa libra**.

Çfarë mbante në duar? – **disa libra**.

Disa libra – kundrinor i drejtë.

Pavarësisht se grupi emëror *dhjetë ditë* dhe grupi emëror *disa libra* tregojnë sasi, pyetja dhe kuptimi brenda fjalisë ndryshon. Në varësi të pyetjes **Sa** apo **Çfarë** dhe kuptimit, ne përcaktojmë nëse kemi rrethanor sasië apo kundrinor të drejtë.



Ushtrim



Dalloni rrethanorin dhe thoni llojin e tyre.

Puna u pengua *nga shiu*. **Nga se** u pengua puna?

Nga shiu. Kemi rrethanor _____

Në *mbrëmje* rrugët u zbrazën. **Kur** u zbrazën?

Në mbrëmje. Kemi rrethanor _____

Ata e kaluan *me shpejtësi* rrugën. **Si** e kaluan?

Kemi rrethanor _____

Dardani erdhi *me dy shokë*. Me **sa** shokë?

Kemi rrethanor _____

Blerina ka shkuar *për të pushuar*. **Për se** ka shkuar?

Kemi rrethanor _____

Vendose *këtu* librin e gjuhës. Ku?

Kemi rrethanor _____

Mbani mend



Gjymtyrë e dytë e fjalisë

Tregon rrethanën e kryerjes së veprimit.

Llojet:
vendi, kohe mënyre, sasi,
shkaku, qëllimi

RRETHANORI

Lidhet me
foljen.
Bën pjesë në GF.

Grup i lëvizshëm në fjali pa
e humbur kuptimin.

U përgjigjet pyetjeve me
ndajfolje.

Detyrë



Në vend të pyetjeve vendosni një nga rrethanorët në kllapa dhe thoni ç'loj është.
(*katër kilometra, dorë më dorë, me mall, njëri pas tjetrit, shumë, gjysmë ore*).

1. Fëmijët i çonin tullat (si?) te muratorët.
2. Arbeni e përqafoi gjyshen (si?)
3. Motrës sime i pëlqejnë (sa?) trëndafilat.
4. Pasagjerët pritën në stacion (sa?).....
5. Gjahtarët shkojnë për gjah (si?)
6. Atë ditë kishim ecur (sa?)



Detyrë



Gjeni rrethanorët e vendit, të kohës dhe të mënyrës, duke bërë pyetje: *ku?*, *kur?*, *si?*

Bekimi u nis në gjashtë të mëngjesit.kur?....rrethanor i kohës.....

Ai do të shkojë në Strugë.

Atje kishte gjyshin dhe gjyshen.

Në Strugë do të shkojë me veturë.

Udhëtimi do të zgjasë dy orë e gjysmë.



Për çdo fjali të dhënë, ndërtoni një fjali pyetësor që të fillojë me *ku?* *kur?* dhe *si?*

Zana u nis herët. - Kur u nis Zana?

Ajo shkoi në Ulqin.?

Atje do ta presë shoqja e saj me kënaqësi??

Ajo do të kthehet pas dy javësh.?

Gjatë kthimit do të qëndrojë pak edhe në Durrës.?



Vendose rrethanorin në krye të fjalisë dhe shkruaj çfarë rrethanori është.

Kaluam mirë në Tetovë – Në Tetovë kaluam mirë. *Rrethanor vendi – ku?*

Bardha do të kthehet të martën - -?

Ne i përcollëm mysafirët me buzëqeshje - -?

Beni u largua në mbrëmje. - -?

Dje shëtitëm tërë ditën në park. - -?

U djersita nga vapa. - -?

Nëna e hapi dritaren për ajrosjen e dhomës - -?



Lidhi fjalitë me rrethanorët përkatës

Vendos këtu vazon me lule.
 Ndeshja do të zhvillohet nesër.
 Ajo vajzë erdhi nga qyteti.
 Fëmijët u nisën për në fshat.
 Ai punonte pa pushim.
 Mësuesi hyri në klasë duke buzëqeshur.

rrethanor vendi

rrethanor mënyre

rrethanor kohe



LEKSIKOLOGJIA

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> ç'është leksikologjia? kuptimin leksikor të fjalëve: kuptimin e drejtpërdrejtë dhe kuptimin e figurshëm të fjalëve. 	<ul style="list-style-type: none"> se çfarë është leksikologjia; të njohim kuptimin e drejtpërdrejtë dhe kuptimin e figurshëm të fjalëve në komunikimin e përditshëm e në veprat letrare.

Lexoni këto vargje:

Fjalët

<i>Sa shumë</i>	<i>Por,</i>
<i>fjalë ka</i>	<i>për çudi,</i>
<i>në këtë</i>	<i>kanë veç,</i>
<i>botë,</i>	<i>një lojë:</i>
<i>t'i numërosh</i>	<i>hyjnë</i>
<i>është</i>	<i>nëpër vesh,</i>
<i>punë</i>	<i>dalin</i>
<i>e kotë.</i>	<i>nëpër gojë.</i>

Agim Deva

Çfarë na mëson poeti me këtë vjershë?

Tërësia e fjalëve të një gjuhe përbën leksikun e saj. Gjuha shqipe, ashtu si gjuhët e tjera, ka një numër shumë të madh fjalësh.

Fjalor është libri në të cilin radhiten fjalët sipas rendit alfabetik dhe shpjegohen kuptimet e tyre. Prandaj sa herë që nuk e kuptojmë ndonjë fjalë, ne e hapim fjalorin dhe shpjegimin e saj e gjejmë aty. Ka disa lloje fjalorësh. Së pari dallojmë: fjalorë njëgjuhësh, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh. Quhen shpjegues fjalorët njëgjuhësh sepse në ta shpjegohen kuptimet e fjalëve. *Fjalori i madh shpjegues i shqipes ka 100.000 fjalë.*

Shkenca që studion fjalët dhe kuptimin e tyre quhet **leksikologji**. Termi leksikologji rrjedh nga greqishtja e vjetër: *leksis = fjalë, logos = dije, shkencë*. *Leksikografia* është degë e gjuhësisë që merret me hartimin e fjalorëve.

Kuptimi leksikor i fjalëve

Kuptimi i drejtpërdrejtë dhe kuptimi figurativ i fjalëve

Si në komunikimin tonë të përditshëm, ashtu edhe në letërsinë popullore e artistike (në prozë e në poezi) fjalët përdoren në **kuptimin themelor**, në **kuptimin e parë** të tyre, pra në **kuptim të drejtpërdrejtë**. Por, shpeshherë fjalët përdoren edhe në **kuptim figurativ**.

Në kuptimin themelor fjalët përdoren më shumë në komunikimin e përditshëm, në shkencë, në administratë, në drejtësi etj. Në letërsi fjalët përdoren më shumë në kuptim figurativ, duke krijuar figura stilistike.

Ndjenja e thellë, imagjinata e vullshme, gjendja e veçantë shpirtërore e nxisin njeriun, sidomos shkrimtarin, të shprehet me gjuhë të figurshme, duke sajuar tablo të vërteta me fjalë, ashtu siç krijon piktori tablo me ngjyra.

P.sh., kur themi:

- **frymë** - kuptojmë ajrin që e thithim dhe e nxjerrim. Ky është kuptimi themelor i kësaj fjale.

Mirëpo, fjala frymë kur lidhet me fjalët e tjera, merr edhe një varg domethëniesh të tjera:

- **erdhi me një frymë**, domethënë me vrap;
- ai është **si fryma** – d.m.th. shumë i shpejtë;
- **dha frymën e fundit** – d.m.th. ndërroi jetë;
- ishin mbledhur **frymë më frymë** – një mori njerëzish afër njëri-tjetrit në një vend;
- **fryma e kësaj vepre** – ideja themelore e saj;
- kjo kope ka pesëqind **frymë** – pesëqind dhen;
- **doli fryma** – u çua era;
- bisedimet u zhvilluan në **frymën e miqësisë** – atmosferën;
- **fryma** e Renesancës – prirja themelore e Renesancës;
- kjo nuk është në **frymën** e Gjuhës shqipe – është jonormative, e huaj, e papranueshme etj.

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Mësimdhënësi merr një fjalor shpjegues të shqipes në klasë. Nxënësve ua jep ta shohin dhe më pas u jep shpjegime për të.

Mendoni dhe përgjigjuni

1. A është e pasur me fjalë Gjuha shqipe?
2. Sa fjalë ka Fjalori i madh shpjegues i shqipes?
3. Çfarë është fjalori?
4. Ç'është leksikologjia?
5. Ç'është leksikografia?





FJALËT ME NJË KUPTIM DHE FJALËT ME SHUMË KUPTIME

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> fjalët me një kuptim dhe fjalët me shumë kuptime. 	<ul style="list-style-type: none"> të njohim e të dimë të përdorim fjalë që kanë një kuptim dhe fjalë që kanë shumë kuptime.

Po ta shfletojmë “Fjalorin shpjegues të shqipes” do të vërejmë se shumë fjalë kanë kuptimin e parë dhe një varg kuptimesh të tjera, ndër të cilat edhe kuptime të figurshme.

Në fjalorë, së pari jepet kuptimi i parë (me numrin 1), pastaj kuptimet e tjera (2, 3, 4...) dhe në fund edhe kuptimi apo kuptimet e figurshme (5 apo me ndonjë numër tjetër pasues). P.sh.: folja dal në “Fjalorin shpjegues” ka 35 kuptime, këmbë – 14 kuptime, qafë – 10 kuptime, vend – 15 kuptime etj.

Detyrë



Vazhdoni edhe ju të gjeni fjalë me një kuptim dhe fjalë me shumë kuptime në “Fjalorin shpjegues të shqipes”.

Disa fjalë në gjuhën shqipe kanë vetëm një kuptim, ndërsa disa të tjera kanë dy e më tepër kuptime.

Kanë vetëm një kuptim, për shembull, fjalët:

dajre - vegël muzikore popullore, def.

këmbëhollë – që i ka këmbët të holla a të dobëta.

telefon – aparat për komunikim në largësi.

përtac - që nuk ka dëshirë të punojë, që i pëlqen të rrijë pa punë, dembel.

Kanë shumë kuptime, për shembull, fjalët:

këmbëbardhë – 2 kuptime: 1. që ka këmbë të bardha; 2. kuptimi figurativ: këmbëmbarë.

bajame - 2 kuptime: 1. thelb që e hamë; 2. gjëndra në fytyrë e njeriut.

borë – 3 kuptime: 1. reshje atmosferike; 2. shumë i ftohtë, akull; 3. fig. shumë i bardhë.

kokë – 9 kuptime: 1. pjesa e sipërme e njeriut; 2. njësi për të numëruar bagëtitë (njëqind kokë dhen); 3. mendja e njeriut; 4. jeta e njeriut: humbi kokën. 5. udhëheqës, drejtues i një vendi; 6. kokë qepe, 7. pjesa e një vegje (koka e çiftelisë); 8. pjesa e parë e diçkaje (koka e trenit); 9. kuptim figurativ: përfundim, përmbyllje e diçkasë (t’ia lidhim kokën kësaj pune (shprehje frazeologjike).



Po sjellim në formën autentike (originale) gjashtë fjalë nga Fjalori elektronik shpjegues i Gjuhës shqipe.

Fjalë me një kuptim:

ABETARE *f. sh.*

Libër fillestar për të mësuar shkrim e këndim. *Abetare e Gjuhës shqipe. Abetare për të rritur. Festa e abetares.*

KOKARE *f. sh.*

Qepujkë.

ABSTENOJ kal.

Nuk marr pjesë në votim, nuk shprehem as «po» as «jo» për një vendim që merret me votim; nuk marr pjesë në një punë, shmangem. *Abstenoj gjatë votimit.*

Fjalë me shumë kuptime:

ABËCË *f. sh.*

1. Alfabeti i Gjuhës shqipe, i emërtuar sipas tri shkronjave të para të tij; alfabet. *Abëcëja e shqipes. Mësoj abëcënë.*
2. *vet. nj. fig.* Fillimet e një pune, hapat e para; njohuritë e para më të thjeshta e më të domosdoshme për diçka, bazat e diçkaje. *Abëcëja e artit (e shkencës). Abëcëja e jetës.*

KOKËÇARJE *f. sh.*

1. Diçka e padëshirueshme, që të mërzit e të shqetëson; ngatërresë e vështirësi, telash. *Punë pa kokëçarje. I nxori (i shkaktoi, i solli) kokëçarje. Ka shumë kokëçarje.*
2. Kujdes, merak për dikë a për diçka. *Punon pa kokëçarje.*

ACAR m.

1. Të ftohtë i madh, i thatë e me ngricë; fraq, cingërimë, thëllim. *Acar i ashpër. Acari i dimrit. Bën (ka) acar.*
2. *kryes. sh. ~E, ~ET.* Të ftohtat e dimrit, ngricat. *Duron (kalon) acaret.*
3. *fig.* Ashpërsi, vrazhdësi; zemërim. *I flet me acar. E merr me acar.*
4. *fig.* Frikë që të ngrin zemrën. *I hyri acari në shpirt. Rrinte me acar në zemër.*
5. *përd. mb.* Shumë i pastër e i ngrirë (për veshjen). *I ka petkat acar.*



Mbani mend



Në gjuhën shqipe kemi shumë fjalë që kanë më shumë se një kuptim, p.sh. *këmba* (e njeriut) dhe *këmba* (e tryezës, e urës). Në vargun e kuptimeve të saj, fjala ka një **kuptim kryesor**. Ky **kuptim themelor**, **kuptim bazë**, na del kur atë fjalë e përdorim të palidhur me fjalë të tjera, si p.sh., nëse themi vetëm fjalën *këmbë* mendja na shkon menjëherë te *këmba e njeriut*. Kur themi *dhëlpër* mendja na shkon te *kafsha e egër*, që është dinake; por, kur themi; *Ai është dhëlpër*, atëherë fjala *dhëlpër* merr kuptim të dytë, d.m.th. Ai është *dinak*, pra **kuptim figurativ**.

Fjalë me një kuptim është ajo fjalë që ka vetëm një kuptim. Fjalë me shumë kuptime është fjala që ka më shumë se një kuptim (2, 3, 4, ...). P.sh. fjala *drekë* – ka dy kuptime: 1. ushqim që hahet në mesditë, 2. koha e mesditës; *bar* – 1. bimë; 2. lëndë e përgatitur për mjekim (ilaç).

Të mësuarit kreativ



Nxënësit punojnë në çifte. Çdo çifti i jepet një fletë pune me një tekst, përmbajtja e të cilit është e pasur me fjalë me një kuptim dhe fjalë me shumë kuptime. Nxënësit duhet t'i tregojnë fjalët që kanë vetëm një kuptim dhe fjalët që kanë dy, tri ose më shumë kuptime.

Nxënësit vazhdojnë të punojnë në grupe me detyrën e njohjes së fjalëve dhe shprehjeve me kuptim të drejtpërdrejtë dhe të figurshëm, me kuptim konkret dhe abstrakt dhe ta riformulojnë fjalinë duke i përdorur fjalët/shprehjet prej të cilave kuptimet do të njihen drejtpërsëdrejti (p.sh.: *Lina gjeti një unazë floriri*. Gjysh Sokoli ka një zemër *floriri*; *Nëna ime mban një pjatë në dorë*. Ajo *mban mbiemrin e saj të vajzërisë*). Grupet i lexojnë me zë fjalitë e sapo përpiluara dhe të gjithë së bashku diskutojnë për shprehshmërinë e tekstit në të cilin përdoren fjalë/shprehjet me kuptim të figurshëm. Në fund mësimit/ndërrimit/ja paraqet fjali me kuptim të drejtpërdrejtë dhe të figurshëm (p.sh.: *Sa i bukur mali!*. - *Ti je njeri mali!*) dhe në diskutim nxënësit e interpretojnë kuptimin e tyre.

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Mësimit/ndërrimit/ përzgjedh disa fjalë nga fjalori dhe lexon kuptimin e tyre. Nxënësit dëgjojnë me vëmendje dhe dallojnë kuptimin e drejtpërdrejtë dhe kuptimin figurativ të fjalëve. Një nxënës shënon në dërrasë të zezë fjalën dhe jep shkurtimisht të dy kuptimet. Kjo përsëritet edhe për disa fjalë të tjera.



KUPTIMI KONKRET DHE ABSTRAKT I FJALËVE

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> kuptimin konkret dhe abstrakt të fjalëve. 	<ul style="list-style-type: none"> përdorim fjalë me kuptim konkret dhe me kuptim abstrakt.

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Në botë kemi shumë gjallesa, sende, objekte etj., që janë konkrete; si dhe dukuri, ide e gjëra të tjera abstrakte. Për t'i emërtuar këto, njeriu ka krijuar fjalë.

Cilat nga këto fjalë kanë kuptim konkret e cilat kanë kuptim abstrakt:

libër, kujtesë, mollë, mal, dituri, krenari, kompjuter, gëzim, telefon, përparim.

Kuptim konkret kanë fjalët: _____

Kuptim abstrakt kanë fjalët: _____

Fjalë me kuptim konkret është ajo fjalë që emërton një send të kapshëm me anë të shqisave, pra diçka lëndore (materiale), që mund ta shohim, ta prekim etj. Bie fjala, në gramatikë themi: *Emër (mbiemër) konkret* (lule e kuqe). *Shembull konkret. Kuptim konkret.*

Abstrakte është fjala që shpreh diçka që nuk kapet me anë të shqisave, që nuk është lëndore (është jomateriale), por që del me anë të përgjithësimit mendor; që del me anë të abstraksionit. Them: *emër abstrakt. Kuptim abstrakt.*

Detyrë



Shkruani nga pesë fjalë me kuptim konkret dhe pesë me kuptim abstrakt.

Fjalë me kuptim konkret	Fjalë me kuptim abstrakt

GJUHA SHQIPE DHE KOMPJUTERI

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> përdorimin e kompjuterit për të marrë njohuri si dhe për përdorimin e platformave softuerike për gjuhën shqipe. 	<ul style="list-style-type: none"> të kërkojmë, të gjejmë e të lexojmë materiale mësimore nga interneti; të shfrytëzojmë platformat softuerike për gjuhën shqipe.

Mësim ndërveprues (interaktiv)



Lexojeni këtë vjershë:

Interneti

*Jam botë pa skaj
më quajnë internet,
informata brenda mbaj
për çdo gjë në jetë.*

*Për dituri a argëtim
pandarë ju shërbej,
veç kliko miku im
për ty çdo gjë do të gjej.*



Mendoni dhe përgjigjuni

- Çfarë na thotë kjo vjershë?
- A keni ju kompjuter në shtëpi?
- A dini ta përdorni?
- Për çfarë e përdorni atë?
- A e përdorni për të mësuar lëndët e shkollës?



Çdokush prej nesh shfrytëzojmë internet. Edhe nxënësit është e udhës ta shfrytëzojnë internetin. Aty mund të gjejmë të dhëna shumë të rëndësishme e bashkëkohore për çdo lëndë mësimore dhe mund të komunikojmë drejtpërdrejt me të afërmit, shokët dhe miqtë tanë. Në internet ka shumë gjëra të dobishme që na informojnë, na mësojnë; por ka edhe gjëra të padobishme e të dëmshme.

Aktivitet praktik



- Në kabinetin e informatikës të demonstrohet përdorimi i internetit.
- Aftësohuni të kërkonit materiale nga interneti për qëllime mësimore si dhe të shfrytëzoni platformat softuerike për gjuhën shqipe.



Qendra për Edukim dhe Përparim e Prishtinës në kuadër të projektit shumëvjeçar “Gjuha shqipe dhe kompjuteri” ka bërë punë të mëdha në kompjuterizimin e Gjuhës shqipe, ngjashëm me anglishten e disa gjuhë të tjera.

Kulla e shqipes 2.0 është softueri më i përparuar për gjuhën shqipe, i domosdoshëm për çdo shqiptar, i lehtë për t’u përdorur. Shkarkimi dhe instalimi i tij në kompjuterin tënd është shumë i lehtë dhe i thjeshtë.

Shumë platforma softuerike gjenden në portalin **Gjuhashqipe.com**: Fjalori i madh i Gjuhës shqipe 2.0, Fjalori drejtshkrimor, Fjalori shpjegues, Kulla e shqipes 2.0, Morfologjia digjitale e shqipes 2.0, Sinonimia 1.0, Sintaksori 1.0, Korpusi i shqipes 1.0, Drejtshkrimori 2.0 e 3.0; Korrektori 1.0; Autokorrektori 2.0, Mëso shqip 1.0 (“Shqipja për fëmijë”, “Shqipja për të rritur” dhe “Shqipja për të huaj”).

Këto aplikacione do të na ndihmojnë shumë që ta përdorim sa më mirë gjuhën shqipe, të mësojmë fjalë të reja e të mos bëjmë gabime drejtshkrimore etj.

Të mësuarit kreativ



Nga mësime të mësuara (i Gjuhës shqipe, i Informatikës ose nga cilido mësues tjetër që di të përdorë mirë kompjuterin) të demonstrohet mënyra e përdorimit të disa platformave softuerike që gjenden në portalin **Gjuhashqipe.com** si dhe mënyra e instalimit të tyre. Me ndihmën e Fjalorit shpjegues shkruani shkurtimisht kuptimin e parë dhe kuptimet e tjera të fjalëve *urë, dritë, gjuhë, gjarpër*.

Detyrë



Me ndihmën e Fjalorit elektronik shpjegues (që e gjeni në internet: Gjuhashqipe.com e mund ta shkarkoni, FESH) gjeni fjalë me një kuptim dhe fjalë me shumë kuptime dhe shkruani në një dokument në formatin Word.



Teksti i mëposhtëm është me plot gabime gjuhësore. Shkruajeni atë në kompjuter. Aktivizojeni programin kompjuterik të drejtshkrimit dhe bëni korrigjimin e tij. Tekstin e përmirësuar shtypeni në letër ose rishkruajeni në fletore.

Çpikja e alfabetit paraqet në kthes jashtzakonisht t’ransishme në historin e njerzimit. Shkrimi është mjeti i vetëm nëpërmjet të cillitë popujt e lashtë mund t’naj kumtojnë informacionet për mënyrën e tyre të jetes, për botkuptimet, për besimet ose çëndrimetë e tyre.

Nga shpikja e alfabetit t’par janë shkruar shumë tekste: mbishkrime të gdhënme n’gur, njoftime të përditshme, letra, shkresa dhe dokumenta zirtare, urdhresa, lixe, tekste profesionale dhe shkollore, fatura tregëtare, vepra letrare. të xhitha këto shkrime, tekste të llojeve të ndryshme, një kohë t’gat, deri në zbulimin e shtip shkronjës në shekllin e pesmëdhjetë, janë shkruar veç me dorë.

SINONIMET, HOMONIMET DHE ANTONIMET

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> • sinonimet, homonimet, antonimet. 	<ul style="list-style-type: none"> • të identifikojmë sinonimet, homonimet dhe antonimet; • gjatë të folurit dhe të shkruarit të dimë të përdorim sinonime e antonime.

Sinonimet

Sinonimet janë fjalë që kanë kuptime të njëjta ose të ngjashme me kuptimin e një fjale tjetër; por që janë të ndryshme nga shqiptimi dhe shkrimi (gr. sin+onoma - i njëjti emër, emër i ngjashëm).

Sinonimet e pasurojnë gjuhën me nuanca kuptimore, që mundësojnë të shprehemi më bukur e më saktë. Sa më shumë sinonime të ketë gjuha, aq më i pasur është leksiku i saj. Gjuha shqipe është mjaft e pasur me sinonime. Pjesa më e madhe e sinonimeve krijohen me fjalë të toskërishtes e të gegërishtes, po edhe me fjalë të shqipes dhe me fjalë të huaja. Sinonimet janë të zëvendësueshme (të këmbyeshme) njëra me tjetrën. P.sh.:

- fshat - katund;
- rrugë - udhë;
- krye - kokë;
- dyzet - katërdhjetë;
- mëmëdhe - atdhe;
- filloj - nis;
- vajzë - vashë - cucë - gocë - çupë - çikë;
- argëtim - dëfrim - zbavitje;
- mjerim - skamje - varfëri - vobektësi;
- shqetësim - brengë - kokëçarje;
- pikëpamje - aspekt;
- mjaft - boll etj.

Detyrë



Fjalët e mëposhtme janë ngatërruar. Ndani nga dy ose nga tri fjalë sinonimike: *shuaj, ndryshim, dituri, lotoj, mbaroj, fik, dallim, vajtoj, kryej, njohuri, qaj, përfundoj, dije.*

Detyrë



Shënoni fjalë shqipe përbri fjalës së huaj që të krijoni sinonime:

sinonime: fjalë e huaj - fjalë shqipe		sinonime: fjalë e huaj - fjalë shqipe	
medicinë	→	devijim	→
progres	→	apel	→
eksperiencë	→	aksham	→
adaptoj	→	akoma	→
detaj	→	bosh	→
kojshi	→	vadit	→
aksham	→	sabah	→

Këshillë:

Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj. Kur kemi fjalë shqipe që kanë kuptimin e njëjtë me fjalën e huaj, atëherë duhet të përdorim fjalën shqipe. Fjalët e huaja duhet t'i përdorim vetëm kur na mungon fjala, shprehja ose termi i shqipes.

Në ligjërim ka raste kur kuptimisht njëri sinonim mund të zëvendësohet me tjetrin, por ndonjëherë ky ndërrim nuk mund të bëhet, meqë sinonimet dallohen ndërmjet tyre:

- nga nuanca kuptimore (*shikoj - vërej - vështroj, laps - kalem*);
- nga ngjyrimi stilistik emocionues (p.sh. fjala *mësues* ka kuptim asnjanes, ndërsa *dhaskal* kuptim përbuzës, keqësues; si edhe *fytyrë - surrat, tregti - pazarllëk* etj.), dhe
- nga aftësia për të krijuar fjalë të reja (fjalë të përbëra – kompozita) dhe për t'u lidhur me fjalë të tjera në togfjalësha ose në njësi frazeologjike (p.sh. fjalë të tjera formon emri *kokë*, si *kokëtul, kokëderr, kokë drejtuese, kokë me rëndësi* “i ditur” etj. dhe të tjera fjalë formon emri *krye*: *kryeqytet, kryeqendër, kryeministër, kryetar, kryesues* etj.



Pra, *kokë* dhe *krye* janë sinonime, por nuk e mbulojnë plotësisht njëra-tjetrën në përdorim (sepse nuk mund të thuhet *kokëqytet, kokëministër* etj.).

Me sinonime i shprehim më bukur e më saktë mendimet tona. P.sh. në një lajm të shkurtër në gazetë, për të thënë se cilët ishin në një mbledhje ka disa mënyra sinonimike: (në mbledhje) *ishin, merrnin pjesë, ishin të pranishëm, kishin ardhur, ndodheshin, ishin ftuar* etj.

Përsëritja e shpeshtë e po asaj fjale ngjall përshtypje të pakëndshme, prandaj kjo shmanget nëpërmjet sinonimisë. Kështu, fjalët e fjalisë:

Karakteristika kryesore që *karakterizon karakterin* e njeriut ... do të ishte e udhës të zëvendësohen me: *Tipari themelor* që *dallon karakterin* e njeriut.



Përdorimi i sinonimeve shpreh shkallën e lartë të kulturës gjuhësore të folësit.

Një dukuri e shpeshtë në shqipen është prania e sinonimeve në togje, në çift, të cilat kanë rol përforcues: *shend* e *verë*, *një herë* e *një kohë*, *çikë* e *thërrime*, *u qorroftë* e *u verboftë*, *paç ymër* e *jetë*, *fuqi* e *kuvet*, *halle* e *derte* etj.

Detyrë



Gjeni dhe shënoni sinonime për fjalët:

sinonime		sinonime	
gjel		baltë	
gjalpë		hap	
misër		fasule	
litar		ngrihem	
ulem		pushoj	
gënjeshtër		xhaxha	
ajër		ftesë	
luleshtrydhe		eja	

Homonimet

Homonimet (gr. homo - i njëjtë dhe onoma - emër) janë fjalë që shqiptohen e shkruhen njësoj, por kanë kuptim të ndryshëm, si *zë* (zëri – emër) – *zë* (folje); *vesh* (vesh-i – emër) – *vesh* (rroba – folje), *verë* (stinë) – *verë* (pije), *pres* (mish) – *pres* (shokun), *pjek* (bukën) – *pjek* (takoj), *bredh*-i (emër) – *bredh* (folje) etj.

Në gjuhën shqipe homonimet janë të rralla. Nga folklori kemi një gjëegjëzë të tillë për breshkën:

- Kudo *vete*, shtëpinë me *vete*;
- ndonjë lojë fjalësh, si: *Pashë* një *pashë* me një mjekër shtatë *pashë* të gjatë;
- një shprehje humoristike: *Qe si qe*, *u bë si ka*.

Antonimet

Bota është mjaft e larmishme. Shumë gjëra në jetë i vlerësojmë, i kuptojmë dhe i shpjegojmë në bazë të krahasimit (kemi plus, sepse kemi minus). Themi, p.sh.: shkollë e madhe – sepse kemi edhe shkollë të vogël, mirë – sepse diçka mund të jetë – keq, e gjatë – e shkurtër (rrugë e gjatë – rrugë e shkurtër), ditë – natë, punëtor – përtac etj. Të gjithë themi:

Deti është *i madh*, liqeni është *i vogël*.

Zjarri është *i nxehhtë*, akulli është *i ftohtë*.

Lepuri vrapon *shpejt*, breshka ec *ngadalë*.

Ne herë *flasim* e herë *heshtim*.



Çiftet e fjalëve *e madhe – e vogël, mirë – keq, ditë – natë, punëtor – përtac, i nxehtë – i ftohtë, shpejt – ngadalë, flasim – heshtim* janë **antonime**.

Antonimet (gr. anti - kundër, onoma - emër) janë fjalë të ndryshme që kanë kuptim të kundërt. Antonimet i shprehim me emra, folje, mbiemra dhe ndajfolje, si p.sh.:

- emra: *gëzim – hidhërim, dritë – errësirë, rini – pleqëri*;
- folje: *blej – shes, marr – jap, këndoj – vajtoj*;
- mbiemra: *i ri – plak, i mirë – i keq, i pastër – i fëlliqur, i papastër*;
- ndajfolje: *afër – larg, këtu – atje, lart – poshtë* etj.

Si fjalët e tjera, ashtu edhe antonimet i përdorim shpesh, si në komunikimin e përditshëm, ashtu edhe në veprat letrare. Me anën e tyre theksohet më tepër kundërshtimi ndërmjet dukurive të ndryshme dhe i japin gjuhës gjallëri të veçantë. Kështu:

- kuptimi i fjalës *i ri* del më qartë në kundërvënie me kuptimin e fjalës *i vjetër, plak, i moçëm*;
- kuptimi i fjalës *poshtë* kundërshton kuptimin të fjalës *lart*;
- kuptimi i fjalës *gëzim* kundërshton kuptimin të fjalës *hidhërim* etj.

Antonimet përdoren mjaft në urtitë popullore, si:

- Bëj *mirë* e *harro*, bëj *keq* e *kujto*.
- *E keqja të shkyen, e mira të arnon*.
- Ku *s'hyn dielli, hyn mjeku*.

Kalimi i menjëhershëm nga një pol te tjetri ka funksion estetik dhe krijon figurën e antitezës: *Zhvish* rrobat e djalërisë, *vish* rrobat e dhëndërisë (Popullore).

Antonimet në gjuhën shqipe janë dy llojesh:

- antonime ndërmjet fjalësh krejt të ndryshme, si *jashtë – brenda, ngjitem – zbres, hap – mbyll, lirë – shtrenjtë*; dhe
- antonime që lindin gjatë formimit të fjalëve me parashtesa me kuptim të kundërt: anti-, ç-, (sh-, zh-), s- (z-), kundër-, mos-, pa-, jo-. P.sh.: *lodhem – çlodhem, dredh – zhredh, kamje – skamje, sulm – kundërsulm, marrëveshje – mosmarrëveshje, i aftë – i paaftë, zyrtar – jozyrtar* etj.

Përveç këtyre, ka antonime me temë të njëjtë, por me parashtesa të ndryshme, të tipit *mbishtresë – nënshtresë, mbiçmoj – nënçmoj, paraardhës – pasardhës* etj.

Fjalët antonime krijojnë çifte në shkallë të ndryshme kundërvënieje, për shkak të fjalëformimit mjaft të zhvilluar të shqipes; p.sh., *i pastër – i papastër, i fëlliqur; i rregullt – i parregullt, i çrregullt; i qepur – i paqepur, i shqepur* etj.

Detyrë



Shënoni antonimet e fjalëve:

antonime			antonime		
natë	→		ulem	→	
e bukur	→		i ditur	→	
shpejt	→		bllokoj	→	
ftohtë	→		blej	→	
i ëmbël	→		rregulloj	→	

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Nxënësit punojnë të pavarur mbi detyrat dhe kërkesat e paraqitura në fletën e punës. Para së gjithash, duke e përdorur teknikën *Pica*, ata duhet të shkruajnë në çerekun e copave të picave kuptime sinonime për një fjalë të dhënë, për shembull: e bukur (e *pashme*, e *shkëlqyer*, *tërheqëse*, *magjepsëse*). Në vazhdim të aktivitetit shënojnë në tabelë kuptimin e kundërt të fjalëve të dhëna më parë. Duke i përdorur antonimet dhe sinonimet nga fleta e punës, nxënësit krijojnë fjali. Nga disa homonime të dhëna, ata hartojnë fjali për të treguar kuptimet e ndryshme të fjalëve (*Qeni u shtri mbi **barin** e njomë / I sëmuri e mori **barin** në orën e duhur*). Disa nxënës i lexojnë shembujt e tyre përpara nxënësve të tjerë në klasë.




FJALËT E PARME, TË PREJARDHURA DHE TË PËRBËRA

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> ç'janë fjalët e parme, të prejardhura dhe të përbëra; cilat janë pjesët përbërëse të fjalës (parashtesa, rrënja, tema, prapashtesa dhe mbaresa); si formohen fjalët në gjuhën shqipe. 	<ul style="list-style-type: none"> të njohim fjalët e parme, fjalët e prejardhura dhe fjalët e përbëra; të identifikojmë pjesët përbërëse të fjalës (temën, rrënjën, parashtesën, prapashtesën dhe mbaresën); të japim shembuj të fjalëve të parme, të prejardhura dhe të përbëra.

Forma dhe kuptimi i fjalës

- **Fjala** është njësia themelore e fjalisë.
- Të gjitha fjalët e një gjuhe përbëhen nga **forma** dhe **kuptimi**.
- **Forma** është tërësia e tingujve në të folur ose e shkronjave në të shkruar që ndërton fjalën. Forma e fjalës lidhet me **kuptimin** e saj.
- Një pjesë e fjalës është e *pandryshueshme* dhe quhet **temë e fjalës**, tjetra është e *ndryshueshme* dhe quhet **mbaresë e fjalës**.
- Fjala përbëhet nga **tema** dhe **mbaresa**.
- **Tema** është ajo pjesë e fjalës që mbetet pasi të heqim mbaresën. Një teme mund t'i shtohen **parashtesa**, **prapashtesa** si dhe të dyja së bashku.
- **Rrënja** bart kuptimin kryesor të fjalës.
- **Mbaresa** jep veçoritë gramatikore të fjalës (shquarsinë, rasën, numrin etj.).

Në gjuhën shqipe janë krijuar e krijohen fjalë: me parashtesa, me prapashtesa, me bashkëngjitje fjalësh etj. Shqipja ka në përdorim **100 parashtesa dhe rreth 370 prapashtesa** (burimore dhe të huazuara), disa prej të cilave alomorfe e disa variante fonetike. Duke i bashkuar dy e më tepër fjalë në një fjalë të vetme janë formuar e po formohen shumë fjalë të reja (hekur+udhë=hekurudhë, krye+ministër= kryeministër; zë+vendës+krye+redaktor= zëvendëskryeredaktor).

Skema e pjesëve përbërëse të fjalës:

Për shembull:

<i>fjala</i>	<i>parashtesa</i>	<i>rrënja</i>	<i>tema</i>	<i>prapashtesa</i>	<i>mbaresa</i>
punëtori		punë	punëtor	-tor	-i
shfaqjen	sh-	-faq	shfaq	-je	-n
rilindësit	ri-	lind	rilind	-ës	-it

Detyrë


Dalloni parashtesën, rrënjën, temën, prapashtesën dhe mbaresën në fjalët: *qytetar, librari, mospajtimi, përshkruaj, pasiguri, përhapje.*

Të mësuarit kreativ


Lexoni me kujdes fjalët e ndara në dy grupe:

- Grupi I: *laps, punë, gur, lum, det, ujë, dhe, lis, unë, ti, ne, kam, jam, bëj, dal, për, mos.*
- Grupi II: *mbi-kalim, për-mirë-sim, para-ardhës, nxën-ës, letër-si, shqip-tar, pun-im, miq-ësi, krye-qytet, hekur-udhë, ujë-sjellës, pa-gjumë-si; gjë-e-gjëzë, tu-ngjat-jeta!*

Mendoni dhe përgjigjuni

1. Cilat fjalë janë më të shkurtra?
2. A mund të ndahen në pjesë që kanë kuptim fjalët e grupit të parë?
3. Po, fjalët e grupit të dytë, a mund t'i ndani në pjesë që kanë kuptim?
4. Çfarë dallimi kemi ndërmjet fjalëve të grupit I dhe grupit II?





Vërejmë se:

Fjalët e grupit të parë janë më të shkurtra, të thjeshta. Ato nuk janë formuar nga ndonjë fjalë tjetër dhe nuk mund të ndahen në pjesë më të vogla të kuptimshme. Këto janë fjalë të parme.

Fjalët e grupit të dytë janë më të gjata, të përbëra. Janë formuar prej dy e më tepër pjesësh të kuptimshme dhe mund të ndahen në copa. Këto janë fjalë jo të parme.

Së bashku përfundojmë se:

Nga mënyra se si është formuar fjala, kemi fjalë **të parme** dhe **jo të parme**.

- **Të parme** fjalët që nuk janë formuar prej fjalësh të tjera, si p.sh.: *det, pyll, unazë, i ri, e re, pesë, shtatë, unë, ne, bëj, për, as, mos* etj. Pra, të parme janë ato fjalë të cilat kanë vetëm rrënjën e që nuk mund të copëtohen më shumë;
- **Jo të parme** janë ato të cilat kanë një apo dy rrënjë si dhe pjesë të tjera para ose/ dhe pas tyre.

Fjalët jo të parme mund të jenë tri llojesh:

- të prejardhura (**për-pun-o-j**): parashtesë+rrënjë+prapashtesë;
- të përbëra (**bukë+pjekës**); që përbëhen prej dy fjalësh të kuptimshme;
- të përngjitura (**megjithatë**), 2-3 fjalë të bashkuara në një fjalë të vetme.

Që të na kuptoni edhe më mirë:

» **Fjalët e prejardhura** krijohen kur rrënjës i shtohet një parashtesë, një prapashtesës ose të dyja së bashku, si P.sh.:

- **parashtesë + rrënjë**: **për+plas**, **stër+gjysh**, **mos+besim**, **për+mbyll**, **mbi+shkrim**, **nën+kuptoj**, **para+mendim** etj.
- **rrënjë + prapashtesë**: **qytet+ar**, **shkrim+tar**, **mosha+tar**, **mbret+ëreshë**, **ulk+onjë**, **besnik+ëri** etj.
- **parashtesë + rrënjë + prapashtesë**: **për+mirë+sim**, **ndër+marr+ës**, **për+fund+im** etj.

» **Fjalët e përbëra** (kompozitat), krijohen nga bashkimi i dy fjalëve me kuptim të mëvetësishëm p.sh.:

bukë + pjekës = bukëpjekës, krye + qytet = kryeqytet, hekur + udhë = hekurudhë. botë+kuptim, mirë+sjellje, sy+shkruar, udhë+heqës, vend+banim, bashkë+punëtor, drejt+shkrim, mirë+mbaj etj.

» **Fjalët e përngjitura**. Për shkak se i kemi përdorur me shekuj njërën afër tjetrës, disa fjalë i kemi bashkuar dhe tani i shqiptojmë dhe i shkruajmë si një fjalë të vetme. Quhen fjalë të përngjitura sepse janë bashkëngjitur në rrjedhë të shekujve. P.sh.:

një (dy, tre, katër,... nëntë) mbi dhjetë > njëmbëdhjetë;

gjë e gjëzë > gjëgjëzë;

kush do > kushdo;

gjith kush > gjithkush;

Mirë mëngjesi! > Mirëmëngjesi!

Tu ngjat jeta! > Tungjatjeta!



Fjalët e përbëra mund të jenë:

- emra** (**frymëmarrje** = frymë + marrje);
- mbiemra** (**flokëverdhe** = flokë + verdhë);
- folje** (**buzëqesh** = buzë + qesh);
- ndajfolje** (**duarkryq** = duar + kryq).

Detyrë



Thoni edhe ju ndonjë fjalë të parme e jo të parme.



Thoni edhe ju ndonjë fjalë të përngjitur.

Mbani mend

Në gjuhën shqipe kemi dy lloje fjalësh:



- fjalë të thjeshta**, që nuk mund të ndahen në pjesë më të vogla (**mal**, **ujë**), dhe
- fjalë jo të thjeshta**, që kanë të paktën dy pjesë përbërëse (**përshtat**, **drejtshkrim**).

Fjalët jo të thjeshta mund të jenë **të prejardhura** ose **të përbëra**.

- Fjalët e prejardhura** formohen duke i shtuar rrënjës përpara një parashtesë apo prapa një prapashtesë, ose të dyja së bashku (**mosbesim**, **shkrimtar**, **rilindës**);
- Fjalët e përbëra** (kompozitat dhe fjalët e përngjitura) formohen nga bashkimi i dy ose më shumë fjalëve që kanë kuptim më vete (**bukurshkrim**, **mirëdita**; **përgjithmonë**, **katëmbëdhjetë**).

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)




Mësimdhënësi/ja shkruan në dërrasë të zezë tri fjalë të parme. Nga nxënësit kërkon që në mënyrë individuale të formojnë tri fjalë të prejardhura dhe tri fjalë të përbëra. Disa nxënës praqesin punën e bërë para të tjerëve.

Detyrë



Vëzhgojeni skemën e mënyrës së formimit të fjalëve në gjuhën shqipe dhe përgjigjuni: Si formohen fjalët në gjuhën shqipe?



Qako (rretho) shkronjën e përgjigjes së saktë. Fjalët: *paftësi, i paditur, i pafund* janë:

- fjalë të parme;
- fjalë të formuara me parashtesim;
- fjalë të formuara me prapashtesim;
- fjalë të përngjitura.



Bashko njëren nga parashtesat *për-, mbi-, ri-* me fjalët e dhëna. Shkruani fjalët që do t'i fitoni.

parashtesa		fjala	fitohet fjala
		<i>lexoj</i>	
për-		<i>punoj</i>	
		<i>ngarkesë</i>	
		<i>forcoj</i>	
mbi-	+	<i>shikoj</i>	
		<i>vlerësoj</i>	
		<i>shpejtoj</i>	
ri-		<i>kalim</i>	
		<i>shkruaj</i>	

Detyrë



Qako (rretho) shkronjën e përgjigjes së saktë. Fjalët: *mosbesim, mosbindje* janë:

- a) fjalë të parme;
- b) fjalë të formuara me parashtesim;
- c) fjalë të formuara me prapashtesim;
- ç) fjalë të përngjitura.



Qako (rretho) shkronjën e përgjigjes së saktë. Fjalët: *vend, bukë, kam, jam* janë:

- a) fjalë të parme;
- b) fjalë të formuara me parashtesim;
- c) fjalë të formuara me prapashtesim;
- ç) fjalë të përngjitura.



Qako (rretho) shkronjën e përgjigjes së saktë. Fjalët *çarmatos, shqep, shthur, zhvendos; kundërajror* janë:

- a) fjalë të parme;
- b) fjalë të formuara me parashtesim;
- c) fjalë të formuara me prapashtesim;
- ç) fjalë të përngjitura.



Çfarë kuptimi kanë fjalët pa parashtesa dhe me parashtesa. Shkruani kuptimin e tyre.

Fjalët pa parashtesë dhe ato me parashtesë kanë kuptim të kundërt. Fjalët që kanë kuptim të kundërt quhen **antonime**.

<i>fjalë pa parashtesë</i>	<i>kuptimi</i>	<i>fjalë me parashtesë</i>	<i>kuptimi</i>
aftësi		paaftësi	
i ditur		i paditur	
besim		mosbesim	
shkencor		joshkencor	
armatos		çarmatos	
vendos		zhvendos	
ajror		kundërajror	



Ushtrim



Shtoni pas fjalëve të dhëna njërën prapashtesë që të fitoni fjalë të re. Shkruani fjalët që do t'i fitoni.

<i>fjala</i>		<i>prapashtesa</i>	<i>fitohet fjala</i>
sport	+	-ar, -tar:	
shetit		-(ë)si	
drejt		-tor:	
shqip		-ist:	
punë		-im:	
drejt		-je:	
nxë		-shëm:	
udhë		-ës	
vend		-os	

Detyrë



Nga fjalët e parme *lyej, plas, kthej* formoni fjalë të prejardhura. Shpjegoni kuptimin e fjalëve të prejardhura që keni fituar.

Ushtrim



Me ndihmën e parashtesave ç-/sh-/zh- formoni fjalët që tregojnë të kundërtën e fjalëve të mëposhtme: organizoj, vulos, qep, dredh, thur, orientoj.



Bashkoni me një shigjetë fjalët që kanë parashtesën ri- me shpjegimin e kuptimit të tyre.

rifitoj	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	E shkruaj përsëri.
rifilloj	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	Filloj për së dyti diçka.
rishikoj	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	Përsërit diçka që kam thënë më parë.
rishkruaj	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	Shfaq përsëri diçka.
ritregoj	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	Fitoj atë që kam humbur.
ripunoj	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	E punoj përsëri diçka.
rishfaq	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	Shqyrtoj sërish diçka për të ndrequr.
ripohoj	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	Shfaq përsëri diçka.



Gjeni parashtesat dhe prapashtesat e fjalëve: *vendos, përmbledh, traktorist, shtëpizë, tregtar, zbardh, hyrje, i paplotë, mbikalim*. Thoni kuptimin e çdo fjale.



Ushtrim



Formoni fjalë të prejardhura me prapashtesa nga fjalët e mëposhtme.
kopsht, pjesë, akull, treg, futboll, ngadalë, gjallë, mend.



Ndani në pjesë fjalët e përbëra:

<i>fjalë e përbërë</i>	<i>pjesët e saj</i>	<i>fjalë e përbërë</i>	<i>pjesët e saj</i>
bregdet		shumëkatëshe	
dyluftim		vëmendje	
peshkaqen		dorështrëngua	
atdhe		drejtshqiptim	
dorështrënguar		baraspeshë	



Ndani në pjesë fjalët e përngjitura:

<i>fjalë e përngjitur</i>	<i>pjesët e saj</i>	<i>fjalë e përngjitur</i>	<i>pjesët e saj</i>
farefis		tetëqind	
gjëgjëzë		askund	
nëntëmbëdhjetë		gjithandej	
kurrkush		përmbi	
gjithkush		dyqind	



Fjalët e shtyllës së parë i bashkoni me fjalët përkatëse të shtyllës së dytë. Formoni fjalë të përbëra dhe shkruani në vijën pas tyre:

udhë	mirë	_____
lule	gjerë	_____
gjel	heqës	_____
pemë	hollë	_____
bukur	shitës	_____
zemër	deti	_____
mik	dielli	_____
ujë	ngrënës	_____
shpatull	pritës	_____
mendje	sjellës	_____
bukë	shkrim	_____
bar	pjekës	_____



Ushtrim



Shkruani në kolonat përkatëse fjalët: *shqip, sipërfaqe, kryeqytet, gjëegjëzë, mal, jozyrtar, anëmbanë, gurgdhendës, enë, hekurudhë, shtëpi, orëndreqës, mësues, gjashtëdhjetë, përpunoj, kurdoherë, shkrimtar, ritregoj.*

<i>fjalë të thjeshta</i>	<i>të prejardhura</i>	<i>të përbëra</i>	<i>të përngjitura</i>

Hulumtim

Hapni Fjalorin shpjegues elektronik në kompjuter dhe gjeni fjalët e përbëra dhe të përngjitura me fjalën bazë: *krye, kokë* dhe *udhë*. Shënoni ato në fletore.

PËRDORIMI I SHKRONJAVE TË MËDHA

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> • disa rregulla drejtshkrimore; • përdorimin e shkronjave të mëdha. 	<ul style="list-style-type: none"> • të përdorim drejt shkronjën e madhe në secilën pjesë të emrave të përveçëm (emri, mbiemri, pseudonimi); • të përdorim drejt shkronjën e madhe në fillim të secilës pjesë të emërtimit të institucioneve, organizatave, festave kombëtare etj.

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Lexoni këto mendime. Çfarë na mësojnë ato?

- “Gjuhën e folur dialektore na e ka mësuar nëna, të shkruarën duhet ta nxëmë vetë”.
- Shqipja standarde nuk është variant i lindur i askujt. Për ta zotëruar atë, duhet ta mësojmë.
- “Për të shkruar duhen shtatë sy: një sy për shkronjat e vogla e të mëdha, një për shenjat e pikësimit, një për fjalën, një për fjalinë, një për kuptimin, një për tekstin, një për stilin”.

Gjuhën e krijon populli, e studiojnë dhe e kodifikojnë gjuhëtarët; e përpunojnë, e përsosin dhe i japin larmi e fuqi shprehëse shkrimtarët.

Drejtshkrimi është sistem rregullash që kodifikon shkrimin e fjalëve në të gjitha trajtat e tyre gramatikore, shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes; ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit, shkrimin e datave, shkurtesave, përdorimin e shkronjave të mëdha, transkriptimin e emrave të huaj dhe përdorimin e shenjave të pikësimit.

Normat drejtshkrimore janë të detyrueshme për të gjithë dhe askush nuk ka të drejtë t’i shkelë e as të krijojë rregulla të tjera “vetjake”.

Të rikujtohem:

Shihni me çfarë shkronje të parë janë shkruar emrat:

- *nxënës, nënë, fletore, shkollë, oborr, lule, liri.*
- *Agron, Vjollcë, Millosh Gjergj Nikolla, Vardar, Republika e Maqedonisë së Veriut.*

Emrat *nxënës, nënë, fletore, shkollë, oborr, lule, liri* i kemi shkruar me shkronja të vogla. Emrat *Agron, Vjollcë, Millosh Gjergj Nikolla, Vardar, Republika e Maqedonisë së Veriut* janë shkruar me shkronjë të parë të madhe.



Emrat e grupit të parë janë emra të përgjithshëm, ndërsa emrat e grupit të dytë janë emra të përveçëm. Në përgjithësi, **emrat e përveçëm** i shkruajmë me shkronjë të parë të madhe, ndërsa **emrat e përgjithshëm** me shkronjë të vogël.

Për përdorimin e shkronjave të mëdha ka rregulla drejtshkrimore. Këto rregulla janë të ngjashme në të gjitha gjuhët, por ka edhe disa dallime.

Në vijim po sjellim disa nga rregullat kryesore për përdorimin e shkronjës së madhe:

Me shkronjë të madhe shkruhen:

1. Fjala e parë e çdo fjalie. P.sh.:

Artani është nxënës. Ai lexon shumë. Sa e bukur qenka kjo lule! Si quresh?

2. Shkruhen me shkronjën e parë të madhe emrat, mbiemrat dhe llagapet e njerëzve (pseudonimet):

Ali Kelmendi, Avni Rustemi, Gjergj Elez Alia, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, Gjon Buzuku, Ismail Qemali, Naim Frashëri, Jeronim de Rada, Gavrill Dara i Riu, Leka i Madh; Migjeni (pseudonim i Millosh Gjergj Nikollës), Asdreni (pseudonimi i Aleksandër Stavre Drenovës), Leonardo da Vinçi etj.

3. Emrat gjeografikë (të lumenjve, maleve, deteve, shteteve, krahinave, qyteteve, rrugëve, shesheve etj.):

Lumi Vardar, Drini i Zi, Mali Sharr, Deti Adriatik, Deti Jon, Gjermania, Kosova, Pollogu, Malësia e Tetovës, Shkup, Gostivar, Dibër, Strugë, Kërçovë, Kumanovë, Prishtinë etj.

Edhe pjesët përbërëse të një emërtimi gjeografik prej dy a më shumë fjalësh shkruhen me shkronjë të madhe (me përjashtim të nyjave, lidhëzave e parafjalëve), si p.sh.:

Gadishulli Ballkanik, Maqedonia e Veriut, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Amerika Latine, Bjeshkët e Nemuna, Deti i Zi, Zelanda e Re, Oqeani i Ngrirë i Veriut, Qafa e Thanës, Mali i Zi i Shkupit, Fusha e Pajtit, Kosovrasti i Poshtëm, Kosovrasti i Epërm etj.

4. Emrat e institucioneve shtetërore, politike, arsimore, shkencore, kulturore; si dhe emrat e organizatave, të ndërmarrjeve:

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare në Universitetin "Shën Kirili e Metodi" në Shkup, rruga "Hasan Prishtina", bulevardi "Liria", Sheshi "Nëna Terezë", Shkolla Filllore Komunale "Liria" (ShFK), Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup (ITShKSh), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK), Instituti Albanologjik (IA), Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe (KNGjSh), Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare (ShGjSh), Agjencia e Zbatimit të Gjuhës (AZGj) etj.

Nga shembujt e dhënë, shihet se edhe shkurtimet e emrave të shteteve, të organizatave, të shoqërive, të institucioneve, të ndërmarrjeve etj., shkruhen me shkronja të mëdha, pa vënë pikë as ndërmjet, as pas tyre.



5. Emrat e periudhave dhe e ngjarjeve historike (me përjashtim të nyjave dhe të fjalëve shërbyese):

Rilindja Kombëtare Shqiptare, Konsulta e Prishtinës, Kongresi i Manastirit, Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip, Lidhja e Prizrenit, Lufta e Dytë Botërore, Karta e Kombeve të Bashkuara etj.

6. Shkruhen me shkronjë të madhe emrat e festave kombëtare, ndërkombëtare e fetare, si edhe emrat e figurave e të tregimeve popullore:

Ramazan, Bajram, Pashkët; Dita e Alfabetit, Dita e Flamurit, Dita e Mësuesit; Viti i Ri, Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare; Borëbardha, Hirushja, Kësulëkuaja etj.

7. Titujt e librave, të veprave letrare, të revistave, të gazetave, shkruhen me shkronjën e parë të madhe dhe vihen ndërmjet thonjzash, si p.sh.:

“Drejtshkrimi i Gjuhës shqipe”, “Lumi i vdekur”, “Malësorja”, “Sikur t’isha djalë”; revista “Gjuha shqipe”, gazeta “Fakti” etj.

8. Shkruhen me shkronjë të madhe emërtimet e planetëve, të yjeve e të trupave të tjerë qiellorë:

Toka, Dielli, Hëna, Marsi, Neptuni, Arusha e Madhe, Galaktika, Ylli Polar etj.

9. Emërtimet e titujve të nderit shkruhen me shkronjë të madhe vetëm në fjalën e parë:

Artist i merituar, Anëtar nderi, Mjeshtër i sportit etj.

Me shkronjë të parë të madhe shkruhen edhe emrat e fushave shkencore e të lëndëve mësimore:

Anatomi, Kimi organike, Bazat e tregut të kapitalit, Gjuhë shqipe, Matematikë etj.

Zgjerohet diturinë nga interneti

<http://www.drejtshkrimi.info/shemadhe/078>



Detyrë



Plotëso fjalët me shkronjat e duhura:

__lir, __lirian; __etovë, __etovar-e; __trugë, __trugan-e; __umanovë, __umanovar-e; __qpëri, __qiptar-e; __ngli, __nglez-e; __allkan, __alkkanas-e; __uropë, __uropian-e.



2. Shkruaj emrat e mbiemrat e dhjetë shokëve dhe të shoqeve të klasës.



3. Shkruaje orarin tënd të lëndëve mësimore:

ora	e hënë	e martë	e mërkurë	e enjte	e premte
1.	_____	_____	_____	_____	_____
2.	_____	_____	_____	_____	_____
3.	_____	_____	_____	_____	_____
4.	_____	_____	_____	_____	_____
5.	_____	_____	_____	_____	_____
6.	_____	_____	_____	_____	_____
7.	_____	_____	_____	_____	_____



Detyrë



4. Shkruaj emrat e disa maleve, lumenjve, qyteteve, fshatrave, shkollave dhe të rrugëve.



5. Tekstin e mëposhtëm shkruaje pa gabime. Kini kujdes në përdorimin e shkronjës së madhe.

republika e maqedonisë së veriut shtrihet në pjesën juglindore të europës. ajo në lindje kufizohet me bullgarinë, në jug me greqinë, në perëndim me shqipërinë dhe në veri me kosovën dhe serbinë. maqedonia e veriut është e ndarë në 84 Komuna dhe qytetin e shkupit. Eksporton ushqim, cigare, hekur, çelik në: serbi, mal të zi, gjermani, greqi, itali, bullgari, kroaci etj.

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup merr përsipër që të shkruajë gjëra të ndryshme:

- (1) pesë emra gjeografikë (me një fjalë emërtimi dhe me dy fjalë emërtimi): të kontinenteve, të shteteve, të qyteteve, të oqeanëve, të liqeneve, të lumenjve, të maleve;
- (2) pesë emra të nxënësve në klasë;
- (3) pesë mbiemra të mësuesve që u japin mësim;
- (4) pesë pseudonime;
- (5) pesë emra planetësh dhe galaktikash;
- (6) pesë tituj të librave të preferuar;
- (7) pesë lëndë mësimore;
- (8) tre emra të institucioneve që kanë më shumë fjalë në emërtim.

Grupet i shkruajnë përgjigjet në dërrasën e zezë dhe diskutojnë bashkë saktësinë e asaj që është shkruar. Në fund diskutohet për rregullat e përdorimit të drejtë të shkronjës së madhe gjatë shkrimit të emrave të përveçëm, veçanërisht kur emërtimi përbëhet nga dy e më shumë fjalë.



Në një prezantim të përgatitur paraprakisht, nxënësit ndjekin sllajde me foto. Në fletore duhet t'i shënojnë emërtimet e asaj që e shohin (ngjarje historike, tubime kulturore, xhami, kishë, manastir e të ngjashme). Më pas shembujt shkruhen në tabelë dhe diskutohet se si janë shkruar. Pas diskutimit pasojnë sllajdet me emra të shkruar drejt. Nxënësit bëjnë korrigjime të gabimeve eventuale.

PËRDORIMI I SHENJAVE TË PIKËSIMIT

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> përdorimin e shenjave të pikësimit. 	<ul style="list-style-type: none"> të përdorim drejt shenjat e pikësimit: pikën, presjen, pikëpyetjen, dy pikat, shumëpikëshin, pikëçuditjen dhe thonjëzat në komunikimin me shkrim.

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Lexoni dy fjalitë e dhëna:

Mëso si motra, mos u bëj përtac.

Mëso, si motra mos u bëj përtac

Çfarë kuptoni me fjalinë e parë?

Ç'kuptoni me fjalinë e dytë?

A ndryshojnë në kuptim? Pse?

Shpjegim

Varësisht se ku vëmë presje, fjalisë i japim dy kuptime të ndryshme.



Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Të lexojmë të njëjtin tekst me titull "Provimi".

Pa shenja të pikësimit:

Babai Bir a i ke ditur pyetjet në provim

Djali Po, babi

Babai E pse ke rënë nga provimi biri im i dashur

Djali Nuk i dija përgjigjet babi

Me shenja të pikësimit:

Babai: Bir, a i ke ditur pyetjet në provim?

Djali: Po, babi!

Babai: E pse ke rënë nga provimi, biri im i dashur?

Djali: Nuk i dija përgjigjet, babi...





Shenjat e pikësimit (interpunksionit) përdoren për të pasqyruar në shkrim intonacionin (uljen e ngritjen e zërit, pauzat etj.) dhe qartësinë e tekstit. Thjesht, sa më mirë që i shkruajmë fjalët dhe shenjat e pikësimit, aq më me saktësi gjuhën e folur e shndërrojnë në gjuhë të shkruar. Nga ana tjetër, sa më mirë të jetë i shkruar një tekst, aq më mirë e ringjallim atë nga forma e shkruar në formën e folur dhe aq më mirë e kuptojmë.



Shenjat kryesore të pikësimit janë: **pika .**, **presja ,,**, **pikëpresja ;**, **pikëpyetja ?**, **pikëçuditja !**, **dy pikat ::**, **shumëpikëshi (tri pikat) ...**, **viza -**, **thonjëzat ,, ”** dhe **kllapat ()**.

Ato mund të ndahen në tri grupe:

- shenjat që përdoren në fund të fjalisë, pra shenjat e intonacionit të fjalisë;
- shenjat që përdoren brenda fjalisë për të shënuar një pushim të shkurtër;
- thonjëzat dhe viza.

a) Shenjat që përdoren në fund të fjalisë (shenjat e intonacionit)

Katër shenjat e pikësimit **pika**, **pikëpyetja**, **pikëçuditja** dhe **shumëpikëshi (tri pikat)**, që përdoren në fund të fjalisë, shënojnë grafikisht intonacionin dhe pauzën që ndan dy fjali në gjuhën e folur.

Pika . shënon intonacionin zbritës, që vihet në fund të fjalisë dëftore. P.sh.:

Nora dhe Besa janë shoqe. Ato mësojnë në një klasë. Janë nxënëset më të mira të gjeneratës.

Pikëpyetja ? shënon grafikisht intonacionin ngjitës që karakterizon pyetjen gjatë të folurit: *Si quresh?, Nga jeni?, Sa vjeç je?, Ku banon?* etj.

Pikëçuditja ! shënon të shprehurit tonë me emocion (një e papritur, kundërshtim, zemërim, gëzim). Atë e shënojmë në fund të fjalive thirrmore e nxitëse. P.sh. *Oh sa e bukur qenka kjo lule!, Obobo sa qenke rritur!, Merre librin dhe mëso!* etj.

Shumëpikëshi ... shenjë pikësimi e përbërë prej tri pikash të njëpasnjëshme, që shërben për të treguar se një mendim nuk shprehet plotësisht apo se ligjërimi ndërpritet; se mendimi mbetet i pambaruar. Ky mosshqiptim i fjalëve në të folurit sinjalizohet përmes intonacionit të posaçëm. Heshtja, intonacioni i papërfunduar, mban pezull, si kuptimin ashtu edhe njerëzit, tërheq vëmendjen dhe na bën përshtypje emocionale. P.sh.: *Të them të drejtën..., kjo fare nuk më pëlqen. Ma merr mendja se ... nuk e di ..., nuk e di ç'të them.*

b) Shenjat që përdoren brenda fjalisë (shënojnë një pushim të shkurtër)

Presja , shënon një pushim të shkurtër brenda fjalisë. P. sh.:

- Stinët e vitit janë: pranvera, vera, vjeshta dhe dimri.*
- Artani, djali më i madh, po mëson rregullisht.*
- Ajo figurë mishëron vetitë më pozitive të popullit: urtësinë, besën, mençurinë e trimërinë.*
- Zogu, për çudi, nuk shkoi larg; u kthye e fluturoi fare ulët.*



Pikëpresja ; shënon një pushim më të gjatë sesa presja:

Ata që na donin, erdhën; ata që s'na donin nuk erdhën.

Dy pikat : shënojnë një pushim që zgjat pothuajse sa pikëpresja, por, ndryshe prej saj, dy pikat kanë një vlerë logjike: ato paralajmërojnë një shpjegim, një varg shembujsh etj. P.sh.:

Tani më ra ndërmend: librin ta kam dhënë brenda në bibliotekë.

Më është mbushur mendja për diçka: njeriu i fortë ia del mbanë edhe kur e ka vështirë.

Dy pikat përdoren gjithnjë pas fjalëve të autorit kur i thotë fjalët e tjetrit me përpikëri. P.sh.: *Drita i tha s'ëmës: "Nesër të më zgjosh në orën gjashtë".*

Përpara pikëpresjes ose dy pikave, intonacioni mund të ngrihet ose të ulet, sipas rastit. Ngrihet, nëse të folurit është i vazhdueshëm dhe i shpejtë; zbret, kur të folurit është i ndërprerë dhe i ngadaltë.

Kllapat () shënojnë një pushim të shkurtër, si presja. Shërbejnë për të dalluar, shquar dhe izoluar një grup fjalësh që shpreh një sqarim ose mendim të ndërshtënë. P.sh.:

Eqrem Çabej (1908-1980) është gjuhëtari më i shquar shqiptar. Te Fusha e Pajtimit (quket kështu, sepse aty janë bërë shumë pajtime gjaqesh) Agimi u takua me Ilirin.

Thonjëzat „ ” shërbejnë për të rrethuar fjalët e një ose më shumë bashkëbiseduesve në një ligjëratë të drejtë, si *Naimi ka thënë: „Punë, punë natë e ditë, që të shohim pakëz dritë”*. Thonjëzat shërbejnë gjithashtu për të shënuar emërtimet e rrugëve, të institucioneve etj.

P.sh.: rruga „Xhon Kenedi”, Biblioteka „Naim Frashëri” etj.

Detyrë



Vini shenjat e duhura të pikësimit në fjalitë e dhëna:

Libri është shoku më i mirë

Bujar pse nuk i ke bërë detyrat

Dëgjojeni mësimin me vëmendje

Ditët e javës janë e hënë e martë e mërkurë e enjte e premte e shtunë dhe e diel

Çbën Arben

A do të vish sonte në teatër

Jo skam kohë

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Atyre u jepet tekst të cilit i mungojnë shenjat e pikësimit: *pika, presja, pikëpyetja, dy pikat, shumëpikëshi, pikëçuditja, apostrofi, thonjëzat*. Nxënësit duhet t'i vendosin shenjat përkatëse në vendin e duhur. Në fund të aktivitetit nxënësve u jepet teksti ku shenjat e pikësimit janë përdorur drejt dhe secili nxënës e krahason me punën e tij.

Detyrë



Rishkruajeni tekstin. Kini kujdes hapësirat dhe shkronjat e mëdha.

Pushimi i verës

shpresa dhe zana (dy shoqe të ngushta) me prindërit e tyre u nisën për në durrës (shqipëri).

rrugës,ato bisedonin e këndonin . kënaqeshin me pamjet e bukura të natyrës : fushat,grykat, malet...

-sa të larta janë këto male! –tha shpresa e befasuar.

-nëpër këto male kalon tuneli i kalimashit .

-sa i gjatë qenka ky tunel !

arritën në durrës .u vendosën (sistemuan) në hotelin “ Iliria ” , që gjendet buzë detit .Zgjoheshin në mëngjes ,rreziteshin e laheshin në det.Në mbrëmje shëtisnin nëpër qytet.U kënaqën shumë .dhjetë ditë pushimi nuk do t'i harrojmë kurrë- thanë ato .

Hulumtim

Analizojeni ndonjë tekst dhe vëreni në ç'vend vihen shenjat e pikësimit.

Bëjeni një punim për hulumtimin dhe shënoni rregullat:

1. Kur nuk lëmë hapësirë (zbrazëtirë) para e pas shenjave të pikësimit.

1. Kur lëmë hapësirë para e pas shenjave të pikësimit.

Ja një rregull e tillë:

Shenjat e pikësimit i vëmë menjëherë pasi përfundon shkrimi, pa lënë hapësirë. Pas tyre lëmë një hapësirë (zbrazëtirë) e pastaj shkruajmë fjalën tjetër.

NË PLAZH



PËRDORIMI I VIZËS

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> përdorimin e vizës. 	<ul style="list-style-type: none"> të përdorim drejt vizën gjatë të shkruarit.

Viza - përdoret në dialogje, në lidhjen e dy fjalëve si dhe në ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit. P.sh.:

Shkruhen me vizë në fillim:

- Bashkëbisedimet (dialogjet):
 - Si të quajne?
 - Arbëreshë.
 - Po, ti, si e ke emrin?
 - Teuta.

Shkruhen me vizë në mes:

- Fjalët që përsëriten: e bëri *copë-copë*, u ndanë *grupe-grupe*, *lara-lara*, *shkallë-shkallë*, *dita-ditës*.
- Bashkimi i dy antonimeve (fjalëve me kuptim të kundërt): *hyrje-dalje*, *ngarkim-shkarkim*, *vajtje-ardhje* etj.
- Bashkimi i dy numërorëve themelorë (për të treguar një sasi të përafërt): *dy-tri orë (2-3 orë)*, *katër-pesë veta (4-5 veta)*, *pesë-gjashtë ditë (5-6 ditë)* etj.
- Tingullimitimet (onomatopetë), si: *zogu bën ciu-ciu*, *qeni leh ham-ham*, *diçka bëri bam-bum*, *ora bën tik-tak* etj.
- Gjuhët e fjalorëve dygjuhësh e shumëgjuhësh: *fjalor shqip-anglisht*, *fjalor maqedonisht-shqip*, *fjalor shqip-maqedonisht* etj.
- Pjesëza ish-(i mëparshëm, i dikurshëm) përpara emërtimeve të ndryshme, si: *ish-drejtor*, *ish-nxënës i shkollës sonë*, *ish-Jugosllavia*.
- Viza shkruhet edhe për të ndarë fjalët në fund të rreshtit (kjo do të shpjegohet në mësimin tjetër).

Detyrë



Shkruani siç duhet fjalët:

<i>gabimisht</i>	<i>drejt</i>	<i>gabimisht</i>	<i>drejt</i>
llojloj		këmbakëmbës	
laralara		gatigati	
ngjyrangjyra		dytrembëdhjetë	
doradorës		taktak	
fiufiu		shoqishoqin	
fjalor shqiplatinisht		ishministër	

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Dy nxënës/e zgjedhin një dialog të shkurtër të cilin e interpretojnë para klasës. Nxënësit e tjerë shkruajnë atë që dëgjojnë, duke i përdorur rregullat e drejtshkrimit për ta shënuar ligjëratën e drejtë. Forma e dialogut shkruhet në një tabelë interaktive ose në një fletë pune ku shenjat për shënimin e ligjëratës së drejtë janë përdorur drejt. Pas kësaj nxënësit së bashku me mësimmshënës/in diskutojnë për përdorimin e drejtë të shenjave.

Diktim



Cili është më i rëndësishëm?

Tri makina arrijnë përnjëherë në një udhëkryq pa semaforë.

Secili nga to donin të kalonin sa më shpejt. Shoferët filluan të bërtisnin:

- Lironi rrugën! Po ngutem! Jam vonuar! Po shkoj në punë!
- Edhe unë po ngutem! Unë jam polic.
- Ma lëshoni rrugën! Jam autoambulanca! Jam me urgjencë. A nuk po e dëgjoni sirenën?

Na thoni nxënës: Cili është më i rëndësishëm? Cili duhet të kalojë i pari?





NDARJA E FJALËVE NË FUND TË RRESHTIT

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> • ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit. 	<ul style="list-style-type: none"> • të ndajmë drejt fjalët në fund të rreshtit.

Gjatë të shkruarit ndodh që në fund të rreshtit të mos kemi hapësirë të mjaftueshme për ta shkruar fjalën e plotë. Në rastet e tilla, fjalën e ndajmë në dy pjesë me një vizë në mes. Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit mbështetet kryesisht në ndarjen e fjalëve në rrokje, por merr parasysh edhe strukturën morfologjike të fjalës si dhe disa parime të tjera. Për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit ka disa rregulla:

1. Nuk ndahen në fund të rreshtit:

- fjalët njërokové, si *jam, lis, dal, sy, dru, dje* etj.;
- shkronjat e një dyshkronjëshi: *mo-lla* (jo mol-la), *bre-dhi* (jo bred-hi), *bu-rrri* (jo bur-ri) etj.
- fjalët e përbëra të shkurtuara: *RM, ShBA, OSBE, NATO* etj.;
- shkurtime të tipit *b.f.* (bie fjala), *d.m.th.* (domethënë), *e.r.* (era e re), *p.sh.* (për shembull) etj.;
- një shkronjë e vetme nuk mund të qëndrojë as në fund të rreshtit, as në fillim të rreshtit të ri: *bu-ka* (jo b-uka ose buk-a), *mu-ri* (jo m-uri as mur-i) etj. Nuk ndahen as edhe fjalët që përbëhen prej një tingulli, siç është pjesëza e mohimit *s'* dhe përemri pyetës *ç'*;
- nuk duhet të ndajmë shkurtime të shifrave që tregojnë masë nga shifrat që tregojnë sasinë: *2 m², 5 kg, 100 %* etj.;
- nuk mund të hapen kllapa a thonjëza në fund të rreshtit e as të mbyllen në fillim të rreshtit tjetër. Nuk mund të kalojnë në rreshtin tjetër as shenjat e pikësimit, me përjashtim të vizës.

2. Ndahen në fund të rreshtit:

1. Dy shkronja të njëlojta që takohen në një fjalë, mund të ndahen në fund të rreshtit: *i pa-anshëm, i pa-arsyeshëm, ko-operativë, vaku-um, kundër-revolucion, hesht-te, e gjet-të (e mira)* etj.

2. Në fjalët me dy ose më shumë rrokje, bashkëtingëllorja që gjendet midis dy zanoresh ndahet në fund të rreshtit ashtu që shkruhet me zanoren që vjen pas, si p.sh.: *dru-ri, bo-ta, mi-ku, qe-ni, u-ji, ba-rra, gë-zim, nje-ri-u, bu-ku-ri-a, li-ri-a* etj.

3. Kur ndërmjet dy zanoresh ndodhen dy a më shumë bashkëtingëllore, atëherë njëra bashkëtingëllore shkon me zanoren e parë, ndërsa tjetra apo bashkëtingëllorja e fundit shkruhet me zanoren që pason. Parapëlqehet ndarja që ruan më qartë kufijtë e pjesëve të kuptimshme të fjalës ose kufijtë morfologjikë: *maj-tas, lo-dra ose lod-ra, po-sta ose pos-ta, i brend-shëm, për-parim* etj.



4. Fjalët e përbëra, fjalët e përngjitura si dhe fjalët e prejardhura ndahen në kufirin e pjesëve përbërëse të tyre: *hekur-udhë, bukur-shkrim, gjith-monë, tungjat-jeta, bashk-atdhe-tar, i për-kohshëm, zëvendës-drejtor, nën-oficer, shpër-ngul, mbi-shkrim, për-parim, për-mirë-sim, punë-tor* etj.

5. Kur kalon në rreshtin tjetër pjesa e dytë e një fjale a e një emërtimi të përbërë që shkruhet me vizë lidhëse, atëherë në krye të rreshtit përsëritet viza lidhëse, si p.sh.: *copa-/-copa, aty-/-këtu, vajtje-/-ardhje, hyrje-/-dalje* etj.

Ndarja e fjalës në fund të rreshtit vlen më shumë për shkrimin me dorë, sepse programet e sotme kompjuterike nuk lejojnë ndarje të tilla.

Detyrë



Ndajeni fletën e fletores me një vijë vërtikale në mes me dy hapësira të barabarta. Tekstin e dhënë rishkruajeni në dy kolona. Ndani fjalët në fund të rreshtit sipas rregullave të dhëna.

Mendimi se shqiptimi i drejtë përputhet plotësisht me shkrimin dhe rregullat e tij drejtshkrimore nuk është i drejtë. Shkrimi dhe shqiptimi kurrë nuk përputhen në mënyrë absolute. Siç dihet, drejtshkrimi i gjuhës sonë, përveç parimit fonetik, sipas të cilit fjalët shkruhen siç shqiptohen, mbështetet edhe në parimin morfologjik, më pak edhe në parimin historik, kështu që shkrimi nuk përputhet gjithnjë me shqiptimin.

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Nxënësve u diktohet një tekst. Përqendrimi i kontrollit të diktimit është ndarja e fjalëve në fund të rreshtit. Nxënësit kontrollojnë nëse i kanë ndarë drejt fjalët, sipas shembullit të treguar në dërrasën e zezë.

Hulumtim

Gjeni disa gabime drejtshkrimore në ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit në ndonjë gazetë ditore. Shkruani gabimet në fletore me të dhënat (në cilën gazetë, datën e botimit, faqen). Më pas ndani ato fjalë si duhet.

Zgjerohj diturinë nga interneti

<http://www.drejtshkrimi.info/ndarja/098>



PËRDORIMI I DREJTË I APOSTROFIT

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> përdorimin e drejtë të apostrofit. 	<ul style="list-style-type: none"> të përdorim drejt apostrofin.

Gabime të shpeshta drejtshkrimore gjejmë në përdorimin e **apostrofit** ', sidomos te trajtat e shkurtra, pjesëza mohuese **s'** apo përemri pyetës **ç'**. Për ta shkruar drejt apostrofin, duhet ditur katër rregulla:

Apostrofi përdoret:

- Te trajtat e shkurtra të përemrave vetorë **më** dhe **të**, kur bashkohen me trajtën e shkurtër **i**, për të shënuar rënie e zanores **ë**. Prandaj kemi: (më+i) **m'i** dha; (të+i) **t'i** dha; **m'i** dërgoi; **t'i** dërgoi etj.
- Te pjesëza **të** e mënyrës lidhore, e kohës së ardhme të dëftores, si dhe te ndërtimet e ndryshme me pjesore (për të, me të, një të+pjesore) etj. P.sh.: **t'i** mësosh mësimet; do **t'i** rrëfej të gjitha; për **t'i** mbajtur mirë; do **t'u** them; **t'ia** thuash; do **t'ia** numëroj; për **t'iu** përgjigjur asaj; do **t'ju** telefonojmë; do **t'jua** di për nder; do **t'ua** tregoj shokëve; **m'u** bë zemra mal; si **t'u** duk? etj.
- Pas pjesëzës mohuese **s'** dhe pas përemrit pyetës **ç'**, si: **s'**arrin, **s'e** di, **s'**presim, **ç'e** do?, **ç'**do?, **ç'**zë i ëmbël! etj.
- Për të shënuar rënie e **ë-së** te nyjat e përparme **të**, **së** me kuptim pronor në rasat e zhdrejta të emrave: i ati, e ëma: (i, e) **t'et**, (i, e) **s'emës**, me **t'ëmën**.

Formimi i trajtave të bashkuara të përemrave vetorë

Ja trajtat e shkurtra që përdoren me apostrof apo pa apostrof:

më + e = ma	i + e = ia	ju + e = jua
më + i = m'i	i + i = ia	ju + i = jua
të + e = ta	na + e = na e	u + e = ua
të + i = t'i	na + i = na i	u + i = ua

Shkruhen pa apostrof:

Shkruhen pa apostrof trajtat përemërore **ma**, **ta**; ku nuk kemi rënie të **ë-së**, por shkrimet e zanores **ë** me **a-në**: **ë + e = a** (më + e = ma; të + e = ta), si në shembujt: **ma** dha librin, **ta** dha lapsin.

Shkruhen pa apostrof përemri i pacaktuar (i pakufishëm) **çdo** dhe përemri pyetës **çfarë?**, si edhe fjalët e formuara prej tyre.

Detyrë



Lexoni me kujdes këto fjalë të urta popullore, rishkruani ato dhe vini apostrofin aty ku duhet.

Çbën, gjen.

Çsjell një orë, se sjell viti.

Gjithë çfluturon, shahet.

Po mbolle, skorr.

Koka që sdëgjon, pëson.

I ngopuri se di se është uria.



Shkruaj shenjën ✓ nëse apostrofi është përdorur drejt ose shenjën ✗ nëse apostrofi është përdorur gabimisht.

M'i tregoi fotografitë e fëmijërisë.	Më i tregoi fotografitë e fëmijërisë.	
Më u afrua dhe më përshëndeti.	M'u afrua dhe më përshëndeti.	
T'ia jap lapsin shokut.	Të ia jap lapsin shokut.	
Të i dha fletoret.	T'i dha fletoret.	
M'i dha librat.	Më i dha librat.	
Të i them se sot jam mirë.	T'i them se sot jam mirë.	
T'u thuash miqve se ...	Të u thuash miqve se ...	
T'ua thuash të vërtetën miqve.	Të ua thuash të vërtetën miqve.	
Duhet t'i them se...	Duhet të i them se ...	
Më i jep librat.	M'i jep librat	
M'u (më u) plotësuan dëshirat.	Më u plotësuan dëshirat.	
Të u dha rasti.	T'u dha rasti.	
Porosinë e t'et s'e harron kurrë.	Porosinë e të et se harron kurrë.	
Kujtimin e s'ëmës e ruante si sytë e ballit.	Kujtimin e së ëmës e ruante si sytë e ballit.	

Shpjegim

Rënia e ë-së së patheksuar fundore te fjalët shërbyese (pjesëza **të**, nyjat e përparme **të**, **së**; trajtat e shkurtra të përemrave vetorë **më** dhe **të**) bëhet për shkak të shqiptimit të fjalëve shërbyese me fjalët kuptimplota sikur të ishin një fjalë e vetme. Në drejtshkrimin e Gjuhës shqipe, kjo rënie e ë-së pasqyrohet me shkrimin e apostrofit (**m'i**, **t'i**, **m'u**, **t'u**, **t'et**, **s'ëmës**).



Detyrë



Ku duhet të shkruhet e ku nuk duhet të shkruhet apostrofi në fjalët e këtyre fjalive. Pse?

Sot do të vi te ti.

Duhet ti bëj detyrat.

Ma dha fjalën se do të mësojë.

Ti ma tregove bibliotekën e shtëpisë.

Tu tregojmë shokëve se sot do të luajmë futboll.



Tekstit të mëposhtëm i kemi hequr shumë shenja pikësimi, shkronjat e mëdha, kemi hequr ose shtuar apostrofin, vizën. Korrigjoheni duke e rishkruar.

ta pyesim plakun

dy vëllezër kishin vendosur t'a ndanin pasurinë dhe gjënë e gjallë në mënyrë që t'jetonin secili n'shtëpi t'vet ata shkuan për ta pyetur plakun e urtë se si ta ndanin pasurinë mes vete si vëllezër që ishin për të mos i hyrë në hak njëritjetrit

plaku i urtë u thotë atyre

- a jeni ju vëllezër të vërtetë mes vete

po ia kthyen ata.

- atëherë kot qenkeni munduar deri këtu

pse kot - e pyetën ata përnjëherësh plakun e urtë

- Po nëse jeni vëllezër të vërtetë siç thatë edhe vetë atëherë është shumë lehtë që ta e ndani pasurinë: me vëllanë ç'do gjë e ke përgjysmë pasurinë fitimin varfërinë të mirat por edhe të këqijat prandaj e ke vëlla dhe i thonë vëlla



Si të flasim dhe si të shkruajmë mirë?

Për të folur e shkruar mirë, përveç njohurive gramatikore, duhet të kemi parasysh edhe disa kushte të tjera. Ja disa prej tyre:

- Para se të fillojmë të flasim ose të shkruajmë, duhet të bëjmë një plan se çfarë duam të themi ose të shkruajmë.
- Të jemi të vëmendshëm dhe të shfrytëzojmë gjithë imagjinatën dhe aftësitë tona krijuese.
- Mendimet duhet t'i shprehim në mënyrë të qartë dhe të drejtë.
- Të jemi real dhe bindës në atë që e shprehim.
- Të mos përdorim fjalë fyese.
- Të flasim qetë e me zë të ulët, jo shumë shpejt as shumë ngadalë.
- Fjalitë duhet t'i ndërtojmë sipas aftësive tona.
- Të respektojmë rregullat e drejtshqiptimit (kur flasim) dhe të drejtshkrimit (kur shkruajmë), të zgjedhim fjalët dhe të krijojmë fjali sipas natyrës së shqipes.
- Shkrimi të jetë i lexueshëm dhe i bukur; shqiptimi të jetë normativ.
- Tekstin e shkruar ta rilexojmë disa herë dhe ta përmirësojmë.
- Të lexojmë sa më shumë.
- Të ndjekim modelet e mira të të folurit e të të shkruarit. Kështu kanë vepruar edhe shkrimtarët e mëdhenj.
- Duke lexuar autorë që shkruajnë mirë, mësojmë të shkruajmë e të flasim mirë.

NDARJA E LETËRSISË

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<p>Ndarjen e letërsisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> sipas vetive të brendshme: lirika, epika, dramatika; sipas formës: prozë dhe poezi; sipas autorësisë: letërsi popullore, letërsi artistike. 	<ul style="list-style-type: none"> të shpjegojmë domethënien e nocionit letërsi; të kuptojmë ndarjet e letërsisë nëpërmjet shembujve përkatës; t'i identifikojmë karakteristikat themelore të gjinive letrare, duke përdorur shembuj; të bëjmë dallimin e letërsisë së shkruar në varg dhe letërsisë së shkruar në prozë; të përcaktojmë cilës gjini letrare i takon një tekst i caktuar letrar sipas veçorive të brendshme dhe sipas formës; të shpjegojmë kriterin e ndarjes së letërsisë popullore me atë artistike.

Njeriu, gjatë jetës së tij, krijon vepra të ndryshme, të cilat japin kënaqësi shpirtërore. Një lloj i veprimtarisë së tillë është edhe krijimtaria letrare apo letërsia.

Letërsia është një nga veprimtaritë krijuese, që e ka shoqëruar historinë e njerëzimit që në lashtësi. Ajo gjithashtu është edhe pjesë përbërëse e jetës së përditshme.

Në periudhën antike kjo veprimtari quhej literaturë dhe me këtë term emërtohej gjithçka e shkruar, qoftë kjo letërsi ose jo. Por letërsia nuk është vetëm ajo që është shkruar në libra, sepse përveç letërsisë së shkruar, ekziston edhe letërsia gojore.

Që nga koha antike, letërsia është ndarë në tri gjini, që janë **lirika**, **epika** dhe **dramatika**.



Lirika mbështetet më tepër në harmoninë melodike të fjalëve. Shpreh botën e brendshme të autorit, kështu që mbizotërues është rrëfimi në vetë të parë.

Epika ka në thelb rrëfimin e ngjarjeve heroike, ku karakteristikë e saj është objektiviteti, rrëfimi në vetën e tretë dhe ndjeshmëria, por natyrisht kemi rrëfim edhe në vetën e parë.

Dramatika mbështetet në konfliktin mes së mundshmes dhe realitetit. Ka si mjet kryesor dialogun, ku autori rrëfen përmes personazheve.



Krijimet letrare kanë dy forma kryesore: **prozën** dhe **poezinë**.

Ndarja e letërsisë në prozë e në poezi bëhet në bazë të veçorive të tyre të jashtme dhe të brendshme. Tipar i jashtëm (pamor, vizual) është se proza shkruhet në tërë faqen, me rreshta të ngjeshur, me fjali të njëpasnjëshme e periudha të gjata. Poezia shkruhet në vargje, në një pjesë të faqes.

Veçori e brendshme është se proza i shtjellon gjërat shtruar (gjerë e gjatë), aty flet edhe autori edhe personazhet. Në gjuhën e prozës ndërthuren rrëfimi, monologu dhe dialogu. Aty kemi përshkrim të hollësishëm të një ngjarjeje me disa personazhe, përmes të cilëve shkrimtari rrëfen në vetën e tretë dhe në kohën e shkuar.

Me pak fjalë mund të thuhet se në prozë mbizotëron objektiviteti i shkrimtarit, me ngjyrim subjektiv; ndërsa në poezi (lirike) mbizotëron forma e shprehjes subjektive, bota e brendshme intime.

Veprat që shkruhen për t'u luajtur në skenë janë **drama**.

Veç tjerash, krijimtarinë letrare e dallojmë edhe sipas autorësisë së krijuesi. Sipas këtij kriteri, letërsia ndahet në dy degë kryesore:

- **Letërsi popullore;**
- **Letërsi artistike.**

Letërsia popullore

Letërsia popullore, që njihet edhe me termin letërsi gojore, ka lindur në kohën kur njerëzit akoma nuk dinin shkrim-lexim dhe ngjarjet janë rrëfyer gojarisht. Pra, krijimtaria shpirtërore e një populli, e krijuar që nga kohët më të lashta dhe e trashëguar brez pas brezi quhet letërsi gojore apo popullore. Fillimet e saj janë që në kohën e hershme kur njeriu ka pasur nevojë tua transmetojë të tjerëve përvojën e fituar në luftë me kafshët apo natyrën, në fillim me gjeste, e më vonë edhe gojarisht.

Bartësit e kësaj veprimtarie krijuese nuk janë të njohur, prandaj dhe janë quajtur krijues anonim, ndërsa letërsia ka marrë epitetin letërsi e popullit ose popullore.

Në këtë letërsi bëjnë pjesë krijimet si: **legjendat, përrallat, gojëdhënat, mitet, gjëgjëzat, anekdotat, ninullat, fjalët e urta** etj.

Letërsia artistike

Kur u shfaq shkrimi, njerëzit zunë t'i shprehin me shkrim ndjenjat dhe mendimet e veta. Andaj në letërsinë e shkruar apo artistike ne ua dimë emrat shkrimtarëve, poetëve dhe tregimtarëve. Shkrimi mbetet dokument i gjallë, ndërsa në letërsinë gojore nuk i dimë emrat e autorëve.



Detyrë



Lexoni tri tekstet e mëposhtme.

1. Babai i Albanit punon çdo ditë. Ai del nga shtëpia herët në mëngjes dhe kthehet natën vonë. Albani e sheh vetëm në darkë. Ai do të luajë me të, por shpeshherë, babanë e lodhur e kap gjumi.

* * *

2. Erdhi babai në shtëpi,
Është i lodhur, kushedi,
Se punon e lodhet shumë,
Që të jem i lumtur unë.

* * *



3. Mësuesi: Po, pesëshe. Por, sigurisht ti nuk e di që më parë.

Edmondi: E di... e di edhe për nesër.

Mësuesi: si mund ta dish përpara?

Edmondi: E di. Nesër në mëngjes, para fillimit të mësimit, do të më vijë tezja nga Ulqini.

Mendoni dhe përgjigjuni



1. A dallohen këto tri pjesë?
2. Me se dallohen ato?
3. Në sa gjini ndahet letërsia dhe cilat janë ato?
4. Çka e dallon poezinë nga proza?
5. Ku dallohen letërsia popullore dhe letërsia artistike?

LIRIKA

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> • lirikën; • veçoritë strukturore të poezisë lirike - vargu, strofa dhe rima; • poezinë patriotike; • poezinë e peizazhit; • elementet vizuale të poezisë; • elementet auditive të poezisë; • ritmi, rima, theksi, rrokja; • figurat stilistike; • epiteti, metafora, krahasimi, antiteza, onomatopeja dhe personifikimi. 	<ul style="list-style-type: none"> • të dallojmë llojin e poezisë lirike sipas formës dhe tematikës; • të përcaktojmë vargun dhe llojet e tyre; • t'i përcaktojmë strofat dhe llojet e saj; • ta dallojmë rimën dhe llojet e rimave; • të bëjmë analizë strukturore të poezisë së caktuar lirike dhe të përcaktojmë motivin e poezisë; • ta dallojmë poezinë e peizazhit dhe poezinë patriotike; • t'i identifikojmë figurat stilistike (rima, onomatopeja, epiteti, krahasimi, personifikimi) dhe t'i ilustrojmë ato me shembuj.

Kemi thënë që gjinitë letrare ndahen në gjininë **epike**, **lirike** dhe **dramatike**. Gjinia epike rrëfen një ngjarje, shkruhet në rreshta dhe në të bëjnë pjesë romani, tregimi dhe përralla. Gjinia lirike shpreh ndjenjat e poetit, përkatësisht shpreh botën e tij të brendshme. Lirika shkruhet në vargje, ka gjuhë të pasur letrare dhe muzikalitet të brendshëm. Ndërkaq gjinia dramatike është krijuar për t'u vënë në skenë. Personazhet flasin nëpërmjet dialogut ose monologut. Pjesë përbërëse të dramatikës janë tragjedia, komedia dhe drama.

Si lindi poezia lirike?

Në kohët antike poezia lindi si mishërim i shprehjes së botës së brendshme të njeriut. Ajo shoqërohej me tingujt e një vegle muzikore të quajtur **lyra**. Më vonë poezia vazhdoi jetën e saj pa nevojën e shoqërimit me muzikë. Në natyrën e vet ajo realizohet nëpërmjet harmonizimit të tri karakteristikave: imazheve, efekteve tingullore dhe mesazheve që transmeton nëpërmjet fjalës.

Lirika, apo thënë ndryshe poezia lirike, ndahet **sipas formës** dhe **sipas tematikës**.

Llojet **sipas formës** janë:

- elegjia;
- odeja;
- himni;
- soneti.



Sipas tematikës që trajton poezia lirike ndahet në:

- poezi lirike atdhetare;
- poezi lirike dashurie;
- poezi lirike peizazhi dhe
- poezi lirike meditative-filozofike.

Veçoritë e poezisë

Njerëzit shkruajnë poezi për të shprehur ndjenjat e tyre: gëzim, hidhërim, dashuri, vuajtje. Kush ka shkruar poezi, ai e di që ajo zakonisht vjen pas një frymëzimi shpirtëror. Megjithatë, njerëzit shkruajnë poezi edhe për të luajtur me fjalët, për të krijuar imazhe dhe për t'u argëtuar. Poezitë më së shumti shkruhen në vargje me gjatësi të barabartë ose të ndryshme dhe përdorin mjete stilistike. Në poezi gjejmë shpesh fjali të ngarkuara me figura letrare që nxitin imagjinatën, ndërsa roli i pikësimit është për t'i treguar lexuesit ku të ndalojë ose ku të krijojë ritëm. Poezia tingëllon bukur.

Tingujt që përsëriten ose rima, e bëjnë poezinë më të këndshme për të dëgjuar. Shpesh, për hir të rimës poetëve u lejohej që të mos respektojnë rregullat gramatikore ose drejtshkrimore kur këto janë në dobi të tingëllimit të bukur të poezisë. Për të shijuar veçoritë e poezisë artistike, lexojeni vjershën e mëposhtme të Asdrenit.

D U A

<i>Mbi bar dua të prehem, të këndo, të dëfrehem,</i>	<i>bilbili t'ia thotë nën diellin e ngrohtë.</i>
<i>të shoh rreth bagëtinë, kur hanë dhe pinë;</i>	<i>Dua dhe Shqipërinë, se atje kam shtëpinë,</i>
<i>të shoh fushat e blerta, bimët kur i fryen era,</i>	<i>kur rrija nëpër ferrat edhe lozja me shqerrat;</i>
<i>njerëzit kur punojnë dhe çupat kur këndojnë!</i>	<i>për këtë kam dëshirë dhe s'dua më mirë,</i>
<i>Ah, dua dhe lulet, kur i shfaqin pekulet,</i>	<i>atje dua të shkoj, sa të jem e të rroj</i>
<i>dhe fluturat që venë, mbi to dua të jenë;</i>	

Asdreni



Vargu dhe llojet e vargjeve

Krijimet poetike (vjershat, poemat) ndërtohen me vargje. Vargu është njësi poetike, që përbëhet prej fjalësh e fjalish të shkruara në një radhë dhe që ka një ritëm e një numër të caktuar rrokjesh.

Ky numër i caktuar rrokjesh i jep vargut edhe emrin, p.sh.: varg 6-rrokësh, 8-rrokësh, 10-rrokësh, 11-rrokësh etj.

- a) Kur brenda një vjershe (poezie) çdo varg ka numër rrokjesh të njëjta me vargjet e tjera, themi se këto vargje janë të matura. Këto lloj vargjesh janë tipike për krijimet folklorike dhe për pjesën më të madhe të poezisë shqipe të traditës dhe të letërsisë së sotme. P.sh.:

*U nis burimi zemërak
prej shkëmbit të ronitur,
dhe shkoi i pastër si zambak
e duke pëshpëritur.*

L. Poradeci "Mërgimi"

Këto janë vargje 8-rrokëshe me rimë dhe quhen të rregullta.

- b) Kur lexojmë një krijim poetik të popullit ose të poetëve, na bie në sy që disa vargje rimojnë (poezia "Mërgimi") dhe disa të tjera jo (poezia "Statujë pa krahë"). P.sh.:

*Të tillë botë statujat s'kanë parë,
as në ëndrrat e tyre të bardha
statujat të dashuruara
janë
por, statujat duar
s'kanë.*

I. Kadare "Statuja pa krahë"

Edhe vargjet e ciklit të kreshnikëve janë pa rimë. Këto lloj vargjesh quhen **të bardha** ose **pa rimë**.

- c) Kur lexojmë vargjet:

*O, si nuk kam një grusht të fortë
t'i bij mu në zemër malit që s'bëzanë
ta dij dhe ai se ç'domethënë i dobët,
n'agoni të përdridhet si vigan i vramë.*

Migjeni "Recital i malësorit"



Vëmë re se nga një varg në tjetrin mungojnë rima dhe numri i caktuar i rrokjeve. Këto quhen vargje të lira. Për herë të parë këto vargje në letërsinë tonë i përdori Migjeni.

ç) Kur lexojmë vargjet:

*Për pesë shekuj luftuan ato rresht
Mbi qiell të Shqipërisë në rrebesh
Por gjithsesi një ditë do të fitonte
Kundër një hënë gjysmë
Një shqipe me dy kokë.*

I. Kadare "Shqiponja e gjysmë hëna"

Vëmë re që vargu shkruhet i shkallëzuar me qëllim që të theksojë më mire diçka dhe për ta lexuar me intonacionin shprehës. Ky quhet varg i thyer.

Strofa dhe llojet e saj

Le të lexojmë disa vargje nga poetë të ndryshëm dhe nga populli.

*"Emblemë e moçme, krijesë me dy kokë
Ç'trazim ndërgjegjeje të polli në botë".*

I. Kadare, "Shkaba dykrenare"

*"Un' ik liqenit zemërak
fatlum dhe i pastër si zëmbak,
po zemra ime kullon gjak".*

L. Poradeci, "Vdekja e nositit"

*"Jashtë murlani thyen degët
përleshet me flokë bore,
psherëtin natyr' e ngratë
si të rrihej prej një dore".*

S. Malëshova, "Atdhemohuesi"

*Kanan Mazeja nga Shkoza
me një nofull copa-copa
- Kanan, t'u prish bukuria!
- Le të rrojë Shqipëria.
Shqipëria le të rrojë
Çka se mbeta un' pa gojë.*

Populli

Çfarë vërejmë?

Ç'na bën përshtypje në këto vargje?

Vëmë re se shprehjen e mendimeve dhe të ndjenjave, përshkrimin e veprimeve dhe të ngjarjeve, poeti ose populli nuk e bën menjëherë, që në vargun e parë, por me tërësinë e vargjeve. Këtë grup vargjesh që qëndron më vete, në vjershërim, e quajmë **strofë**.

Për emërtimin e strofave shihet numri i vargjeve që i përbën ato. Prandaj, siç e shohim edhe në shembujt e mësipërm, kemi strofa dyshe, treshe, katërshe etj.

Por ka edhe vjersha e poema të pandara në strofa, si: *Cikli i Kreshnikëve, Këngët e Milosaos* etj. Këto quhen **monokolonë**.



Lexojeni këtë poezi:

VALLJA E LULEVE

Vijnë vashat valle valle
Gushë-e-gji-stolisura.
Një pëllumb, një sy-zorkalle
Se vjen m'e mbollisura.

Ç'm'i ka hije shtat'i hedhur,
Hije kraharuari,
Pa fillon me zë të dredhur
Motra së kënduari:

Ju që niseni për lule,
Shoqe moj të mijëza,
Merr-më-ni as edhe mua
Nër pyje-e korijëza;

Pritni moj të vi dhe unë
Maleve, lëndinave,
Ndaj çkëlqen pa të përdhunë
Fill-i trendelinave;

Në mos diçka të bëj tufë,
Shoqe ju dëgjomëni:
Bëni moj një tog me lule
Dhe me to mbulo-më-ni;

Në ju pyeçin për mua:
Ç'u bë flog-banusheja?
Thoni, se më një përrua
E zu gjarpërusheja:

Thoni, se ndaj një mburimi
Më t'e patë fluturën:
Thoni, seç e zuri trimi
Atë bel-këputurën.

Lasgush Poradeci

Mendoni dhe përgjigjuni

1. Sa strofa ka kjo vjershë?
2. Nga sa vargje kanë strofat?
3. Shkruani fjalët e fundit të vargut të parë dhe të tretë, pastaj të vargut të dytë dhe të katërt të strofës së dytë. Tani keni shkruar fjalët: hedhur - dredhur; kraharuari - kënduari.
4. A përputhen tingujt e fundit të këtyre fjalëve?
5. Cilat rrokje na dalin në fund të këtyre fjalëve?
6. Si e quajmë këtë përputhje tingujsh fundorë të vargjeve?



Rima

Rimë është përputhja në fund të dy ose më shumë vargjeve e tingujve që nisin nga zanorja e theksuar. Sipas vendit të theksit ritmik në fund të vargut edhe rima është mashkullore (kur theksi i fjalës bie në rrokjen e fundit), femërore (kur theksi i fjalës bie në rrokjen e parafundit) dhe rrëshqitëse (kur theksi i fjalës bie në rrokjen e tretë ose të katërt).

Sipas renditjes së vargjeve të rimuara dallojmë:

- rimë të puthur, kur rimojnë dy vargjet që vijnë njëri pas tjetrit (shënohet me AABB);
- rimë të kryqëzuar, kur vargu i parë rimon me të katërtin, dhe i dyti me të tretin (ka skemën ABAB);
- rimë të mbyllur, kur vargu i parë rimon me të katërtin, kurse i dyti me të tretin (skema e këtij vargu është ABBA);
- rimë të ngarkuar, kur të gjithë vargjet rimojnë midis tyre (mund të shënohet me skemën AAAA).

Poezia mund të shkruhet edhe pa vargje të rimuara, nëpërmjet vargut të lirë. P.sh.:

*Lexo, nëna ime, këtu, në gur
të fortë - dhembjen
dhe heshtjen tonë.
Lexo kohën e thikës dhe barotit.*

Nehas Sopaj "Guri"

FSHATI IM

*Malet me gurë,
fushat me bar shumë,
arat me grurë,
më tutje një lumë.*

*Fshati për karshi;
me kish' e me varre,
rrotull ca shtëpi,
të vogla fare.*

*Ujët të ftoftë,
era pun' e madhe,
bilbili ia thotë,
gratë si sorkadhe.*

*Burrat nën hije,
lozin kuvendojnë;
pika qe s'u bie,
se nga gratë rrojnë!*

*Gratë venë në arë,
dhe në vreshta gratë,
gruaja korr barë,
punon dit' e natë.*

*Gratë në të shirë,
në të vjela gratë,
ikin pa gdhirë,
kthehen me natë.*

*Gruaja për burrë,
digjet në diell,
punon e s' rri kurrë,
as ditën e diel.*

*O moj shqipëtarë,
që vet i nget qetë,
edhe drek' e darkë,
kthehesh e bën vetë.*

*Moj e mjera grua,
ç'e do burrë zinë,
që ftohet në krua
dhe ti mban shtëpinë.*

Lasgush Poradeci

Çajupi është një ndër shkrimtarët e Rilindjes Kombëtare që u angazhua shumë për fatin e femrës shqiptare të asaj kohe. Në vjershën "Fshati im" për herë të parë flitet haptas për pozitën e vështirë të gruas, për vuajtjen e femrës, e cila ishte e ngarkuar me punët e shtëpisë e të fushës, e shtypur gjithnjë nga zakonet prapanike.



Mendoni dhe përgjigjuni

1. Sa strofa ka kjo vjershë?
2. Nga sa vargje kanë strofat?
3. Çfarë rime ka kjo vjershë?
4. Mësoni përmendësh katër strofat e para të kësaj vjershe dhe recitoni.
5. Pasi ta keni lexuar me kujdes temën e shtjelluar, shkruani gjërat më të rëndësishme për strofën, vargun dhe rimën.



Andon Zako Çajupi (1866 - 1930)

Lindi në Sheper të Zagorisë më 27 mars 1866. Mësimet e para i mori në vendlindje, vazhdoi në kolegjin francez në Aleksandri, ndërsa drejtësinë në Gjenevë. Shkroi elegjinë "Vaje", përmbledhjen poetike "Baba Tomorri" (1902) ku përfshiu komedinë "Katërmëdhjetë vjeç dhëndërr", poemën "Baba Musa lakuriq", tragjedinë "Burri i dheut", komedinë "Pas vdekjes", përmbledhjen poetike "Këngë e vome", "Përrallat e La Fontenit" (1921) dhe "Lulet e Hindit" (1922). Vdiq në Kajro më 11 korrik 1930.

Poezia atdhetare (patriotike)

Poezitë patriotike për motiv kanë dashurinë për vendin, për atdheun, historinë dhe traditën, për gjuhën dhe lirinë. Tematikë patriotike kanë pjesa më e madhe e poezisë sonë të Rilindjes, ku shkrimtarët, ashtu si tërë populli, synonte çlirimin e vendit nga robëruesi.

O moj Shqypni

*O moj Shqypni, e mjera Shqypni,
Kush të ka qitë me krye n'hi?
Ti ke pas kenë një zojë e randë,
Burrat e dheut të thirrshin nanë.
Ke pasë shumë t'mira e begati,
Me varza t'bukura e me djelm t'ri,
Gja e vend shumë, ara e bashtina,
Me armë të bardha, me pushkë ltina,
Me burra trima, me gra të dlira;
Ti ndër gjith shoqet ke kenë ma e mira.*

*Kur kriste pushka si me shkrep moti,
Zogu i shqyptarit gjithmonë i zoti
Ka kenë për luftë e n'luftë ka dekun
E dhunë mbrapa kurr s'i mbetun.
Kur ka lidhë besën burri i Shqypnisë,
I ka shti dridhën gjithë Rumelisë;
Ndër lufta t'rrepta gjithëkund ka ra,
Me faqe t'bardhë gjithmonë asht da.*

Pashko Vasa

Poezia "O moj Shqypni" u bë një nga kryeveprat poetike të Rilindjes. Kjo vjershë lindi në ditët e stuhishme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe qarkulloi gojë më gojë, ngandonjëherë edhe si këngë. Në të ndihet jehona e ngjarjeve dramatike që kalonte vendi ynë, kur shqiptarët mbronin me gjak trojet e tyre nga lakmitë e shovinistëve fqinjë dhe nga vendimet e padrejta të Kongresit të Berlinit.

Vjersha sintetizon në mënyrë poetike gjithë idetë e mëdha të lëvizjes kombëtare. Ajo është ndërtuar mbi bazën e antitezës. Për nga brendia ajo përmban dy pjesë, dy tablo të Shqipërisë. Në të parën, si gjithë rilindësit, autori prezanton të kaluarën, kurse në pjesën e dytë përshkruhet me ngjyra rrëqethëse gjendja e mjerë e atdheut të robëruar. Vjersha fillon me ton elegjiak, me një pyetje plot dhembje drejtuar Shqipërisë, që e kanë "qit me krye n'hi", që s'e ka më forcën dhe lavdinë e mëparshme.

Pashko Vasa është një nga të parët që lëshoi kushttrimin për t'u bashkuar pa dallim feje. Në pikëpamje të kompozicionit, vjersha përbëhet prej dy pjesësh dhe theksi vihet më tepër tek e dyta, por ajo i drejtohet edhe së ardhmes. Vjersha "O moj Shqypni" është një nga krijimet më të frymëzuara të poezisë shqiptare. Figuracioni i pasur e shprehës, epitetet, krahasimet, pyetjet retorike plot ngarkesë emocionale, shkodranishtja e kuptueshme dhe e ëmbël e bënë atë aq ndikues tek masat. Vargu dhjetërokësh (pesërokësh i dyzuar) i jep poezisë një ritëm marshi, në përputhje me përmbajtjen, duke sintetizuar thujtë gjithë idetë e lëvizjes kombëtare: krenarinë për të kaluarën, dashurinë për vendin, urrejtjen për robërinë, thirrjen për bashkim.

Pashko Vasa (1825-1892)

Pashko Vasa (i njohur edhe si Vaso Pasha) lindi në Shkodër më 1825. Njohu disa gjuhë të huaja. Në Turqi, Stamboll, Vasa u ngrit në shkallën e lartë të hierarkisë shtetërore. Nga viti 1883 e deri sa vdiq, më 1892 në Bejrut, ishte guvernator i përgjithshëm i Libanit. Shkroi poezi, prozë artistike, publicistikë dhe libra gjuhe. Veprat më të rëndësishme të P. Vasës janë: përmbledhja me vjersha "Trëndafila dhe gjemba" (1873), romani "Bardha e Temalit" (1890) i shkruar frëngjisht.

Poezia e peizazhit

Lirika e peizazhit ose lirika përshkruese është ajo që frymëzohet nga përshkrimi i pamjes së natyrës dhe dukuritë e saj. Poeti nuk është thjesht një fotograf i natyrës, ai shpreh botën e vet shpirtërore që ka për të.

Peizazhi si formë poetike, e sidomos si frymëzim lirik i përshkrimit dhe paraqitjes së natyrës në poezinë tonë artistike i ka rrënjët që nga poezia romantike, pra që në poezinë e Rilindjes kombëtare shqiptare. Vepra "Bagëti e Bujqësia" e Naim Frashërit është një krijim letrar që mbështetet mbi përshkrimet e bukurive të mahnitshme të natyrës shqiptare të shekullit XIX. Qëllimi i autorit të kësaj poeme ishte zgjimi i dashurisë ndaj atdheut të shqiptarëve, të cilët jetonin larg Shqipërisë. Dhe kësaj Naimi ia arriti duke e derdhur tërë inspirimin e tij, tërë frymëzimin dhe mallëngjimin me figura, shprehje dhe qëndrim romantik ndaj natyrës së atdheut.



BAGËTI E BUJQËSIA

Ju bregore bukuroshe! E ju lumenjt' e kulluar!
 Çuka, kodra, brinja, gërxhe, dhe pyje të gjelbëruar!
 Do të këndonj bagëtinë, që mbani ju e ushqeni;
 O vëndëthit e bukur, ju mendjenë ma dëfreni.
 Kur dëgjon zëthin e s'ëmës, qysh e le qengji kopenë,
 Blegërin dy a tri herë edhe ikën e merr dhenë;
 Edhe në i pëfshin udhën, njëzet a tridhjetë vetë,
 e ta trëmbin aji s'kthehet, po shkon në mes si shigjetë.
 Mëndje! Mer fushat e malet, jashtë jashtë nga qyteti,
 nga brenga, nga thash-e-thëmet, nga rëmuja nga rëmeti.
 Tek këndon thëllëza me gas edhe zogu me dëshirë,
 E qyqja duke qeshur, bilbili me ëmbëlsirë,
 tek hapet trëndafili, atje ma ënda të jem,
 bashkë më shpesh edhe unë, t'ja thëres këngës, t'ia them,
 Të shoh kecërit e shqerrat, deshtë cjepët, dhënt e dhitë,
 Qiellin e zbukuruar, dhenë me lul' e me dritë.
 - Vashë bukurosh' e bariut! Që vjen me llërë përveshur,
 Me zemër të dëfryer, e me buzëzë të qeshur,
 Me dy shqerëza ndër duar të bukura si dhe vetë,
 Në sythit tënd e shoh gazë që s'e kam gjetur ndë jetë.
 Dashi sysk'e me këmborë që e ke manar po të vjen pas,
 Dhe qeni me bes i larmë, të ndjek me dëshirë e me gas,
 Dashç Perëndinë, pa më thua, a mos na pe bagëtinë?
 - I lash' atje pas më të gdhirë... ja atje përtej tek vinë.
 O! Sa bukuri ka tufa! Sa gas bie bagëtia!
 Vinë posi blet e plotë, i bekoftë Perëndia!
 Njëpër shesh e nër bregore, janë përhapur shqerrat!
 E kecërit njëpër rripat dhe në gjethet e në ferrat!
 Sa me vrap e me gas bredhin edhe lozin shok me shok,
 Aty përhapen me nxit, aty mblidhen prapë tok,
 Edhe prapë tufë-tufë, përhapen duke bredhur,
 Duke ikur me vrap shumë, duke lojtur duke hedhur,
 Nxitojn' e s' lodhen kurrë, edhe kur i mer uria,
 se cili futet në tufë, suletë te mëm' e tia.
 Posa gjen mëmën e dashur dhe me vrap i hyn në gji,
 Rri në gjunjë dhe e zë sisën, e qumështin e ëmbël pi,
 Pa e ëma me mall shumë, ndo dhi qoftë ndo dele,
 Bir' e vetëm e mer në gji, me gas e me përkëdhele...
 Sa më pëlqen blegërima, zër' i ëmbël i bagëtisë,
 Qëngji dhe kec' i bukur, që rri në gjunj' e pi sisë,
 Përhapurë bagëtia njëpër shesh e njëpër brinja
 Nër lajthi e njëpër dushnja, ndër muriza ndër dëllinja;
 Bien zilet dhe këmborët, dhe fyelli dhe xhuraja,
 Dhe bleron e gjelbërojnë, fusha male brigje maja,
 Edhe gjithë gjë e gjallë, ndjen në zëmër një dëshirë,
 Një gaz të ëmbël e të shumë! O! Sa bukur e sa mirë!

Naim Frashëri



Në veprën në vargje, “Bagëti e bujqësia” nga Naim Frashëri shihet dashuria e poetit për vendlindjen dhe malli që ndiente duke qenë larg atdheut, në Stamboll. Gjithë mallëngjimin që kishte për vendlindjen, poeti i ka shprehur përmes kësaj vjershe të gjatë – të cilën e quajmë poemë.

Detyrë



1. Pse i këndon me aq dashuri natyrës së vendlindjes?
2. Zgjidhni vargjet me të cilat poeti përshkruan natyrën.
3. Bëni edhe ju një përshkrim të shkurtër për natyrën.

Naim Frashëri (1846 – 1900) lindi në fshatin Frashër, afër Korçës. Është poeti më i madh i Rilindjes sonë. Tërë jetën dhe punën e vet ia kushtoi çlirimit të atdheut të vet nga zgjedha e osmanëve. Veprat e tij letrare janë me temë patriotike, arsimdashëse dhe kanë vlerë të madhe artistike. Vdiq më 1900. Për lexuesit më të vegjël Naim Frashëri ka shkruar: “Këndimit të çunave këndonjëtoreja”, “Të vegjëlit”, “Katër stinët”. Ka shkruar edhe shumë fabula dhe i ka adaptuar bukur fabulat e njohura të La Fontenit etj.

Elementet pamore (vizuale) të poezisë

Poezia dallohet dukshëm nga proza. Nga ana e jashtme shihet se poezia shkruhet në një pjesë të faqes, zakonisht në mes, në vargje që vijnë njëri pas tjetrit. Pra, në të shkruar poezia ka pamjen e një kolone në vargje. Veçori e brendshme e poezisë është se ajo zakonisht nuk ka ngjarje, nuk ka personazhe. Raporti i poetit ndaj realitetit është subjektiv, përplot me emocione dhe poeti aty flet vetë, në vetën e parë dhe në kohën e tashme.

Ka disa lloje poezish. Lloji më tradicional i poezisë është poezia e shkurtër ose e vogël, që zakonisht e njësojnë me poezinë lirike, ku shquhet disponimi emocional, intim dhe subjektiv i poetit.

Elementet dëgjimore (auditive) të poezisë

Elementet kryesore auditive mbi të cilat ndërtohet poezia janë: **ritmi**, **rima**, **theksi**, **rrokja** etj.

Në poezinë shqipe kemi tri lloje vargjesh: varg popullor, varg të huazuar dhe varg të krijuar. Rol vendimtar në ndërtimin e vargut luajnë numri i rrokjeve në varg dhe renditja e rrokjeve të theksuara e të patheksuara. Numri i rrokjeve përcaktohet nga numri i zanoreve.

Poezia ka një gjuhë të përpunuar përplot me figura stilistike, ritëm, muzikalitet e melodi. Me ritëm nënkuptojmë anën melodike, muzikore të poezisë, d.m.th. harmoninë e brendshme të vargut.



Në vargjet e Asdrenit:

*Ardhi koha, ardhi dita,
Iku nata, doli drita,
Ngrihu trima, mos përtoni,
Këtë kohë ta shpëtoni!*

ka simetri të plotë të vargjeve, që përforcohet nga rima.

Detyrë



Lexoni me vëmendje prozën “**Vendlindja ime**” dhe poezinë “**Shtëpia ime**”.

- Si është shkruar proza e si poezia?
- Krahasoni pamjen e jashtme të prozës “*Vendlindja ime*” dhe të poezisë “*Shtëpia ime*”.
- Thoni çfarë dallimi hetoni ndërmjet tyre?

Vendlindja ime

Një djalosh udhëtoi shumë. Kaloi nëpër vendet më të bukura dhe më të largëta të botës. Kur u kthye në vendlindjen e vet, një shok i tij e pyeti se cili vend i kishte pëlqyer më tepër. Djaloshi iu përgjigj:

- Kam parë shumë vende të bukura e të mrekullueshme në botë. Por, më të bukura nga të gjitha, janë muret e bardha të shtëpisë ku kam lindur. Prej të gjitha luleve të bukura të atyre shtëpive të pasura në mërgim, asnjëra nuk më është dukur aq e bukur, sa karafili që ka mbjellë babai im dhe që e ka ujitur nëna ime.

Ndoshta ti nuk i ke parë ato vendet e bukura, për të cilat shpeshherë flasin mërgimtarët - e pyeti me habi shoku i vet.

- Pashë shumë vende, por po të them se të shëtitësh mbarë botën, për ne nuk ka asnjë vend më të bukur dhe më të dashur se vendlindja jonë.

Shtëpia ime

*Atje kah fundi i katundit
Aty afër nj'atij lumit,
Atje larg kam një shtëpi
Ku banojnë prindërit e mi*

*Është e vogël pa zbukurime,
Por e madhe në zemrën time,
Ty të dua, o moj fole
Se je vendi ku kam le.*

*Të kam ndërmend e s'të harroj,
Natë e ditë ty t'kujtoj,
Shumë të dua, pa ty s'rri,
Se te ti janë prindët e mi.*

*S'të ndërroj, jo; as me pallate,
Le të jenë edhe me shumë kate,
Se mbi t'gjitha në këtë dhe
Është shtëpia ku kam le.*



Dëgjoni ndonjë poezi të recituar nga ndonjë aktor i njohur shqiptar. Diskutoni për mjetet dëgjimore (auditive), si ritmin, rimën, theksin, rrokjen, intonacionin.

Figurat stilistike

Të shprehurit e figurshëm është veçori dalluese e letërsisë artistike, por është e shpeshtë edhe në gjuhën e folur e në krijimtarinë gojore. Figurat stilistike janë të shumta. Figura të tilla stilistike janë **epiteti**, **metafora**, **krahasimi**, **antiteza**, **onomatopeja**, **personifikimi** etj.

Epiteti (greq. *epítheton* – shtesë, ndajshtim) është fjalë përcaktuese që i shtohet emrit, për të cilësuar a vënë në dukje një tipar karakteristik të tij. P.sh. në katër vargjet e veprës së Naimit “Historia e Skënderbeut” në dy raste është përdorur epiteti:

*Krujë o qytet i bekuar
prite, prite Skënderbenë,
po vjen si pëllumb i shkruar
të shpëtojë mëmëdhenë.*

ndërsa më poshtë në pesë vargjet - pesë herë:

*Ishte Uran-bukuroshi
dhe Tanushi kordhë-larë
Hamzaj, Muzakë-djaloshi
.....
Maneshi, shpatulla-gjerë,
Golemi mjekërë-ziu,*

Në gramatikë epiteti është mbiemër cilësor (i nyjshëm a i panyjshëm, përcaktor, atribut), që lidhet drejtpërdrejt me emrin.

Metafora (nga greq. *metaphorá* – bartje, ndërrim kuptimi) ka përdorim të gjerë jo vetëm në letërsinë artistike, po edhe në të folurit e përditshëm dhe në folklor. Metafora sajohet kur emërtojmë një send me emrin e një sendi tjetër në bazë të ngjashmërisë. Kështu, kur themi: *Agroni është si gacë e mbuluar*, fitojmë një **krahasim**. Mirëpo, po ta heqim lidhëzën e krahasimit **si**, do të kemi **metaforën**: *Agroni është gacë e mbuluar*. Pra, metafora është rezultat i një krahasimi të menduar dhe fitohet duke e ruajtur vetëm pjesën e dytë të krahasimit, si p.sh.: *ujk i vjetër* (= është *ujk i vjetër*; *dhelpra* (= *dinak si dhelpra*) etj.

Metafora të tilla hasim në dy vargjet e strofës së parë të poemës “Andrra e Jetës” të Ndre Mjedës:

*Molla t’kputuna një deget
dy qershija lidhë n’ji rrfanë, ...*

Krahasimi (lat. *comparatio*) sajohet kur një send, një mendim, një dukuri e krahasojmë me një gjë tjetër, me qëllim që të parën ta njohim ose ta sqarojmë më mirë.

Kjo figurë përbëhet prej dy pjesësh: e krahasueshmja (gjëja që krahasohet) dhe krahasuesja (gjëja me të cilën krahasohet), që lidhen ndërmjet tyre me anën e lidhëzave krahasore mënyrore: **si**, **posi**, **porsi**, **sikur**, **sikurse**, **ashtu**, **ashtu si** etj. P.sh. Ma ka shtatin si selvi, ma ka syrin si filxhan, m’i ka dhëmbët si inxhi, m’i ka buzët si qershia ... Pjesa e dytë është e figurshme.



Antiteza (nga greqishtja *antithesis* – kundërshti) është figurë e përbërë nga dy gjëra apo mendime të kundërta. Si mjet stilistik përdoret për t'i dhënë shprehjes forcë e qartësi. Antiteza përbëhet nga paraqitja e dy anëve të kundërta, që shprehen me antonime, pra me fjalë me kuptim të kundërt. P.sh.: *Koha, atë mëngjes, aty qante, aty qeshte*.

Onomatopeja (vjen nga greqishtja *onoma* - emër, *poieo* - bej, krijoj) është fjalë tingullimituese ose përshkrim i dukurive a i sendeve, duke shfrytëzuar imitimin e zhurmave e të zërave.

Onomatopeja është ajo figurë letrare që realizon imitimin nëpërmjet tingujve të zhurmave të qenieve të gjalla ose të zhurmave të dukurive natyrore, si: kënga e zogjve (ciu-ciu), trokëllima e kuajve (*trak-trak*), lehja e qenit (*ham-ham*), zhurma e pyllit (*fësh-fësh*) etj.

Onomatopeja, si figurë stilistike është përdorur shumë në veprën “*Gjahu i malësorëve*” të Konstandin Kristoforidhit.

Për shembull:

“Ty, ty,ty! Ty, ty, ty! (bie trumbet’ e bririt).

Ha, ha, ha! Ha, ha, ha! Ha, ha, ha! (ndërsejnë qentë).

Kam kum, kam kum, kam kum! (lehin qentë).

Taf tuf! Taf tuf! Taf tuf! (kërcasin pushkët).

- Prite, o Mark! -Prite, o Gjergj! -prite, o Gjon!

Taf tuf! Ha, ha, ha! Ty, ty, ty!....

Personifikimi është ajo figurë letrare stilistike me anë të së cilës sendit ose kafshës i vishen tiparet e njeriut, gjërat pa shpirt shpirtëzohen, gjërat pa ndërgjegje ndjejnë, mendojnë dhe kryejnë veprime njerëzore. Për shembull, ja si i drejtohet Shqipërisë Naim Frashëri.

Ti, Shqipëri, më ep nderë, më ep emrin shqipëtar,

Zemrën ti ma gatove, plot me dëshirë e me zjarr.

ose shembulli tjetër:

Ç’ke flamur që s’valon?

Jam sëmur e po rënkoj...



EPIKA

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> • epikën në prozë; • elemente strukturore të tekstit në prozë; • legjendën ose gojëdhënën; • mitin; • përrallën; • tregimin; • novelën; • romanin; • romanin aventurier; • personazhin; • fabulën; • temën; • idenë; • narratorin (rrëfyesin). 	<ul style="list-style-type: none"> • të bëjmë dallimin mes rrëfyesit/narratorit dhe autorit/shkrimtarit të një vepre të caktuar në prozë; • t'i tregojmë elementet e një teksti në prozë; • t'i përshkruajmë veçoritë e legjendës; • t'i përcaktojmë karakteristikat e një miti të dhënë; • t'i shpjegojmë elementet e përrallës (tema, personazhet, koha, vendi, elementet fantastike); • të bëjmë krahasimin mes miteve dhe përrallave sipas veçorive të tyre; • t'i shpjegojmë elementet e tregimit; • t'i përshkruajmë veçoritë e novelës; • t'i tregojmë karakteristikat e romanit dhe romanit aventuresk të cilat e dallojnë nga veprat e tjera epike në prozë; • t'i dallojmë personazhet, fabulën, temën dhe idenë në një vepër letrare; • ta kuptojmë rolin e narratorit në një vepër letrare.

Folklori letrar ka dy ndarje: **lirikën** dhe **epikën**. Lirika shprehet në poezi, kurse epika rëndom në prozë. Zakonisht poezia këndohet, kurse proza tregohet. Në epikë bëjnë pjesë ato krijime që dallohen për karakterin e tyre tregimtar dhe në to tregohet si ndodh një ngjarje.

Që në fillimet e saj kjo gjini letrare ka qenë e organizuar në mënyrë më të çlirët nga ana gjuhësore sesa lirika apo poezia. Gjuha e prozës është shumë afër komunikimit të përditshëm.

Fjalja nuk fillon gjithmonë me një rresht të ri por vazhdon aty ku ka përfunduar fjalia e mëparshme.

Në prozë, për shkak të organizimit gjuhësor, i kushtohet më pak rëndësi njësive të vogla, fjalës dhe organizimit tingullor të saj.

Veprat në prozë janë: **legjenda, përralla, miti, tregimi, novela** dhe **romani**.

Legjenda ose gojëdhëna

- Lexojeni me vëmendje tekstin e mëposhtëm.
- Mendoni dhe thoni se çfarë është legjenda.

LIQENI I LULEVE

Në kohë të Skënderbeut kanë luftue bashkë me burrat edhe gratë. Turku i zuni do nuse burrnesha, që ia kishin farue asqerin, i lidhi dy nga dy edhe i gremisi në liqen të Lurës.

Atje ku ranë, në fund të liqenit, këto gra burrnesha, u rritën lulet, që rrinë mbi ujë në Liqenin e Luleve.

Legjendë



Shpjegim

Në këtë legjendë flitet për krijimin e njërit nga liqenet malore të Lurës, ku rritet një lloj zambaku i bardhë, shumë i bukur. Duke e lidhur këtë lule me emrin e nuseve trimëresha, populli, në mënyrë poetike, ka dashur ta ruajë kujtimin për gratë e shumta, të cilat janë bërë theror i luftërave të ashpra. Me të, ai ka dashur të theksojë se kujtimi i tyre do të jetojë gjithmonë i bukur, i freskët dhe i gjallë, si vetë zambaku i mrekullueshëm.



Legjenda ose gojëdhëna është kallëzim popullor për një ngjarje të së kaluarës, për një figurë historike etj., që mund të ketë një bazë të vërtetë, por që është shtuar e zbukuruar nga fantazia e popullit dhe përcillet gojë me gojë nga njëri brez në tjetrin.

Sipas tematikës ndahen në dy grupe: me përmbajtje *mitologjike* dhe me përmbajtje *historike*. Dallimi i legjendës apo gojëdhënës nga llojet e tregimeve të tjera është se legjendës nuk i dihet koha dhe vendi i zhvillimit të ngjarjes.

Pothuaj se të gjithë popujt e botës kanë legjenda. Edhe shqiptarët kanë legjendat e tyre. Legjendat më të përhapura ndër shqiptarët janë "Gjergj Elez Alia", "Rozafa", "Besa e Kostandinit", "Aga Ymeri" etj.

Detyrë


Legjenda "Liçeni i luleve" është shkruar në gegërishte. Rishkruajeni atë duke e shndërruar në shqipe standarde.

ROZAFJA

Krenare ngrihet mbi Bunën e gjerë dhe mbi qytetin e Shkodrës kështjella e lashtë e Rozafatit.

Kur është hedhur guri i parë në themelet e kësaj kështjelle? S'dihet. Historia e saj humbet në mjegullën e lashtësisë ilire, banorëve të moçëm të kësaj kënge. Një gjë dihet mirë e qartë; atë e kanë pasur dikur Labeatët dhe pastaj Ardianët, që ishin fise të forta ilire.

Në atë kohë tërë bregu i këtejshëm i Adriatikut, gjer në Tergesten e bujshme apo Triesten e ditëve tona, ishte breg ilir. Më vonë u derdhën këtej romakët, pastaj sllavët, normanët, venedikët, turqit e shumë popuj të tjerë të huaj. Gjatë shekujve ata kepa të thatë nën muret e Rozafatit, si dhe vetë muret e kështjellës, janë lagur me përrenj gjaku të atyre që e kanë sulmuar dhe atyre që e kanë mbrojtur. Të huajt erdhën dhe shkuan, kurse populli ynë mbeti ngulur në këtë tokë ilire. Ndërtimi i Rozafatit ka një gojëdhënë të bukur, por dhe të hidhur që ka ardhur nga lashtësia deri në ditët tona.

Ja ç'thotë kjo gojëdhënë...

I ra mjegulla Bunës dhe e mbuloi të tërë. Kjo mjegull mbeti aty tre ditë e tre net. Pas tri ditësh e tri netësh fryu një erë e hollë dhe e lartoi mjegullën.

E lartoi dhe e shpuri gjer në kodrën e Valdanuzit. Aty majë kodrës punonin tre vëllezër. Ndërtonin një kështjellë. Murin që e bënë ditën u prishej natën dhe kështu nuk e lartnin dot. Na shkon aty një plak i mirë.

- Puna e mbarë, o tre vëllezër.

- Të mbarë paç, o plak i mirë. Po ku e sheh ti të mbarën tonë. Ditën punojmë, natën prishet. A di të na thuash një fjalë të mirë. Ç'të bëjmë që të mbajmë muret më këmbë?

- Unë di - u thotë plaku - po e kam për mëkat tua them.

- Atë mëkat hidhe mbi kryet tonë, se ne duam që ta qëndrojmë më këmbë këtë kështjellë.

Plaku i mirë mendohet e pyet:

- A jeni të martuar o trima? A i keni ju të tre vashat tuaja?

- Të martuar jemi - i thonë ata - edhe të tre i kemi vashat tona.

Na thuaj pra ç'të bëjmë që ta qëndrojmë këtë kështjellë?

- Në doni ta qëndroni, lidhuni me besa-besë: vashave mos u rrëfeni, në shtëpi mos kuvendonit për fjalët që do t'u them unë. Atë nga të tri kunatat që do të vijë nesër t'ju sjellë bukën, ta merrni e ta muroni të gjallë në mur të kështjellës. Atëherë keni për ta parë se muri do t'u zërë vend e do t'u qëndrojë për jetë e mot.

Tha kështu plaku, pastaj shkoi; tani u pa, pastaj s'u pa.

Vaj!

Vëllai i madh e shkeli besën e fjalën: ia tregoi të gjitha vashës së vet kështu e kështu, i tha të mos vinte atje të nesërmen. Edhe i mesmi e shkeli besën e fjalën: ia tregoi të gjitha vashës së vet. Vetëm i vogli e mbajti besën, fjalën: nuk kuvendoi në shtëpi, nuk i tha gjë vashës së vet.

Në mëngjes ata të tre ngrihen shpejt e shkojnë në punë. Çekanjët godasin, gurët copëtohen, zemrat rrahin, muret lartohen...

Në shtëpi nëna e djemve s'di gjë. I thotë së madhes:

- Moj nuse e madhe, mjeshtrit duan bukë e ujë; duan kungullin me verë.

Nusja e madhe ia kthen:

- Besa nënë, sot s'mund të shkoj se jam sëmurë.

Kthehet i thotë së mesmes:

- Moj nuse e mesme, mjeshtrit duan bukë e ujë: duan kungullin me verë.

- Besa nënë, sot s'vete, se do të shkoj tek fisi për të bujtur.

- Nëna e djemve i kthehet nuses së vogël.

- Moj nuse e vogël...

Nusja e vogël brof në këmbë:

- Urdhëro zonja nënë!

- Mjeshtërit duan bukë e ujë; duan kungullin me verë.

- Besa nënë unë shkoj, po e kam djalin të vogël. Druhem se do gji të pijë e qan.

- Nisu, shko se djalin ta shikojmë ne e s'ta lëmë të qajë, - i thonë kunatat.

Ngrihet e vogla, e mira, merr bukë e ujë, merr kungullin me verë, puth djalin e vogël në të dy faqet, niset e bie në Kazenë; që aty ngjit kodrën e Vladanuzit, i afrohet vendit tek punojnë të tre mjeshtrit: dy kunetërit dhe i shoqi.

- Puna mbarë, o mjeshtër!

Po ç'është kështu? Çekanët ndalen e s'godasin, po zemrat rrahin fort e fort. Fytyrat zbehen. Kur e sheh i vogli të shoqen, hedh çekanin nga dora, mallkon gurin e murin.

E shoqja i thotë:

- Ç'ke ti imzot? Pse mallkon gurin e murin?

Hidhet kunati i madh:

- Ti paske lindur në ditë të zezë, moj kunata jonë. Ne e kemi bërë me fjalë të t'murojmë të gjallë në mur të kështjellës.

- Shëndoshë ju, o tim kunetër. Po unë do t'ju lë një porosi: kur të më muroni në mur, syrin e djathë të ma lini jashtë, dorën e djathë të ma lini jashtë, gjirin e djathë të ma lini jashtë. Se djalin e kam të vogël. Kur të nisë të qajë - me njërin sy do ta shikoj, me njërin dorë do ta ledhatoj, me njërin këmbë do t'i tund djepin e njërin gji do t'ia jap të pijë. Gjiri im u muroftë, kështjella qëndroftë, djali im u trimëroftë, u bëftë mbret e mbretëroftë!

Ata e marrin nusen e vogël dhe e murojnë në themel të kështjellës. Dhe muret ngrihen, lartohen nuk shemben më si më parë. Po rreth tyre gurët janë dhe sot të lagur e të myshtë, sepse vazhdojnë të pikojnë lotët e nënës për birin e saj...

Dhe i biri u rrit, luftoi e trimëroi.



Shpjegim


Rozafa është një gojëdhënë (legjendë) e përcjellë brez pas brezi. Në këtë legjendë flitet për tre vëllezër që donin ta ndërtonin një kala. Ata e ndërtonin ditën, por natën shembej. Një ditë kaloi një plak dhe u tha se ai dinte mënyrën se si të mos rrënohej kështjella. Ai u tha që kur të vinte njëra nuse t'ua sillte ushqimin, ta muronin të gjallë në muret e kështjellës, por nuk duhet t'u tregonin grave për këtë gjë. Vëllai i madh e shkeli besën, edhe i mesmi, por i vogli jo. Vjehrra nuk dinte gjë dhe u tha t'ua dërgonin ushqimin burrave. Nusja e madhe dhe e mesmja e dinin që do t'i muronin, andaj gjetën justifikime që të mos shkonin. E vogla pranoi të shkonte, e puthi djalin në ballë dhe faqe e u nis. Kur arriti, vëllezërit i treguan se ç'ju kishte thënë plaku. Nusja e vogël pranoi, por me kusht që gjysmën e trupit t'ia linin jashtë, në mënyrë që me sy ta shihte të birin, me dorë ta ledhatonte, me këmbë t'ia përkundte djepin dhe me gji t'i jepte të pijë. Legjenda thotë se lotët e nënës për të birin rrjedhin edhe sot, ndërsa kalaja është edhe sot e kësaj dite në Shkodër e njohur si Kalaja e Rozafës.

GURI I SKËNDERBEUT

Një ditë Skënderbeu porositi mjeshtër Medarin t'i farkonte një shpatë të re. Pas një jave, Gjergj Kastrioti shkoi në farkën e farkëtarit.

- Puna mbarë, mjeshtër! - e përshëndeti Skënderbeu.
- Mbarë paç, kryezot! - iu përgjigj Medari.
- Erdha të marr shpatën që kam porositur. E keni gati? - e pyeti Skënderbeu.
- Po, shpata e pret të zotin.
- I keni respektuar porosinë e mia?

- Po, kryezot, të gjitha. Kurrë në jetën time nuk kam farkëtuar shpatë kaq të madhe dhe kaq të rëndë, - i tha farkëtarit.

- Unë dua të di sa e fortë është? - e pyeti Skënderbeu.

- Më e fortë s'ka si bëhet, - ia ktheu mjeshtri.
- Tani do ta provojmë, - i tha Skënderbeu. - Eja me mua!

Skënderbeu doli nga farka me shpatën në dorë. Pas tij doli edhe mjeshtër Medari, si edhe njerëzit që e shoqëronin. Jashtë farkës qe një shkëmb sa një qerre. Skënderbeu hipi në kalë dhe filloi ta godiste shkëmbin me shpatë, pastaj shikoi te huna e saj mos i qe bërë ndonjë dhëmb. Shpata ishte po aq e mprehtë sa edhe më parë.

Skënderbeu i tha Medarit:

- Të lumtë, mjeshtër! Se shpata s'më duhet si stoli, po për të luftuar.

Skënderbeu shpërbleu mjeshttrin, ngjeshi shpatën në brez dhe iku i gëzuar.

Që atë ditë, shkëmbit ku provoi shpatën Skënderbeu, i thonë "Guri i Prerë", ose "Guri i Skënderbeut".





Mendoni dhe përgjigjuni

1. A dini edhe ju ndonjë legjendë për Skënderbeun?
2. A keni dëgjuar për historinë e tij?
3. Thoni çfarë dini ju për të?
4. Luteni mësuesin e historisë t'ju tregojë për jetën dhe të bëmat e Skënderbeut.



Përralla

Përrallat janë lloji më i njohur i tregimeve popullore. Përralla është një tregim i trilluar, plot fantazi dhe elemente të çuditshme në subjekt, me anë të së cilës paraqiten mendimet dhe ëndërrimet e njerëzimit në formë alegorike.

Ato janë të përhapura në të gjithë botën dhe janë tepër të pëlqyera si për vlerat filozofike, ashtu edhe për vlerat e tyre didaktike.

Përrallat tregohen në prozë dhe në qendrën e tyre kanë personazhe dhe ngjarje të çuditshme, fuqitë shkatërrimtare të natyrës, si vërshimet e lumenjve etj. Të gjitha këto fantazia popullore i personifikoi në qenie të mbinatyrshme dhe u dha emra të ndryshëm, si Kuçedra, Lubia etj.

Populli u përpoq gjithmonë t'i mposhtë këto forca të natyrës edhe pse atëherë nuk mund t'i kuptonte dhe t'i shpjegonte.

Ideja themelore e përrallave është fitorja e së mirës mbi të keqen, dëshira për lumturinë e njeriut.

Lexojeni me vëmendje këtë përrallë.

E BIJA E MBRETIT DHE TRËNDAFILAT

Ishin një mbret dhe një mbretëreshë. Ata kishin një vajzë të vetme. Ajo ishte e bukur, e mençur dhe aq e gëzuar, sa qeshte ditë për ditë më shumë herë sesa kokrra ka shega.

Pallati i mbretit tundej nga e qeshura e princeshës. Qeshte shumë, por qeshte bukur. S'kishte një të qeshur të marrë e të sëmurë, po një të qeshur të re e të dashur.

Por një ditë, vdiq mbretëresha dhe princeshës iu vrenjt pak buza. Një natë, vdiq edhe mbreti dhe princeshës iu pre gazi. Dhe pak kohë më pas i ra zjarri pallatit dhe e dogji. Princësja e vogël, e varfër dhe e vetme, ndjeu për të parën herë trishtimin.

Me zemër të fryrë nga psherëtimat, e bija e mbretit u vesh si fshatare, mori një shkop në dorë dhe doli nga dheu i babait të vet duke qarë.

Loti i parë që derdhi, mbiu mbi dhe menjëherë një rrënjë trëndafili, i gjatë, i bukur e me degë shumë. E kudo që derdhte lot princësja, mbinin trëndafila. Ngaqë të qarët e saj s'kishte pushim, e të ecurit e saj s'kishte qëndrim, trëndafilat mbinin në të katër anët e botës.

Një ditë princësja, e lodhur dhe e trishtuar më tepër se ditët e tjera, arriti në qytet të Ispahanit, në Persi. Atje qëndroi në një gur dhe qau tri ditë, e prandaj Ispahani është qyteti ku janë trëndafilat më të bukur të botës. Në fund të ditës së tretë, princësja e mjerë vdiq dhe trupi i saj u shndërrua në një trëndafil, degët e të cilit dolën më sipër se gjithë të tjerët.

Mendoni dhe përgjigjuni


1. Ritregojeni këtë përrallë.
2. Ç'janë përrallat?
3. A dini edhe ju ndonjë përrallë? A mund ta tregoni ndonjë prej tyre?
4. Luteni gjyshin, gjyshen apo prindin t'jua tregojë një përrallë dhe shkruajeni në fletore.

Miti

Miti është lloj i veçantë i krijimtarisë gojore popullore, rrëfenjë për qenie të mbinatyrshme, për heronj legjendarë, për ngjarje e dukuri të çuditshme, ku pasqyrohen parafytyrimet primitive të njerëzve për prejardhjen e botës e të jetës mbi tokë, për natyrën dhe shoqërinë; rrëfenjë e trilluar, për diçka që nuk ka qenë e nuk është në të vërtetë.

PËRBINDËSHI I BISTRICËS

Këtu, në Bisticë, pat jetuar dikur një përbindësh, një gjarpër i madh. Hante njerëz dhe bagëti ky gjarpër i pangopur, prishte pemë dhe të mbjella, rrëzonte kasolle dhe shtëpi, shkretonte vendin rreth e rrotull, tek vërtitej si i tërbuar.

Pse s'e vrisnin? E si ta vrisje? S'ishte gjarpër sidokudo, po katana. Ai, sapo shikonte dikë, ose nxirrte zjarr jeshil dhe e përvëlonte ose e kollofiste pa një pa dy.

Po një plak i varfër vendosi:

- Do vete, - tha, - ta vras përbindëshin. Dhe, në më përpiftë, unë e hëngra çairin tim. Se s'durohet i mallkuari.

Ngarkoi plaku një gomar me eshkë, e vuri përpara dhe u nis. Kur u afrua te gjarpri, ky flinte. Plaku ndezi me uror dy copë eshka dhe i hodhi njërenë në një thes të barrës, tjetrën te thesi i dytë. Filluan të ndizen dy thasët me eshkë, por me ngadalë e si fshehurazi, se kështu e ka eshka. Pastaj plaku u fsheh dhe filloi ta gjuante gjarprin me gurë, që ta zgjonte. Gjarpri u zgjua, pa gomarin e u turr dhe e përpiu me gjithë barrën. Por eshka digjej në bark të gjarprit. Kështu u ndez vetë përbindëshi. Dha e mori të shuhej, po ëhë! Atëherë thirri:

- Ku je, o nënë Bisticë, dhe ti, o det vëllai! Më ndihmoni!

Bistrica vajti me të shpejtë ta shuante gjarprin, por s'mundi. Deti nuk lëvizi, se gjarpri i thirri "vëlla", kurse Bisticës "nënë".

Gjarpri e kuptoi gabimin dhe thirri:

- Ndihi më, o baba det!

Atëherë deti u nis të shkonte të shuante gjarprin, por, sa erdhi ai në Finiq, gjarpri u dogj krejt. Dhe deti u kthye prapë poshtë.

Kështu mbaroi ky gjarpër përbindësh e i patën mbetur vetëm kockat.

Thonë se disa nga këto kocka i morën ustallarët dhe i bënë shtylla, kur ndërtuan manastirin e Mesopotamit.

Populli



Fjalor

Bistricë – fshat dhe lumë në jug të Shqipërisë.

katana - që ka trup tepër të madh.

kollofit - gëlltit diçka me një frymë, e kapërdij të gjithë menjëherë, e përlej.

çair - livadh me bar.

eshkë - lloj kërpudhe, që rritet në trungjet e drurëve, e cila, pasi zihet e thahet, mund të ndizet shpejt nga shkëndijat e gurit të zjarrit.

uror - copë e vogël e një shufre çeliku, zakonisht në trajtë gjysmërrethi me të cilën i biem gurit të zjarrit për të nxjerrë xixa.

Mendoni dhe përgjigjuni

1. Ç'është miti?
2. Ritregojeni këtë mit.



Tregimi

Njerëzit, në komunikim me të tjerët, mund të tregojnë përjetimet e tyre ose ngjarje të ndryshme, por këtë nuk mund ta bëjnë të gjithë në mënyrë artistike. Tregimi është një krijim artistik që i kushtohet një ngjarjeje të veçantë, pa përmendur me hollësi se çfarë ka ndodhur përpara dhe pas kësaj ngjarjeje.

Tregimi është më i shkurtër se novela. Ai zakonisht përfshin vetëm një detaj, një fragment të shkëputur nga jeta e njeriut. Ai është një tekst që ka tri pjesë themelore: *hyrjen, zhvillimin e përmbajtjes dhe mbylljen.*

Tregime kanë shkruar shumë autorë shqiptarë. Ndër më të njohurit janë: Migjeni, Ramiz Kelmendi, Abdylaziz Islami, Konstantin Kristoforidhi, Naim Frashëri, Mitrush Kuteli, Anton Pashku, Vath Koreshi, Teodor Laço, Zija Çela, Dritëro Agolli, Naum Prifti, Murat Isaku, Rexhep Zllatku, Kim Mehmeti etj.

Struktura e tregimit

Tregimi, si një krijim letrar, përbëhet nga disa elemente kryesore:

- përmbajtja (fabula);
 - shtresa kuptimore (lidhjet që krijojnë fjalët me njëra-tjetrën);
 - personazhet dhe
 - skema.
- Në hyrje paraqiten fakte që u përgjigjen pyetjeve ku? kur? dhe kush?
 - në zhvillimin e përmbajtjes paraqitet ngjarja kryesore, ndërsa
 - në mbyllje jepet përfundimi i tregimit.

Lexoni me kujdes tregimin e mëposhtëm dhe diskutoni rreth tij.

NJË NATË NË STAMBOLL

Nata ka mbuluar me krahët e vet Stambollin. Dritat e shtëpive të qytetit po shuhën njëra pas tjetrës. Në një dhomë, buzë një rrugice të ngushtë, dritat nuk shuhën akoma. Është dhoma e punës e një shqiptari të madh.

Nga dritarja e vogël, drita duket ende. Brenda në dhomë ndodhet rilindësi i madh. I rrethuar nga librat, është ulur në një kolltuk të vjetër dhe shkruan.... Nga kalldrëmi i rrugës së ngushtë vazhdon të kumbojë zhurma e hapave të zaptijeve. Dinjitoz, i heshtur, i vrazhdë, i brengosur nga të therurat e gjunjëve, nga reumatizmi i pashërueshëm, ai vazhdon të shkruajë. Kohë pas kohe e lëshon penën mbi tryezë dhe diku i mbërthen sytë. Ai ëndërron dhe shkruan, shkruan dhe ëndërron.

I mbështjellë në ëndrrën e tij të madhe, ai kaloi dete, male, fusha, bregore dhe arriti atje ku ëndërronte kryeqytetin e Shqipërisë së ardhshme në Belsh. Qëndroi para liqeneve dhe në pasqyrën e atyre ujërave të kristalta soditi një botë të tërë përmes ëndrrës së vet. Njeriu me mjekër të gjatë dhe të thinjur para kohe shikonte me sytë e mendjes atë që sot e shikojmë me sytë e ballit. Ai e dinte se ëndrrat e tij s'mund të qëndronin ëndrra; ai e njihte fuqinë shpirtërore të popullit shqiptar, zotësinë e tij, talentin e tij, vetëmohimin e tij dhe, mbi të gjitha, trimërinë e tij legjendare.

Në ato ujëra të kristalta ai soditi Shqipërinë, të lirë, pa shtypës pa pushtues, pa të ligj. Ai kundroi universitetin ku hynin e dilnin mijëra djem e vajza me libra në sqetull. Ai aty pa si në pasqyrë minierat nga të cilat rridhnin lumenj nafte dhe sere, ai pa male plot me krom, hekur e nikel.

E tërë Shqipëria aty ishte. Dhe u mahnit. Një lot shkau si një rubin nga sytë e tij, çau përmes rrudhave të asaj fytyre, u rrokullis në ujërat e kulluara të liqenit e një valëz uji e rrethoi atë lot. Ai buzëqeshi. Ndofta pas kaq e kaq vitesh ishte e para buzëqeshje që zbukuronte fytyrën e tij. Një valëz u përplas lehtas në breg dhe me zhurmën e vet, ndoshta përshëndeti rilindësin e madh.

U zgjua nga ëndrra, erdhi në vete, fërkoji sytë me duart e veta dhe duart iu qullën. Kishte qarë.

Drita e zbehtë e llambës me vajguri vazhdonte të përpëlitej dhe hapat ritmikë të rëndë të zaptijeve dëgjoheshin që nga jashtë. Ngriti pakëz kokën, hodhi sytë rreth e rrotull dhe i mbërtheu me mallëngjim mbi librat që e rrethonin nga të katër anët. Ndoshta desh t'u jepte lamtumirën e fundit. Mori përsëri penën, por pena për herë të parë nuk iu bind dhe i shkau nga dora.

E uli kokën mbi libër, po sytë iu veshën, fytyra iu zbeh, mjekra iu drodh. Pena pret një dorë që të lëvizë, por dora s'lëviz më. Dhe boja u tha mbi libër. Vdiq mbi libra, i rrethuar nga libra, si trimi në fushën e betejës me armë në dorë.

Sipas Nonda Bulkës

Mendoni dhe përgjigjuni

1. Ç'është tregimi?
2. Cilat janë elementet kryesore të tregimit?
3. Lexojeni edhe një herë me vëmendje tregimin e dhënë më sipër dhe gjeni hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e tregimit.





Novela

Novela është formë e shkurtër e shkrimit në prozë. Ajo, rrëfimin e vet e ka më të kufizuar dhe ka pak personazhe. Në të jepen më pak informata, ndërsa rrëfimi i ngjarjes është më i dendur dhe më konciz.

Janë të njohura novelat e Mihal Gramenos, “Oxhaku”, “E puthura” dhe “Varri i pagëzimit”. Novela kanë shkruar edhe Shefqet Musaraj “Isha unë Çobo Rrapushi”, Zejnulla Rrahmani “Udhëtimi i një pikë uji”, “E bukura e dheut”.

Lexojeni këtë novelë.

OXHAKU

PJESA E PARË

Krye I

Më 1821, në kohën e Ali Pashës, Shqipëria dhe më shumë Toskëria gjendej në rrëmujë. Katunde edhe qytete shkretoheshin dhe njerëzia mërgoheshin në vende të huaj, duke lënë shtëpitë, plaçkat e gjithë ç’kishin edhe vështronin vetëm si e si të shpëtojnë nga rreziku shpirtin e tyre.

Asi kohe, qyteti Korça kishte zënë të lulëzojë, duke qenë më parë një qyteti i vogël edhe i padëgjuar siç është sot, po njerëzia dridheshin nga frika se mos kenë gjithë atë fat që kishin edhe të tjerët të cilët ngryseshin të gjallë e gdhiheshin të vdekur. Andaj, me të perënduar dielli, mbylleshin nëpër shtëpitë edhe nuk dinin ç’bëhesh natën në qytet.

Nga ky shkak nuk kishin vërejtur që “shtëpia e zezë” prej ca kohe mbante njerëz brenda. “Shtëpia e zezë”, siç e quanin qytetarët ishte një shtëpi e madhe, ndërtuar me gurë dhe rrethuar më gjithë anët me avlli edhe fortesa edhe ishte mbanë qytetit pranë kroit të Abdi beut. Prej shumë kohe, kjo shtëpi ishte e pandënjur edhe e shkretuar, të gjithë sa kishin ndenjur, gjithë atë fat kishin pritur që të shuhen me gjithsej, edhe nga ky shkak kishte arritur të jetë fole e kukumjaçkave edhe e galave, se njerëzia jo vetëm që nuk guxon të hyjnë brënda, por edhe kur shkonin pranë asaj shtëpie do të faleshin me tmerr, duke iu lutur zotit t’i shpëtonjë edhe t’i mpronjë nga nonjë gjëmë e madhe.

Në të këtilla frikëra gjendeshin korçarët, kur një natë të marsit frynte një erë e marrë edhe dëgjojnë të zbrazura prej pushkësh. Të gjithë mbetnë të tmerruar, se pandeshnin që afrojtë edhe për ata fundi i jetës. Andaj që të gjithë faleshin, duke kërkuar nga nonjë vent të fshehtë për shpëtimin e shpirtit, edhe asnjë nuk guxonte të dalë përjashta që të mësonjë shkakun e pushkëve.

Po sa vinte më shumë dëgjoheshin të zbrazura prej pushkësh, pastaj dëgjoheshin edhe zëra njerëzish, të cilët bërtisnin sa muntnin që të vraponin të shuanin zjarrin që diqte shtëpinë e zezë, se ishte shumë frikë mos përhapet zjarri mi gjithë qytet.

Vetëm atëhere njerëzia, si u siguruan që nuk është tjetër rrezik përveç zjarrit, të cilin e pandeshnin t’ja ketë vënë nonjë njeri mëndjeshkurtër, vraponin me ujë, dhiqelë e sëpata, edhe me çfarë muntnin për të shuar zjarrin.

Po, me t’u afruar pranë shtëpisë së zezë që digjesh, mbetnë të nemitur e të habitur kur vështronin sot krrerë njerëzish në dritaret e shtëpisë, të cilët u luteshin edhe u kërkonin ndihmë që t’i shpëtojnë mos digjen të gjallë.

Një grua e re edhe e bukur, që dukesh fare mirë në dritare të flagëvet me leshrat e lëshuar edhe të pakrehura, me sy të zgurdulluar, veshur me rrobën e natës si ç’ishte ngritur me tmerr nga gjumi, zgjate duar, duke lutur njerëzinë t’i shpëtojnë të vetmin djalë që kishte, i cili flinte në katin e dytë, meqënëqë ajo nuk munte nga flagët e zjarrit ta shpëtonjë!



Po njerëzia gjithë mbetnë të shurdhër në blegërimet e në lutjet e kësaj gruaje, mënjanë nga frika e zjarrit që nuk muntnin t'afroheshin, më tjatër anë nga tmerri që vështronin njerëz në atë shtëpi, të cilën e dinin të pandenjur edhe të shkretuar. Andaj vështronin vetëm që të mos zgjatet zjarri më tjatër shtëpi, duke lënë të brengmit në duart e Perëndisë! Ah, sa keq është të veshtrosh shpirta që digjen edhe të mos mundësh t'i shpëtosh!

Zërat që brenda pushuan së bërtituri edhe së kërkuari ndihmë edhe nuk dëgjohesh përveç trak-trak! nga drurët edhe nga dhogat që digjeshin, se zjarri sa vinte po përhapte flagët më të gjitha anët, kur dëgjohet pas pakëzë, për të fundit herë, një buçim i math përzierë me një zë të thellë edhe pastaj bëhet një heshtje e madhe, se çatia me dyshemetë e gjithë ç'kishte shtëpia, ranë të gremisura, edhe zjarri më s'kishte fuqi.

Qytetarët ndenjë të gjithë pranë zjarrit gjer më të gdhirë, për të ruajtur mos kërcenjë nonjë shkëndijë afër, edhe pyesnin njëri-tjatrën në dinte gjësendi që kur rronin njerës në këtë shtëpi po asnjë prej syresh nuk e dinte ç'njerës rronin, që kur kishin ardhur në atë shtëpi, edhe sa ishin. Andaj, me gjithë helmin që ndjenin për ata që u bën therorë të zjarrit, gëzoheshin më tjatër anë se zjarri i vuri funt asaj shtëpie së zezë, që kishte shuar kaq njerës, edhe të cilën e nëmëronin si shkakun e gjithë të ligave që ngjisin në qytet!

Mihal Grameno

Detyrë



Në këtë fragment të novelës "Oxhaku" përshkruhet momenti i djegies së "Shtëpisë së zezë" në të cilën ishte strehuar Vahideja me shërbëtorin Rrustemin dhe me fëmijët. Analizojeni këtë pjesë dhe vëreni si e ka bërë shkrimtari përshkrimin e kësaj skene.



Ç'mendojnë qytetarët kur dëgjojnë krisma pushkësh, si veprojnë kur kuptojnë se ka shpërthyer zjarri dhe përse nuk u ndihmojnë njerëzve që ishin në flakë?



Lexoni edhe pjesët e tjera të kësaj novele. Ato mund t'i gjeni edhe në internet.

Mihal Grameno (1871-1931)

Lindi në Korçë. Mësimet e para i mori në vendlindje. Në moshë të re mërgoi në Bukuresht, ku u lidh me shoqërinë "Drita". Botoi vjersha dhe artikuj në shtypin e kohës. Në vitet 1907-1908 luftoi në radhët e Çetës së Çerçiz Topullit, më 1908 mori pjesë në Kongresin e Manastirit. Vdiq në Korçë më vitin 1931. Shkroi novelat "Oxhaku" (1904-1905), "Varri i pagëzimit" (1909) dhe "E puthura" (1909).



Romani

Romani është lloji më i gjatë i gjinisë epike, në të cilën gjerësisht pasqyrohet jeta dhe dukuritë shoqërore.

Kompozicioni i romanit është shumë i afërt me kompozicionin e dramës, me një dallim se veprimi i romanit zhvillohet shumë më ngadalë dhe në formë të shtrirë.

Në roman, si dhe në të gjitha format tjera rrëfyese, ekziston një ngjarje kryesore e cila i bashkon të gjitha ngjarjet e tjera.

Llojet kryesore të romanit janë:

- a) **sipas tematikës:** roman aventuror, kriminal, historik, social, psikologjik etj.
- b) **sipas qëndrimit të autorit:** roman humoristik, satirik, didaktik etj.

Romanet e para në letërsinë tonë i kanë shkruar: Ndoc Nikaj "Shkodra e rrethuar", Foqian Postoli "Për mbrojtjen e atdheut" dhe "Lulja e kujtimit", Haki Stërmilli "Sikur të isha djalë", Dhimitër Shuteriqi "Çlirimtarët", Sterjo Spasse "Ata nuk ishin vetëm", "Afërdita", Hivzi Sulejmani "Njerëzit", Fatmir Gjata "Kënetë", ndërsa më vonë romane kanë shkruar edhe Ismail Kadare, Shefqet Musaraj, Jakov Xoxa, Murat Isaku, Nazmi Rrahmani, Jusuf Buxhovi, Ramiz Kelmendi, Luan Starova etj.

Detyrë



Paraqiti në mënyrë skematike llojet e romaneve.

AFËRDITA

Mesi i natës kishte kaluar, por Afërdita ende notonte në një pellg të pafund mendimesh. Edhe kur qëllonte të kotej për ndonjë grimë, përsëri i ngjante sikur vështronte nxënës të leckosur, njerëz të leckosur e të ftohtë, deri edhe kafshë si të leckosura edhe ato, dhe shtëpi të rrënuara. Shpesh e më shpesh, duke ardhur në vete, kërcente nga vendi e tmerruar. Errësira e dhomës ia shtonte tmerrin: fytyrat e djegura të fshatarëve i dukeshin si fytyra gjakpirësish. Vështrimi i çuditshëm i kryeplakut dhe shpotia e tij e rëndë, i kishin lënë mbresë të madhe qytetares së re: dyshonte se mos mësynin natën këta njerëz të heshtur për ta rrëmbyer. Sa episode të tilla që i erdhën ndër mend për rrëmbime vashash, më të gjalla edhe se atëherë kur kishte lexuar disa romane të huaja! Reshperimi më i mbytur i minjve dhe pipëtitja më e vdekur e druve të vjeshtës ia shtonin frikën dhe pa dashur mbështillej më mirë me mbulesat e strukej më shumë pas s'ëmës. Luftonte, luftonte me vetveten, me fatin e saj, me errësirën e natës e me botën e tërë! Barra e familjes ishte shumë e rëndë, por detyra e re e rëndoi edhe më tepër. Ajo vetë, vajzë e re, - mezi i kishte mbushur të shtatëmbëdhjetat dhe pa praktikë: që nga bankat e shkollës, që nga jeta e përbashkët e konviktit, përplasej tutje-tej në vetmi, pa asnjë udhëheqës pranë, pa asnjë ndihmë. I ngjante vetja si një filiz i ri që ishte ngarkuar me peshën e rëndë të dëborës. Po a do të ishte e zonja ta mbante këtë peshë pa u thyer?

E shihte jetën e saj të paskëtajme vetëm me mjerime e me vuajtje familjare, ekonomike e shoqërore. Nga errësira sterrë e natës dhe e blozës i ngjallej pellgu i mundimeve të saj të përhershme. I dukej se kishte përënduar përgjithnjë jeta e bukur e shkollës. I dukeshin të venitura buzët e saj qumështore, që më parë i ndeheshin aq fort në vathën e gazit e të lumturisë.

Agimi, kur përhapi rrezet e veta argjendore, e gjeti vashën syçelur e të hutuar. E ëma e preku me kujdes pas krahut, që ta zgjonte. Afërdita përmbloodhi veten.

- E, Ditkë, a fjete mirë? - e pyeti.

- Si urdhëron, mama, fjeta shumë mirë! - u përgjigj.

- Sa gjumë të rëndë që bëra! Po dhe sa e lodhur që isha! - tha plaka duke fërkuar sytë e duke hapur gojën e përgjumur.

- Edhe ç'ëndrra të këqija që pashë! Qoftë për të mirë!

- Unë, mama, s'mbaj mend sonte të kem parë ndonjë ëndërr. Isha e lodhur edhe fjeta aq lehtë! - i përgjigjej vasha duke palosur velenxat. Pastaj me disa shkarpa e me ca thekërishte ndezi zjarrin në vatër. Mori xhezven e mbushi me ujë dhe e vuri në prush për të bërë kafën e mëngjesit. E ëma, duke u dridhur nga të ftohtit, pak edhe nga dhembjet e trupit, të shkaktuara nga rruga, strukej kruspull afër gllanikut dhe me një purtekë trazonte shkarpat për të shtuar zjarrin.

- Ditkë, lëre se po e bëj kafën vetë: shko rregullo dhomën, - i tha pastaj. Afërdita bëri si e porositi e ëma. Mirëpo pagjumësia e kishte dëmtuar: koka i rëndonte, trupi i dalldisej dhe stomaku i përzihej. Punët i bënte me mundim, madje i vinte rëndë edhe nga fjalët e s'ëmës, që fliste herë pas here:

- Ja edhe kockat më dhembkan fort! Bëmë gabim, që s'morëm një dyshek nga shtëpia... Dy velenxa të shtruara nuk na mjaftojnë. Dhe këta rrogizat e mallkuar m'i paskan prishur velenxat. Mos harro, kur të vejë qiraxhiu në Korçë, t'i themi të na marrë dyshekun e vjetër... Sa keq qenka në këtë dhomë: as derri nuk ndenjka mbyllur!... Uh, ç'më mërziti kafeja: uji akoma nuk valon... Oxhaku qenka kosh për misër. O Zot, kushedi se si do të jenë gdhirë në shtëpi! Dhe Thimi i shkretë ndoshta vetëm mendohet e qan! Ah, burrë, burrë derëziu! Po Netka, po Tinka!

Çupa fatkeqe!...

Plaka belbëzonte si me vete pranë gllanikut. Afërdita vente e vinte nëpër dhomë.

Fragment nga romani "Afërdita" i Sterjo Spasses

Fjalor

shpoti - tallje, përqeshje; qesëndi.

reshperim - qarkullim, lëvizje e dendur.

konvikt - ndërtesë ku flenë, hanë e mësojnë së bashku nxënës a studentë.

sterrë - shumë i zi, shumë i errët.

blozë - pluhur, që lë tymi kur kalon nëpër oxhak.

i venitur - i fishkur, i vyshkur.

velenxë - mbulesë e gjerë prej leshi.

kruspull - me trup të përkulur e të mbledhur si lëmsh.

gllanik - gryka e vatrës me gjithë oxhakun.

purtekë - thupër e hollë dhe e drejtë.

shkarpë - degë të holla e të thata.

rrogiz - hasër.



Mendoni dhe përgjigjuni

1. Ç'është romani?
2. A keni lexuar ndonjë roman?
3. Lexojeni në tërësi romanin "Afërdita" të Sterjo Spasses.



Sterjo Spasse (1914-1989)

Lindi më 14 gusht të vitit 1914 në fshatin Gllomboç të Prespës, në rrethin e Korçës.

Veprimtaria krijuese e Sterjo Spasses është e larmishme. Ai fillon të shkruajë që në bankat e shkollës Normale të Elbasanit. Botoi rreth pesë vëllime me përmbledhje tregimesh: "Kurorë rinie", "Në krahët e një femre" 1934, "Nusja pa duvak" 1944, "Të fala nga fshati" 1958, "Sokolesha" 1967. Por ato që e bëjnë të njohur emrin e tij janë romanet: "Pse?!..." 1935, "Afërdita" 1944, "Ata nuk ishin vetëm" 1952, "Afërdita përsëri në fshat" 1954, "Buzë liqenit" 1965, "Zjarre" 1972. Ka botuar rreth 13 tekste shkollore. Vdiq më 12 shtator 1989.

Romani aventurier

Romani aventurier quhet ai roman që pasqyron jetën në mënyrë jo të zakonshme. Për krijimet e tilla, rol të madh luan imagjinata (fantazia) e shkrimtarit. Këtu mund të bëjnë pjesë edhe romanet kalorësiake, fantastike, kriminalistike, romani historik dhe shoqëror etj.

DON KISHOTI PRET ME SHPATË KOKËN E VIGANIT...

Sanço Panço doli me shamatë nga plevica ku flinte Don Kishoti, duke thirrur:

- Ejani shpejt or zotërinj, dhe ndihini tim zoti, i cili është përleshur në betejën më të tmerruar e më të llahtaritur që më kanë parë sytë. Për zotin, me një të goditur të shpatës që i këputi viganit, ia preu kokën si kastravec.

- Ç'thua mor vëlla? - tha prifti, i cili e la këndimin e novelës. Je ndër mend or Sanço? Si është e mundur një gjë e tillë, kur vigani ndodhet shumë larg së këtejmi?

Mbi këtë e sipër dëgjuam një shamatë të madhe nga oda e Don Kishotit, i cili po bërtiste:

- Mbrohu, kusar, zuzar, zagar, se tani të kam në dorë dhe jatagani s'të hyn në punë! Me këto fjalë, Don Kishoti po godiste muret me shpatë dhe Sançoja tha:

- Mos rrini aty duke dëgjuar, po hyni brenda dhe i ndani luftuesit dhe i ndihni ustait. Po nuk besoj të jetë nevoja, se pa dyshim është vrrarë, se unë ia pashë gjakun që i rridhte përdhe si rrëke dhe kokën e prerë, që iu rrokullis në një çip, e cila ishte e madhe sa një shakull i verës.

- Djall o punë! - tha hanxhiu, - Don Kishoti a Don shejtani më ka shpuar ndonjë nga shakujt me verë të kuqe që kishte pranë shtratit dhe vera që u derdh, duhet të jetë gjaku që ka parë ky budalla.

Me të thënë këto fjalë, hanxhiu hyri në odë dhe të gjithë të tjerët i ranë pas dhe e gjetën Don Kishotin me kostumin më të çuditshëm në botë. Ishte me këmishë vetëm. Këmbët i kishte të gjata, leshtore dhe jo shumë të paqme; në kokë mbante të mbështjellë çarçafin e shtratit, me dorën e djathtë mbante shpatën e zhveshur, me të cilën po godiste nga të gjithë anët, sikur luftonte vërtetë me ndonjë vigan. Dhe, bukuria ishte që s'i kishte sytë të hapur, po të mbyllur, flinte dhe ëndërronte që po luftonte me viganin. Duke pandehur se po godiste viganin, kishte hapur shakujt dhe plevica ishte mbushur e tëra me verë. Kur e pa këtë gjë hanxhiu, u zemërua aq shumë, sa iu vërtit Don Kishotit dhe nisi ta godiste me grusht aq keq, sa sikur të mos e mbanin Kardeni dhe prifti, do të kishte marrë fund beteja e viganit. Po, megjithëkëtë, kalorësi i varfër prapë nuk u zgjua, gjersa solli berberi një kovë ujë të ftohtë nga pusi dhe ia derdhi të tërë mbi trup dhe nga kjo i doli gjumi Don Kishotit, po jo aq sa të shikonte në ç'hall po ndodhej. Dorotea, e cila vuri re veshjen e tij të shkurtër dhe të hollë, nuk desh të hynte brenda për të shikuar betejën. Sançoja po shikonte përtokë kokën e viganit dhe duke mos e gjetur tha:

- E di fare mirë se në këtë shtëpi të gjitha janë të magjepsura, se ja edhe tani u zhduk ajo kokë që e pashë me sytë e mi, kur e preu ustai dhe i rridhte gjaku si krua.

- Ç'kokë dhe gjak më thua, more budalla i djallit? - tha hanxhiu. Nuk i sheh, or buf shakujt e shpuar dhe verën e kuqe të derdhur në odë? Ah, iu derdhtë shpirti në skëterrë atij që m'i shpoi.

- Nuk di gjë, - u përgjigj Sançoja, - di vetëm që po të mos e gjej unë i ziu atë kokën e prerë, atëherë më humbi e m'u tret nisia si kripë në ujë.

Kështu Sançoja i zgjua ëndërronte më keq se i zoti i fjetur, aq shumë ia kishin turbulluar mendjen zotimet që i kishte dhënë ustai. Hanxhiu po marrosej nga përçartjet e shqyrtarit dhe nga zullumet e kalorësit, po bënte be se këtë herë nuk shpëtonin si herën tjetër, se privilegjet e kalorësit nuk shkonin më, se duheshin paguar të gjitha dëmet për verën e derdhur dhe për shakujt e shpuar.

Prifti po e mbante për dore Don Kishotin, i cili besonte që e kishte mbaruar aventurën e viganit.

- Nuk e thashë unë? - tha Sançoja. Jo, or jo, se nuk jam as budalla as i pirë.

E fitova nisinë dhe titullin e kontit dhe më bëfshin mirë. Kush mund të mbante të qeshurat për marrëzitë e të dyve, të ustait e të çirakut! Të gjithë qeshnin, përveç hanxhiut, i cili shfrynte dhe mallkonte. Më në fund, me një mijë mundime, berberi, Kardeni dhe prifti e shpunë në shtrat Don Kishotin, të cilin e zuri menjëherë gjumi nga lodhja e madhe. E lanë të flinte dhe dolën tek dera e hanit, për të ngushëlluar Sançon që nuk e gjeti dot kokën e viganit. Gjithashtu u përpoqën të qetësonin hanxhiun, i cili ishte i dëshpëruar për vdekjen e papritur të shakujve. Hanxhiu po ulërinte me klithma:

- E mallkuar qoftë dita dhe ora që na hyri në shtëpi ky kalorës i arratisur!

Ah, sikur të mos ma kishin parë sytë kurrë, se më ka kushtuar shumë shtrenjtë.

Miguel de Servantes

Shënim

Kjo pjesë është shkëputur nga romani "Don Kishoti" i shkrimtarit të njohur spanjoll Miguel Servantes. Romani, që u botua së pari më 1605, është ribotuar shumë herë. Është një nga kryeveprat e letërsisë botërore. Në të demaskohen përpjekjet për ta kthyer rotën e historisë prapa. Ky roman lexohet edhe sot me ëndje si lexim shkollor.



Fjalor

plevicë-a - kasollë, ahur bagëtish, shtëpi përdhese.

i, e llahtaritur - i tmerruar, i trembur.

zuzar-i - njeri i poshtër, rrugaç, faqezi.

jatagan-i - shpatë jo shumë e madhe, e përkulur në majë.

shakull-i - kacek lëkure bagëtish të imëta, e regjur dhe e bërë si thes për të mbajtur bulmet, vaj etj.

nisi-a - ishull.

shqytar-i - trimi (njeriu) që shoqëronte kalorësit në mesjetë dhe u mbante armët dhe mburojën.

shqyt-i - mburojë.

Mendoni dhe përgjigjuni



1. Cila skenë ju bën për të qeshur dhe pse?
2. Cilat janë personazhet që marrin pjesë?
3. Si paraqitet Don Kishoti nga autori?
4. Pse është turbulluar Sançoja?
5. Pse nuk qesh hanxhiu si të tjerët?

Miguel de Servantes (1547-1616)

Miguel Servantes është shkrimtar spanjoll nga Madridi. Më 1571 mori pjesë në betejën e famshme detare kundër ushtrisë osmane. Botoi: “*Don Kishotin*”, “*Udhëtim në Parmas*”, “*Andrrallat e Persilit dhe të Sigismundës*” etj.

Personazhi

Kur lexojmë një vepër letrare, ndeshemi me njerëz të ndryshëm që i dallojmë jo vetëm nga pamja, por edhe nga fjalët që thonë, nga veprimet që kryejnë.

Një njeri që vepron në një vepër letrare e quajmë personazh. Personazh është individualiteti i krijuar nga shkrimtari në një vepër nëpërmjet tipareve vetjake të të cilit mishërohen disa anë tipike të një karakteri shoqëror, të kuptuara dhe të vlerësuara sipas një botëkuptimi të caktuar ideologjik. Kështu, në veprat letrare dallojmë personazh kryesor dhe të dorës së dytë; personazh pozitiv, negativ, personazh tipik etj.

Detyrë


Lexojeni këtë përrallë

DY VËLLEZËRIT

Një grua e ve kishte rritur dy jetimë. Ata jetonin në varfëri të madhe dhe nëna i rriste me vështirësi. Pasi u bënë 7-vjeç, ajo i çoi të punonin me rrogë si barinj te një i pasur.

Kur u rritën fëmijët, e lanë punën tek i pasuri dhe filluan të merreshim vetë me tregti. Për një kohë të shkurtër bënë pasuri të madhe.

Një ditë u erdhi në vizitë daja i tyre, i cili më parë nuk qe interesuar fare për ta. Ai i këshilloi se njëri djalë duhej të martohej, pasi nëna e tyre ishte plakur dhe nusja do t'i ndihmonte asaj në punët e shtëpisë. Në fund daja e bindi djalin e madh që të martohej me një vajzë të pasur.

Bënë dasmë të madhe. Vëllai i vogël me 300 krushq shkuan ta merrnin nusen në një vend të largët, tri ditë e tri net udhëtim. Kur erdhi nusja, daja me qëllim djallëzor e këshilloi nusen të mos flinte me dhëndrin, por t'i thoshte që ajo dashuronte vëllain e tij të vogël. Këtë nusja ia tha dhëndrit natën e parë, ai i besoi dhe u dëshpërua thellë.

Të nesërmen vëllai i madh i propozoi vëllait të vogël të dilnin në gjueti, pasi shpesh edhe më parë dilnin ashtu për dëfrim. Pasi arritën në vendin e caktuar, ai i thotë vëllait ta vendoste shenjën ku do të qëllonin. Vëllai i vogël duke mos e ditur qëllimin e tij, veproi ashtu dhe vëllai i madh e qëlloi nga prapa, duke e akuzuar për tradhtinë që i kishte bërë. Në çastin e fundit para se të vdiste, vëllai i vogël i tha se kjo ishte një shpifje të cilën mund ta kishte bërë daja i tyre. Pasi kuptoi qëllimin djallëzor të dajës dashakeq, vëllai i madh kërkoi falje nga vëllai i vogël, ia bëri varrin dhe e varrosi.

Kur u kthye në shtëpi, nënës së vet i tha se më nuk do ta shohë të birin pasi kishte rënë në një çetë hajdutësh dhe ishte zënë peng. Pastaj shkoi te nusja për ta kuptuar të vërtetën. Ajo pranoi se nuk kishte qenë e vërtetë që ajo donte vëllain e vogël, por kështu e kishte këshilluar të thoshte daja i tij.

I dëshpëruar thellë, nuses ia mori jetën dhe në fund bëri vetëvrasje, duke e qëlluar vetveten me thikë në zemër. Nga kjo që ndodhi nëna e vetmuar filloi të qante derisa u verbua.

1. Gjeni dhe përshkruani personazhet e kësaj përralle.

2. Ndani në personazhe pozitive dhe negative.

personazhe pozitive	personazhe negative

- Ndani në personazhe kryesore dhe të dorës së dytë.

personazhe kryesore	personazhe të dorës së dytë



Detyrë



Lexojeni këtë pjesë të shkëputur nga tregimi "Luli i vocërr".

LULI I VOCËRR

Askush s'e njej Lulin. As shokët e tij, që përpara tij lozin, nuk e njoftin. Ma mirë me thanë se e njoftin, por ata lozin për hesap të vet e Luli i shikon për hesap të vet. Sot gjithkush ka punët dhe telashet e veta, ashtu dhe fëmijtë, ashtu dhe Luli. More Lul! Shumë heret ke fillue me shikue punën tande!

Kur Luli hyn n'oborr të shkollës, buza i qeshet nga pak, por askuj, asnjë fjalë s'i thotë. Ecë ngadalë, tue shikue djathtas e majtas, po gjithnji tue ecë deri sa të mbërrijë në cak të vet.

Aty, te dera e rruginës shkollore, shumë i pëlqen të qëndrojë. Aty asht caku i tij, i praruem me rrezet e ngrofta të diellit në këto ditët e vjeshtës. Mbështetet Luli për mur, grushtat e vogjël i shtje ndër xhepa, hundën picrroke të kuqun nga të ftoftit e mëngjesit ja sjell diellit dhe...shikon.

Gjaja që ma tepër tërhjek vëmendjen janë çizmet që i kanë të veshun disa shokë të tij. Sa te bukura janë! Si shkëlqejnë! - mendon Luli dhe pa dashtje i shkojnë sytë ndër tullumbat e veta, nëpër të cilat shifen fare mirë të pesë gishtat e kambëve të zbathuna.

Nga kureshta i afrohet një shokut që ka çizmet ma të reja. Ulet dhe shef në lustrin e çizmes kambët e veta të zbathuna - aq shumë shkëlqejshin çizmet!!!

Mbasi shoku me çizme fluturoi, Luli ngadalë shkoi te caku i vet, në diell, t'i ngrohi kambët. Por kur s'ka diell, si ia ban i shkreti Lul? Ndoshta ia bajnë hallin apostujt e mëshirës dhe të dashunis... Noshta, ndoshta...

Nganjisher i afrohet mësuesi Lulit. Dhe kur Luli e ka ftyrën e dliërë dhe pa puça, mësuesi ia ledhaton faqet, gushën, e Luli i afrohet, ja merr dorën, e shikon me sy pëllumbi, dhe kishte me dashtë t'i falë diçka mësuesit. Por vjollca nuk ka. Veç në i faltë tollumbat e veta, që kanë hapun gojën si me dashtë me e hangër mësuesin. Po, po, tollumbat e Lulit të vocërr kanë me e hangër mësuesin.

Migjeni (fragment)

Bëni përshkrimin fizik dhe shpirtëror të Lulit të vocërr. Portretizojeni atë sipas kërkesës së mëposhtme:

Portretizimi i jashtëm	Portretizimi i brendshëm

Fabula, tema dhe ideja e veprës epike

Fabula

Fabula është mbarështrimi i ngjarjeve themelore, për të cilën flitet në ndonjë vepër letrare.

Në vepër hasim edhe ndjenja, përshkrime dhe qëndrime, por fabula shënon vetëm rrjedhjen e ngjarjeve më të rëndësishme të një veprë letrare.

Në një tekst tregimtar (poemë, roman, tregim etj.) ne dallojmë fabulën dhe subjektin. Fabula është vetë thelbi i ngjarjes, ashtu si ajo ka ngjarë, në renditjen e vet logjike e kronologjike. Subjekti është më i gjatë e më i zhvilluar sesa fabula.

Tema

Kur analizohet një tekst letrar, në radhë të parë duhet vështruar se cila anë e jetës është pasqyruar në të. Pra, çdo vepër letrare flet për diçka dhe kjo ka të bëjë me temën e veprës.

Tema është motivi themelor i një veprë letrare, mbi bazën e të cilit zhvillohet e gjithë ngjarja. Titulli i veprës letrare rregullisht është në lidhje të drejtpërdrejtë me temën.

Edhe në jetën e përditshme themi: tema e mbledhjes (e bisedimit), tema e mësimit, hyri në temë, nuk është në temë etj. Gjatë bashkëbisedimit: folësi flet për thelbin e çështjes, ndërsa dëgjuesi kupton për se a për kë flitet.

Tema është problemi themelor që pasqyrohet në një vepër letrare.

P.sh.: tema bazë në veprën e Migjenit është padrejtësia, vuajtja dhe mjerimi i vegjëlisë. Romani "Heshtja e armëve" i Ramiz Kelmendit, për temë ka hakmarrjen, ndërsa në romanin e Haki Stërmillit "Sikur të isha djalë" tema është shoqërore dhe bën fjalë për emancipimin e femrës.

Ideja

Ide është mendimi kryesor që përshkon një vepër artistike, parim themelor, mbi të cilin mbështetet ndërtimi i saj. Ideja e veprës letrare shpreh porosinë e tërësishme që vepra ia ofron lexuesit. Bie fjala, ideja e përbashkët e veprave të Migjenit në prozë e në poezi është kërkesa për ndryshimin e jetës shoqërore, politike e ekonomike të shoqërisë.

LUMI I VDEKUR

Shpërngulja

Në qerren e parë të karvanit, ngushtuar nga rregullimat e shtëpisë, përveç Pilos që e ngiste, ishte e reja me të vjehrën. Plaka e ndënjur te koka e nuses, te koka i thënçin, se gruaja që po çaplehej në të dhëmburat e hidhura të lindjes (ku vinte kokën, s'vinte këmbët) kishte kryqosur duart në kraharor me një pikëllim të madh dhe s'dinte ç'të bënte. Vetëm kur ranë kambanat e Shën-Gjergjit, që lajmëronin se po dilte nga kisha, plakës iu kujtua zoti i madh dhe filloi t'i lutej shenjtit t'i lehtësonte dhimbjet së resë e t'i ipte lirim të mbarë. Me gjithë të keqtë e atij çasti, nuk harroi të falej që t'i gëzonte shtëpinë me një djalë. Të gjithë këto i bëri me mënt e saj, vetëm këtë të fundit e tha me zë, sikur kërkonte që ta dëgjonte dhe e reja.



Nusja që kishte rënë një hop në atë qetim të shkurtër në të cilin bien rëndom gratë shtatzëna kur janë duke mbledhur fuqi për shtëzimin e fundit, u dha buzëve të mavjosura një fije gazi të hidhur.

- Ashtu, vërtet, moj nënë, djalë qoftë, çupë mos u bëftë, se ne gratë na ka nëmur zoti qëkur na bëri gra...

Qerrja që hidhej sa më një krah, më një krah nga një herë në tjetrën, po bënte të sajën, lehtësonte dhe afronte orën e madhe të dritës e të qetësisë.

Atë hop, kur Piloja shpoi rëndë kalin që të bënte djathtas e të linte mënjane një pellg të thellë më ujë, nusja lëshoi dhe afronte orën e madhe të dritës e të qetësisë.

- Uf, nëno moj! - sikur hosteni të ishte ngulur në trup të saj e jo në lëkurën e argasur të kaut.

Kjo ndjenjë e çuditshme e zптоi menjëherë Pilon, që në çast hoqi hostenin nga vithet e kafshës dhe ktheu kokën të shikonte ç'kishte e shoqja.

Qetë, lënë në punë të tyre, i ranë lerës përmes. Shtatzënia në të dhëmbura e sipër, u shpëtoi duarve të plakës që e mbanin të mos e briste e ta dëgjonin bota dhe u kthye më krah, sikur ashtu do të gjente lehtësimin që kërkonte. Gjunjët, mbledhur mbi bark, iu përpoqën në faqen e një dengu me plaçka. Rrangullat e shtëpisë u rrokullisën nëpër qerre dhe një trastë shkau e ra ne tokë. Trahanaja e imët dhe e thatë kërcë u përhap mbi baltë.

- Uaha kazil, uaha kuqo! U foli Piloja qeve që të ndalojnë dhe vetë, si pështeti hostenin në tokë, u hodh poshtë.

Edhe qerrja e dytë pushoi së qari. Qetë duke shfryrë jashtë avullin e dendur e të ngrohtë, zhytën turinjte në trahana dhe nisën të përtypen me qejf. Një shkumë e bardhë filloi t'u rrjedhë si zinxhir i hollë nga të dy anët e bulçive.

Nga bishti i qerres së pasme kërcëu në rrugë dhe ndau drejt së parës një vajzë nja gjashtëmbëdhjetë vjeçe. I ra baltës përmes dhe doli në krye të karvanit. Ishte Vita, çupa e madhe e Pilos.

- Ç'kërkon, moj bijë, që erdhe?... I foli gjyshja. - Nuk bën të rrish, këtu, po shko... Je çupë e rritur tashti...

- Nëna, ç'ka nëna?...

Piloja, pasi u vuri qeve përpara e më këmbë hostenin e gjatë, si shenjë që s'duhej të lëviznin nga vendi, i ra qerres rrotull dhe doli në bisht të saj.

- Po ty, moj, kush të thirri të vish?

Kur vajza pa t'anë kaq të ngrysur e tek vetulla e mëngjër i epte fët-fët poshtë e lart si për kohë të lirë, uli kokën dhe mërmëriti:

- Erdha se mos më do gjëkafshë nëna... dhe, sikur të kishte në duar ndonjë palë kriga, kapërceu gishtërinjtë me njëri - tjetrin pa ditur ç'të bëjë tjetër.

- Shko, shko, te qerrja, se s'mbeti jot'ëmë për ndihmën tënde! I foli i ati, duke i bërë me kokë, sikur kërkonte ta shtynte tutje.

Si u largua çupa, Piloja iu afrua s'ëmës.

- E, plakë, si duket puna, a do të mbajë dot gjer në Seman?

- Zor, o bir... Më duket se po e mendojmë e po hyjmë në gjynah me zotin dhe me të ... Ktheje më mirë qerren për në Bishtanakë, te hani. Gjyshja ngriti kokën dhe pa të birin në sy, si për t'i zgjidhur mendjen.

- Ma desh zemra të lindte fëmija në dhe të ri, se, kush e di, mund të na sillte të mbarë... Po, nejse, kur s'do perëndia, s'ka ç'bën robi...

- Tundi kokën dhe u largua drejt kreut të karvanit. Mori hostenin, hodhi lart dhe shpoi kuqon që të kthente, më të djathtë.

- Pse qan ata, mos e rrahu tata?... pyeti vëllai i vogël zgjuar në kohën kur qerrja kishte pushuar së tunduri e përkunduri.

- Jo vëllaçko, nuk qan ata, por prit dhe pak, të shohësh se kush do të qajë: vëllai apo motra... iu përgjigj Vita, duke tërhequr me një dorë tërkuzën e lopës dhe me tjetrën duke shtrirë të vëllanë.

Qerrja filloi të lëkundej përsëri dhe boshti i palyer ia nisi vajit të tij: "criu-criu fiq..." avaz që po e mbante që atë mëngjez kur i zoti i harroi, apo s'pat nge, t'hedhë masën katranit. Kjo e qarë zvarrë-zvarrë, si ajo tërkuzë e lëshuar e lopës që Vita e kish lënë nga dora, shiu i imët i fushës së Myzeqesë, që s'priti gjersa karvani të zinte Kilin e vogël. Koka, lëshuar gjumit dhe ëndërrave, po i shkonte sa mënjanë nga troshitja.

Sytë e vajzës, si kaluan një çast vështrimin e plogët e të qullët të kafshës që vinte pas, u mbushën përnjëherë me lot. Bulzat e ujit mbi faqen e një pellgu të rrahur nga shiu, dukeshin si barka të vogla që kishin ngritur velat për udhëtim, ashtu si lotët e vajzës që kishin marrë teposhtë faqeve. Kapur fort pas hunjve të qerres, kokën pështetur mbi faqen e rrogëzit që mbulonte plaçkat dhe binte gjer poshtë, vështrimin mbytur në atë re të madhe shiu, as Vita s'e kuptonte dot kush ja ndillte gjithë këtë trazim e pikëllim: arratia nga fshati ku kishte lerë e ishte rritur, lëngimi dhe dhembjet e nënës, apo ndonjë duf i ri që s'pati ndjerë gjer atë ditë në kufijt e fshatit të saj, në gjerdhet e kasolles së saj.

E ku kuptohet ndonjëherë nga çastisin rrëketë që mbushin lumin dhe e bëjnë të buçasë nga shtrati dhe udha e tij!...

Fragment nga romani "Lumi i vdekur" i Jakov Xoxës

Shpjegim

Në pjesën e shkëputur nga romani "Lumi i vdekur" shquhen çastet që tregojnë: shpërnguljen e familjes së Pilo Shpiragut dhe dhimbjet e lindjes që e kanë shtrënguar gruan e tij, e cila përpëlitet në qerren që lëviz rrugës me gropa fushës së Myzeqesë. Në të dyja rastet përmes rrëfimit të qetë, Jakov Xoxa shpreh, botën e ngarkuar me reflekse, përfytyrime e asociacione të pasura, botën psikologjike të personazheve, si dhe drithërima të brendshme, të thella shpirtërore... E gjithë rruga që përshkon karvani ka një domethënie simbolike.

Varfëria, rruga me llucë, qerret me qetë e lodhura, karrocet e mbushura me njerëz dhe dengje leckash është rruga e jetës së familjeve Myzeqare në vitet '30. Tiparet përcaktuese të personazheve dalin që të përgatisnin për ngjarjet e mëpastajme: plaka me urimet dhe mallkimet e saj, Pilo me zemërimin dhe përgjegjësinë e prijësit të karvanit; Lili i vogël që e sheh botën ende përmes përngjumjes nga lëkundja e qerres, Vita në prag të shpërthimit të vajzërisë; gruaja shtatzënë me dhimbjet e rënkimit që s'dihen në janë ogur i mirë apo i keq. Pamjet, përshkrimet, gjendjet janë dhënë me një leksik aq të përshtatshëm dhe aq të pasur, sa të duket sikur i ke të gjalla para syve. Kjo është dhe nga veçoritë më karakteristike të stilit të J. Xoxës.



Mendoni dhe përgjigjuni

1. Ç'është fabula?
2. Ç'është tema?
3. Ç'është ideja?
4. Ku qëndron dallimi ndërmjet fabulës dhe përmbajtjes së veprës letrare?



Detyrë



Lexojeni në tërësi romanin "Lumi i vdekur". Analizojeni këtë vepër letrare: shkruani në fletore për personazhet, fabulën, temën dhe idenë e veprës.

Për t'ju ndihmuar për detyrën e dhënë, po japim këtë skemë:

LUMI I VDEKUR

Tema: Jeta e vështirë e fshatit të Myzeqesë gjatë viteve 1938 - 1939

Fati i tri familjeve:

- Familja Shpiragu e dëbuar nga beu i vendit;
- Familja Tafilaj, kosovarë të dëbuar nga pushtuesi serb;
- Familja e Koz Dynjasë, vendase nga fshati Trokth.

Linjat paralele:

- Vështirësitë e jetës e mbijetesës së fshatarëve përballë bejlerëve e tregtarëve;
- Dashuria e Vitës me Adilin (një bashkim simbolik).

Zhvillimi i ngjarjeve:

- Dëbimi nga toka e vet e familjes së Shpiragajve;
- Vendosja e tyre në Trokth;
- Marrëveshja e Pilo Shpiragut me tregtarët e Fierit;
- Shpërthimi i lumit;
- Zhgënjimi i Pilo Shpiragut nga tregtarët;
- Marrëveshja e tij me beun;
- Arratisja e Adilit me Vitën.

Personazhet kryesore:

- Pilo Shpiragu e Koz Dynjaja, që tipizojnë figurën e fshatarit shqiptar mes dilemave të kohës.
- Sylejman Tafili tipizon figurën e kosovarit të ikur nga serbët, por dhe të zhgënjyer nga raportet me fshatarët e Myzeqesë.
- Adili dhe Vita janë dy personazhe romantikë të dashuruarish, që autori i parapërgatit për ngjarjet e mëpasme të luftës.

Veçori të veprës:

- Ka unitet të brendshëm të qëndrueshëm, me anë të të cilit lidhen rrjedhat fabulare.
- Ndërhyrja e autorit për të bërë zgjidhje qëllimore.
- Synimi për të rrëfyer bindshëm.
- Gjuha e pasur me frazeologji dhe filozofi popullore.

JAKOV XOKA (1923-1979)

Jakov Xoxa në letërsinë shqipe është i njohur si romancier, novelist e tregimtar. Lindi në Fier ku e mbaroi shkollën fillore, ndërsa të mesmen e kreu në Korçë. Pasi përfundoi studimet e larta për letërsi, një kohë punoi si gazetar dhe më vonë si profesor i letërsisë në shkollën e lartë. Nga viti 1965 Jakov Xoxa kryesisht filloi të merret me krijimtari letrare, ku në fillim shkroi skica, reportazhe dhe tregime. Tregimet e Jakov Xoxës janë përmbledhur në "Novela" I dhe II. Në letërsinë shqipe Jakov Xoxa u bë i njohur me romanet "Lumi i vdekur", "Juga e bardhë" dhe "Lulja e kripës". Është marrë me stilistikë dhe teori të letërsisë.

Narratori (rrëfyesi)

Çdo vepër letrare i dedikohet lexuesit ose dëgjuesit. Në dramë aktorët në skenë u flasin shikuesve, kurse autori flet përmes tyre. Në llojet e tjera letrare, të ashtuquajtura narrative (sipas latinishtes: *naratio*, rrëfim) narratori drejtpërdrejt ose tërthorazi i drejtohet lexuesit.

Narratorin nuk duhet ta identifikojmë çdo herë me autorin. Rolin e narratorit mund ta marrë ndonjë personazh në vepër ose një personazh i shpikur, si dëshmitar i ngjarjes. Narratori ka një rol të rëndësishëm për t'i kuptuar elementet e tjera të veprës. Tema, fabula dhe motivimi nuk mund të kuptohen drejt pa bërë edhe analizën e rolit të narratorit në një vepër letrare.

Vepra letrare nga ana gjuhësore përbëhet:

- a) nga ligjërata e autorit (kur fjalët dhe fjalitë janë thënë në vetën e tretë nga autori);
- b) nga ligjërata e personazhit (kur fjalët dhe fjalitë thuhet nga një pjesëmarrës i veprës), dhe
- c) nga ligjërata e rrëfimitarit a narratorit (kur një pjesëmarrës i veprës tregon në vetën e parë).

Gjuha e autorit dhe gjuha e personazheve ndërthuren.



MALËSORJA

(fragment)

Sa shumë e ndryshuan Hajrinë ato tetëmbëdhjetë vjet të martesës së dytë, habitej edhe ajo vetë. Nëpër fytyrën dikur të njomë e të bukur, të shëndoshë e të plotë, si lulja në mëngjesin e pranverës plot rreze të këndshme dielli, ishin kryqëzuar tash do rrudha që ia kishin bërë koha dhe vuajtjet, thua se në atë mënyrë i kishte shënuar çdo vuajtje kujtimet e veta me nga një rrudhë në fytyrën e saj. Të gjitha ato kishin marrë tash pamjen e një rrjete marimange në ndonjë qoshe të çardakut. Edhe trupi i saj, dikur i hollë e i gjatë si selvia në mes të malit, ishte kërrusur pak, tash dukej më e vogël. Sytë i ishin zgjeruar e flokët, dikur aqë të zez e të gjata, sa të gjitha shoqet ia lakmonin, ishin thinjur e rralluar. Megjithatë, Hajria, mu tash, në këto vite pleqërie, e ndjente veten më krenare se kurr ndonjëherë më parë. Sa herë e mendonte jetën e vet, i dukej se ka lindur mu atë ditë, që u krijua bota dhe se është më e vjetër se të gjithë njerëzit në të. Se kishte parë e përjetuar gjithçka që ndodhi deri tash në botë. E ka përcjellë çdo ngjarje të asaj ane dhe i dukej se vetë kishte marrë pjesë në to, pasi të gjithë ngjarjet e kaluara i mbante mend fare mirë.

Sabiti tashmë ishte rritur. Raba kishte vdekur para tri vjetësh. Të gjithë kujtimet e Hajrisë për të kaluarën e vështirë tashmë i mbuloi bukur shumë pluhuri i harresës, sidomos tash kur e shihte të birin burrë, të zotin e çdo pune; tash kur e shihte dhe veten dikund lart, lart mbi të gjithë, thuajse prej andej dëshironte t'u thonte të gjithëvet me plot mburrje:

"Qe, unë nuk kam qenë fajtores kurr!..." e ndjente në vete se si i shtohet ajo krenari pse arriti t'u bëjë ballë të gjitha atyre ngjarjeve të mundimshme dhe t'i harrojë deri dikund.

E vetmja brengë, të cilën nuk mund ta shlyente kurrsesi që Aliu. Ai i dhembet e dashuria për të nuk i zvogëlohet fare, edhe pse i urrente nganjëherë ata njerëz. Dashuria prindërore e shtynte të harrojë tërë të kaluarën dhe ta ledhatojë të birin herë pas here, por vetëm me ato kujtime e dëshira, të cilat e ndjente në vete se si i rridhnin dita ditës më tepër.

Plot nëntëmbëdhjetë vjet nga ndarja mbusheshin atëherë e asaj i kujtohej vetëm fytyra e tij, ajo fytyrë të cilën e la para aq vjetësh në mesin e atyre maleve të thepisura të Gollakut të largët, të cilën nuk e pa kurr më.

"Mos ka vdekë? Kur nuk e ka dëgjue ma as një fjalë për te!" u frigua shpeshherë dhe thellë në vete ndjeu atë dhembje e pikëllim që ia djeg zemrën nënës, të cilën e mundonte dashuria për të birin e humbur.

Tash edhe po ta shihte të birin, me siguri nuk do ta njihte më e ëma nuk do ta njihte të birin! Nëna të mos e njohë të birin! I vinte keq edhe asaj dhe çuditëj, por s'kishte çka të bënte, pasi e tillë që jeta ndaj saj. Të mos e njohë djalin, për të cilin mendoi gjithmonë, në ditët më të vështira dhe më të lumtura të jetës së vet, të mos e njohë nëna fëmijën, gjirin e së cilës e kishte thithur, atë që e kishte shpëtuar nga vdekja, sepse sikur Hajria të mos mendonte për të, të mund të mendonte jetën e të birit pa të sajën, atëherë i dukej se jeta e vet ishte e kotë dhe nuk kishte pse të jetojë, prandaj qysh atëherë do të vdiste. Të gjitha këto tash i dukeshin shumë të çuditshme. Sa net i kaloi pa gjumë dhe duke menduar për të!

Sa herë ëndërroi e në mëngjes u zemërua në vete pse pranoi të ndahet: pse nuk u kap për derën e shtëpisë sa të mos mundesh askush ta ndajë prej saj. Sa lotë derdhi gjatë atyre nëntëmbëdhjetë vjetëve malli përvëlues, i cili që shumë më i nxehtë se dielli i korrikut. Sa e sa herë e kujtoj atë moment të ndarjes, kur e la të birin për herë të fundit me duar të zgjatura kah ajo dhe vetëm

kur e mendonte këtë pamje i kujtohej më së miri fytyra e tij. Iu duk se i biri donte ta luste të mos ndaheshin, por ajo ia ktheu shpinën, kurse kali vazhdonte të ecë rrugës përpjetë, t'i ndajë e t'i largojë ëmë e bir prej njëri-tjetrit, edhe pse këtë nuk e dëshironin asnjëri.

Aq më tepër e lodhnin edhe mendimet se i biri nuk dinte asgjë për të, për vuajtjet e së ëmës dhe për dashurinë e harruar. Mendonte se i biri do ta përfytyrojë tash vetëm si një grua zemërkeqe, të shëmtuar dhe shtrigë, e pa fije dashurie për të birin, të cilën e urrente pse e kishte lënë atë pa nënë për t'u martuar me tjetërkend.

Atij kurr nuk do t'ia tregojë kush romanin e jetës së saj. Atë roman të pashkruar të malësorës, i cili me siguri një ditë do të harrohet, ashtu sikur janë harruar edhe mija e mija të tjerë në këto male të Llapit e të Gollakut, atë roman që e shkruan njerëzit me pashpirtësinë e tyre ndaj njeriut. Romanin për vuajtjet e njeriut nga njeriu. Romanin që zë fill dikund në Gollak, me një vajzë të bukur që ende nuk e kishte shijuar jetën që vazhdon për një grua të pafat dhe që përfundon me ...

Mendimet e tilla e lodhnin Hajrinë tash më tepër se gjithçka.

Friga se mos e kishte humbur dashurinë e të birit nuk e lente të qetë, sa herë që i kujtohej jeta e tashme e lumtur. Dëshironte vetëm të dijë se a e urrente ai apo jo dhe se a dëshironte të shohë ndonjëherë të ëmën. Çfarë lehtësimi do të ndjente ajo vetëm sikur ta dinte se i biri e donte, nuk e kishte harruar kurrë dhe se mendonte gjithnjë për të.

Por, në atë moment në kokë i fluturonte përherë një mendim i ftohtë: "Me më pas dashtë kishte ardhë ndonjëherë. Ai tash asht burrë, kishte mujtë me ardhë!" i thonte vetes dhe pikëllohej përsëri.

E sa e sa mendime nuk e lenin të qetë shpeshherë edhe pas kaqë vjetësh; aq shumë pikëllohej nganjëherë sa dilte e shikonte përmallshëm qiellin e përhimtë, andej në drejtim të katundit, ku e la të birin, thua se përpiqej ta shihte atë copë qielli që e mbulonte atë.

Nazmi Rrahmani

TË KUPTOJMË PËRMBAJTJEN

Hajria është personazhi kryesor i romanit. Ajo është personifikimi i vuajtjes së femrës së nënshtruar dhe të shtypur shqiptare në Kosovë e më gjerë. Vuajtjet e saj janë të shumta, por më të madhen autori ka spikatur dhimbjen e nënës për djalin që ia kanë marrë me forcë dhe tani ai është i rritur.

Rrëfimin e historisë së vet para djalit, Hajria e quan roman, një roman të pashkruar, kjo për dy arsye: asnjëherë fëmija nuk mund të njohë aq thellë historinë e prindit të vet, aq më tepër në këtë rast kur i biri i Hajries është rritur larg prehërit të nënës së vet. Kjo e bën dhe më tragjike dramën që fsheh Hajria përbrenda.

Drama e Hajries merr përmasa të mëdha shoqërore. Me dhimbjen e vet ajo përpiqet të kundërshtojë botën e egër të mentalitetit e të dhunës mashkullore. Po deri në këtë fragment protesta e saj është e heshtur. Asaj s'i mbetet gjë tjetër veçse të shikojë qiellin e përhimtë.

Si stil shkrimi në këtë fragment e në tërë romanin të bie në sy ndërthurja e monologut të personazhit kryesor me gjuhën e drejtpërdrejtë të shkrimtarit.

Detyrë



Lexojeni këtë roman në tërësi.

Shkruajeni në fletore përmbajtjen e këtij romani.



Kompozicioni i veprës epike

Kompozicioni është pjesa kryesore e formës artistike të veprës letrare. Këtë komponentë e gjejmë në të gjitha gjinitë dhe llojet letrare (epike, lirike, dramatike, epiko-lirike etj.).

Kompozicion është ndërtimi i brendshëm i një veprë letrare, që përcaktohet nga synimi për të zbuluar më mirë idenë e veprës; mënyra se si janë lidhur e si janë vendosur pjesët përbërëse të saj.

Me fjalë të tjera, mënyra se si i organizon shkrimtari ngjarjet në vepër, si i vendos personazhet, marrëdhëniet që kanë ata me njëri-tjetrin, përbën kompozicionin (ndërtimin) e veprës.

Veprat në prozë janë kryesisht me subjekt dhe me personazhe. Veprat epike përbëhen nga këto elemente kompozicionale:

- a) paraqitja e veprimit;
- b) thurja e veprimit;
- c) kulminacioni;
- ç) peripecia dhe
- d) shthurja e veprimit.

Në fazën e **paraqitjes së veprimit** bëhet një hyrje, në të cilën lexuesi njihet me personazhet kryesore, me vendin e ngjarjeve etj.

Në **thurjen e veprimit** ndodh diçka, një veprim a situatë e papritur që bëhet shkak për konfliktin kryesor. Bëhet koklavitja e veprimeve, të cilat e çojnë konfliktin përpara.

Nga kjo fazë pastaj kalohet në **kulminacion**, që është pika më e lartë e arritjes së konfliktit.

Pason pika e kthesës apo **peripecia**, që përbëhet nga një sërë veprimesh që çojnë drejt zgjidhjes së krizës.

Në fund kemi **shthurjen e veprimit** ose fundin e konfliktit, kur ngjarjet plotësisht marrin fund.

Ka vepra ku subjekti ndërtohet sipas rrjedhës së mësipërme të ngjarjeve, por ka edhe të tilla që në fillim jepet zgjidhja, mandej zhvillimi i ngjarjes.

Në kompozicionin e veprave asgjë nuk duhet të jetë e tepërt. Çdo pjesë, çdo veprim duhet të ndihmojë për shtjellimin e plotë të temës së veprës, për zbërthimin e ideve të saj, me qëllim që ato të kuptohen mirë dhe të ndikojnë në ndjenjat dhe në mendimet e lexuesit.

BUKURIA QË VRET

Hana e zbetë, si fytyra e një të vdekuri, kundron nga kupa e qiellës. Kundron botën e maleve të kristalizueme nga bora. Kundron kasollet e kristalizueme të katundit, të cilat as fymë nuk marrin. Të gjitha janë mbështjellë në bardhësinë e borës. Dhe të vret kjo bukuri e bardhë. Vret shpirtin e malsorit siç vret shpirtin e artistit shtatorja e bardhë e ftoftë e një gruaje lakurige. E në kasollë, e cila gjëmon nën barrën e borës, derdhen dy ngjyra, kuq e zi. I kuq zjarrmi i votrës në fund të kasollës, e zi rrethi. Të zeza, t'errta janë skutat e kasollës, nga dëgjohet blerimë e mekun e ndoj delje ose kumona e lopës. Edhe ata i vret bukuria e bardhë. Nga goja u del avulli i afshavet që

ngrihen n'ajr, bie mbi qimet e tyne si brymë dhe kristalizohet. Heshtje.

Gjithçkafja e kristalizume.

- Një dorë shtrihet, zen një dru, e shpupurish zjarrmin. Ropos një botë gacash. Flaka lëpin errësirën e njerëzve që dridhen, nëpër kuriz u përshkohet të ftohtit që vjen nga skutat, andej nga errësina.

Br... uf... andej mbrapa shpinet përpijnë errësina me të ftohtit e saj.

- Po shiko mos ngrini Laroja?

Dhe çohen, i lëshojnë vend rreth zjarrit Larojës, lopës së shtëpisë. Të nxehet dhe ky pjestar familjeje në kasollën e kristalizueme.

- E Laroja din si duhet m'u shtrimë rreth zjarrit. Por, me trupin e saj të madh, gati shtypi dy vocrrakë, të cilët i kish zanë gjumi pranë zjarrit.

E kur andej nga mesnata acarimi arrin dhe kulmin e vet, atëherë ndër bagëtit fillon një lëvizje. Po, një lëvizje. Një nga një u aviten njerëzve e me sytë e vet si me u lutë: "Na lëshoni edhe neve të ngrohemi pak rreth zjarrit se u ngrimë. Dhe njerëzit kundrejt njerëzve s'kanë mëshirë, po kundrejt shtazëve po. Prandej çohen, ua lëshojnë bagëtisë vendin rreth votrës, e ata vetë shkojnë n' erësinën që përpin.

... Dhe agimi zbardh me bukurinë e bardhë që vret. Çohen njerëzit me trupa të mpirë dhe me kujtim në ndërgjegje se u kalua edhe një natë e vështirë. U çuan, por nuk çohet një vocrrak. Dora e s'amës shtrihet mbi te dhe m'at çast një britmë e tmershme çpoi zemrat e kasollës. Dhimba e një nane i shkrin zemrat në vaj, por ç'e do kur nuk shkrin zemrën e ngrime të vocrrakut.

Po, ishte ngrimë lokja e nanës. Gjaku i tij i kuq e i purpurt ish ngri ndër dej dhe në zemër, ish bamë kristal, që të bahet një servis për milionarin, jo, gjaku ish ba rubis, për gjerdhanet e metresave.

E trupi i vocrrakut, i lokes së nanës, ishte bamë një shtatore e ngurtë e zhgulun nga gjiri i nanës.

- Merrnje dhe çonje në qytet këtë shtatore. Vendosije në një shesh!

Dhe si permendore kushtonja ndokujt! Kushtonja atij që ka më shumë merita për këtë vend! Po, ndoj ministrit o deputetit o ndokujt tjetër... E në rasë se nuk gjeni ndonjë njeri që ka merita të mjaftueshme, atëherë kushtonja atij që ka merita ma pak, perendisë klasike.

Millesh Gjergj Nikolla - Migjeni

Fjalor

kundroj - vërej dikë a diçka me kujdes, e shoh mirë dhe me vëmendje nga të gjitha anët.

shtatore - statujë trupore, permendore.

mek - dobësoj, e mpak, e shuaj për zërin.

rropat - përplas këmbët duke ecur dhe bëj zhurmë.

rubin - gur i çmuar, shumë i fortë e me ngjyrë të kuqe.



INTERPRETIM

- Për cilën kohë bën fjalë shkrimtari në këtë tregim?
- Si e përshkruan shkrimtari dhembjen e nënës për vocërrakun?
- Plani kompozicional i këtij tregimi mund të paraqitet si më poshtë:
 1. **paraqitja e veprimit:** të gjithë janë mbështjellë në bardhësinë e borës;
 2. **thurja e veprimit:** trupnat e njerëzve dridhen, nëpër kurriz u përshkohen të ftohtit që vjen nga skutat, andej nga errësina;
 3. **kulminacioni:** të gjithë u çuen, por nuk çohet një vocërrak;
 4. **peripecia:** dhe njerëzit kundrejt njerëzve s'kanë mëshirë, po kundrejt shtazëve po;
 5. **shturja e veprimit:** demaskimi i realitetit, i regjimit në fuqi dhe revolta e shkrimtarit kundër dallimeve të skajshme klasore në shoqëri.

Detyrë



Lexoni me kujdes tekstin e mëposhtëm dhe gjeni etapat e kompozicionit në tekst.

Njeriu që bëri të qeshë një mbretëri

Një ditë, pasi u largua nga vendi i tij, ku nuk kishte mbetur njeri pa mësuar të qeshë, shakatarit u nis nëpër botë të takonte njerëz që mund të kishin nevojë për të. Kutinë me pluhurin magjik me vete, trastën në shpinë dhe ec e ec na sheh së largu një vend me re të zeza.

Vendosi të kthehej aty e të shikonte ç'bëhej. Rrugës takoi shumë njerëz. E përshëndesnin, por asnjërit s'i qeshte buza, njëri më i zyrtë se tjetri. Më në fund nuk iu durua dhe pyeti njërin prej tyre:

- *Pse të gjithë njerëzit që takoj rrugës janë të zyrtë?*
- Burri vetullngrysur iu përgjigj.*
- *Ke ardhur në vendin ku njerëzit kanë harruar të qeshin.*
- *Si kështu?! - Ç'ka ndodhur?!*
- *Shumë vite më parë, kur ka sunduar gjyshi i mbretit të sotëm. Ai pati ndaluar të qeshurën me ligj. Që atëherë asnjëri nuk qesh dot në këtë vend.*
- *Mirë, po mbreti juaj pse nuk e ndryshon këtë ligj?*
- *Mbreti ynë i zyrtë?! Ai e ndjen veten aq fatkeq, sa zor t'i qeshë fytyra ndonjëherë, jo më të ndryshojë ligjin. Meqë është vet fatkeq, nuk do që njerëzit e tjerë të qeshin.*
- *E kuptova, - tha shakatarit...*

Ai mendoi se e vetmja rrugë shpëtimi është që ta bënte vetë mbretin për të qeshur. Prandaj, pa thënë asgjë, nxori nga xhepi një grusht pluhur dhe ia hodhi mbretit përsipër me shumë mirësjellje. Shprehja e fytyrës së mbretit ndryshoi përnjëherësh.

Vetullat e ngrysurat iu drejtuan, buza iu përvesh pak sipër dhe filloi të qeshë. Qeshi e qeshi me orë të tëra duke i lënë të habitur të gjithë oborrtarët e pallatit që e ndoqën këtë skenë me buzë në gaz...

Mbreti kërkoi pak nga pluhuri magjik.

- *Do të të jap të gjithë arin e thesarit tim si shpërblim, - i tha shakatarit.*
- *Nuk ka nevojë më për këtë, - ia ktheu shakatarit. Pasi të mësosh të qeshësh dhe të duash me gjithë shpirt të qeshësh, nuk ke nevojë më për këtë pluhur.*
- *Të hiqet ligji që ndalon të qeshurën! - urdhëroi mbreti. Njerëzit të jenë të lirë të qeshin.*

Fragment nga përralla turke

DRAMATIKA

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> dramatikën; llojet e dramatikës; dramën; komedinë; tragjedinë. 	<ul style="list-style-type: none"> të shpjegojmë specifikën e tekstit dramatik në raport me lirikën dhe epikën; t'i dallojmë veçoritë e llojeve të ndryshme të dramës, komedisë dhe të tragjedisë.

Njohuri për dramatikën

Veprimet dramatike e japin jetën nëpërmjet dialogëve, monologëve dhe veprimit të personazheve. Ne këto vepra mungon fjala e autorit. Vendin e saj e zë gjuha e personazheve (dialogu, monologu).

Dramat, zakonisht, kanë në qendër një konflikt të vetëm, kurse, konfliktet e tjera janë të dorës së dytë, i shërbejnë zgjidhjes së konfliktit kryesor.

Këto vepra shkruhen për t'u shfaqur në skenat e teatrit, prandaj duhet të plotësojnë disa kërkesa, si: të mos zgjaten më shumë se dy orë, ngjarjet të jenë shumë të përqendruara dhe të paraqiten sikur zhvillohen para syve të shikuesit, në kohën e tashme.

Personazhet vendosen përballë njëri-tjetrit. Veprat dramatike ndërtohen me akte, skena ose pjesë.

Kompozicioni në veprën dramatike është më i ndërlikuar. Aty mbizotëron dialogu dhe monologu, si formë e të shprehurit të aktorit.

Dialog është bashkëbisedimi që zhvillohet ndërmjet dy personazheve, ndërsa **monolog** quhet biseda që e zhvillon një personazh duke folur me vetveten ose që u drejtohet lexuesve, dëgjuesve a shikuesve në një shfaqje teatrale.

Dialogu apo bashkëbisedimi përveç se në dramatikë, shumë shpesh haset edhe në veprat e tjera letrare, si dhe në jetën e përditshme. P.sh.:

a) në komedi

Tana

Ç'bën ashtu, moj Kote?

Kote

S' është puna jote.

Tana

Moj, mos je e marrë? Kam ardhë më parë.

Kote

S'mund të rri këtunë, Kam të tjera punë, po hiq nga unë!

Tana

Ç'thotë kjo murtajë! Ujku të të hajë!



b) në tregim

- Ç'po bën shamia?
- Asgjë, gjysh.
- A po e valëvit era?
- Po, gjysh.
- Nga po valëvit, nga lindja apo nga perëndimi?
- Nuk e di, gjysh.

Gjyshi priti dhe pastaj tha:

- Nga deti, apo nga toka?
- Nga deti, nga deti...

c) në bisedë

Nëna: Agim, zgjohu!

Agimi: Sa është ora?

Nëna: Shtatë.

Agimi: O, qenkam vonuar!

Nëna: Jo, bir. Sot nëna do të të dërgojë në shkollë me veturë.

Agimi: Mirë, nënë.

Detyrë



Lexojeni pjesën në vijim. Kjo është një pjesë e shkëputur nga tragjedia "Romeo e Zhulieta" e Shekspirit. Përcaktojeni cila pjesë është dialog e cila monolog.

Romeo e Zhulieta SKENA III

Qelia e Fratit Laurens. Hyn FRATI LAURENS me një shportë.

FRATI LAURENS:

*Pas natës së vrenjtur, qesh mëngjes' i zbehtë.
Kur drita larushon nga lindja retë;
Dhe cip' e zeze zbardhet bëhet ditë
Nga zjarri i Titanit që sjell dritë.
Pa dalë dielli erën të përçajë,
Të zgjojë ditën, vesën të na thajë,
Barishte do të mbledh me helm të fortë,
Dhe lule për ilaç në këtë shportë.
Ky dhé, q'është' nënë, është' dhe varri ynë
Pra gropë varri qënka mitra jonë,
Kjo mitër, lloj-lloj hijesh na ka dhënë
Që thithin gjin' e tokës për të ngrënë.
Disa fëmijë plot virtyte kanë
Asnjë nuk është bosh, po njësh nuk janë.
Oh! Fuqiplotë është' hiri që qëndron,
Përmbi çdo bim' e gur që na rrethon,
Se s'ka asgjë të ligë a të kotë,*

Që s'bën asnjë shërbim në këtë botë,
 Po dhe një gjë e mirë na bën keq
 Kur shtrëmbër e përdorim dhe për dreq.
 Virtyti, kur e nxin, në ves ndërron
 Dhe vesin pun' e mir' e zbukuron.
 Kështu edhe kjo lule e uruar
 Nën luspë ka një helm për të shëruar.
 Në qoftë se i merr erë ta ka ënda
 Po n'e shijofsh me ndjenjat humb dhe mëndja.
 Dhe tek njeriu luftojnë dy fuqira
 Dy mbretër hasmë: E liga dhe e mira.
 Dhe kur ai m'i ligu na fiton,
 Sakaq bimën sëmundja e shkurton.

(Hyn ROMEUA).

ROMEUA: Mirëmëngjesi, uratë!

FRATI LAURENS: Paç uratën!

Ky zë i ëmbël ç'është që me natë?
 O bir që kaq shpejt më ke munguar
 Do kesh një hall të madh të paduruar.
 Meraku vjen kur plaket ca njeriu,
 Kur vjen ai dhe gjumi shkon vetiu;
 Po trurin e shkujdesur të rinisë,
 E ruan gjum' i art' i qetësisë.
 Prandaj, mëngim' i yt më siguron
 Se një merak i madh të çqetëson.
 Ose, t'i shtie shenjës ca më mirë,
 Në shtrat ti sonte fare nuk je shtrirë.

ROMEUA: Tamam, po sonte isha m'i qetuar.

FRATI LAURENS: O Zot! Tek Rozalina paske shkuar?

ROMEUA: Oh jo, imzot atë e kam harruar

Dhe dhëmbja që më sillte m'është shuar.

FRATI LAURENS: Pra thuaj ku e shkove këtë natë?

ROMEUA: Ja ku ta them pa pyetur më gjatë.

Tek hasmi isha mbrëmë në gosti
 Kur rashë në një tjetër dashuri.
 Si unë u plagos edhe ajo
 Prandaj si shenjti, na ndih e na shëro.
 Për' të, uratë, s'kam ndonjë mëri
 Dhe lutjen për të dy e bëj tani.

FRATI LAURENS: Shpjegom biro punën pa e zgjatur.

Se ndjesë s'merr përveç nunosj' e hapur.

ROMEUA: Ta them pra hapur, zemrën me të parë

E bij e Kapuletit ma ka marrë.
 Si zemr' e saj dhe e imja u bashkuan.
 Të gjitha, veç kurorës, u mbaruan.
 Tani ta them më mirë, duke shkuar
 Se ku dhe kur dhe qysh jemi takuar
 Dhe si këmbjem fjalë zumë dorë;
 Po vetëm, zot, që sot na ver' kurorë.

FRATI LAURENS: O Zoti Krisht! E ç'është ky ndryshim?



Llojet e dramatikës

Llojet kryesore të gjinisë dramatike janë:

- a) **drama**;
- b) **komedia** dhe
- c) **tragjedia**.

Drama

Drama është një lloj letrar (në rreshta ose në vargje) që shkruhet në formë dialogu për t'u shfaqur në teatër. Ajo përbëhet nga fjalët që thonë personazhet, dhe nga të dhënat për skenën, mënyrën se si flasin dhe si sillen personazhet etj.

Drama paraqet një konflikt të ashpër, por që gjen rrugëzgjdhje. Ajo paraqet ngjarje tronditëse, që shkaktojnë vuajtje të mëdha shpirtërore. Subjekti është mjaft i përqendruar e i ngjeshur.

Drama ndahet në akte. Në çdo akt zhvillohet një ndodhi. Vetë akti përbëhet nga disa skena. Çdo skenë ka një pjesë të ngjarjes që ndodh brenda një akti. Rregullimi dhe veshja e skenës me inventarin e nevojshëm në të cilin luajnë aktorët quhet skenografi.

Përveç personazheve kryesorë në dramë ka edhe shumë personazhe dytësorë (që plotësojnë tërë ngjarjen).

Personi që e shkruan veprën dramatike quhet dramaturg. Personat që luajnë rolet në skenë quhen aktorë ose artistë.

Dramaturgë të njohur të letërsisë sonë janë: Kolë Jakova, Spiro Çomora, Anton Pashku, Hivzi Sulejmani, Kasëm Trebeshina, Sulejman Pitarka, Ruzhdi Pulaha, Ekrem Kryeziu, Resul Shabani etj.

EMIRA

*(Kalina u jep ujë dhenve në Krojin e Ftohtë dhe
po i këndon një qingji të porsalindur, pastaj vjen Emira)*

Skena 1

*KALINA: I lumi ti,
Që pa u trëmbur
Këcen, o shqerr!
Qumshtin dhe barin
Saher' e do
E gjen, e merr:
Njerin dhe tjetrin,
Kur s'të pëlqen,
E lë tek është
Vihe lodron
Me bark të ngopur.
Plot me hare
Ditën e shkon.
I par' ti leve...*



EMIRA: Ohi, ndrikull Kalinë, Uh!

KALINA: Kush po më thërret?

EMIRA: Ndrikull Kalinë!

KALINA: Dëgjojmë, dëgjojmë!

EMIRA: Ku je?

KALINA: Këtu te Kroi.

EMIRA: Kur erdhe? Nuk të pashë të zbritshe këtej poshtë.

KALINA: S'ka një copë herë që jam këtu. Te ky bar, ja delet po kullosin.

EMIRA: E po si, pa furkë gjënde? Jot ëmë s'të shtërngon të punosh gjithnjë si imja më?

KALINA: Ç'thua, diç zotin edhe ti Emirë? Ajo është një kulshedër, që nuk ngopet kurrë. Po t'ish si thotë ajo, do të donte të përgatis ja një palë çorape ditën. Çdo herë, kur mblidhemi në mbrëmje, të parën të pyetur që më bën është kjo: Punove sot, apo fjete e shtruar në diell, apo në ndonjë hije? Ku e ke çorapin që ke bërë?

Unë rri e qetë se po t'i përgjigjesha edhe një gjysmë fjale, m'atë çast do të zihej lufta.

EMIRA: Eh, motra ime, ashtu është bërë jeta, ka më shumë thartira se ëmbëlsira.

KALINA: Veçse thuhet se kush vuan më shumë, e kush më pak.

EMIRA: Moj po kush e di? Më kujtohet se kur isha, të të them, nja tetë a nëntë vjeç, Tata më shpuri ndër Sheshe, atje tek kishim arën; atje ishin burrat që korrnin. Pasi hëngrëm e pimë mezdritë, atje nën hijen e një lisi degëgjërë dhe plot fletë, ashtu si ishin, ata zunë të flisnin për mjerimet e kësaj bote dhe, kush duke qeshur, kush duke u tallur, kush duke folur me tamam, për secilin mjerimet e veta ishin më të rënda se të të tjerëve. Kur ja ku ja arriu Eremiti i Shën Pantaleut Motëmadhi.

KALINA: Motro, mba mënd se ku qëndron, dhe ndjemë se po të pres fjalën, po unë do të të rrëfej një të pësuar me këtë; unë tani jam e madhe.

EMIRA: Mëma më tha se ke lindur dy vjet para meje.

KALINA: Sa vjeç je ti?

EMIRA: Mbaroj tetëmbëdhjetë në muajin që po hyn.

KALINA: Popo, ç'thua, moj motër? Unë jam shtatëmbëdhjetë vjeç.

EMIRA: Atëhere, në unë jam dy vjet më e vogël se ti, sa vjeç mund të jem?

KALINA: Njëzet vjeç.

EMIRA: Ah! Ah! Ah! vjetët u nëmëruakan së prapëthi!

Anton Santori



Analiza e veprës



"Emira" e Anton Santorit është drama e parë në gjuhën shqipe. Aty trajtohet gjerësisht dukuria shoqërore e cubërisë, që Santori e kishte prekur edhe te novelat e romanet. Ngjarjet zhvillohen në fshatin arbëresh Shën Katerinë të Italisë.

Subjekti me pak fjalë është ky: dy vajza fshatare, Emira dhe Kalina, dashurojnë të njëjtin djalë, Mirianin, të cilit i rrah zemra për të parën, po këtë e lakmon edhe bariu i derrave të fshatit, Kallonjeri, njeri pa skrupull, që i vjen rrotull edhe Kalinës.

Veprimi zhvillohet në dy linja, përpjekjet e Fumelit për zbulimin e bandave të cubave nga njëra anë, dhe pengesat që i sjell dashurisë së Emirës dhe Mirianit, zilia e Kallonjerit dhe e Kalinës, nga ana tjetër. Kjo zili e shpie përpara veprimin. Si kallauz i cubave, Kallonjeri i shtyn ata t'i djegin kasollen e t'i mbytin bagëtinë Mirianit, orvatet të rrëmbejë edhe Emirën, po s'ia arrin qëllimit (se vajzën e shpëton vëllai i Mirianit, Albenci). Ky gati sa nuk e vret Kallonjerin, që padit Mirianin me t'anë si bashkëpunëtorë të bandave.

Të dy arrestohen dhe janë gati për t'u pushkatuar, kur intrigantin Kallonjer e vrasin vetë cubat për poshtërsitë e tij. Gabimi sqarohet. Miriani me të atin lirohen nga burgu; dhjetë cuba pushkatohen.

Drama mbyllet me një fund të lumtur: vendi shpëton prej grabitjeve dhe vrasjeve; Emira dhe Miriani martohen, kështu edhe Kalina me Albencin.

Drama frymëzohet nga simpatia e autorit për njerëzit e thjeshtë, nga dhimbja për jetën e vuajtur të fshatarëve.

Me realizëm janë pasqyruar rrethanat tipike të jetës së fshatarëve arbëreshë të kohës. Këtu na dalin personazhe të gjalla e të goditura si: Emira, Kalina dhe nënat e tyre.

Në figurën e Emirës kemi tipin e vajzës së thjeshtë të popullit, plot virtyte e cilësi të trashëguara nga mjedisi ku u rrit.

Kalina është lozonjare e ziliqare, po në thelb naive e zemërmirë. Një figurë e ndërlikuar është edhe Kallonjeri: djalë i ri, i etur për jetë e dashuri, i pashëm, këngëtar i talentuar, por tek ai është tepër i fortë egoizmi që e shndërron në një hipokrit, intrigant të gatshëm të përdorë çdo rrugë për të arritur qëllimet e veta.

Ljipisia dhe Ligjërësha janë figura të goditura plakash fshatare, të cilat kanë të përbashkët mentalitetin konservator.

Dramën "Emira" e gjallëron humori i këndshëm. Dialogu është i zhdërvjelltë dhe ka frymë popullore.

Detyrë



Lexojeni në tërësi dramën e parë të letërsisë shqiptare "Emira" të Anton Santori.



Komedia

Komedia është një lloj i lashtë i gjinisë dramatike. Në kohërat antike ajo shfaqej në skenë ku luanin dy-tre aktorë që përdornin maskat për të krijuar efekte komike.

Karakteristikë kryesore e komedisë është e qeshura. Në komedi pasqyrohen dukuri shoqërore të shëmtuara dhe të ulëta, që vihen në lojë nëpërmjet personazheve me vese. Elementet kryesore të saj janë ironia dhe sarkazma.

Ndryshe nga tragjedia, që përfundon me dhimbje, komedia zakonisht përfundon në mënyrë të gëzueshme dhe në të mirën e personazheve pozitivë.

Komediografët më të njohur kanë qenë Aristofani, Shekspiri, Molieri, Gogoli etj.

Një nga komeditë e para të letërsisë shqiptare është "14 vjeç dhëndër" e Çajupit. Komedi të bukura janë edhe "Karnevalet e Korçës" (Spiro Çomorra), "Zonja nga qyteti" (Ruzhdi Pulaha) etj.

KOPRRACI

- Komedi -
(akti IV, skena VII)

*Harpagoni është fajdexhi i pasur dhe koprrac i jashtëzakonshëm.
Kleanti, i biri, në bashkëpunim me shërbëtorin e tij, marrin arkën me florinj.
Harpagoni bëhet si i marrë dhe thërret komisarin e policisë për zbulimin e hajdutëve.*

Personazhet kryesore në këtë pjesë:

Harpagoni (koprraci) - i ati i Kleantit dhe Elizës;

Kleanti - i biri;

Eliza - e bija;

Komisari i policisë etj.

*HARPAGONI - (thërret që nga kopshti dhe del në skenë pa kapelë).
Hajdutët! Hajdutët! Vrasësit! Kriminelët! Oh! I mjeri unë! Drejtësi, o Zot i drejtë! Më fikën,
më vranë, më prenë kokën, më vodhën paratë e mia! Kush m'i ka marrë? Ç'u bë? Ku është?
Ku fshihet? Si mund ta gjej? Ku të vete? Ku të mos vete? Mos është atje? Mos është këtu?
Kush je ti?*

Qëndro! Paratë!

*Paratë, i poshtër!... (Zë krahun e tij). Oh, jam unë! M'u prish mendja s'di ku jam, cili jam e
ç'po bëj. Oh, paratë e mia të gjora, miqtë e mi të dashur! Më lanë pa ju. Tani që ju rrëmbyen
prej meje, e humba mbështetjen, ngushëllimin, gëzimin; të gjitha mbaruan për mua; s'më
duhet më jeta; pa ju është e pamundur të rroj. Kaq ishte, më la fryma,*

*po vdes, vdiqa, më varën. S'ka ndonjë zemërbardhë që të më ngjallë, të më kthejë
verdshushkat e mia të dashura, ose të më thotë kush m'i ka marrë? E? Si thoni? Asnjë s'ka?
Kushdo që ma bëri gjëmën, mirë ma gjeti rastin; zgjodhi tamam kohën kur i flisja atij të
mallkuarit djalë.*



Të dal. Të vete në polici, t'i them t'i shkojnë në hell të gjithë të shtëpisë, me shërbëtorë e shërbëtore, me djalë, me vajzë, more dhe mua vetë. Sa njerëz qenkan mbledhur! Kujtdo që i hedh sytë, më bën të dyshoj, të gjithë më ngajnë me hajdutin që më vodhi. Ej! Për cilin flisni atje tej? Për atë që më vodhi? Çfarë zhurme bëhet atje lart? Mos është atje hajduti? Amani, kush e di ku është futur, i lutem të ma tregojë! Mos është fshehur aty në mesin tuaj? Më vështronë të gjithë dhe qeshin.

Keni për të parë, edhe ata kanë gisht në vjedhjen që më është bërë patjetër. Hajde, shpejt, komisarë, xhandarë, gjykatës, litarë, trarë, xhelatë! Të gjithë t'i varin, të gjithë: dhe sikur të mos i gjej paratë e mia, do të varem edhe vetë pastaj.

* * *

KOMISARI - Ma lini mua në dorë. Ai është zanati im. U regja në këso punësh.

S'është e para herë që po merrem me zbulimin e hajdutëve dhe do të isha bërë pasanik i madh sikur të kisha aq thasë nga një mijë franga sa njerëz kam varur.

HARPAGONI - Të gjithë gjykatësit të interesohen për shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe, në qoftë se nuk m'i gjejnë paratë e mia, do të kërkoj drejtësinë e drejtësisë.

KOMISARI - Duhet bërë gjitha hetimet e nevojshme. Sa para kishit në arkë, thatë?

HARPAGONI - Dhjetë mijë florinj, të numëruar një për një.

KOMISARI - Dhjetë mijë florinj?!

HARPAGONI - Dhjetë mijë florinj.

KOMISARI - Vjedhje e rëndësishme.

HARPAGONI - S'ka torturë që mund ta lajë këtë krim kaq të madh dhe, sikur të mos i jepet dënimi i merituar hajdudit, s'ka siguri më as për gjërat më të shenjta.

KOMISARI - Në ç'monedhë ishte kjo shumë?

HARPAGONI - Në flori tingëllues.

KOMISARI - Cilin dyshoni për këtë vjedhje?

HARPAGONI - Të gjithë! Dua të arrestoni e të burgosni qytetin me gjithë rrethet.

KOMISARI - Po të më dëgjoni mua, nuk duhet të inatosim asnjëri, po të mundohemi me të urtë e me të butë të shtiem ndonjë provë në dorë, që të mundim të veprojmë pastaj me anën e forcës dhe të kërcënim për t'i gjetur gjithë paratë që ju kanë vjedhur. (Kleanti i jep arkën me florinj me kusht që Harpagoni të heqë dorë nga marrëzia e tij për t'u martuar me Marianën).

Molieri

Shënim

Kjo pjesë është marrë nga komedia "Koprraci" e shkrimtarit të madh francez Molier, emri i vërtetë i të cilit ishte Zhan Baptist Pokëlen (1622-1673). Përmes skenave me humor të goditur, Molieri demaskon koprracinë që shkatërron shpirtin e njeriut.

Fjalor

koprrac - ai që kursen tej masës edhe për sendet e domosdoshme për jetesë; ai që ka para dhe nuk ndihmon tjetrin kur ky ka nevojë, njeri dorështrënguar.

gjëmë-a - fatkeqësi e madhe, e keqe e madhe.

xhelat-i - vrasës, mizor, ai që pret kokën e njeriut.

u regja - u mësova, u kalita.

hetim-i - zbulim, vëzhgimi me kujdes për të zbuluar diçka.

t'i shkojmë në hell - t'i mundojmë shumë, t'i vrasim në mënyrë të egër.

kanë gisht - kanë pjesë në një veprim, kanë dijen.

Mendoni dhe përgjigjuni


1. Si e jep autori gjendjen e koprracit, kur kupton se e kanë vjedhur?
2. Pse autori përdor një varg pyetjesh?
3. Si ndikojnë ato te lexuesi ose te shikuesi i komedisë?
4. Si e kuptoni shprehjen e koprracit: "Tani s'më duhet më jeta"?
5. Ç'tregon çasti kur koprraci zë krahun e tij dhe pandeh se kapi hajdutin?

MOLIERI (1622-1673)

Zhan Batist Molier është komediografi më i madh francez. Në moshën 20-vjeçare doli në skenë dhe u çmua si aktor komik. Më 1643 formoi teatrin e vet "Molier", në skenën e të cilit u luajtën me sukses komedi dhe tragjedi të ndryshme.

Ka shkruar shumë komedi, nga të cilat më të njohura janë: "Tartufi", "Mizatropi", "Koprraci", "Don Zhuani", "Borgjezi xhentëlmen", "I ligu për mend" e të tjera.

Veprat e Molierit kanë rëndësi mjaft të madhe si për letërsinë franceze ashtu edhe për letërsinë botërore. Është përkthyer në shumë gjuhë të botës. Në letërsinë shqiptare është imituar nga Çajupi, Fishta e shkrimtarë të tjerë komedish.

Tragjedia

Tragjedia është lloj i gjinisë dramatike që përfshin vepra, të cilat përshkohen nga tragjikja dhe kanë në bazë një konflikt të brendshëm ose një hero tragjik. Pra tragjedia përfundon në mënyrë të dhembshme me vdekjen e heroit. Ndër tragjeditë më të njohura janë tragjeditë e letërsisë antike, tragjeditë e Shekspirit etj.

Në letërsinë shqipe të Rilindjes Kombëtare ka pasur ndonjë përpjekje për të shkruar tragjedi, si për shembull dallohet Çajupi me tragjedinë "Burri i dheut", Mihail Grameno me "Vdekja e Piros" etj. Në letërsinë e sotme shqipe ky lloj i gjinisë dramatike është shumë pak i lëvruar.

Në vazhdim po japim një skenë nga vepra "Antigona" e Sofokliut, e cila është e llojit të gjinisë dramatike që quhet **tragjedi**.

ANTIGONA

- Skena e tretë -

Personazhet: Kori, Antigona, Kreoni, Rojtari, Ismena

KREONI

(Duke iu drejtuar Ismenës)

*Moj ti, që më thithnje fshehurazi gjakun,
strukur si nepërkë brenda në shtëpi!*

*Si nuk e kuptonja se dy veta mbanja,
dy armiq të fronit, dy armiq të mij?*



ISMENA

Në më jep kjo lejë, thom se edhe unë
asaj i ndihmova në këtë varrim;
e pra edhe unë jam bashkëfajtores.

ANTIGONA

Këtë drejtësia nuk do ta lejojë;
se as ti s'ke dashur as unë s'të mora
bashkëpunëtore.

ISMENA

Unë turp s'e quaj, kur ti ke mjerime,
të lundrojmë bashkë në det plot rreziqe.

ANTIGONA

Hadi m'ata poshtë dinë kush e bëri
punën e varrimit; unë nuk e dua,
nuk e dua mikun që vetëm me fjalë tregon
dashuri.

ISMENA

Mos, të lutem motër, mos më ler pa nder;
më lejo të vdesim që të dyja bashkë
207

e kështu dhe unë të nderoj vëllanë.

ANTIGONA

Një gjë që s'ke prekur, si qënka e jote?
S'është aspak nevojë të vdesësh dhe ti;
mjafton vdekja ime.

ISMENA

Jeta më për mua ç'shije do të ketë,
po qe se do mbetem, do të jetoj pa ty?

ANTIGONA

Pyete Kreonin; e ke kujdestar.

ISMENA

Pse më ndez me fjalë nga të cilat ti
s'ke ndonjë fitim?

ANTIGONA

Vërtet qesh me ty, porse me sa helm!

ISMENA

Thuaj: a do të mund të të jap një ndihmë,
qoft' edhe tashti?

ANTIGONA

Shpëto jetën tënde; nuk të kam zili.

ISMENA

Oh e mjera unë! Pse të mos e kem
fatin tënd dhe unë?

ANTIGONA

Ti ke zgjedhur jetën, kurse unë vdekjen.

ISMENA

Po unë të thashë ç'kisha për të thënë,

ANTIGONA

Ca të quajnë ty, ca mua të urtë.

ISMENA

Sidoqoftë fajin të dyja e kemi.

ANTIGONA

Mos u bëj merak, se ti je e gjallë,
ndërsa shpirti im ka vdekur prej kohe;
po dobi kjo vdekje të vdekurve u sjell.

KREONI

Nga këto dy vajza njëra tani çmendet;
Kurse ajo tjetra, qëkur është lindur.

ISMENA

Ndër mjerimet, mbret, mëndja nuk mbetet
ashtu siç ka mbirë, porse ikën, zhduket.

KREONI

Pa dyshim menç dole, mbasi me të liqtë
ke bërë dhe ti punëra të liga.

ISMENA

Si mund të jetoj, pa ditur këtë.

208

KREONI

A! Këtë?

Mos e zër në gojë, zëre sikur s'është.

ISMENA

Si? Mendon të vrasësh nusen e tyt' biri?

KREONI

Ka të tjerë brazda që mund të lërohen.

ISMENA

Po s'mund të ujdysin si këta të dy.

KREONI

Unë gra të liga kurrë s'marr për djemtë.

ISMENA

Emon fort i dashur! Sa të fyen yt atë!

KREONI

Shumë më mërzit ti dhe kjo martesë.

KORI

Vërtet ke vendosur t'ia rrëmbesh t'yt biri?

KREONI

Po këtë martesë Hadi do ta prishë.

KORI

U vendos, si duket, vdekja e kësaj.

KREONI

Ashtu them dhe unë! porse s'duhet zgjatur;
shpjerimi, shërbyes, brenda në pallat.

Lidhini, të lira mos i lini fare;

se edhe guximtarët mendojnë të ikin,

kur e shohin vdekjen fare pranë tyre.

(Të dy motrat i shpiejnë brënda në pallat,

(Kreoni qëndron)

Sofokliu



Fjalor

nepërkë - gjarpër helmues me kokë të shtypur në formë trekëndëshi.

mjerim - fatkeqësi.

zili - inat.

të ligj - të dobët, të këqij.

Shpjegim

Ky fragment është shkëputur nga tragjedia "Antigona" e shkrimtarit të vjetër grek, Sofokliut. Zhvillimi i subjektit bëhet me një gjallëri e qartësi që rrallë mund ta gjesh në tragjeditë e tjera.



Kreoni mundohet ta mbështesë urdhëresën e tij të rreptë mbi argumente jo të vërteta, si ato që përdorin njerëzit e kategorisë së tij, d.m.th. njerëzit krenarë dhe brutalë. Thotë me plot gojën se i thirri njerëzit nga Teba për t'u këshilluar gjoja me ta, por kjo është vetëm një maskë që përdori për ta mbuluar vendimin e tij të egër, meqë kur mblodhi Këshillin e pleqve, vendimi ishte marrë dhe urdhëresa kishte dalë.

Mendoni dhe përgjigjuni

1. Cili është personazh pozitiv në këtë tragjedi?
2. Si e gjykoni veprimin e Kreonit?
3. Si e vlerësoni veprimin e Ismenës?
4. Si përfundon fragmenti?
5. Si do ta kishit përfunduar ju këtë tragjedi?





TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> tregimin dhe ritregimin e një ngjarjeje, të një filmi, romani; përshkrimin e personazheve, objekteve, dukurive, peizazheve; shkrimin e teksteve në mënyrë të pavarur (kompozicioni: hyrja, zhvillimi, mbyllja; të shkruarit krijues, ditari). 	<ul style="list-style-type: none"> të ritregojmë përmbajtjen e një tregimi dhe romani të lexuar (me gojë dhe me shkrim), duke respektuar radhitjen e ngjarjeve në tekst; të ritregojmë përmbajtjen e një filmi të shikuar (me gojë dhe me shkrim), duke respektuar radhitjen e ngjarjeve në film; të tregojmë për një ngjarje të përjetuar ose të imagjinuar; të përshkruajmë personazhe, persona, objekte, dukuri, peizazhe nga jeta reale ose nga ilustrimet/incizimet; të shkruajmë tekst për një temë të dhënë dhe për temë sipas dëshirës, duke i respektuar rregullat e kompozicionit të tekstit; të shkruajmë në mënyrë të pavarur një tregim të shkurtër të imagjinuar me personazhe dhe ngjarje të dallueshme qartësisht; të tregojmë një përjetim personal dhe të përshkruajmë ndjenjat nga përjetimi në formë të një ditari; t'i respektojmë rregullat e drejtshkrimit gjatë përpilimit të një teksti.

Të treguarit (me shkrim dhe me gojë)

Për çdo ditë tregojmë ngjarje të ndryshme në shkollë, në familje e në shoqëri. Tregojmë diçka që dimë ne për t'i informuar të tjerët. Ka dallim ndërmjet tregimit të përditshëm apo tregimit joartistik dhe tregimit artistik.

Me tregimin joartistik rrëfejme një ngjarje të jetës së përditshme, me gjuhë të qartë e me stil të thjeshtë. Me tregimin artistik tregojmë një ngjarje të imagjinuar, por edhe nëse është e vërtetë në të ka plot imagjinatë, me plot figura e me stil të lartë.

Të treguarit mund të jetë i shkurtër ose i gjatë. Ai ka strukturë të thjeshtë: fillimin (hyrjen), trupin (pjesën qendrore, thelbin e informatave) dhe përfundimin. Kur fillojmë të tregojmë diçka, zakonisht japim shembuj apo ndonjë anekdotë që ilustron idenë. Në trupin e tregimit japim informatën kryesore, e tregojmë thelbin e ngjarjes, japim ndonjë shembull etj. Në përfundim të procesit të tregimit japim vlerësime të përgjithshme apo edhe ndonjë porosi dhe e rumbullakojmë gjithë idenë që e kishim ndërmend ta themi.

Të lexojmë

TREGIMI PA MEND

Një mbrëmje, vogëlushi Armend, iu lut gjyshit që t'i kallëzojë një tregim pa mend. Gjyshi rrudhi supet, mbeti i hutuar, por kësi tregimi - tha, nuk paskam dëgjuar.

- Si? - pyeti Armendi, po çuditëm shumë, a bën gjysh t'ia filloj unë.
- Posi - tha gjyshi, edhe shumë u gëzua, nga barra që i ngarkoi Mendi, sikur u lirua.
- Atëherë - tha Armendi, të lutem mirë dëgjo, nëse nuk është i tillë, mos e prano.
- Mirë Mendi, fillo sa më parë, për ta dëgjuar këtë tregim jam tepër kureshtar.

Pasi ca çaste Armendi mendoi, tregimin e tij kështu e filloi:

Na ishte një çun, emrin nuk ia di, por ishte tepër çapkën, nuk dëgjonte as babë, as vëlla, as motër, as nënë.

Gjyshi ngrysi vetullat, nga vendi u ngrit, - nga ishte ky çun or vëlla kaq i pacipë?

- Vandin nuk ia di - u përgjigj Mendi, as kurrë nuk e kam takuar, por se ka qenë i tillë, për këtë e kam dëgjuar.

Vazhdo më tutje, më trego, ç'bënte ai lanet? - paska qenë i çuditshëm me të vërtetë.

*- Po - tha Armendi, i çuditshëm shumë, për çdo ditë ai shkonte në lumë.
- Ç'ka të keqe këtu or vëlla? - pyeti gjyshi, unë nuk di, mos qenka lumi vetëm për të rritur e jo edhe për fëmijë.*

- Është, është, si nuk është - tha Mendi, pak i nervozuar, po pasi detyrat t'i ketë mbaruar.

- Eh, aty ke të drejtë - gjyshi pranoi dhe për të vazhduar tregimin nga Mendi kërkoi.

- Kam të drejtë, si nuk kam, të lutem prit pak, ky çun cipëplasur çdo herë kthehej me natë.

Merakosej e ëma, babai, gjyshi, gjyshja, motrat e vëllai. E jepte besën se ashtu më nuk do të vepronte, por të nesërmen të gjitha i harronte.

- S'është e mundur - tha gjyshi, besën për ta harruar, kësi çunash asnjëherë nuk kam takuar.

- Është e vërtetë, për kokë të mamit po, po deshe mos beso.

- Po mirë tha gjyshi, ja po të besoj, po tjetër ç'bënte, a mund të dëgjoj.

- Mundesh or gjysh, si nuk mundesh, unë do të tregoj, por të lutem mos më ndërpre deri sa ta mbaroj.

- Pajtohem - tha gjyshi pak i menduar, ta jap fjalën deri në fund kam për të dëgjuar.

- Ky çuni - vazhdoi Mendi, asnjëherë me kohë nuk zgjohej dhe për mësim çdo ditë vonohej.

Pastaj, detyrat rrallë i shkruante, vetëm me laps kokën e kruante. Rrugës për në shtëpi sillej shumë keq, nuk përsëndeste as fëmijë, as të rritur, as pleq. Fjalët e ndyta s'i hiqte nga goja, nuk e dinte i gjori se ç'është loja.

Këshillat e mësuesit nuk kishin ndikuar, edhe prindi kot e kishte qortuar. Prapështitë e tij nuk kishin patur të sosur, për asnjë çast me to nuk ishte ngopur. Dikush, me sytë e tij e paska shikuar, çerdhet zogjëve duke ua shkatërruar. Edhe në një kopsht tinzisht ishte futur, lulet më të mira, pa kurrfarë nevoje i kishte këputur. Tash së voni, një plak e paska zënë, xhamit të shoqës së klasës, Dritës me një guralec duke i rënë. I ati i Dritës prapa iu kishte lëshuar, e po ta kapte, kushedi puna si do të kishte mbaruar.

A nuk është ky, or gjysh, tregim pa mend, kur të gjitha veprimet e personazhit janë pa vend.

- Pajtohem - tha gjyshi, Armendin e përqafoi, për mençurinë e tij, të mira i uroi.

Riza Haziri



Ritregimi (me gojë dhe me shkrim)

Shpeshherë kemi nevojë të ritregojmë përmbajtjen e një teksti të lexuar, të një shfaqje teatrore të shikuar apo të ndonjë filmi, të ndonjë ngjarjeje të dëgjuar etj. Me anë të të ritreguarit, me fjalë tona, të tjerëve u transmetojmë atë që e kemi kuptuar gjatë të lexuarit, të shikuarit apo të dëgjuarit.

Për të ritreguar diçka që lexojmë, që shohim apo që dëgjojmë nuk është gjë e lehtë apo e thjeshtë. Duhet të kemi aftësi që me fjalët tona të tregojmë bukur dhe këndshëm për të pasur dëshirë për të na dëgjuar apo lexuar të tjerët.

Gjatë të ritreguarit gjithmonë duhet ta kemi parasysh skemën e strukturës së mëposhtme, për t'iu dhënë përgjigje këtyre pyetjeve: Ku? Kur? Kush? Çfarë? Pse? Si?

Për shembull:

- Ku dhe kur zhvillohen ngjarjet e tregimit?
- Cilat janë personazhet kryesore?
- Cilat janë personazhet ndihmëse apo ato që përmenden?
- Çfarë problemi kanë ato?
- Pse e kanë atë problem?
- Si zgjidhet problemi i tyre?

Për të bërë një ritregim të këndshëm, duhet pasur parasysh disa kërkesa paraprake:

- lexojeni disa herë tregimin, dëgjojeni ose shikojeni me vëmendje ndodhinë e ndonjë filmi;
- veçoni pjesët themelore: hyrjen, brendinë dhe përfundimin e ndodhisë;
- flisni qartë dhe mos tregoni hollësira të panevojshme, sepse të tjerët do të mërziten dhe nuk do t'ju dëgjojnë;
- flisni duke vënë në lëvizje jo vetëm mendimet tuaja, por edhe ndjesitë tuaja për ta bërë ritregimin sa më tërheqës. Mund të përdorni dhe gjestet, por mos e teproni;
- kini kujdes, ngjarjen që po ritregoni mund ta zbukuroni, por jo ta shtrembëroni vërtetësinë e saj.

Lexoni tregimin

UJKU

Isha vetëm në mes asaj lugine anës Devollit të mbuluar me dëborë. Ndoshta kishte edhe të tjerë që ecnin si unë, po as i njihja, as ndieja. Isha atëherë 13 vjeç, po kisha një trup të gjatë dhe krahë të fortë. Kthehesha në fshatin tim nga shkolla, që mbante ndonjë orë larg. Trastën e librave e kisha hedhur në qafë dhe, me opingat e lidhura me gjalmë leshi, çaja dëborën që kërciste si kripë e thatë. Kur iu afrova dy lisave të mëdhenj, ndjeva një ulërimë të largët, që i ngjante ulërimës së një qeni të llahtarshëm.

Ndala dhe zemra më rrahu. Shikova diku në kodër dhe preva për një çast frymën.

- Ujk! - thashë.

- Sytë e mi vanë në dy lisat e mëdhenj.

- Vrapo! - i thashë vetes.

- Dhe iu qepa lisave binjakë, se kisha dëgjuar që, kur derdhen në dimër ujkit, e mira e të mirave është të hipësh në ndonjë pemë për t'iu shpëtuar dhëmbëve të tyre të mprehtë.

- Shpejt!

Era frynte dhe degët e lisave të mëdhenj vërshëllenin, po tani e ndjeva veten më të siguar se atje poshtë në dëborë. Dhe, megjithëse isha lart dhe e ndjeja se asgjë e keqe nuk mund të ndodhte, m'u drodh zemra dhe dhëmbët filluan të më kërcitnin.

Poshtë meje, fare pranë, dy metra afër këmbëve, vinin verdallë pesë ujç. Dy ishin më të mëdhenj dhe tre më të vegjël, që u shëmbëllenin këlyshëve të një bushtre. Ai më i bëshmi dhe më i egri duhet të ishte i ati i tre të vegjëlve, kurse ajo më e dobëta dhe më e holla, që rrinte pranë të vegjëlve, patjetër ishte e ëma. Ujku, i ati i këlyshëve, herë pas here e ngrinte kokën nga unë dhe mua më dukej se i kërciste dhëmbët. O, sa ishte ajo koka e tij. Ajo ishte shumë më e madhe se e qenit. Balli ishte i gjerë dhe qafa e trashë e mbuluar me një lesh të murrmë, që i rrinte si një jakë e trashë.

Veshët qëndronin të ngritur lart e dukeshin sikur dëgjonin gjithçka që bëhej rreth e qark, dëgjonin edhe të rrahurat e zemrës sonë. Po sytë? Si shkëlqenin ata me një dritë si të verdhë, me një dritë të frikshme! Dy herë m'i nguli ai ata dy sy dhe ajo dritë e verdhë për pak sa m'i mori mendtë, po u mbajta.

- Mos u tremb. Ai nuk mund të ngjitet. Shtrëngohu pas degës! – i thashë vetes.

Ndërsa ujçit e vegjël hidheshin nëpër dëborë dhe luanin me t'ëmën, i ati i tyre u shtri m'u në fund të lisit, dy metra poshtë meje.

"- O ujç i paturpshëm!" - mendova unë duke u dridhur. U mata njëherë të merrja një copë dëborë, që kishte mbuluar degët e lisit e t'ia hidhja atij të paturpshmit drejt e në kurriz, po pata frikë se mos e egërsoja dhe ngriva në vend.

Kisha dëgjuar për ujçit në përralla, por me sy kurrë nuk i kisha i parë. Tani e kisha nën këmbët e mia. Ndoshta, po të mos ishte ai lisi i madh, lisi i fortë, mua do të më kishin shqyer ata.

U drodha. Tre ujçit po grindeshin me njeri-tjetrin. Ata po shqyenin trastën time dhe po hanin bukën që më kishte mbetur. Ujku i madh, i ati, vazhdonte të rrinte i shtrirë, por i shikonte me zemërim të vegjlit dhe të ëmën e tyre. Ai ndoshta nuk kishte qejf që ata të grindeshin për atë copë bukë në fund të trastës sime. Por, më shumë duhet t'i vinte inat për ulkonjën që ishte e shkujdesur dhe nuk ndërhynte t'i ndalte ata shamatanë të pabindur.

Zënkat ndërmjet tre të vegjëlve u trashën. Ata filluan të kafshonin njeri-tjetrin dhe të bënë një zhurmë, që fundja nuk mund të durohej nga babai nevrrik. Atëherë ai u hodh me një të kërcitur të dhëmbëve dhe me një ulërimë të llahtarshme i solli në vete të bijtë. Ku jemi kështu? Duhet të kemi një çikë respekt, ashtu siç i ka hije një ujku të nderuar, apo duhet të jemi për çdo gjë grindavecë? Pa fjalë. Dhe të vegjlit u larguan të heshtur e duke kthyer herë pas here prapa kryet me sy të dëshpëruar e të fyer. Ujku pastaj e hapi gojën, mori me dhëmbë trastën time, e shkundi dy-tri herë dhe mbi dëborë ranë shishja e bojës, fletorkat, librat, pena me kalem dhe copat e bukës. Ai i ndau dhe ftoi të bijtë të hanë të qetë.

Unë shikoja nga lisi. Ulkonja dhe ujku me dukeshin të ligj. Ujku, në të vërtetë nuk më pëlqente, se ai në një farë mënyre mjaft të paturpshme dhe krejt haptazi synonte të më hante mua dhe ndoshta trupin tim t'ua ndante, si atë copën e bukës, të vegjëlve të tij. Për këtë qëllim ai nuk përtonte të priste nën lis, gjersa unë të zbritja në dëborë dhe pastaj ai të më hidhej. Po mbahesha me gishtat e mi të hollë e të mpirë nga era e dimrit. Shikoja kurrizin e tij të zi me lesh të trashë, si tel me lesh të ashpër.

Po fillonte të ngrysej, po ujku vazhdonte të rrinte i shtrirë nën këmbët e mia me veshë të ngritur, duke më ndjekur.

Sipas Dritëro Agollit



Rregulla dhe këshilla

- Përpiquni ta ndani tregimin e mësipërm në pjesë dhe ta ritregoni atë sipas pikave të planit. Gjatë ritregimit duhet të keni parasysh pyetjet e mëposhtme:

- a) **Ku** dhe **kur** zhvillohen ngjarjet?
- b) **Cili** është personazhi kryesor?
- c) **Cilat** janë personazhet ndihmëse dhe personazhet kundërshtarë të personazhit kryesor?
- ç) Ç'probleme kanë personazhet?
- d) Si përpiqen t'i zgjidhin ato?
- dh) Cili është problemi kryesor në tregim dhe si zgjidhet ai në fund të tregimit?
- e) Në ç'kohë janë përdorur foljet në hyrje të tregimit. Po në përmbajtjen (zhvillimin) dhe mbylljen e tij?
- ë) Ç'mendim keni për gjuhën e tregimit?

Kur doni të ritregoni përmbajtjen e një teksti që keni lexuar, kini parasysh disa rregulla: parasysh disa rregulla:

- Lexoni dhe rilexoni pjesën me vëmendje sipas parimit: Të lexosh do të thotë të kuptosh atë që lexon. Pa e kuptuar mirë një tekst, nuk mund ta ritregosh atë;
- Ndani tekstin në pjesë dhe gjeni mendimin themelor a idenë kryesore të çdo pjese;
- Gjuha me të cilën ritregojmë të jetë e zgjedhur, e zhdërvjelltë dhe e përpiktë;
- Ngjarja kryesore e tregimit mund të shkurtohet, por jo të shtrembërohet.

Detyrë



- Vazhdojeni tregimin "Ujku" sipas përfytyrimit tuaj.
- Ritregojeni atë me shkrim.

Përshkrimi (me gojë e me shkrim)

Përshkrim do të thotë të paraqesësh disa cilësi ose veçori të një personi, të ndonjë objekti ose vendi të caktuar. Përshkrimi mund të bëhet për gjëra reale, por edhe për gjëra të imagjinuara. Gjithashtu, ne mund të bëjmë një përshkrim me gojë dhe me shkrim.

Për të bërë një përshkrim të suksesshëm na nevojitet një vëzhgim i vëmendshëm. Të vëzhgosh do të thotë të arrish të zbulosh tek objekti apo te personi gjëra të veçanta që lidhen me anën e tij të jashtme dhe të brendshme. Pas vëzhgimit na nevojiten fjalët e veçanta, të domosdoshme për të përshkruar. Përgjithësisht këto fjalë tregojnë cilësi, prandaj në përshkrim përdoret shumë mbiemri; figurat më të përdorura janë epiteti, krahasimi etj.

Teknika e përshkrimit

1. Si duhet të hartojmë një përshkrim?

- a) Përpara se të hartojmë një përshkrim, duhet të përcaktojmë përshtypjen e përgjithshme që do të krijojë objekti i përshkruar. Pas kësaj do të gjejmë elementet që do ta japin këtë përshtypje;



- b) Më pas do të mendojmë për planin e përshkrimit;
- c) Së fundi, do të përdorim fjalor të përshtatshëm dhe të saktë. (Ku zakonisht përshekruhen fytyra, sytë, goja, hunda, flokët, trupi, pra elementet që përbëjnë trupin e një qenieje).

2. Ku duhet vendosur përshkrimi?

Përshkrimi vendoset:

a) Në fillim të një tregimi:

- kur përshkruhet vendi, rrethanat ku do të fillojë veprimi. Ky vend mund të jetë, sipas rastit, një peizazh (pyll, mal, rrugë etj.) ose një mjedis i mbyllur (shtëpi, dhomë, klasë etj.).

b) Në brendësi të një tregimi:

- kur prezantohet një personazh i ri (e paraqesim duke përshkruar fizikun e tij, gjestet, qëndrimet, bëjmë pra, portretin e tij);
- kur një personazh vjen për herë të parë në një vend dhe ky vend ka rëndësi për rrjedhën e mëtejshme të veprimeve (përshkruajmë vendin: një shesh, një shkollë, një dyqan etj.);
- kur një personazh përshkon një rrugë të caktuar (p.sh. përshkruhet rruga që bën një njeri në fshat);
- së fundi, kur një personazh ndalon në një pikë vëzhgimi (në dritare, në një kodër etj.) dhe shkrimtari përshkruan pamjen që shfaqet para personazhit: rrugën, kalimtarët, ndërtesat e tjera etj.

Mbani mend

- objekte ose peizazhe: Përshkrimi i tyre varet nga rëndësia që ka secili për personazhin ose nga mundësia e përdorimit të ardhshëm të objektit (p.sh. arma e krimit në një roman policor).
- personazhe: Bëhet portreti i një njeriu. Përshkrimi varet nga roli i personazhit në tregim.
- Për të bërë një përshkrim të mirë duhet:
 - të përcaktojmë përshtypjen e përgjithshme;
 - të mendojmë për planin;
 - të kërkojmë fjalë të përshtatshme.





FSHATI IM

Sokol,

Letrën ta vonova, se të prisnim, por ti s'paske mundësi që të na vish. Kjo na dëshpëroi, jo vetëm mua me nënën e me babagjyshin, por edhe shokët. Ne të prisnim me padurim. Tani dashke të të tregoj ndonjë gjë për fshatin. Po të shkruaj, por me zemër të thyer, pse s'na erdhe.

Fshati ynë? A e di: merre me mend një liqen të bukur rrethuar me male të larta, - të bleruara dimër e verë - me dëllinja dhe me pisha të egra. Merre me mend edhe vargmalin si është Mali i Thatë yni e prej tij një fushë që shtrihet tatëpjetë e vjen e puthet me ujërat e liqenit. Merre me mend se nga kjo fushë shkapulet një siujdhesë në formë tumbë, që futet edhe më thellë në liqen. Mbi këtë tumbë mendo një fshat me ca shtëpi përdhese, me disa të tjera të reja, - aty këtu të zë syri edhe gërmadha - dhe pranë çdo shtëpie do të shohësh lëmenjtë. Ja ky është fshati ynë.

Me të vërtetë natyrën e kemi shumë të bukur edhe të gjithë miqtë, Kallamasai ynë, që na vinë, mbeten gojëhapur.

Dhe është për t'u habitur me këtë bukuri: ujërat e liqenit na rrethojnë nga të trija anët e ne jemi bërë-si të themi-shokë që në foshnjëri me këto ujra. Gjatë verës, që kur ishim të vegjël, mundoheshim të bënim not këmbëzbathur e me rrobat arna-arna; not me gjithë rroba! Kushedi sa herë i kam vajtur nënës në shtëpi laçkë nga trupi si pul'e lagur. Ajo e shkreta më rrëmbente, e në vend që të më jepte ndonjë dackë, më shtrëngonte në gji e shpejt e shpejt m'i ndrronte rrobat. Një marrëzi të tillë e bëra edhe vjet, kur isha në klasën e gjashtë: Pirros i kishte sjellë i ati një top llastiku; se gjithë me topa prej lecke luajmë. E që thua ti, më thërret Pirrua i gëzuar e vemi të luajmë te lëndina e Kosornikut. Ama është një lëndinë e bukur atje, që ka edhe dy mana degëgjera për hije, - ke edhe flladin e liqenit, - e luaj tërë ditën në mes të zhegut, dhe të mos djersitesh fare. E ne aty të vajtëm. Na erdhi edhe Vasoja, edhe Gjergji, edhe Todri. Filluam lodrën. Por do ti sa i rrash njëherë - e t'i jap një shkelmë të fortë e fërr... topi mu në mes të liqenit! Po tani? Mua sa s'më ra pika! S'mu durua: mbylla sytë e u futa mu në ujë, edhe e di si? Me gjithë rroba! Topin e shpëtova, por unë u bëra gazi i botës!

Ja kështu na gënjen liqeni, të tilla ngatërresa kemi me të. Por këto janë ngatërresa që na pëlqejnë. Le verës, por edhe dimrit me liqenin jemi miq; sidomos sivjet që bën një dimër i fortë, liqenit nuk i jemi ndarë. Më pëlqen shumë edhe kur është i zemëruar, me ato dallgët e shkumbëzuara e të tërbuara. E di ç'bëjmë ne? Vëmë në zallishtet dhe përpiqemi t'i gënjejmë dallgët? E si do të thuash? Ja kështu: kur tërhiqet dallga nga bregu - ne ashtu si jemi mbathur me opingat e ndjekim valën në thellësi; kur fryhet ajo si e zemëruar, ne rendim të largohemi. Por shpesh herë ajo na mund: se si na gënjen e sakaqë me pllas - pllus na mbushen opingat me ujë. Ne shkulemi së qeshuri! Ka edhe më keq: duke dashur që t'i largohemi sa më shpejt dallgës, pengohemi dhe bëllduf më brenda në liqen. Dallga e shkumzuar duket sikur zbardh dhëmbët me ne na kalon mbi trup dhe më betër! Sivjet mua më qëlloi dy herë një gjë e tillë. Le Pirrua: është e pamundur që të mos shtrihet sa gjatë e gjerë nja dy herë në çdo lojë.

Por fshati ynë ka bukurira të ndryshme; për këto do të shkruaj herë pas here sipas rastit. Mos harro edhe ti: dua të më shkruash më gjatë. Na përshkruaj edhe vendin e përmendores së partizanit.

Mirupafshim
Ylli

Sterjo Spasse



Fjalor

siujdhesë – gadishull.

tumbë – kodër.

gërmadha – grumbull, por edhe rrënimë.

u bëra gazi i botës – u bëra të qeshë bota me mua.

ma shkeli syrin – ma bëri me shenjë.

Detyrë



Në këtë tregim të shkurtër, personazhi, Ylli ka bërë një përshkrim të fshatit të tij. Bëje edhe ti përshkrimin e fshatit apo të qytetit tënd!

GAZETARIA

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> disa njohuri themelore mediatike; rolin e gazetarisë (lajmet, opinionet, gazetarin, gazetarinë, standardet etike, paanësinë dhe ekuilibrin). 	<ul style="list-style-type: none"> të tregojmë shembuj të përmbajtjeve informative dhe shembuj të përmbajtjeve ku jepen opinione; të shpjegojmë rolin e gazetarisë në shoqëri; të shpjegojmë rëndësinë e paanësisë dhe të ekuilibrit si standarde etike.

Gazetaria (publicistika) përfshin veprimtarinë e prodhimit dhe të shpërndarjes së raporteve për ngjarjet e fundit apo të ditës. Themi: *Dega e gazetarisë. Merret me gazetari. Studion për gazetari. Punon në fushën e gazetarisë.* Mediat gazetareske përfshijnë shtypin, televizionin, radion; tani edhe internetin.

Gazetar/e është punonjës/e i/e një gazete ose i një reviste, që shkruan artikuj për shtypin apo përgatit programe për radion ose televizionin. Themi: *Gazetar i aftë (i mirë, i zotë, me përvojë). Gazetarët shqiptarë. Gazetar i huaj. Klubi i gazetarëve. Foli përpara gazetarëve.*

Pra, gazetár/-i/-ja është person që mbledh informacion në formë të shkruar, të folur ose fotografi, i përpunon ato dhe ia shpërndan publikut. Veprimtaria që kryen gazetari quhet **gazetari**.

Lajmet janë njoftime për ngjarje të rëndësishme të ditës, që japin agjencitë telegrafike, gazetatat dhe radioja e televizioni. P.sh., themi: *Lajme politike (ekonomike, kulturore). Lajmet e fundit. Lajme të shkurtra. Lajmet e ditës (e mbrëmjes). Agjencia e lajmeve. Emisioni i lajmeve. Faqja (shtyllat) e lajmeve (në një gazetë). Lexoj (dëgjoj) lajmet. Po jepen lajmet.*



Me fjalë të tjera, lajmi është riprodhim me fakte i një ngjarjeje që realizohet duke u përgjigjur pyetjeve: *Kush?, Kur?, Ku?, Çfarë?. Kush?, Kur?, Ku?, Çfarë?*.

Ai është një komunikim i shkurtër, i qartë dhe faktik që në mënyrë skematike mund të paraqitet kështu:



Lajmet zënë një vend të rëndësishëm në mjetet e informimit publik, si në ato të shkruara, ashtu edhe në ato elektronike (radio, televizion, gazetë etj.).

Në mjetet e informimit publik shpeshherë jepen edhe opinione. **Opinion** është mendim që kemi formuar për dikë a për diçka, gjykimi e vlerësimi ynë për të; bindja se dikush a diçka është ashtu si e njohim ose si e mendojmë. *Opinion i mirë (i keq). Kam opinion të mirë për të. Shpreh opinionin tim.*

Shtypi (gazetat), i kushtohen aktualitetit të përditshëm, lexohen nga masa e gjerë popullore me shkallë të ndryshme arsimimi. Gazetaria ditë për ditë e paraqet me shkrim rrjedhën e ngjarjeve në vend dhe në botë.

Gazetarët duhet të punojnë me **standarde etike**. Ndër standardet etike më të rëndësishme janë:

- Gazetarët duhet të sigurojnë informacione të sakta, të dëshmuara e jo të rreme;
- Gazetarët duhet të jenë të ndershëm dhe të shmangin spekulimet e pabaza;
- Gazetarët nuk guxojnë ta orientojnë publikun në kahe të gabuara;
- Gabimet duhet të pranohen dhe të korrigjohen sa më shpejt që është e mundur, në mënyrë të qartë dhe përkatëse;
- Ata duhet të kenë qëndrim të drejtë e të paanshëm;
- Duhet të gjykojnë e të veprojnë në mënyrë të matur, të peshuar mirë.



Shpikja e radios, televizorit dhe kompjuterit kanë hapur rrugë të reja për të mësuar. Këto janë mjete të mira, jo vetëm për të kaluar kohën e lirë, por edhe për të mësuar gjëra të reja. Në to mund të ndiqen emisione të ndryshme, si emisione për fëmijë, filma të vizatuar, muzikë, filma dokumentarë, emisione shkencore, filma artistikë, lojëra sportive, lajme etj.

Radioja për një periudhë ka qenë gazetari e folur. Emisionet përgatiteshin me shkrim dhe lexoheshin. Të folurit në radio ka ushtruar ndikim për përhapjen e gjuhës letrare.

Roli i radios u ndryshua me depërtimin e gjerë të televizionit. Televizioni në fillim lindi si gazetari pamore, e filmuar. Folësit lexonin tekstin, lënda ishte e njëjtë me gazetatat dhe radion.

Roli i medias është jo vetëm për të informuar dhe argëtuar publikun e gjerë, por edhe për t'i dhënë vend edukimit dhe ruajtjes së vlerave etike e morale.

Qëllim tjetër kanë përparimin e shoqërisë dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Detyrim i tyre është ta nxisin, ta përforcojnë dhe ta mbrojnë lirinë e shprehjes dhe lirinë e informimit.



Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet një komplet prej 8 kartash me tekste të shkurtra publicistike (të trilluara ose të marra) me një autor të emërtuar (i trilluar ose real). Tri nga tekstet duhet të jenë me përmbajtje informative, kurse pesë me përmbajtje ku jepet opinion dhe secili tekst duhet të jetë për temë të ndryshme (p.sh. shëndeti, kultura, sporti, korrupsioni, mbrojtja e mjedisit):

Shembuj të teksteve informative:

Rezultatet e çerekfinales së Kampionatit Botëror të Futbollit; Informacion për vendet e lira për regjistrim në shkollat e mesme; Pasqyrë e aksidenteve të trafikut, në të cilat kanë humbur jetën këmbësorët gjatë vitit të kaluar.

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)

Shembuj të teksteve ku jepet opinion:

Si të bëhen gratë më të përfaqësuar në qeverisje; Si të ushqehemi në mënyrën e duhur për të qenë të shëndetshëm; Të pastrehët u bënë edhe realiteti ynë; Shkupi sërish ndër qytetet më të ndotura në botë: Çfarë mendojnë qytetarët për këtë?; Kush vuan më shumë nga bullizmi – djemtë apo vajzat?

Në të njëjtën kohë, duhet pasur kujdes që tekstet të jenë të paanshme/objektive (t'i përjashtojnë paragjykimet e gazetarëve), kurse ato që shprehin opinion të jenë edhe të ekuilibruar (t'i përmbajnë qëndrimet/argumentet e njerëzve me pikëpamje të ndryshme në lidhje me çështjen/problemin).

Grupeve u jepet për detyrë t'i analizojnë tekstet dhe t'i grupojnë ato sipas faktit nëse ato përmbajnë vetëm informacion ose, përveç informacionit përcjellin edhe një opinion (mendim). Pasi të bëjnë prezantimin e përgjigjeve, hapet një diskutim rreth dallimit mes përmbajtjeve informative dhe përmbajtjeve që shprehin opinion. Në bazë të diskutimit, arrihet përfundimi se cilat janë përgjigjet e sakta të pritura (veçanërisht e rëndësishme nëse ndonjë grup nuk i ka ndarë tekstet saktë).

Kartelat e njëjta përdoren për t'u identifikuar autorët e teksteve dhe për të treguar se ata janë gazetarë dhe se tekstet janë artikuj gazetaresk që gjenden ose mund të gjenden në media (elektronike ose të shkruara).



Grupeve u jepen nga dy kartela me tekste (kombinime të ndryshme për secilin grup) me detyrë t'i analizojnë ato në aspektin:

- (1) çfarë informacioni ose problemi përfshijnë,
- (2) si e ndihmojnë lexuesin ose ndikojnë tek ai, dhe
- (3) si ato mund të kontribuojnë në jetën e përditshme të njerëzve ose në zgjidhjen e problemeve në shoqëri.

Pasi nxënësit do t'i prezantojnë rezultatet e analizës, diskutohet bashkërisht roli i gazetarëve dhe rëndësia e gazetarisë për jetën e përditshme të njerëzve dhe për demokracinë në shoqëri.



Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Mësimdhënës-i/ja përdor një nga tekstet që shprehin opinion për të treguar se çfarë nënkuptohet me raportimin gazetaresk të paanshëm (objektiv) dhe të ekuilibruar. Më pas, secili grup merr një tekst me detyrë për ta kthyer atë në një tekst të njëanshëm dhe të paekuilibruar. Pastaj grupet i lexojnë tekstet "e reja" dhe në fund diskutohet se cilat janë pasojat e raportimit të njëanshëm dhe të paekuilibruar dhe pse është e rëndësishme që të gjithë artikujt gazetaresk të ndjekin kërkesat për raportim të paanshëm dhe të ekuilibruar.



Bashkë me mësimdhënësin tuaj bëni një vizitë mësimore në ndonjë redaksi gazete. Kërkoni nga përgjegjësi t'u njoftojë me procesin e punës.



LIRIA E SHPREHJES DHE SJELLJA ETIKE NË MJEDISIN DIGJITAL

Do të mësojmë për:	Do të dimë:
<ul style="list-style-type: none"> • lirinë e shprehjes dhe sjelljen etike në mjedisin digjital (fyerjet dhe shpifjet personale, respektimi i privatësisë). 	<ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojmë rëndësinë e shprehjes së lirë gjatë krijimit dhe ndarjes së përmbajtjeve mediatike; • të njohim fyerjet dhe shpifjet personale në komunikimin online; • të shpjegojmë (me shembuj) se çfarë do të thotë të mbrosh privatësinë në hapësirën digjitale; • të njohim shkeljen e të drejtës së privatësisë në komunikimin online; • të shpjegojmë pasojat e sjelljes joetike në mjedisin digjital.

Nuk lejohen fyerjet e shpifjet në media

Mediat duhet ta paraqesin botën ashtu siç është, në mënyrë reale. Ato janë të detyruara që të balancojnë midis të drejtës të publikojnë përmbajtje të reja dhe përgjegjësisë për mbrojtjen e të tjerëve nga shpifjet dhe fyerjet. Mediat dhe gazetarët duhet të jenë të kujdesshëm ndaj publikut, veçanërisht në përmbajtjet që kanë të bëjnë me fëmijët.

Me përmbajtje fyese nënkuptohet të folurit ofendues, dhuna, nënçmimi, shqetësimi, cenimi i dinjitetit njerëzor, diskriminimi gjuhësor, diskriminimi në bazë të moshës, invaliditetit, gjinisë, racës, religjionit etj.

Shpifjet janë fjalë të pavërteta, të rreme, trillime, gjëra të paqena që thuhet me qëllim për të përlyer nderin a emrin e mirë të dikujt, për t'i ngarkuar një faj që nuk e ka bërë, për të njollosur diçka ose për synime të tjera të pandershme; përhapja e fjalëve a e trillimeve të tilla.



Respektimi i privatësisë

E drejta e privatësisë do të thotë e drejtë e qytetarëve të lihen të qetë, ose e drejtë për të pasur kontroll ndaj publikimit të padëshiruar të të dhënave personale. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare, të drejtën e banimit, të shëndetit, përfshi këtu edhe komunikimin digjital.

Mediat kanë për detyrë ta respektojnë privatësinë dhe të mos e shkelin atë. Mediat janë të detyruara të respektojnë dhe mbrojnë privatësinë, dinjitetin, autoritetin dhe nderin e individit.



Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin këtë detyrë:

Secili nga grupi duhet të imagjinojë se në ndonjë rrjet social (*Facebook, Instagram, TikTok...*) ka publikuar një *selfie*. Në një fletë të përbashkët secili nxënës i grupit shkruan nga një koment që ai/ajo do të dëshironte ta merrte nën *selfie*-n e postuar (p.sh.: *Ti je shumë tërheqëse; Dukesh TOP; Model i vërtetë!; Super tip*). Më pas fletët vendosen në mur dhe lexohen komentet e të gjithëve. Nxënësit bashkërisht vijnë në përfundim se **të gjithë duan të marrin komente pozitive**.

Grupeve u jepet detyrë që në një fletë tjetër të shkruajnë komente negative, të cilat nën *selfie*-n e tij/saj do t'i kishin postuar disa të tjerë kur duan ta fyejnë atë (p.sh.: *Dukesh si dinosaur; Dukesh si thes!; Shih si dukesh bre!*).

Fletët vendosen në mur dhe lexohen komentet e shkruara. Diskutohet se çfarë ndjenjash shkaktjnë komentet e këtilla te personi, të cilit i thuhet.



Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Grupeve u jepet për detyrë të imagjinojnë një situatë në të cilën dikush e shkarkon *selfie*-n e publikuar dhe e ndan atë me dikë tjetër dhe nën imazhin e shkarkuar publikon edhe një koment në formën e shpifjes - gënjeshtër për dikë me synim për ta baltosur, për t'ia dëmtuar reputacionin (p.sh.: *Ky është hajduti i garderobave në orët e edukimit fizik*).

Në një fletë të veçantë, secili anëtar i grupit shkruan një koment në formë shpifjeje. Më pas fletët vendosen në mur dhe lexohen komentet e të gjithëve. Të gjithë së bashku i diskutojnë pyetjet:

- (1) Cilat janë pasojat për personin, për të cilin është shpifur?
- (2) Si është shkelur privatësia e tij edhe atëherë kur emri i tij nuk është publikuar?
- (3) Sa etike është të ofendosh të tjerët dhe të shpifësh për ta përmes rrjeteve sociale?

Bashkërisht arrihet në përfundimin se secili ka përgjegjësi të veprave në mënyrë etike njësoj si në realitet - shpifja dhe fyerja në rrjetet sociale është sjellje e dhunshme, edhe pse personi që shpif dhe fyen "nuk shihet".

Secili grup jep propozime për sjellje etike në rrjetet sociale – çfarë duhet, përkatësisht nuk duhet të bëhet (për shembull, *Mos i ofendo dhe nënçmo të tjerët. Mos përdor fjalë fyese dhe të pahijshme kur komenton fotot dhe postimet e të tjerëve. Mos zbuloj informacione private për të tjerët. Mos (shpër)ndaj foto dhe informacione për të tjerët pa lejen e tyre.*).

Nga rekomandimet e dhëna përpilohet bashkërisht një kod i sjelljes në rrjetet sociale.



Bashkë me mësuesin tuaj bëni një vizitë mësimore në ndonjë televizion në qytetin tuaj. Kërkoni nga përgjegjësi t'u njoftojë me procesin e punës.

Gjuha e urrejtjes

Ne duhet të jemi shumë humanë e tolerantë. Duhet t'i duam të gjithë njerëzit, pavarësisht se cilit komb i përkasin, çfarë besimi fetar kanë, çfarë gjuhe flasin, çfarë gjinie kanë, janë të pasur apo të varfër, të gjatë apo të shkurtër etj.

Asnjëherë nuk duhet të flasim keq për të tjerët, as të fyejmë, as të përqeshim e as të urrejmë askënd. Pra, bota është shumë e larmishme dhe ne duhet të pranojmë këtë larmi njerëzish me pozitivitet. Nëse jemi të njerëzishëm, kurrë nuk do të përdorim as gjuhën e urrejtjes.

Gjuha e urrejtjes është problem i gjithë njerëzimit. Fatkeqësisht, jo rrallë dëgjojmë edhe fyerje, sharje, kërcënime, dhunë e shprehje të urrejtjes ndaj tjetrit. Gjuhën e urrejtjes shpeshherë e gjejmë në media. Kjo gjuhë e shëmtuar po përdoret shumë sidomos në rrjetet sociale.

Mbrojtja e fëmijëve nga rreziqet e rrjeteve sociale

Mbrojtja e fëmijëve dhe e të rinjve nga mashtrimet, joshjet, kërcënimet, rreziqet dhe gjuha e urrejtjes është përgjegjësi e përbashkët e të gjithëve. Çdo fëmijë duhet të kujdeset të mos bëhet viktimë e këtyre keqpërdorimeve që bëhen në rrjetet sociale, pra ta ruajë vetveten. Por, për sigurinë e tyre duhet të kujdesen edhe prindërit, shkolla si dhe gjithë shoqëria.

Nxitja ose shprehja e urrejtjes racore, etnike, gjuhësore, gjinore, fetare jo vetëm që është jonjerëzore, por dënohet me burgim shumëvjeçar.

As gazetari nuk duhet të çenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk do të përdorë gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë ose diskriminim mbi çfarëdo lloj baze qoftë (kombëtare, fetare, racore, gjinore, shoqërore, gjuhësore, politike etj.).

Si të pakësojmë gjuhën e urrejtjes?

Gjuhën e urrejtjes nuk duhet ta përdorim as në jetën e përditshme, as në mjetet e informimit e as në rrjetet sociale. Askush nuk duhet të përdorë gjuhën e urrejtjes dhe nuk duhet të ushtrojë dhunë ose diskriminim kombëtar, fetar, racor, gjinor, shoqëror, gjuhësor, politik etj.



Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Nxënësit, të ndarë në 5 grupe, tërheqin një nga kompletet e kartave në të cilat shkruhet (një nocion në secilën kartelë):

- RACA (të bardhë, zezakë e të tjerë);
- GJINIA (djalë, vajzë, grua, burrë);
- PROFESIONI (policë, mjekë, mësues e të tjerë);
- MOSHA (të moshuar, të rinj, adoleshentë);
- FAMILJA (bijë, bir, nënë, baba, gjyshe, gjysh).

Secili grup, në një fletë të madhe letre, duhet të përshkruajë (me fjalë dhe me një vizatim) se si njerëzit nga karta e zgjedhur janë paraqitur në media (në filma, seriale, reklama) - *si duken, si sillen dhe çfarë cilësish kanë.*

Në një fletë tjetër, ata duhet të japin edhe shembuj të mediave ku i kanë parë këto (në cilin film, serial apo reklamë).

Pas përfundimit të punës, secili grup (një nga një) i var në mur fletët e veta me përshkrimet e shembujt dhe ua prezanton punën e vet të tjerëve.

Pas çdo prezantimi, nxënësit e grupeve të tjera bëjnë plotësime me shembujt e tyre dhe së bashku përfundohet se cili është përshkrimi që dominon në media. Mësimdhënës-i/ja i shkruan në tabelë të gjitha përshkrimet e dhëna që përputhen me stereotipet e zakonshme për grupet (p.sh.: *Zezakët janë kriminelë, shesin drogë... Gjyshet janë të kujdesshme, bëjnë byrek, nuk i kushtojnë shumë rëndësi pamjes së vet... Djemtë janë të guximshëm, të fortë, nuk qajnë.*)



Mësimdhënës-i/ja i përdor përshkrimet e shkruara në tabelë për ta përkufizuar termin **stereotip** (një karakteristikë që u atribuohet anëtarëve të grupeve të caktuara) dhe për t'i treguar llojet e stereotipeve që janë përcaktuar nga grupet të cilave u referohen (stereotipe racore, gjinore, profesionale, të moshës). Përshkrimet e anëtarëve të familjes lidhen me stereotipet gjinore dhe të moshës.

Brenda çdo grupi, secili nxënës duhet të japë shembull të një personi konkret që ai e njeh, por që është i ndryshëm nga stereotipi dhe t'i tregojë karakteristikat e tij/saj që e bëjnë atë të dallohet (të jetë i ndryshëm) nga stereotipi.

Grupet i prezantojnë shembujt e tyre. Në një diskutim të hapur, arrihet në përfundimin se media kryesisht na bën që të gjithë anëtarët e një grupi t'i shohim sikur janë të njëjtë (sipas stereotipit), edhe pse shumë prej tyre ndryshojnë nga stereotipi.

Aktivitet ndërveprues (interaktiv)



Zhvillohet diskutim i hapur për të shpjeguar se si stereotipet gjinore në media transmetohen edhe në rrjetet sociale:

- (1) Sa ndihet i lirë dikush (djalë apo vajzë) që është i ndryshëm nga stereotipi të prezantohet në këndvështrimin e duhur?;
- (2) Si do të reagonin të tjerët në qoftë se ai/ajo paraqitet në një këndvështrim tjetër;
- (3) Cilat janë pasojat e kësaj? Së bashku konstatohen pasojat negative të përhapjes së stereotipeve gjinore dhe të llojeve të tjera përmes mediave dhe rrjeteve sociale.

Grupeve u kërkohet të përgatisin një paralajmërim që do të vendoset përpara filmit, serialit ose reklamës që nxit stereotipe për një grup të caktuar, sipas parimit të paralajmërimit për cigaren: *Duhani vret* - të krijojnë një fjali goditëse që tregon për pasojën e pranisë së stereotipit konkret.



